

Dr. Majlinda Ziu

LIBËR PËR MËSUESIN
Gjeografia 11

BOTIME



Përmbajtje

HYRJE	5
ÇFARË NA ORIENTON PROGRAMI I GJEOGRAFISË 11	6
MODELE TË PLANIFIKIMIT VJETOR DHE 3-MUJOR	14
MODELE TË PLANIFIKIMIT TREMUJOR	17
DISA MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR (MODELE SKEMATIKE)	61
MODELE TESTESH SIPAS TREMUJORËVE	291

Mësues të dashur!

Ky libër mësuesi ju vjen në ndihmë në punën tuaj të përditshme, me anë të planifikimeve dhe udhëzimeve që ofron. Udhëzimet e tij bazohen në programin e IZHA-s, miratuar nga MAS-i. Libri i mësuesit, ashtu si edhe vetë teksti mësimor dhe harta skicë për nxënësit, janë hartuar në frymën e të nxënësve me kompetenca. Ju do t'i orientoni nxënësit tuaj drejt krijimit të kompetencave, drejt punës kërkimore, gjetjes dhe zgjidhjes së situatave problemore.

Përveç udhëzimeve që të ofron dhe të detyron programi mësimor, në këtë libër sugjerohen planifikimet vjetore, 3-mujore dhe ditore. Ju mund t'i përmbaheni atyre planifikimeve, por jeni të lirë të bëni planifikimet tuaja, në përputhje me kërkesat dhe nivelin e nxënësve tuaj.

Mirëpresim çdo këshillë dhe mendim nga ju.

Ju uroj punë të mbarë!
Autorja

I. Çfarë na orienton programi i Gjeografisë 11


(Bazuar në programin e hartuar nga IZHA, shkurt 2016)

I.1. Qëllimet e programit

Programi i gjeografisë për shkallën e 5-të synon që nxënësi:

- të zhvillojë dijet për dukuritë gjeografike, fizike dhe humane, në shkallë të ndryshme, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
- të zhvillojë kuptimin për ligjet e përgjithshme të gjeosistemit dhe të veprojë në përputhje me to për zgjidhjen e problemeve gjeografike të jetës së përditshme;
- të zhvillojë interesin dhe respektin për vendin ku jeton, për vende të tjera, për njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë;
- të kuptojë mundësitë dhe sfidat e ndërvarësisë globale;
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik;
- të edukohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.

Korniza konceptuale e programit



1.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës /lëndës

Mësuesi duhet të mbajë parasysh lidhjen e **kompetencave kyçe me kompetencat e fushës**. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme që i shërbejnë procesit të të nxënimit. **Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet të fitojë gjatë procesit të nxënies.**

- **Kompetenca qytetare**

Programi i gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare. Përmes kërkimit gjeografik për çështje të tilla, si ndërvarësia, shfrytëzimi i burimeve natyrore, qëndrueshmëria mjedisore në nivel lokal e global etj., nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe të marrë vendime që ndihmojnë në zhvillimin e tij si individ.

- **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit**

Programi i gjeografisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe të kuptojë se si gjuha mund të përdoret për të manipuluar të nxënimit. Përmes diskutimeve, debateve apo prezantimeve të punimeve e detyrave që ndërmerret, nxënësi zhvillon shkathtësi të të shprehurit, zhvillon dhe përdor në mënyrë progresive fjalorin gjeografik për të komunikuar idetë në mjedise të ndryshme.

- **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai zhvillon shkathtësi për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues e të zhvillojë imagjinatën përmes veprimtarive në klasë dhe vëzhgimeve në terren. Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathtësive matematikore për kryerjen e analizave statistikore, ndërtimin e grafikëve, tabelave, llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, të tilla si: shkalla, largësia, koordinatat, projeksionet.

• **Kompetenca e të nxënit**

Në procesin e kërkimit gjeografik nxënësi zhvillon kompetencën e të nxënit. Programi mundëson që nxënësi të shfrytëzojë në mënyrë efektive përvojat paraprake për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe realizimin e veprimtarive; të parashtojë pyetje për çështje të ndryshme dhe të organizojë mendimet për të gjetur përgjigje për një situatë/problem të caktuar gjeografik. Nxënësi aftësohet të paraqesë/skicojë idetë e tij për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarive duke e argumentuar para të tjerëve. Për këtë, shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare.

• **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësit vlerësojnë rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme, zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, analizojnë elementë të situatës, kompleksitetin e saj, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.

• **Kompetenca personale**

Programi i gjeografisë nxit të nxënit bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive, shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

• **Kompetenca digjitale**

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për proceset e dukuritë gjeografike, për vendin e tij, vendet e tjera në botë dhe marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë në shkallën V.

SHKALLA V

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

Nxënësi:

- shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material gjeografik (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim);
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, *e-mail* (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;
- prezanton një projekt, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar gjeografike duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)**Nxënësi:**

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse;
- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative;
- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje duke u bazuar në njohuritë paraprake, prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve.
- krijon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

Kompetenca e të nxënës (Nxënësi mëson për të nxënë)**Nxënësi:**

- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose veprimtarie në lëndën e gjeografisë, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyrë të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënës për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme;
- në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënës;
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, me qëllim të vetëvlerësimit të përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohej prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatit e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh., burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë etj.).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit etj.);
- hulumton dhe analizon forma të ndryshme të sipërmarrjes për mundësi të orientimit për karrierën, si dhe për të kontribuar në të mirë të komunitetit;
- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore apo në veprimtari për jetë, për punë dhe për mjedis duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit si dhe kohën, rreziqet dhe buxhetin në dispozicion;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicicion zgjidhje konkrete.

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, lokal dhe shtetëror) duke treguar tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në aktivitete të jetës së përditshme në shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet, propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të shprehurit, paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh të ndryshme;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara.

I.3 Kompetencat e lëndës dhe nëntematikat e saj

Programi i gjeografisë (i shkallës së pestë) zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

- *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike*
- *Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit*
- *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur*

SHKALLA V

Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi:

- përcakton një çështje gjeografike për kërkim/hetim;
- formulon pyetje ose jep shpjegim, zgjidhje ose opinion duke përcaktuar disa aspekte thelbësore të çështjes;
- përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe dukurive gjeografike që ndodhin në vende dhe rajone të ndryshme.

Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- përdor burime informacioni që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre;
- zgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore dhe dytësore në dispozicion;
- përcakton metodat, strategjitë ose teknikat e përshtatshme;
- komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

- jep shpjegime në lidhje me çështjen gjeografike të marrë në shqyrtim;
- identifikon pasojat që mund të shoqërojnë zgjidhjen e çështjes;
- identifikon rrugë të ndryshme të veprimt;
- përdor pyetje për të reflektuar në çdo fazë të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”.

Gjeografia e klasës së 11-të zhvillohet në 72 orë mësimore. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet dhe testimet. Mësuesit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës dhe janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë dhe nëntematikë.

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Ndërvlerësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve. (72 orë)	Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal.	4
	Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare.	10
	Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.	9
	Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.	10
	Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.	35
	Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale.	4

1.4 Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi gjatë procesit të të nxënit:

Nxënësi - aktiv dhe i interesuar. Në gjeografi, nxënësi studion dukuritë dhe proceset gjeografike, ndërton kuptimin për vendin e tij. Ai inkurajohet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe, duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi angazhohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij; bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij. Ai punon individualisht ose në grup, dhe mbështetet nga mësuesi.

Nxënësi si partner. Partneriteti i mësuesit me nxënësin në mësimdhënie rrit motivimin dhe e bën mësimdhënien më tërheqëse, duke krijuar kushte që ajo të jetë e suksesshme;

Mësuesi - udhëheqës dhe lehtësues. Mësuesi i gjeografisë ndihmon nxënësit të zbulojnë kënaqësitë e të nxënit. Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai moderon kërkimin dhe eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesit veprojnë si moderatorë midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ato krijojnë kontekste të nxëni të cilat i aftësojnë nxënësit të përftojnë mjetet e gjeografisë. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxënit të nxënësve. Ai i angazhon nxënësit në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.


1.5 Çfarë situata duhet të përdoren në funksion të të nxënit

- Situatat e të nxënit në gjeografi **duhet të jenë të larmishme dhe komplekse**. Nxënësi duhet të perceptojë lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme.
- Situatat **duhet të jenë të hapura**, që do të thotë që nxënësi aftësohet të kërkojë zgjidhje të ndryshme për një çështje apo problem, dhe jo një zgjidhje të vetme apo një përgjigje të vetme. Situata të tilla përfshijnë detyra të ndryshme, favorizojnë përdorimin e mediave të ndryshme dhe rezultojnë me punime të llojeve të ndryshme.

- Situatat e të nxënësve **duhet të jenë komplekse**, që do të thotë të përdoren burime të ndryshme të të nxënësve dhe nxënësve të punojnë së bashku. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxënësve. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijesë.

1.6 Si vlerëson mësuesi?

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësve) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara (skema e mëposhtme).




Përdorimi i portofolit, si një koleksion sistematik i punës së nxënësve, siguron një tablo të plotë të zhvillimit e të progresit të nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai u afron nxënësve gjithashtu mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

1.7 Çfarë vlerësohet?

Vlerësimi për të nxënë	Vlerësimi i të nxënësve
<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i vazhduar Vlerësimi me test/detyrë Vlerësimi i portofolit të nxënësve 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi periodik Vlerësimi përfundimtar

1.8 Çfarë përfshin secili prej vlerësimeve? Çfarë vlerësohet në notën semestrale dhe atë vjetore?



II. Modele të planifikimit vjetor dhe 3-mujor

II.1 Modeli i planifikimit vjetor

PLANI MËSIMOR VJETOR

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: GJEOGRAFI 11

TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	SHTATOR – DHJETOR (26 ORË)	JANAR – MARS (24 ORË)	PRILL – QERSHOR (22 ORË)
Tematika: Ndërvlerësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve (72 orë) - Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal.	Nëntematika: Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal (4 orë është bërë 3 orë)	Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë (10 orë) (vazhdim).	Nëntematika V: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë (vazhdim)
	1. Rajoni dhe llojet e rajoneve	1. Migrimet e popullsisë shqiptare. Shkaqet dhe pasojat e tyre	1. Popullsia, trashëgimia kulturore dhe ekonomia e Nënrajonit Verilindor
	2. Ndërvlerësia rajonale	2. Struktura e vendbanimeve në Shqipëri	2. Disa nga njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor
	3. Kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë	3. Potencialet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe veçoritë e tij	3. Disa nga njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor (vazhdim)
	Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare (10 orë)	4. Ekonomia e Republikës së Shqipërisë	4. Njësitë e tjera përbërëse të Nënrajonit Verilindor
	4. Pozita gjeografike e Rajonit të	5. Përsëritje 2 (Popullsia dhe	5. Punë Praktike Nr 2 Tema: Rajoni

- Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare.	Evropës dhe veçoritë natyrore të saj	ekonomia e Republikës së Shqipërisë)	Verior dhe Verilindor i Republikës së Shqipërisë
	5. Tiparet kryesore të kulturës, popullsisë dhe ekonomisë së Evropës	6. Testim 2	6. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Juglindor
	6. Hapësira shqiptare në Evropën Juglindore dhe në Mesdhe	7. Projekt 1. ora e dytë: Pasuria e madhe natyrore, humane dhe kulturore e Shqipërisë, zhvillimi ekonomik dhe perspektiva e saj drejt integritetit evropian.	7. Njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor
	7. Ndryshimet e hartës politike të trevave shqiptare përgjatë shekujve	Nëntematika V: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë (35 orë)	8. Popullsia e Rajonit Juglindor
	8. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Kosovës	8. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Perëndimor	9. Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Juglindor dhe ekonomia e tij
	9. Popullsia e Kosovës dhe trashëgimia kulturore e saj	9. Njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor	
	10. Ekonomia e Republikës së Kosovës	10. Popullimi në Rajonin Perëndimor	10. Punë Praktike Nr 3 Tema: Rajoni Juglindor i Republikës së Shqipërisë
	11. Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë	11.Struktura e popullsisë dhe veçoritë e vendbanimeve në Rajonin Perëndimor	11. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Jugor
	12.Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë (vazhdim)	12. Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Perëndimor	12. Njësitë e Rajonit Jugor
	13. Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë. Organizimin administrativo-territorial i saj	13. Ekonomia bujqësore në Rajonin Perëndimor	
	Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë (9 është bërë 10 orë)	14. Industria në Rajonin Perëndimor	13. Popullsia e Rajonit Jugor
	14. Larmia e peizazheve të Shqipërisë dhe ndërtimi gjeologjik i saj	15. Sektori i tretë i ekonomisë në Rajonin Perëndimor	14. Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Jugor dhe ekonomia e tij
	15. Pasuritë minerare të truallit shqiptar	16. Punë Praktike Nr 1 Tema: Rajoni Perëndimor	15. Punë Praktike Nr 4 Tema: Rajoni Jugor i Republikës së Shqipërisë
	16. Relievi i Shqipërisë	17. Pozita gjeografike e Rajonit Verior	16. Projekt 2. ora e parë: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.
	Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		

		e Verilindor dhe disa veçori të përgjithshme të tij	Pabarazia dhe mundësitë e zhvillimit rajonal.
17. Klima e Shqipërisë	18. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Alpeve Shqiptare	18. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Alpeve Shqiptare	17. Përsëritje 4 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë (Rajoni Verilindor, Juglindor dhe Jugor i Shqipërisë)
18. Hidrografia e Shqipërisë	19. Njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe veçoritë e tyre	19. Njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe veçoritë e tyre	18. Testim 2
19. Llojet e tokave dhe faktorët e formimit të tyre	20. Tiparet kryesore të popullimit në Alpet Shqiptare	20. Tiparet kryesore të popullimit në Alpet Shqiptare	Nëntematika VI: Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale
20. Bota bimore dhe shtazore në Shqipëri	21. Trashëgimia natyrore e kulturore e Alpeve Shqiptare dhe ekonomia e tyre	21. Trashëgimia natyrore e kulturore e Alpeve Shqiptare dhe ekonomia e tyre	19. Pabarazia e zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit dhe treguesit e saj
21. Trashëgimia natyrore e vendit tonë dhe problemet e mjedisit	22. Përsëritje 3 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë (Rajoni Perëndimor dhe Alpet Shqiptare)	22. Përsëritje 3 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë (Rajoni Perëndimor dhe Alpet Shqiptare)	20. Faktorët dhe pasojat e pabarazisë së zhvillimit të rajoneve
22. Përsëritje 1 (Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë)	23. Testim 3	23. Testim 3	21. Projekt 2. ora e dytë: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale.
23. Testim 1			
Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë (10 orë)	24. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Nënrajonit Verilindor	24. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Nënrajonit Verilindor	22. Projekt 2. ora e tretë: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale
24. Popullimi dhe ndryshimet demografike në Shqipëri			
25. Shpërndarja e popullsisë dhe struktura e saj			
26. Projekt 1. ora e parë: Pasuria e madhe natyrore, humane dhe kulturore e Shqipërisë, zhvillimi ekonomik dhe perspektiva e saj drejt integritetit evropian.			

II.2 Modele të planifikimit tremujor

PLANI 3 MUJOR (SHTATOR-DHJETOR -26 orë)

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: GJEOGRAFI 11

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

- Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim mbi kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe llojet e ndryshme të rajoneve.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim (duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm) kuptimin mbi: konceptin e sotëm evropian mbi rajonin në frymën e respektimit të diversitetit dhe të ndërveprimit rajonal; zhvillimin e konceptit shqiptar për rajonin; kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri;
- Evidenton tiparet e përgjithshme natyrore dhe ato të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës dhe të trevave shqiptare jashtë kufirit shtetëror të RSH-së (strukturën dhe dinamikën e popullsisë, shpërndarjen gjeografike të popullsisë, zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit);
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV, etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të detyrave me shkrim.

2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë debateve.
- Zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse (p.sh. vëzhgon kushtet e motin dhe të klimës etj.
- Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë: tiparet e përgjithshme natyrore (ndërtimin gjeologjik, relievin, klimën, hidrografinë dhe botën e gjallë) dhe tiparet e zhvillimit demografik e socio-ekonomik të Republikës së Kosovës e të trevave shqiptare jashtë kufirit shtetëror të RSH (strukturën dhe dinamikën e popullsisë, shpërndarjen gjeografike të popullsisë, zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë);

3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mësion për të nxënë)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, foto, harta të ndryshme, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e detyrave të dhëna.
- argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës;
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar: rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integrimin e tij në BE;
- përshkruan tiparet kryesore natyrore, demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës dhe ndërvarësinë midis nënrajoneve të Evropës;
- analizon pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Evropë (dhe më gjerë) dhe analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë e në hapësirë harta politike e trevave shqiptare;
- analizon pozitën gjeografike, kushtet natyrore (pasuritë natyrore), trashëgiminë natyrore, tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës e të trevave të tjera shqiptare.

<ul style="list-style-type: none"> • analizon dallimet që vihen re në zhvillimet rajonale midis pjesëve të ndryshme të trevave të tjera shqiptare, faktorët që kanë ndikuar, si dhe perspektivën e zhvillimit të tyre; • analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë dhe ndikimin e tij në zhvillimin e në integrimin rajonal e evropian; • interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve në Shqipëri duke dalluar faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë; • analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; • Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga burimet e përdorura për detyrat e ndryshme tematike. • Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike. • Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. • Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së detyrave në klasë/shkollë apo në terren. 	<p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin. • Diskuton në grup për tematikën e projektit dhe të detyrave të ndryshme tematike. • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e projektit dhe të detyrave të ndryshme tematike. • Vlerëson rolin e: pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit; pasurive hidrike në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshme; faunës e të florës së vendit tonë në zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në ruajtjen e zhvillimin e biodiversitetit; <p>5. Kompetenca personale (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan përvoja dhe mendime në grup. • vlerëson rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore, të popullimit të trevave shqiptare dhe të zhvillimit ekonomik, si dhe në ndryshimet që ka pësuar harta politike e tyre; • vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian; • vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë në zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit; • vlerëson rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj; <p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerren pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit. • Merr pjesë në aktivitetet/detyrat tematike që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj. në shkollë apo në komunitet), ku përfrshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë. • sjell shembuj të standardeve që kanë përmbushur vendet e tjera anëtare apo candidate të BE-së me zhvillimet e tyre rajonale.
---	--

<ul style="list-style-type: none"> • evidenton <i>site</i>-t kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tonë; • hulumton në burime të ndryshme mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit; • vlerëson ndikimin e veprimitarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme; • parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi <p>7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive. • Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht. • Hulumton në burime të ndryshme mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit; 	<p><u>Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave të fushës/lëndës</u></p> <p><u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formulon, drejton pyetje e interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë e të vendbanimeve në Shqipëri si dhe tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; • interpreton me ndihmën e hartës tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë; • Përpunon dhe prezanton të dhëna mbi: tiparet kryesore natyrore, demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës dhe ndërvlerësinë midis nënrajoneve të Evropës; pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Evropë (dhe më gjerë) duke analizuar ndryshimet që ka pësuar në kohë e në hapësirë harta politike e trevave shqiptare; dallimet që vihen re në zhvillimet rajonale midis pjesëve të ndryshme të trevave të tjera shqiptare, si dhe mbi faktorët që kanë ndikuar, por edhe në perspektivën e zhvillimit të tyre; • analizon pozitën gjeografike, kushtet natyrore (pasuritë natyrore), trashëgiminë natyrore, tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës e të trevave të tjera shqiptare. • analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë dhe ndikimin e tij në zhvillimin e në integrimin rajonal e evropian. • Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza mbi to. <p><u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim (p.sh. harta, grafikë, video, foto të ndryshme, materiale të printuara, etj.). • vlerëson dhe argumenton rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës); • sjell shembuj të rritjes së ndërvlerësive rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Evropë; • sjell shembuj të standardeve që kanë përbushur vendet e tjera anëtare apo kandidatë të BE-së me zhvillimet e tyre rajonale. • vlerëson ndërvlerësinë midis nënrajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvlerësive dhe bashkëveprimit rajonal; • vlerëson pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Evropën Juglindore dhe rolin e saj në zhvillimin dhe bashkëpunimin rajonal e më gjerë;
--	---

<ul style="list-style-type: none">vlerëson rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore, të popullimit të trevave shqiptare dhe të zhvillimit ekonomik, si dhe në ndryshimet që ka pësuar harta politike e tyre;vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian;vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë në zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit;vlerëson rolin e pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit;vlerëson rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj;vlerëson rolin e pasurive hidrike në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshme;vlerëson rolin e faunës dhe të florës së vendit tonë në zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit;evidenton <i>site</i>-t kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tonë;hulumton në burime të ndryshme mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;							
3. <u>Marria e vendimeve</u> Nxënësi:							
<ul style="list-style-type: none">Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyç.Nxënësi identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”.vlerëson ndikimin e shoqërisë shqiptare në ndryshimin e peizazheve të ndryshme dhe parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi.							
SHTATOR-DHJETOR (26 orë)							
Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet

1.	<p>Tematika: Ndërvlerësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve (72 orë)</p> <p>Nëntematika 1: Hapësira në trajtimitin gjeografik rajonal</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> vlerëson dhe argumenton rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës); identifikon kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe llojet e ndryshme të rajoneve; shpjegon kuptimin e sotëm evropian mbi rajonin, nën frymën e respektimit të diversitetit dhe të ndërvlerësimit rajonal; sjell shembuj të rritjes së ndërvlerësimit rajonal përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Evropë; interpretin zhvillimin e konceptit shqiptar për rajonin; identifikon kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri; vlerëson problematikat që shoqërojnë rajonizimin gjeografik të vendit tonë; argumenton rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integritetin e tij në BE; sjell shembuj të standardeve që kanë përmblusur vendet e tjera anëtare apo 	<p>1. Rajoni dhe llojet e rajoneve</p>	<p>Situata 1.1: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - koncepteve <i>rajon</i> dhe <i>rajonizim</i> - llojeve të rajoneve (duke sjellë edhe shembuj) 	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat;</p>	<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpërndarjes; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>Teksti i gjeografisë Harta fiziko-gjeografike dhe politike të botës. Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës dhe të Shqipërisë. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.</p>
----	--	--	---	---	--	--	---

<p>Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare</p>	<p>kandidate të BE-së me zhvillimet e tyre rajonale.</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës; përshkruan tiparet kryesore natyrore, demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës; vlerëson ndërvlerësinë midis nënrajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë dhe bashkëveprimit rajonal; vlerëson pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Evropën Juglindore dhe rolin e saj në zhvillimin dhe bashkëpunimin rajonal e më gjerë; vlerëson vendin që zë hapësira shqiptare në rajonin e Mesdheut, me tiparet që karakterizojnë natyrën, popullimin dhe ekonominë e saj; analizon pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Evropë dhe më gjerë; vlerëson rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore, të popullimit të trevave shqiptare dhe të zhvillimit ekonomik, si dhe në 		<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat;</p>	<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shfëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>Teksti i Harta fiziko-gjeografike dhe politike të botës. Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës; trevave shqiptare; Shqipërisë. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.</p>
---	--	--	--	---	---

					<p>ndryshimet që ka pësuar harta politike e tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare; • argumenton rëndësinë e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis vendeve fqinje të Shqipërisë, në kuadër të perspektivës së tyre në familjen e madhe evropiane (si dhe të të gjitha trevave shqiptare që janë pjesë e këtyre vendeve); • analizon kushtet natyrore të Republikës së Kosovës: pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore, trashëgiminë natyrore; • analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës: strukturën dhe dinamikën e popullsisë (faktorët), shpërndarjen gjeografike të popullsisë, zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit; evidenton nëpërmjet hartës diferencimin rajonal të Republikës së Kosovës; • vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me 	<p>Teksti i Harta fiziko-gjeografike dhe politike të botës. Harta fiziko-gjeografike dhe politike të: Evropës; trevave shqiptare; Shqipërisë.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat;</p>	<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim</p>
--	--	--	--	--	--	---	--	--

		<p>shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan pozitën geografike dhe veçoritë natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale; • analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të trevave të tjera shqiptare; • analizon dallimet që vihen re në zhvillimet rajonale midis pjesëve të ndryshme të trevave të tjera shqiptare, faktorët që kanë ndikuar, si dhe perspektivën e zhvillimit të tyre; • vlerëson rolin e pozitës geografike të Republikës së Shqipërisë në zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit; • përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-të vendit tonë; • analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë; • argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativo-territorial të 				<p>i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>Harta fiziko-geografike dhe politike të botës. Harta fiziko-geografike dhe politike të Evropës; trevave shqiptare; Shqipërisë.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et</p>	
							<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat;</p>	

	Shqipërisë në zhvillimin dhe në integrimin rajonal dhe evropian.				dhe nxënësit.
2.	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan: <ul style="list-style-type: none"> - larinë e mjediseve dhe të peizazheve natyrore të Shqipërisë; - faktorët e përgjithshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim; • analizon etapat e formimit të truallit, përbërjen litologjike dhe strukturore të tij; • identifikon në hartë rezervat minerare të vendit tonë dhe shpërndarjen e tyre gjeografike; • vlerëson rolin e pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit; • identifikon faktorët gjeografikë dhe interpreton rolin e tyre në krijimin e larmisë së formave të relievit; • interpreton, me ndihmën e hartës, shtrirjen e formave kryesore të relievit; • analizon rolin e relievit në zhvillimet dhe shpërndarjen hapësinore të elementeve demografike dhe ekonomike; • identifikon elementet kryesore klimatiparet e tyre; 	2.Ndërvarës ia rajonale	Situata 1.2: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - rëndësinë e ndërveprimit rajonal në botë/në Evropë; - rëndësinë e zhvillimit rajonal të vendit tonë si një nga kriteret kryesore për integrimin e tij në BE. 	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shërbimit; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; Vlerësim i lojës me role.	
3.		3. Kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë	Situata 1.3: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - rajonizimit të territorit shqiptar; - disa veçorive mbi të cilat është bërë rajonizimi gjeografik i 	Punë në grup; Punë në dyshe;	

4.		<ul style="list-style-type: none">evidenton tiparet kryesore të klimës së vendit tonë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj;vlërëson rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj;analizon larinë dhe pasurinë e madhe hidrografike të Shqipërisë dhe faktorët që kanë ndikuar në to;vlërëson rolin e pasurive hidrike në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshme;analizon kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larinë e tokave të vendit tonë;analizon faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larinë dhe pasurinë e madhe bimore e shtazore të Shqipërisë;vlërëson rolin e faunës dhe të florës së vendit tonë në zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversiteti;evidenton <i>sitet</i>-t kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tonë;	1. Pozita gjeografike e rajonit të Evropës dhe veçoritë natyrore të saj	Situata 2.1: Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike të rajonit të Evropës dhe rolit të saj; - veçoritë të relievit, hidrografisë dhe klimës së këtij rajoni.	Punë individuale; Bashkëbisedim ; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat;	
5.		<ul style="list-style-type: none">vlërëson rolin e pasurive hidrike në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshme;analizon kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larinë e tokave të vendit tonë;analizon faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larinë dhe pasurinë e madhe bimore e shtazore të Shqipërisë;vlërëson rolin e faunës dhe të florës së vendit tonë në zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversiteti;evidenton <i>sitet</i>-t kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tonë;	2 Tiparet kryesore të kulturës, popullsisë dhe ekonomisë së Evropës	Situata 2.2: Diskutojmë rreth: - qytetërimeve të hershme evropiane dhe ndikimit të tyre në kulturën e rajonit e më gjerë; - dinamikës së popullsisë së rajonit; - zhvillimit të vendeve të rajonit dhe degëve kryesore të ekonomisë.	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtrëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me	
6.		<ul style="list-style-type: none">vlërëson rolin e pasurive hidrike në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshme;analizon kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larinë e tokave të vendit tonë;analizon faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larinë dhe pasurinë e madhe bimore e shtazore të Shqipërisë;vlërëson rolin e faunës dhe të florës së vendit tonë në zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversiteti;evidenton <i>sitet</i>-t kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tonë;	3. Hapësira shqiptare në Evropën Juglindore dhe në	Situata 2.3: - përbërjes së trevave shqiptare; - pozitës		

					shkrim; Vlerësi m i lojës me role. -Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; Vlerësi m i lojës me role.
				Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat;	
Mesdhe	gjeografike të trevave shqiptare dhe rolit të saj në kushtet natyrore, në popullimin dhe në zhvillimin ekonomik të tyre.	Situata 2.4: Diskutojmë rreth: - shtrirjes gjeografike të fiseve ilire; - ndryshimeve që pësoi harta politike e trevave shqiptare nga vendimet e Konferencës së Londrës.	5. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Kosovës	Situata 2.5: Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike të Republikës së Kosovës; - kushteve natyrore të saj.	
				6. Popullsia e Kosovës dhe trashëgimia kulturore e	Situata 2.6: Diskutojmë rreth: - popullimit të Kosovës në
7.					
8.					
9.					

10.	<p>saj</p> <p>periudha të ndryshme historike; - trashëgimisë kulturore të saj.</p>	<p>7. Ekonomia e Republikës së Kosovës</p> <p>Situata 2.7: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - natyrës së ekonomisë së Kosovës dhe rolit të kushteve natyrore në zhvillimin e saj; - fushave të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë. 	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat;</p>
11.	<p>8 Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë</p>	<p>Situata 2.8: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të trevave shqiptare në Serbi dhe në Maqedoni; - kushteve natyrore dhe rolit të tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave. 	

12.		<ul style="list-style-type: none"> • hulumton në burime të ndryshme mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit; • identifikon faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve mjedisore në vendin tonë; • interpreton faktorët që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit e në shkrëtimin e tokave, si dhe pasojat e tyre; • vlerëson ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme; • parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi. • interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve; • analizon ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë; dallon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë; • interpreton me ndihmën e hartës tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë; • analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; 	9. Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë (vazhdim)	Situata 2.9: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të trevave shqiptare në Malin e Zi dhe në Greqi; - kushteve natyrore dhe rolin të tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave. 		
13.		<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme; • parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi. • interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve; • analizon ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë; dallon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë; • interpreton me ndihmën e hartës tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë; • analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; 	10. Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë. Organizimi administrativ-territorial i saj	Situata 2.10: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë dhe rolin të saj; - organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë. 	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat	
14.		<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme; • parashikon rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi. • interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve; • analizon ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë; dallon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë; • interpreton me ndihmën e hartës tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë; • analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; 	1. Larmia e peizazheve të Shqipërisë dhe	Situata 3.1: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - llojeve të peizazheve të 		

15.	ndërtimi gjeologjik i saj	Shqipërisë dhe disa prej faktorëve që kanë ndikuar në formimin e tyre; - llojet e shkëmbinjve që përbëjnë truallin shqiptar.	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat.		
		2. Pasuritë minerare të truallit shqiptar	Situata 3.2: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> rezervave minerare të vendit tonë dhe shpërndarjës së tyre gjeografike rolit të pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit. 		
16.		3. Relievi i Shqipërisë	Situata 3.3: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> larmisë së relievit të Shqipërisë dhe formave që mbizotërojnë në të; 	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim	Harta fiziko-geografike dhe politike të botës. Harta fiziko-geografike dhe politike të Evropës; trevave shqiptare; Shqipërisë.

17.				- rolit të relievit në klimë, hidrografi, bimësi, shpërndarjen e popullsisë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Situata 3.4: Diskutojmë rreth: - tipareve kryesore të klimës së vendit tonë dhe faktorëve që ndikojnë në formimin e saj; - rolit të klimës në kushtet e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj.	i detyrës së shërbimit; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; Vlerësim i lojës me role.	Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.
		4 Klima e Shqipërisë				
18.				5. Hidrografia e Shqipërisë Situata 3.5: Diskutojmë rreth: - larmisë hidrografike të vendit tonë, duke sjellë shembuj të ndryshëm; - rolit të		

19.	6. Llojet e tokave dhe faktorët e formimit të tyre	rezervave hidrike në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.				Harta fiziko-geografike dhe politike të botës. Harta fiziko-geografike dhe politike të:
		Situata 3.6: Diskutojmë rreth: - larmisë së tokave në vendin tonë; - faktorëve që ndikojnë në degradimin e tyre.				
20.	7. Bota bimë dhe shtazore në Shqipëri	Situata 3.7 Diskutojmë rreth: - larmisë së peizazheve që karakterizojnë territorin shqiptar; - veçorive të florës dhe faunës së Shqipërisë dhe llojeve të tyre; - llojeve të specieve endemike që rriten në vendin tonë dhe faktorëve që kanë ndikuar në formimin e				
						-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; Vlerësim i lojës me role.
						Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.

21.	Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë		8.Trashëgimia natyrore e vendit tonë	tyre. Situata 3.8 Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore të vendit tonë dhe rëndësisë së saj në zhvillimin e turizmit; - problemeve të mjedisit dhe faktorëve që kanë ndikuar në to.			
22.			9. Përsëritje 1 (Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë)				
23.			10. Testim 1				
24.	Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë		1.Popullimi dhe ndryshimet demografik e në Shqipëri	Situata 3.9 Diskutojmë rreth: - popullimit dhe vendbanimeve të hershme ilire; - ndryshimeve që ka pësuar numri i popullsisë së Shqipërisë përgjatë		-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve;	Harta fiziko-geografike dhe politike të botës. Harta fiziko-geografike dhe politike të: Evropës; trevave shqiptare; Shqipërisë. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi

25.			2.Shpërnda rja e popullsisë dhe struktura e saj	periudhave të ndryshme. Situata 3.10 Diskutojmë rreth: - shpërndarjes gjeografike të popullsisë në vendin tonë dhe faktorëve që ndikojnë në të; - tipareve të përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, sipas moshës, gjinisë, etnisë etj.		-Vlerësim me shkrim; Vlerësim i lojës me role.	Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.
26.			Projekt 1. ora e parë: Pasuria e madhe natyrore, humane dhe kulturore e Shqipërisë, zhvillimi ekonomik dhe perspektiva e saj drejt integritit evropian.				

PLANI 3 MUJOR (JANAR-MARS -24 orë)
FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI
LËNDA: GJEOGRAFI 11

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyce

1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

- Shpreh mendimin e vet mbi: procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën e viteve '90; mbi problemet e integritetit të emigrantëve shqiptarë; tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, referuar: moshës, gjinisë, vendbanimit, etnisë dhe fesë; tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë;
- Përkrauan karakteristikat kryesore të popullimit të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare;
- Liston disa nga shkaqet dhe pasojat e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor;

2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati;
- Argumenton, me gojë ose shkrim: migrimin si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare (duke u ndalur në periudhën e viteve '90); tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare; tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare; rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Shqipërisë; veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor e të Alpeve Shqiptare dhe potencialet natyrore për zhvillim;
- Evidenton shkaqet e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor dhe urbanizimin e shpejtë të tij;
- Evidenton disa veçori të trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor e të Alpeve Shqiptare;

3. Kompetenca e të nxënës (Nxënësi mësion për të nxënë)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, të dhëna të marra nga publikime të qeverisjes vendore, enciklopedi, internet, ose vëzhgime në terren), të cilat i shfrytëzon për realizimin e projektit kurrikular dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, harta të ndryshme, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e detyrave të dhëna.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit mbi: tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare (sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, etnisë dhe fesë); tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare; rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Shqipërisë dhe shkallën e zhvillimit të tyre; veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor e të Alpeve Shqiptare dhe potencialet natyrore për zhvillim;
- Analizon shkaqet e pasojat e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor dhe urbanizimin e shpejtë të tij, si dhe rrjedhojat;
- Analizon trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare;
- Parashikon perspektivën e zhvillimit të Rajonit Perëndimor.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë ose për të realizuar një detyrë që i kërkohet.

<ul style="list-style-type: none"> • Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit, sipas një radhitjeje logjike. • Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga burimet e përdorura për detyrat e ndryshme tematike. • Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për tematikën që trajtohet/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. • Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren). 	<p>4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</u> (<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) diskuton dhe jep mendimin e tij mbi dinamikën e popullsisë, shpërndarjen gjeografike të saj dhe zhvillimin ekonomik. • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti/projekti/detyre tematike të përbashkët, duke identifikuar problemin, përcaktuar faktorët e mundshëm që e shkaktojnë, ofruar zgjidhje dhe vlerësuar përfitimet dhe risqet e zgjidhjeve të mundshme; • Vlerëson problemet e sotme dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritetit rajonal dhe evropian. • Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare për zhvillimin socio-ekonomik dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë; • Vlerëson zhvillimin e bujqësisë, industrisë, tregtisë, turizmit, transportit etj., të Rajonit Perëndimor, si dhe të ekonomisë së Alpeve Shqiptare; <p>5. <u>Kompetenca personale</u> (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan përvojat dhe mendimet në grup. • ndërton dhe analizon grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj, si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore e industriale të Shqipërisë. <p>6. <u>Kompetenca qytetare</u> (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit. • vlerëson potencialet natyrore dhe humane të Shqipërisë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. • Vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare dhe rolin e saj në zhvillimin e turizmit; <p>7. <u>Kompetenca digjitale</u> (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive. • hulumton në burime të ndryshme dhe interpreton grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe lëvizjen natyrore të saj; • hulumton në burime të ndryshme dhe interpreton grafikë, të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me ecurinë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare në periudha të ndryshme; • Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. organizimin e informacioneve të siguruar nga interneti duke i përmbledhur në tabela ose grafikë). •
--	---

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës/lëndës

1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi:

- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit mbi: tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare (sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, etnisë dhe fesë); tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare; rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Shqipërisë dhe shkallën e zhvillimit të tyre; veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor e të Alpeve Shqiptare dhe potencialet natyrore për zhvillim;
- Vëzhgon dhe hulumton mbi shkaqet e pasojat e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor dhe urbanizimin e shpejtë të tij, si dhe rrjedhojat;
- Hulumton mbi trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor e të Alpeve Shqiptare;
- Hulumton në burime të ndryshme dhe interpreton grafikë, të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me ecurinë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare në periudha të ndryshme;

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- Identifikon dhe vlerëson potencialet natyrore dhe humane të Shqipërisë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit;
- Hulumton në burime të ndryshme dhe interpreton grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë dhe lëvizjen natyrore të saj;
- Vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare dhe rolin e saj në zhvillimin e turizmit;
- Parashikon perspektivën e zhvillimit të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare.
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, fotove etj, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

3. Marrja e vendimeve

Nxënësi:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, një parashikim apo një gjetje kyç, si p.sh. vlerëson ndikimin e lëvizjes natyrore të popullsisë në numrin e përgjithshëm të popullsisë;
- Ndërtton e analizon grafikë të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare, si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj;
- Nxënësi identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”.

JANAR-MARS (24 orë)

Tematika/	Rezultatet e të nxënës sipas tematikave	Temat	Situata e të	Metodologjia e	Teknikat e	Burimet
-----------	---	-------	--------------	----------------	------------	---------

Nr.	Nëntematika	mësimore	nxënit	mësimdhënies	vlerësimi	
27.	<p>Tematika: Ndërvlerësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve (72 orë)</p> <p>Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë</p>	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; • vlerëson ndikimin e lëvizjes natyrore të popullsisë në numrin e përgjithshëm të popullsisë; • hulumton në burime të ndryshme dhe interpreton grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe lëvizjen natyrore të saj; • analizon procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën e viteve '90; • evidenton territoret ku kanë migruar shqiptarët, si dhe problemet e integritetit të tyre; 	<p>Situata 4.3: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëvizjeve migratore të popullsisë shqiptare pas vitit '90 dhe faktorëve kryesorë që kanë ndikuar në to. 	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;</p> <p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat; Konkurs;</p>	<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpërbërës; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p> <p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpërbërës; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p> <p>-Vlerësim me</p>	<p>Teksti i gjeografisë</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit</p>

[illegible]

		<p>Shqipërisë (bujqësinë, industrinë, tregtinë, transportin, turizmin, shërbimet dhe artizanatin);</p> <ul style="list-style-type: none">vlerëson problemet e sotme dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integrimit rajonal dhe evropian;ndërtton dhe analizon grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj, si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore e industriale të Shqipërisë.			<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;</p>	<p>detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit</p>
					<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me</p>	<p>Teksti i gjeografisë Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p>	

	<p>Nëntematika V: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë</p>				<p>shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit</p>
					<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	
						</

29.	3.Potencialitet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe veçoritë e tij	Shqipëri. Situata 4.5 Diskutojmë rreth: - zhvillimit ekonomik të Shqipërisë gjatë periudhave të ndryshme - potenciale natyrore e humane të Shqipërisë dhe ndikimit të tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.			
30.	4.Ekonomia e Republikës së Shqipërisë	Situata 4.6 Diskutojmë rreth: - sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare; - rreth problemeve që ndeshen sot në ekonomi dhe mundësive për zgjidhjen e tyre; - perspektivës së zhvillimit ekonomik të Shqipërisë në kuadër të integrimit rajonal dhe evropian.			

31.

32.

[illegible]

		natyrore për zhvillim; • evidenton karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, në mënyrë të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj; • analizon shkaqet dhe pasojat e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor; • analizon urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij; • vlerëson zhvillimin e bujqësisë, industrisë, tregtisë, turizmit, transportit etj., të Rajonit Perëndimor; • hulumton në burime të ndryshme dhe interpreton grafikë, të dhëna statistikore,		Rajonit Perëndimor - shpërndarjes gjeografike të popullsisë në këtë rajon; - shkaqeve dhe pasojave të lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor.	Diskutime; Debat; Konkurs;		
37.	11.Struktura e popullsisë dhe veçoritë e vendbanimeve në Rajonin Perëndimor		Situata 5.4: Diskutojmë rreth: - strukturës së popullsisë së Rajonit Perëndimor; - llojeve të vendbanimeve të rajonit dhe veçorive të tyre.	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;		-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup;	Teksti i gjeografisë Harta fiziko-
38.	12. Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Perëndimor		Situata 5.5: Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor, duke sjellë disa shembuj.				
39.	13. Ekonomia bujqësore në Rajonin		Situata 5.6: Diskutojmë rreth: - faktorëve që				

	<p>harta etj., në lidhje me ecurinë e zhvillimit ekonomik të Rajonit</p> <p>Perëndimor në periudha të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none">• vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit <p>Perëndimor dhe rolin e saj në zhvillimin e turizmit;</p> <ul style="list-style-type: none">• parashikon perspektivën e zhvillimit të Rajonit <p>Perëndimor</p>	<p>Perëndimor</p>	<p>ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë bujqësore në Rajonin Perëndimor;</p> <p>- produkteve kryesore bujqësore e blegtorale, për të cilat dallohet rajoni</p>		<p>-Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit</p>	
40.		<p>14. Industria në Rajonin Perëndimor</p>	<p>Situata 5.7: Diskutojmë rreth:</p> <p>- faktorëve që ndikojnë në zhvillimin industrial të rajonit;</p> <p>- degëve kryesore të</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte</p>	<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i</p>		

41.	Rajoni Verior dhe Verilindor i Republikës së Shqipërisë	industrialishtë së rajonit.	kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role; Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;	ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role. -Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpëpës; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.	Teksti i gjeografisë Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.
42.		15. Sektori i tretë i ekonomisë në Rajonin Perëndimor	Situata 5.8: Diskutojmë rreth: Diskutojmë rreth: - mundësive që ka rajoni për zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë; - degëve kryesore të sektorit të tretë të ekonomisë.	ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role. -Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpëpës; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.	Teksti i gjeografisë Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.
43.		16. Punë Praktike Nr. 1-Tema: Rajoni Perëndimor i Republikës së Shqipërisë	Situata 5.9: Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike të Rajonit Verior e Verilindor dhe disa veçori të përgjithshme të tij	ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.	Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.

44.	18. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Alpeve Shqiptare	Situata 5.10: Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të Alpeve Shqiptare.	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpirtërisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.	Teksti i gjeografisë Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.
	19. Njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe veçoritë e tyre	Situata 5.11: Diskutojmë rreth: - tipareve të përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Alpeve Shqiptare.			
46.	20. Tiparet kryesore të popullimit në Alpet Shqiptare	Situata 5.12: Diskutojmë rreth: - veçoritë të vendbanimeve në Alpet Shqiptare; - shpërndarjes së popullsisë në këtë nënrajon.			
	21. Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e	Situata 5.13: Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore dhe			
45.					
47.					

48.			Alpeve Shqiptare dhe ekonomia e tyre	asaj kulturore të Alpeve Shqiptare dhe rolit të tyre në zhvillimin e turizmit.	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;		
49.			22. Përsëritja 3 Rajoni Perëndimor dhe Alpet Shqiptare				
50.			23. Testim 3				
			24. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Nënrajonit Verilindor	Situata 5.14: Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike dhe veçorive natyrore të Nënrajonit Verilindor			

PLANI 3 MUJOR (PRILL – QERSHOR, 22 orë)
FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI
LËNDA: GJEOGRAFI 11

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave krye

1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

- Shpreh mendimin e vet, me gojë ose me shkrim, mbi: tiparet e përgjithshme natyrore dhe mbi tiparet kryesore të zhvillimit demografik të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; trashëgiminë natyrore dhe kulturore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë;
- Evidenton veçoritë e zhvillimit ekonomik në nënrajonin Verilindor, Rajonin Juglindor dhe Rajonin Jugor të Shqipërisë;
- Jep mendimin e vet mbi mundësitë dhe perspektivën e zhvillimit të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë;
- Diskuton mbi: faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale dhe mbi drejtimet kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si: popullimi, zhvillimi ekonomik, shkalla e urbanizimit, niveli i papunësisë, etj.;
- identifikon disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive;
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim (duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm) kuptimin e termat: zhvillim i qëndrueshëm, pabarazi rajonale, potenciale natyrore dhe humane.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV, harta, foto, etj., komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim.

2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

- Parashtron argumente pro/kundër në lidhje me potencialet natyrore e humane të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë si dhe nivelit të zhvillimit ekonomik të tyre.
- Evidenton mozaikun natyror të Rajonit Verior-Verilindor dhe potencialet natyrore të tij;
- identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë;
- analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë;
- analizon tiparet kryesore të aktivitetëve ekonomike të sotme të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe Rajonit Jugor të Shqipërisë;
- Evidenton trashëgiminë natyrore dhe kulturore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë;
- identifikon mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të tyre;
- parashikon rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të rasteve të keqmenaxhimit të burimeve natyrore të tyre.

2. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, të dhëna të marra nga publikime të qeverisjes vendore, enciklopedi, internet, ose vëzhgime në terren), të cilat i shfrytëzojnë për realizimin e projektit kurrikular dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzojnë të dhënat për të demonstruar (nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit) mbi: mozaikun natyror të Rajonit Verior-Verilindor, Rajonit Juglindor dhe Rajonit Jugor të Shqipërisë (potencialet natyrore të tyre); tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve

<p>përbërëse të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidencion tiparet kryesore të zhvillimit demografik të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; • analizon tiparet kryesore të aktiviteteve ekonomike të sotme të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe Rajonit Jugor të Shqipërisë; • vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; • vlerëson perspektivën e zhvillimit të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; • identifikon mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe parashikon rrugë e mundësi të parandalimit ose trajtimit të rasteve të keqmenaxhimit të burimeve natyrore në vendin tonë • hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore në vendin tonë, propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tyre; • analizon faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale; • përcakton drejtimet kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si: popullimi, zhvillimi ekonomik, shkalla e urbanizimit, niveli i papunësisë, etj; • Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga burimet e përdorura për detyrat e ndryshme tematike. • Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike. • Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për tematikën /problemin e dhënë që trajtohet dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. • Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren). 	<p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët si p.sh. heton për një çështje mjedisore në zonën e tij duke identifikuar problemin, përcaktuar faktorët e mundshëm që e shkaktojnë, ofruar zgjidhje dhe vlerësuar përfitimet dhe risqet e zgjidhjeve të mundshme; • Duke zhvilluar projektin kurrikular, realizon edhe shërbime në ndihmë të përmirësimit të mjedisit të komunitetit të tij; • Diskuton mbi potencialet (turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare) të këtyre rajoneve gjeografike, përmes shembujve. • Heton disa ndërproblematikat e krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njerëzve; • Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e banorëve dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre. <p>5. Kompetenca personale (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan përvojat dhe mendimet në grup. • Ndërtton hartën e burimeve natyrore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor e Rajonit Jugor të Shqipërisë duke analizuar mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social-ekonomik. • Identifikon disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive; • Vlerëson potencialet e Shqipërisë për zhvillimet e ardhme rajonale (të tilla, si bujqësia, energjia, turizmi etj.). <p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit. • Vlerëson potencialet e Shqipërisë për zhvillimet e ardhme rajonale dhe mundësitë e anëtarësimit të saj në BE.
--	---

<ul style="list-style-type: none"> Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndërron hartën e burimeve natyrore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor e Rajonit Jugor të Shqipërisë. Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive. Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht. 	<p><u>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</u></p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Formulon dhe drejton pyetje mbi: tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; tiparet kryesore të zhvillimit demografik të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; tiparet kryesore të aktivitetve ekonomike të sotme të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe Rajonit Jugor të Shqipërisë; Vëzhgon dhe vlerëson trashëgiminë natyrore e kulturore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor e të Rajonit Jugor të Shqipërisë; Hulumton mbi perspektivën e zhvillimit të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; Vëzhgon pabarazitë e zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit tonë; Evidenton faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale duke vëzhguar drejtimet kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si: popullimi, zhvillimi ekonomik, shkalla e urbanizimit, niveli i papunësisë, etj; Evidenton disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive; Hulumton dhe paraqet përmes detyrave tematike, potencialet e Shqipërisë për zhvillimet e ardhme rajonale (të tilla, si bujqësia, energjia, turizmi etj.). Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij; Heton ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas. Vrojton/hulumton: mbi mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore; Vrojton/hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore në vendin tonë, propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tyre; Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në mjedisin lokal; <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim. Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Hulumton mbledh informacion dhe diskuton mbi: tiparet e përgjithshme natyrore, tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe atij ekonomik të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor e të Rajonit Jugor të Shqipërisë; Hulumton mbledh informacion dhe diskuton mbi: trashëgiminë natyrore e kulturore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; Diskuton mbi: faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale dhe mbi drejtimet kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si:
--	---

<p>popullimi, zhvillimi ekonomik, shkalla e urbanizimit, niveli i papunësisë etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikon disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive; Ndërton njohuri për mjedisin lokal, duke përdorur mjetet dhe shkathtësitë gjeografike, si hartat, vëzhgimet në terren, fotografi, etj. Propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore; Parashikon rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit e problematikave mjedisore në vendin tonë. Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik; <p>3. Marrja e vendimeve Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerëson potencialet natyrore, humane dhe trashëgiminë natyrore e kulturore të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; Vlerëson perspektivën e zhvillimit të nënrajonit Verilindor, Rajonit Juglindor dhe të Rajonit Jugor të Shqipërisë; Ndërton hartën e burimeve natyrore të këtyre rajoneve dhe vlerëson mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social-ekonomik. Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjeje kyç. Nxënësi identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to. Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kerkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”. 						
PRILL-QERSHOR (22 orë)						
Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënëtit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit
51.	Tematika: Ndërvlerësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjedisve (72 orë)	Nxënësi/ju: <ul style="list-style-type: none"> përkruan mozaikun natyror të Rajonit Verior-Verilindor dhe potencialet natyrore të tij; identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Rajonit Verior Verilindor; evidenton tiparet kryesore të 	1. Popullsia, trashëgimia kulturore dhe ekonomia e Nënrajonit Verilindor	Situata 5.15: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore të Nënrajonit Verilindor dhe rolit të tyre në zhvillimin e disa degëve të ekonomisë. 	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Konkurs;	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shfrytëzimit; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim;
52.	Nëntematika V: Rajonet gjeografike të Republikës së		2. Disa nga njësittë përbërëse të	Situata 5.16: Diskutojmë rreth:		Teksti i gjeografisë Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi

	<p>Shqipërisë</p> <p>Rajoni Verior dhe Verilindor i Republikës së Shqipërisë</p>	<p>zhvillimit demografik të Rajonit Verior-Verilindor;</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon ecurinë demografike të këtij rajoni me fokus të veçantë braktisjen e tij pas viteve '90; • analizon tiparet kryesore të aktiviteteve ekonomike të sotme të Rajonit Verior-Verilindor; • vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Verior-Verilindor; • identifikon mundësitë dhe vlerëson perspektivën e zhvillimit të Rajonit Verior-Verilindor, rolin e korridorit Durrës-Prishtinë në kuadër të këtij zhvillimi dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë; • ndërton hartën e burimeve natyrore të Rajonit Verior- 	<p>Nënrajonit Verilindor</p>	<p>- pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të Malësisë së Gjakovës dhe të Hasit, të Vargut të Korabit dhe të Luginjës së Drinit të Zi</p>	<p>Lojë me role;</p>		<p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.</p>
<p>53.</p>		<p>3. Disa nga njësitet përbërëse të Nënrajonit Verilindor (vazhdim)</p>	<p>Situata 5.17: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kushteve natyrore të Vargjeve të Lurës, Malësisë Pukë-Mirditë dhe Pellgut të Matit. 	<p>Punë në grup;</p> <p>Punë në dyshe;</p> <p>Punë individuale;</p> <p>Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;</p> <p>Përdorimi TIK;</p> <p>Projekte kurrikulare;</p> <p>Hulumtim dhe zbulim;</p> <p><i>Brainstorming</i>;</p> <p>Diskutime;</p> <p>Debat; Konkurs;</p> <p>Lojë me role;</p>			<p>Teksti i gjeografisë</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative së Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit</p>
<p>54.</p>		<p>4. Njësitë e tjera përbërëse të Nënrajonit Verilindor</p>	<p>Situata 5.18: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçorive të Vargjeve të Skënderbeut dhe të Malësive të Martaneshit, Çermenikës e Gollobordës. 				<p>Teksti i gjeografisë</p>
<p>55.</p>		<p>5. Punë Praktike Nr. 2 Tema: Rajoni Verior dhe Verilindor i Republikës së Shqipërisë</p>					<p>Teksti i gjeografisë</p>

56.	Verilindor dhe analizon mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social-ekonomik.	6. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Juglindor	Situata 5.19: Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të Rajonit Juglindor.		Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.
57.	<ul style="list-style-type: none"> • përcakton rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Juglindor në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal; • përshkruan veçoritë e kushteve natyrore të Rajonit Juglindor; • identifikon në hartë njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor; • analizon dinamikën dhe shpërndarjen e popullsisë në Rajonin Juglindor, duke u bazuar kryesisht në lëvizjet migratore pas vitit '90; • evidenton disa nga pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale; • analizon tiparet kryesore të veprimitarisë ekonomike të Rajonit Juglindor, duke e krahasuar edhe me rajonet e 	7. Njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor	Situata 5.20: Diskutojmë rreth: - veçorive të përgjithshme të disa prej fushëgropave, gropave, luginave, maleve e malësive të Rajonit Juglindor.	<p>Punë në grup;</p> <p>Punë në dyshe;</p> <p>Punë individuale;</p> <p>Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;</p> <p>Përdorimi TIK;</p> <p>Projekte kurrikulare;</p> <p>Hulumtim dhe zbulim;</p> <p><i>Brainstorming</i>;</p> <p>Diskutime;</p> <p>Debat; Konkurs;</p> <p>Lojë me role;</p>	<p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit</p> <p>Teksti i gjeografisë</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p>
58.	<ul style="list-style-type: none"> • evidenton disa nga pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale; • analizon tiparet kryesore të veprimitarisë ekonomike të Rajonit Juglindor, duke e krahasuar edhe me rajonet e 	8. Popullsia e Rajonit Juglindor	Situata 5.21: Diskutojmë rreth: - veçorive të popullimit dhe të vendbanimeve në Rajonin Juglindor		
59.	<ul style="list-style-type: none"> • evidenton disa nga pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale; • analizon tiparet kryesore të veprimitarisë ekonomike të Rajonit Juglindor, duke e krahasuar edhe me rajonet e 	9. Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Juglindor dhe ekonomia e tij	Situata 5.22: Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore të Rajonit	<p>- Vlerësim me gojë;</p> <p>- Vlerësim i punës në grup;</p> <p>- Vlerësim i punës praktike;</p> <p>- Vlerësim i</p>	

60.	<p>tjera të vendit;</p> <ul style="list-style-type: none">vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe trashëgimisë kulturore të Rajonit Juglindor për zhvillimin e turizmit;vlerëson mundësitë dhe perspektivën e zhvillimit të Rajonit Juglindor;ndërton hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor, duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë.	<p>10. Punë Praktike Nr. 3 Tema: Rajoni Juglindor i Republikës së Shqipërisë</p>	<p>Juglindor; - sektorëve kryesorë të ekonomisë së këtij rajoni.</p>		<p>detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit</p>
61.		<p>11. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Jugor</p>	<p>Situata 5.23: Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të Rajonit Jugor.</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime;</p>		<p>Teksti i gjeografisë</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power</i></p>

					Debat; Konkurs; Lojë me role;	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shitëpisë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.	<i>point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit
62.	Rajoni Jugor i Republikës së Shqipërisë	<ul style="list-style-type: none"> vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike ndërkufitare të Rajonit Jugor për zhvillimet rajonale; përshkruan tiparet e përgjithshme natyrore të Rajonit Jugor; analizon veçoritë e zhvillimit demografik të Rajonit Jugor; 	12. Njësitë e Rajonit Jugor	Situata 5.24: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> veçoritë kryesore të njësive përbërëse të Rajonit Jugor. 			
63.			13. Popullsia e Rajonit Jugor	Situata 5.25: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> veçoritë të popullimit dhe vendbanimeve të Rajonit Jugor. 	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës	

64.	<ul style="list-style-type: none"> evidenton pasojat e migrimeve të popullsisë së Rajonit Jugor; evidenton tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Jugor, duke e krahasuar edhe me rajonet e tjera të vendit; vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të Rajonit Jugor në zhvillimin e turizmit; vlerëson mundësitë dhe perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor; ndërton hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor. 	14. Popullsia e Rajonit Jugor	Situata 5.26: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - veçorive të popullimit dhe vendbanimeve të Rajonit Jugor. 	Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;	praktike; -Vlerësim i detyrës së shfëtitë; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.	Teksti i gjeografisë Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë. Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi
65.	<ul style="list-style-type: none"> vlerëson mundësitë dhe perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor; ndërton hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor. 	15. Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Jugor dhe ekonomia e tij	Situata 5.27: Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor; - sektorëve kryesorë të ekonomisë së këtij rajoni. 	Punë në grup; Punë në dyshë; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;	-Vlerësim	Tekste nga fusha të tjera: foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit
66.	<ul style="list-style-type: none"> vlerëson mundësitë dhe perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor; ndërton hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor. 	16. Punë Praktike Nr. 4 Tema: Rajoni Jugor i Republikës së Shqipërisë				Tekste nga fusha të tjera: foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit
67.	<ul style="list-style-type: none"> përkrahur tiparet dalluese të pabarazive të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit tonë; analizon faktorët që 	17. Projekt 2 (ora e parë): Tema: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale				Tekste nga fusha të tjera: foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit
68.	<ul style="list-style-type: none"> analizon faktorët që 	18. Përsëritja 4 Rajoni Verilindor, Juglindor dhe				Tekste nga fusha të tjera: foto, harta, video Materiale të përgatitura me <i>power point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit

69.	<p>kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton drejtimet kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si: popullimi, zhvillimi ekonomik, shkalla e urbanizimit, niveli i papunësisë, etj.; • identifikon disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive; • vlerëson potencialet e Shqipërisë për zhvillimet e ardhme rajonale (të tilla, si bujqësia, energjia, turizmi etj.). 	<p>ai Jugor i Shqipërisë</p> <p>19. Pabarazia e zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit dhe treguesit e saj</p>	<p>Situata 6.1: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - veçoritë të zhvillimit socio-ekonomik të secilit prej rajoneve - gjeografike të Shqipërisë; - pabarazisë që vihet re në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të vendit. 	<p>Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;</p>	<p>me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpërbërës; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	
70.	<p>Nëntematika VI: Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimit rajonal</p>	<p>20. Faktorët dhe pasojat e pabarazisë së zhvillimit të rajoneve</p>	<p>Situata 6.1: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - faktorëve që kanë ndikuar në pabarazinë e zhvillimit socio-ekonomik midis rajoneve të vendit. 	<p>Punë në grup; Punë në dyshë; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i>; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;</p>	<p>-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shpërbërës; -Vlerësim i ese-ve; -Vlerësim me shkrim; -Vlerësim i lojës me role.</p>	<p>Teksti i gjeografisë</p> <p>Harta fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.</p> <p>Hartat fiziko-gjeografike dhe administrative Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera: foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me <i>power</i></p>

	<i>point</i> dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit				
71.				21. Projekt 2 (ora e dytë): Tema: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale	
72.				22. Projekt 2 (ora e tretë): Tema: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale	

II. 3 Disa modele të planifikimit ditor (*modele skematike*)

Shënim: Edhe pse në planifikimet e mëposhtme ditore të orëve mësimore, brenda 1 ore mësimore janë paraqitur të gjitha rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe (pra të shtata kompetencat), nuk është detyrim që brenda një ore mësimore ato të realizohen të gjitha, por vetëm disa prej tyre. Paraqitja e plotë e tyre e pasqyruar në këto orë mësimore model, është bërë:

- për shkak të respektimit të formatit të një ore mësimore;
- me qëllim paraqitjen në të, të çdo detaji që do të ndihmonte në orientimin e punës së mësuesit;
- për të paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha pritshmëritë që mund të ketë secila prej orëve mësimore.

Nëntematika: Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal

Tema 1.1

► Rajoni dhe llojet e rajoneve

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika I: Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal		Tema mësimore: I.1 Rajoni dhe llojet e rajoneve	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja <ul style="list-style-type: none">• vlerëson dhe argumenton rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës);• identifikon kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe llojet e ndryshme të rajoneve.		Fjalët kyçe: Rajoni dhe rëndësia e trajtimit rajonal të territorit; Llojet e rajoneve dhe kriteret e rajonizimit të tyre	
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetari, histori, TIK	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u> <ul style="list-style-type: none">• Shpreh mendimin e vet mbi llojet e rajoneve dhe veçorive të tyre.• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth veçorive të rajoneve.• Përshkruan veçorive të rajoneve, duke analizuar shembuj.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u> <ul style="list-style-type: none">• Jep shembuj të ngjashëm ilustrues mbi veçoritë e rajoneve, bazuar në ato që paraqiten si modele në libër.• Shpjegon pse gjeografët krijojnë dhe përdorin rajonet si koncepte organizuese.• Vlerëson dhe argumenton rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës).			

<p>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</p> <ul style="list-style-type: none"> Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. Dallon dhe analizon llojet e ndryshme të rajoneve. <p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. Identifikon kriteret bazë të rajonizimit gjeografik. <p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit të grupit shoqëror, si p.sh rreth rëndësisë së trajtimit rajonal të territorit (hapësirës), apo rreth kriterëve bazë të rajonizimit gjeografik. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi rajonet dhe veçoritë e tyre. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përcakton kuptimin mbi rajonin dhe përshkuan veçoritë e rajoneve, duke analizuar shembuj. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi hulumton, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht mbi llojet e rajoneve dhe kriteret e rajonizimit të tyre. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon se ç'janë rajonet dhe përcakton faktorët kryesorë që çojnë në rajonizimin e hapësirës. 	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në njohuritë e marra nga nxënësit në klasën e gjashtë dhe të tetë mbi rajonet:</p> <p><i>Rajoni</i> përfaqëson një njësi të sipërfaqes së tokës me tipare fizike ose humane qartësisht të dallueshme nga çdo pjesë tjetër e saj. Një grup vendesh me tipare fizike, kulturore, ekonomike, historike etj., të ngjashme apo të përafërta midis tyre, konsiderohen si një rajon.</p>
	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1.</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I : Rrjeti i diskutimit</p> <p>- Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1 në tekst: <i>Diskutojmë rreth:</i></p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

- koncepteve *rajon* dhe *rajonizim*
- llojeve të rajoneve (duke sjellë edhe shembuj)

Nxënësit përshkruajnë, përkufizojnë...

Mësuesi/ja vazhdon: Me veprimtarinë e tij, njeriu ka ndërvepruar që herët me mjedisin fizik, duke e transformuar atë në mënyrë të vazhdueshme. Nga njëra periudhë në tjetrën dhe nga një kulturë në tjetrën, ky ndërveprim ka qenë i natyrave të ndryshme, duke krijuar kështu edhe një larmi të madhe peizazhesh. Për të njohur dhe studiuar hapësirën botërore dhe veçoritë e larmishme që e karakterizojnë, gjeografët e *rajonizojnë* botën në rajone, nënraione ose në zona më të vogla, duke përcaktuar edhe kufijtë ndarës midis tyre.

- Mësuesja u drejtohet nxënësve me pyetjen që nxit brainstorming-un: Çfarë dini për secilin prej tyre? Jepni nga një shembull.

- Mësuesi/ja pret përgjigjet prej nxënësve...

Mësuesi/ja vazhdon: Shkenca që studion veçoritë fiziko-gjeografike dhe humane të një hapësire mbi bazë rajoni, quhet *gjeografi rajonale*. Ndarja e mëtejshme e një rajoni duke u bazuar në specifikat e shfaqura në brendësi të tij, çon në formimin e nënraioneve (p.sh. 5 nënrajonet e Evropës) dhe më tej, në krijimin e zonave më të vogla (p.sh. një zonë industriale, zonë banimi, zonë sportive, zonë tregtare etj.).

- Mësuesja u drejtohet nxënësve: Sillni shembuj të ngjashëm...

- Gjatë përgjigjeve të nxënësve... mësuesja i fton ata të përshkruajnë edhe figurat 1 dhe 2 të tekstit.

Mësuesi/ja vazhdon: Trajtimi rajonal i territorit (hapësirës) përbën një analizë të rëndësishme dhe mjaft të nevojshme, si në aspektin shkencor, ashtu edhe në atë praktik. Disa nga faktorët kryesorë që çojnë në rajonizimin gjeografik të hapësirës botërore janë:

- shpërndarja jo e njëjtë e burimeve natyrore;
- dallimet në aspektin demografik (ndryshimi i numrit të popullsisë, rritja e vazhdueshme e popullsisë urbane në krahasim me atë rurale, si dhe lëvizjet migratore midis vendeve);
- ndryshimet në nivelin e zhvillimit ekonomik midis vendeve ose në strukturën ekonomike të tyre;
- përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës rrugore, i cili e bën më të lehtë lidhjen dhe komunikimin e

	<ul style="list-style-type: none"> vendeve me tregjet rajonale, portet dhe aeroportet. <p>Studimi dhe analiza e territorit në aspektin rajonal ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në njohjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve natyrore, njerëzore dhe ekonomike që gjenden në të. Ato ndihmojnë gjithashtu edhe në ndërhyrjet përmirësuese, në përputhje me stadin e arritur dhe perspektivën e zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të vendeve.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin informacionin e tekstit duke vëzhguar figurat 3 dhe 4 dhe u kërkon nxënësve të përcaktojnë llojet e rajoneve. Në vazhdim i fton ata të paraqesin shembuj të ngjashëm.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Në vazhdim, nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 2 dhe 3 të tekstit, në rubrikën “Radha juaj”.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre: a) argumentojnë rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit; b) identifikojnë disa nga kriteret kryesore ku mbështetet rajonizimi gjeografik.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 1.2

► Ndërvarësia rajonale

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika I: Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal	Tema mësimore: I.2 Ndërvarësia rajonale		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Shpreh mendimin e vet për rritjen e ndërvarësisë rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Evropë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi domosdoshmërinë e bashkëveprimit midis rajoneve.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përdor konceptin e rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.			

- Identifikon tipat kryesorë të rajoneve në botë dhe ndërvarësia midis tyre.
- 3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)**
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.
 - Shpjegon kuptimin e sotëm evropian mbi rajonin, nën frymën e respektimit të diversitetit dhe ndërveprimit rajonal.
 - Argumenton rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integrimin e tij në BE.
- 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)**
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.
- 5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)**
- Ndan mendimet në grup.
- 6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)**
- Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.
- 7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)**
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integrimin e tij në BE.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi shpjegon kuptimin e sotëm evropian mbi rajonin, nën frymën e respektimit të diversitetit dhe ndërveprimit rajonal.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi sjell shembuj të rritjes së ndërvarësisë rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Evropë.

3. Marrja e vendimeve

Nxënësi përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.

Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:

Nxënësi/ja shpjegon:

- kuptimin e sotëm evropian mbi rajonin, nën frymën e respektimit të diversitetit dhe ndërveprimit rajonal;
- sjell shembuj të rritjes së ndërvarësisë rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Evropë;
- argumenton rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integrimin e tij në BE.

Fjalët kyçe: Ndërvarësia rajonale, një domosdoshmëri objektive; bashkëveprimi midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit njohin konceptet: a. rajon, veçoritë e rajoneve
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I. 2 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rëndësisë së ndërveprimit rajonal në botë/në Evropë; • rëndësisë së zhvillimit rajonal të vendit tonë si një nga kriteret kryesore për integrimin e tij në BE. <p>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë....</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë ndërvlerësinë rajonale, si një domosdoshmëri objektive: Shkëmbimet e shumta kulturore dhe ndërveprimi ekonomik ndërmjet vendeve e bëjnë hapësirën ku jetojmë, një sistem përherë e më të globalizuar. Në të njëjtën kohë, problematikat sociale dhe mjedisore që ndeshen në shtete të ndryshme, ndikojnë jo pak edhe në vende të tjera, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike. Kështu, rënia e standardit të jetesës, rritja e migracionit, shkeljet e të drejtave të njeriut, shfrytëzimi i grupeve të dobëta shoqërore, ksenofobia dhe konfliktet etnike e fetare janë disa nga problematikat sociale që kanë thelluar përherë e më shumë hendekun ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Krahës tyre, problemet mjedisore si: efekti serrë, ndryshimet klimatike, ndotja dhe shterimi i burimeve natyrore, i kanë kapërcyer kufijtë shtetërorë dhe rajonalë, çka kërkon bashkërendimin mes të gjitha vendeve për gjetjen e rrugëve të duhura për zgjidhjen e tyre.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të përshkruajnë figurën 1. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja	<p>Më pas vazhdon të trajtojë së bashku me nxënësit faktorët e tjerë që nxitin ndërvlerësimin mes rajoneve: faktorë të tjerë që nxitin ndërvlerësimin mes rajoneve janë zhvillimi gjithnjë e më i madh i rrjeteve të transportit dhe modernizimi i teknologjisë së informacionit (interneti, media etj.). Nëpërmjet tyre mundësohen komunikimi i shpejtë mes vendeve të ndryshme dhe qarkullimi në kohë reale i informacionit.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të sjellin modele ilustruese...</p> <p>Fton nxënësit të shohin modelin e paraqitur në libër (bashkëveprimi Francë-Gjermani) dhe hartat e figurave 3, 4, 5 dhe të diskutojnë rreth tyre dhe rreth domosdoshmërisë së bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet rajoneve...</p> <p>Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 1.3

► Kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika I: Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal		Tema mësimore: I.3 Kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Diskuton dhe interpreton zhvillimin e konceptit shqiptar për rajonin;Dëgjon me vëmendje interpretimet dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth konceptit mbi rajonin në Shqipëri.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Evidenton kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri;Vlerëson problematikat që shoqërojnë rajonizimin gjeografik të vendit tonë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Identifikon kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri;			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			

<ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. <p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri. 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike Nxënësi shpjegon kuptimin mbi konceptin rajon në Shqipëri, nën frymën e zhvillimeve rajonale dhe të ndërveprimit rajonal.</p> <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit Nxënësi identifikon kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri dhe problematikat që shoqërojnë atë në vendit tonë.</p> <p>3. Marrja e vendimeve Nxënësi vlerëson problematikat që shoqërojnë rajonizimin gjeografik të vendit tonë.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënës të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> interpretin zhvillimin e konceptit shqiptar për rajonin; identifikon kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri; vlerëson problematikat që shoqërojnë rajonizimin gjeografik të vendit tonë. 	<p>Fjalët kyçe: zhvillimi i konceptit të rajonit në Shqipëri; kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit njohin konceptet: a. rajon, veçoritë e rajoneve, ndërvarësia midis rajoneve.</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I. 3 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> rajonizimit të territorit shqiptar;

b. Ndërtimi i njohurive të reja

- disa veçorive mbi të cilat është bërë rajonizimi gjeografik i Shqipërisë.

Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë mbi rajonizimin aktual të territorit shqiptar; ndryshimet që solli krahasuar me atë të mëparshmin dhe mbi veçoritë mbi të cilat është bërë rajonizimi gjeografik i Shqipërisë...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë zhvillimin e konceptit të rajonit në Shqipëri: Ndonëse është një vend me sipërfaqe të vogël, Shqipëria dallon për diversitetin natyror dhe human brenda hapësirës së saj. Për njohjen dhe studimin e hollësishëm të saj, hapësira shqiptare ndahet në disa rajone, nënrajone dhe njësi më të vogla territoriale. Në vendin tonë, koncepti mbi rajonin ka evoluuar në varësi të zhvillimeve socio-ekonomike dhe atyre demografike. Përcaktimi i kufijve midis rajoneve dhe emërtimi i tyre kanë qenë produkt i studimeve dhe diskutimeve midis studiuesve të ndryshëm.

Në varësi të kriterëve mbi të cilat bëhet rajonizimi, hapësira shqiptare ndahet në rajone të ndryshme. Kur rajonizimi bëhet në bazë të kushteve natyrore të Shqipërisë, formohen katër rajone fiziko-gjeografike: Krahina Malore Veriore, Krahina Malore Qendrore, Krahina Malore Jugore dhe Ultësira Perëndimore.

Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë dhe të diskutojnë rreth këtij rajonizimi. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Në rastet kur rajonizimi i territorit bazohet vetëm në njërin prej elementeve natyrore (p.sh. ndërtimi gjeologjik, klima, bimësia etj.), formohen rajone gjeologjike, klimatike, bimore etj.

Mësuesja fton nxënësit të shohin hartat gjeologjike, klimatike, bimore etj., të Shqipërisë dhe të diskutojnë rreth këtyre rajonizimeve. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Kur rajonizimi bëhet mbi bazën e elementeve humane, formohen rajone ekonomike, kulturore, etnografike etj. Nëse qëllimi i rajonizimit është pasqyrimi i zhvillimit dhe i shpërndarjes së degëve të ndryshme të ekonomisë, rajonet që formohen janë: rajone industriale, bujqësore, turistike etj. Bazuar në traditat kulturore, Shqipëria ndahet në disa

	<p>rajone, si: Labëria, Myzeqeja, Dibra etj., ndërsa në bazë të dialekteve gjuhësore dallohen dy rajone (gegë dhe toskë), të cilat ndahen midis tyre nga lugina e Shkumbinit.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të shohin hartat ekonomike të Shqipërisë dhe të diskutojnë rreth këtyre rajonizimeve. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Me synimin për të shkuar drejt një rajonizimi të vetëm, Shqipëria është ndarë në <i>rajone gjeografike</i> (Rajoni Verior dhe Verilindor, Rajoni Juglindor, Rajoni Jugor dhe Rajoni Perëndimor), të cilat përfaqësojnë hapësira me veçori natyrore dhe humane qartësisht të dallueshme nga njëra-tjetra. Studimet e mëtejshme gjeografike mbi territorin shqiptar, zhvillimi ekonomik, dinamika e popullsisë dhe e urbanizimit të tij, mund të diktojnë në të ardhmen ndryshimin e përmasave dhe të emërtimeve të këtyre rajoneve.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike, të Shqipërisë dhe të diskutojnë rreth këtij rajonizimi. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Më pas vazhdon të trajtojë së bashku me nxënësit kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë:</p> <p>Rajonizimi gjeografik i Shqipërisë bazohet në disa kriteret, ndër të cilat më kryesoret janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kriteri i kompaktësisë së territorit</i>, i cili ka të bëjë me lidhjen kompakte të veçorive natyrore dhe humane brenda rajonit, që e bëjnë atë qartësisht të dallueshëm nga territoret fqinje; • <i>kriteri i shumësisë</i>, i cili nënkupton ndarjen e një rajoni në njësi më të vogla; ai duhet të përmbajë një numër elementesh gjeografike që kanë lidhje ndërvlerësie midis tyre; • <i>kriteri i përkatësisë historike dhe kulturore</i>, i cili lidhet me përputhjen midis shtrirjes së rajonit gjeografik dhe shtrirjes historike apo kulturore të tij; • <i>kriteri i kufijve konvencionalë</i>, i cili nënkupton shfrytëzimin e objekteve natyrore (lumë, kurriz malor ose kodrinor) si kufij ndarës të rajoneve. <p>Mësuesja fton nxënësit të sjellin modele ilustruese...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 3,4 dhe 5 të rubrikës “Radha juaj”.</p>
--	--

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare

► Tema 2.1

Pozita gjeografike e rajonit të Evropës dhe veçoritë natyrore të saj

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: II.1 Pozita gjeografike e rajonit të Evropës dhe veçoritë natyrore të saj	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përcakton pozitën gjeografike të Evropës.• Përshekruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Evropës.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës.• Vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të Evropës.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës.• Evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të Evropës.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.• Sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal midis rajoneve të Evropës.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të Evropës.			

<p align="center">Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Evropës. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Evropës dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal. 	
<p>Rezultatet e të nxënës të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Evropës; vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e rajonit të Evropës dhe roli i saj; kushtet natyrore; rajonizimi i Evropës</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. pozitës gjeografike të rajonit të Evropës</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 1 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të rajonit të Evropës dhe rolit të saj; - veçorive të relievit, hidrografisë dhe klimës së këtij rajoni. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të rajonit të Evropës dhe rolin e saj: Rajoni i Evropës shtrihet në Hemisferën Veriore, nga Oqeani i Ngrirë i Veriut në veri, deri në Detin Mesdhe (në jug), dhe nga Oqeani Atlantik në perëndim,</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

deri në rajonin e Rosisë në perëndim. Ngushtica e Gjibraltarit dhe ajo e Bosforit e ndajnë rajonin e Evropës me rajonin e Afrikës Veriore dhe të Azisë Jugperëndimore.

Rajoni i Evropës është zgjatim i kontinentit euroaziatik dhe karakterizohet nga një vijë bregdetare e gjatë dhe e përdhër, me shumë ishuj e gadishuj. Gadishujt më të mëdhenj janë: Gadishulli Skandinav, Iberik, Apenin dhe ai i Ballkanit, ndërsa nga ishujt dallojnë Groenlanda, Mbretëria e Bashkuar, Islanda etj.

Për shkak të pozitës gjeografike mjaft të favorshme, rajoni i Evropës dallohet si një prej hapësirave me ndikim të madh në botë. Vija e gjatë bregdetare dhe limanet e përshtatshme për ndërtimin e porteve kanë mundësuar lidhjen e rajonit si me vendet pranë, ashtu edhe me ato larg tij. Zbulimet e mëdha gjeografike, pushtimet koloniale gjatë shekujve të mëparshëm, si dhe lidhjet e shumta detare, kanë bërë që Evropa të jetë një prej rajoneve më të rëndësishme në zhvillimet ekonomike, politike, kulturore e demografike në botë. Për shekuj me radhë, pozita gjeografike e këtij rajoni ka ndikuar ndjeshëm në bashkëveprimin midis popujve evropianë dhe atyre të rajoneve të tjera të botës.

Lumenjtë e shumtë që përshkojnë territorin e rajonit, kanë krijuar një rrjet të dendur rrugësh të brendshme ujore e kanalesh të lundrueshme, të cilat mundësojnë lidhjen e pjesëve të ndryshme të Evropës dhe qarkullimin e shpejtë të mallrave e të njerëzve. Përveç lidhjes në rrugë ujore, përgjatë luginave të lumenjve janë ndërtuar autostrada dhe hekurudha të shumta, të cilat bëjnë të mundur lidhjen tokësore midis vendeve të rajonit.

Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe të diskutojnë rreth kushteve natyrore të saj.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Së bashku me nxënësit mësuesi/ja trajton kushtet natyrore të rajonit të Evropës: format kryesore të relievit të rajonit të Evropës janë malet, pllajat, rrafshnaltat dhe fushat (ultësirat), të cilat shtrihen pothuajse nga perëndimi në lindje, në trajtë zonash (fashash) të gjera...

Pozita gjeografike e rajonit dhe format e relievit kanë kushtëzuar edhe larminë e madhe klimatike të tij. Në pjesën jugore të rajonit mbizotëron *klima mesatare mesdhetare*, me dimër të butë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Pjesa qendrore e tij karakterizohet nga *klima mesatare*,

	<p>e cila në perëndim merr tipare <i>detare e oqeanike</i> dhe në lindje <i>kontinentale</i>, ndërsa në veri mbizotëron një <i>klimë e ftohtë</i> deri në <i>polare</i>. Me rritjen e lartësisë së relievit ndeshet edhe <i>klima malore</i>...</p> <p><i>Lumenjtë</i> janë një element i rëndësishëm i hidrografisë së Evropës. Një pjesë e tyre, si Luara, Sena, Reni, Elba, Danubi etj., janë të lundrueshëm. Lumi më i lundrueshëm i rajonit është Reni, ndërsa lumi më i gjatë është Danubi. Krahast lumenjve, në rajonin e Evropës gjendet edhe një numër i madh <i>liqenesh</i> me origjinë, madhësi, moshë dhe lartësi të ndryshme mbi nivelin e detit...</p> <p>Rajoni i Evropës dallon për larminë e botës së gjallë dhe llojet e ndryshme të tokave. Kështu, në territoret polare (në Norvegji dhe Finlandë) shtrihet <i>zona e tundrës</i>, me toka të varfra dhe të ngrira në pjesën më të madhe të vitit. Në këtë zonë rriten kryesisht myshqet, likenet, mështekna e dëllinja.</p> <p>Në zonën e tajgës (në gjerësitë gjeografike 45-55°) shtrihet <i>zona e pyjeve të përziera</i>, ku drurët gjethembajtës përzihen me ata gjetherënës. Ndër ta dallohen: pisha, bredhi, ahu, bungu, frashri, bliri etj. Llojet kryesore të tokave janë ato të murrme (me 5-6 % humus), ndërsa kafshët që rriten në këtë zonë janë: ariu i murrme, kaprolli evropian, ujku, dhelpra, lepu i murrme dhe ai i bardhë etj.</p> <p>Më në jug të tajgës shtrihet <i>zona stepo-pyjore dhe stepore</i>, me shtrirje më të madhe në Evropën Lindore (sidomos në Ukrainë), por edhe në Ultësirën e Panonisë, në atë të Vllahisë e deri në Rrafshin e Kosovës. Pjesën më të madhe të kësaj zone e përbëjnë tokat e zeza dhe ato kafe, të cilat janë të thella, të pasura me humus dhe, si të tilla, të përshtatshme për kultivimin e drithërave dhe bimëve industriale.</p> <p>Më në jug të zonës stepore shtrihet <i>zona mesdhetare</i>, ku gjenden të gjitha katet e bimësisë dhe rritet një botë shtazore e pasur (ujore dhe tokësore). Tokat që ndeshen më tepër në këtë zonë janë ato të kafenjta, të murrme, të kuqe dhe aluvionale.</p> <p>Më pas mësuesi/sja përcakton në hartë rajonet gjeografike të Evropës dhe vendet që bëjnë pjesë në secilën prej tyre: Larmia e kushteve natyrore, diversiteti i trashëgimisë kulturore dhe veçoritë e zhvillimit ekonomik të vendeve të Evropës, kushtëzojnë ndarjen e këtij rajoni në pesë <i>nërrajone gjeografike</i>: Evropa Veriore, Evropa Perëndimore, Evropa Ishullore, Evropa Mesdhetare, Evropa Lindore.</p>
--	--

	<p>Në Evropën Veriore bëjnë pjesë: Norvegjia, Suedia, Finlanda, Islanda, Danimarka dhe Estonia. Në Evropën Perëndimore përfshihen: Gjermania, Franca, Monakoja, Beneluksi (Belgjika, Luksemburgu e Holanda), Zvicra dhe Austria. Evropa Ishullore përbëhet nga dy shtete: Britania e Madhe dhe Irlanda. Vendet që bëjnë pjesë në Evropën Mesdhetare janë: Portugalia, Spanja, Italia, Greqia, Malta, Andorra, San Marinoja dhe Vatikani. Nënrajoni i Evropës Lindore përfshin: Letoninë, Lituaninë, Bjellorusinë, Moldavinë, Ukrainën, Çekinë, Sllovakinë, Hungarinë, Rumaninë, Bullgarinë, Slloveninë, Kroacinë, Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Kosovën. Bazuar në pozitën gjeografike, vendet e Evropës Lindore që shtrihen në Gadishullin e Ballkanit, si Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bullgaria dhe Rumania, njihen edhe si vende të Evropës Juglindore.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1,2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.2

► Tiparet kryesore të kulturës, popullsisë dhe ekonomisë së Evropës

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.2 Tiparet kryesore të kulturës, popullsisë dhe ekonomisë së Evropës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan tiparet më të përgjithshme demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			

- Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës dhe të kushteve natyrore të saj në zhvillimin ekonomik të saj.

3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.
- Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës.
- Analizon tiparet më të përgjithshme demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.
- Sjell shembuj të rolit që ka luajtur rajoni i Evropës në zhvillimet botërore.

5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

- Ndan mendimet në grup.

6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.

7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

- Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme, demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

- Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Evropës dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës.

3. Marrja e vendimeve

- Nxënësi argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike dhe të kushteve natyrore të Evropës në zhvillimin e saj dhe në marrëdhëniet me rajonet e tjera të botës.

Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:

Nxënësi/ja:

- përshkruan tiparet më të përgjithshme, demografike, ekonomike dhe kulturore të Evropës;

Fjalët kyçe: bashkëveprimi i hershëm kulturor i Evropës me rajonet e tjera të botës; zhvillimet kryesore në Evropën e kohëve moderne, popullimi i rajonit, ekonomia e rajonit.

Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK



Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth: a. pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të rajonit të Evropës</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 2 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qytetërimeve të hershme evropiane dhe ndikimit të tyre në kulturën e rajonit e më gjerë; - dinamikës së popullsisë së rajonit; - zhvillimit të vendeve të rajonit dhe degëve kryesore të ekonomisë. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qytetërimet e hershme evropiane dhe ndikimet e tyre në kulturën e rajonit evropian e më gjerë;
	<ul style="list-style-type: none"> - zhvillimet kryesore të rajonit të Evropës gjatë shek. XV-XX. <p>Më pas ata analizojnë dhe diskutojnë mbi: qytetërimet e para evropiane (qytetërimi grek i viteve 800-86 pr.K. e ai romak i viteve 100 pr.K. - 450 ps.K.) dhe mbi “<i>Magna Cartën</i>” (e vitit 1215, e cilësuar si guri i themelit të kushtetutës britanike)..., mbi ndikimin e kulturave të vendeve të tjera të botës mbi atë evropiane (kryesisht në ekonominë bujqësore, artizanat, arkitekturë e në kulturë) dhe mbi zhvillimet kryesore të rajonit të Evropës gjatë shek. XV-XX.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit ti referohen hartës dhe grafikut që paraqesin dendësinë e popullsisë së Rajonit të Evropës dhe së bashku me ta trajton veçoritë e popullimit dhe të ekonomisë në këtë rajon.</p> <p><u>Popullimi i rajonit:</u> Për shkak të pozitës së mirë gjeografike dhe kushteve natyrore, Evropa është një ndër rajonet më të populluara në botë (me dendësi mesatare rreth 33 b/km²). Rajoni dallohet gjithashtu për shpërndarjen e pabarabartë të popullsisë. Dendësinë mesatare më të madhe të popullsisë e kanë</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

nënrajoni i Evropës Perëndimore (me 177 b/km²) dhe ai i Evropës Mesdhetare (me 117 b/km²), ndërsa dendësinë më të ulët e ka Evropa Lindore (me 16 b/km²). Zona

(fasha) që përfshin Britaninë e Madhe, Francën Veriore, Holandën, Gjermaninë, Italinë dhe vazhdon drejt Varshavës e Bukureshtit deri në Ukrainë, dallohet për dendësinë më të madhe të popullsisë (shih hartën).



Ekonomia e rajonit

Pjesa më e madhe e industrive të rajonit të Evropës është e përqendruar në Anglinë Jugore, vendet e Beneluksit, Gjermaninë Perëndimore, Francën Lindore, Zvicër dhe në Italinë Veriore. Degët kryesore të industrisë janë: industria e prodhimit të makinave, industria e lehtë dhe ushqimore, industria kimike dhe farmaceutike, industria e prodhimit të pajisjeve elektroshtëpiake, industria e prodhimit të *software*-ve dhe pajisjeve elektronike, si dhe industria e përpunimit të drurit. Në sektorin e ekonomisë bujqësore, Evropa dallohet për kultivimin e drithërave (kryesisht grurë, misër e thekër), patates, bimëve industriale, agrumeve, ullinjve, frutikulturës, perimeve, luleve dhe drurëve dekorativë, si dhe për mbarështimin e gjedhit, të bagëtisë së imët dhe të shpendëve. Vendet me dalje të gjerë në Detin e Veriut, në Oqeanin Atlantik dhe në Detin Mesdhe, kanë të zhvilluar

	<p>gjithashtu sektorin e peshkimit.</p> <p>Në rajonin e Evropës janë të zhvilluara të gjitha llojet e turizmit: bregdetar, malor, historik, kulturor dhe turizmi i gjelbër. Në Greqi, Itali, Spanjë, Francë, Zvicër, Gjermani, Kroaci, në Malin e Zi dhe së fundmi edhe në Shqipëri, gjendet një numër i madh qendrash turistike bregdetare, malore, kulturore dhe historike, të cilat tërheqin shumë turistë. Krahas tyre, për numrin e madh të turistëve dallojnë Milanoja dhe Parisi, të cilat janë dy prej qendrave më të rëndësishme të industrisë së modës në botë.</p> <p>Rajoni i Evropës ka një sektor të zhvilluar financiar dhe sistem bankar të konsoliduar. Në shumë qytete evropiane, si Londra, Frankfurti, Zyrihu dhe Milanoja nëpërmjet qendrave të bursës realizohen shkëmbime financiare mes korporatave më të mëdha në botë.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë hartën dhe grafikun...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 5.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.3

► Hapësira shqiptare në Evropën Juglindore dhe në Mesdhe

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.3 Hapësira shqiptare në Evropën Juglindore dhe në Mesdhe	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan duke përcaktuar në hartë, pozitën gjeografike të trevave shqiptare dhe përbërjen e tyre.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e tyre dhe në zhvillimin ekonomik.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			

<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. • Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të trevave shqiptare dhe rolin rajonal të hapësirës shqiptare. • Evidenton përbërjen e trevave shqiptare. <p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. • Sjell shembuj mbi rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare në zhvillimin ekonomik të saj. <p>5. Kompetenca personale (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare, përbërjen e tyre dhe rolin rajonal të hapësirës shqiptare. 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi përcakton në hartë dhe përshkruan pozitën gjeografike të trevave shqiptare dh përbërjen e tyre. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të trevave shqiptare dhe rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe në zhvillimin ekonomik të tyre. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi analizon dhe vlerëson rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare e përbërjen e tyre, si dhe rolin rajonal të hapësirës shqiptare. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Ballkan, Mesdhe, Evropë e më gjerë dhe të vlerëson rolin e kësaj pozite; • evidenton përbërjen e trevave shqiptare; • vlerëson rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik të tyre. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike dhe përbërja e trevave shqiptare; roli i pozitës gjeografike të trevave shqiptare; roli rajonal i hapësirës shqiptare</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	

<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth: a. pozitës gjeografike dhe përbërjes së trevave shqiptare.</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe atë të trevave shqiptare, si dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 3 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përbërjes së trevave shqiptare; - pozitës gjeografike të trevave shqiptare dhe rolit të saj në kushtet natyrore, në popullimin dhe në zhvillimin ekonomik të tyre. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën dhe lexojnë në tekst mbi: pozitën gjeografike, përbërjen e trevave shqiptare dhe rolin e pozitës gjeografike. Më pas ata analizojnë dhe diskutojnë rreth: pozitës gjeografike dhe përbërjes së trevave shqiptare.</p> <p>Trevat shqiptare shtrihen në gjerësitë mesatare të Hemisferës Veriore, në Evropën Juglindore, në perëndim të Gadishullit Ballkanik, me një dalje të gjerë në Detin Mesdhe (nëpërmjet deteve Adriatik dhe Jon).</p> <p>Hapësira shqiptare shtrihet nga lartësitë e Alpeve Shqiptare dhe maleve të Kopaonikut në veri, deri në Gjirin e Ambrakisë (nga Tivari në veri e deri në Prevezë në jug) dhe që prej brigjeve të deteve Adriatik e Jon në perëndim, deri në luginën e Moravës së Jugut dhe luginës së Vardarit në lindje.</p> <p>Në aspektin natyror, trevat shqiptare përbëjnë një hapësirë gjeografike kompakte, ndërsa në aspektin politik, ato gjenden të ndara në shtete të ndryshme...</p> <p>Nxënësit përcaktojnë në hartë përbërjen e trevave shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Republika e Shqipërisë; • Republika e Kosovës; • trevat shqiptare në Republikën e Malit të Zi (Tivari, Ulqini, Tuzi, Plava, Gucia, Hoti, Gruda, Rozhaja, Kraja, Ana e Malit, Shpuza); • trevat shqiptare në Republikën e Serbisë (Presheva, Bujanovci dhe Medvegja);

b. Ndërtimi i njohurive të reja

- trevat shqiptare në Maqedoni (Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Dibra, Kërçova, Struga, Ohri, Prilepi, Manastiri etj.);
- trevat shqiptare në Republikën e Greqisë (Çamëria, Follorina, Kosturi, Grebeneja, Konica etj.).

Së bashku me nxënësit mësuesja argumenton rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare:

Ndikimi në kushtet natyrore

Trevat shqiptare ndodhen në gjerësitë mesatare të Hemisferës Veriore. Ato kanë dalje të gjerë në Detin Mesdhe në perëndim dhe shtrihen drejt qendrës së Ballkanit në lindje. Kjo vendndodhje gjeografike sjell një larmi të kushteve natyrore dhe krijon një hapësirë të përshtatshme për jetesë. Për shkak të ndikimit të masave ajrore detare, në pjesën perëndimore të trevave shqiptare ndeshen tiparet mesdhetare të klimës, hidrografisë, tokave, botës bimore dhe shtazore. Pjesa lindore e tyre, si rezultat i masave ajrore që vijnë nga brendësia e Gadishullit të Ballkanit, karakterizohet nga tipare kontinentale.

Rëndësia strategjike

Në raport me hapësirën ballkanike, trevat shqiptare kanë një pozicion gjeografik mjaft strategjik, pasi shtrihen në kryqëzimin e rrugëve që lidhin Evropën Perëndimore dhe atë Mesdhetare me vendet e Evropës Lindore e më gjerë, me hapësirën aziatike. Në këto treva kalojnë rrugët më të shkurtra detare dhe tokësore, të cilat lidhin Perëndimin me Lindjen dhe mundësojnë transportin e shpejtë të mallrave dhe të njerëzve. Distanca më e shkurtër detare që ndan hapësirën shqiptare nga Italia është Kanali i Otrantos (72 km i gjatë). Luginat e lumenjve Drin, Mat, Shkumbin, Vjosë etj., krijojnë nga perëndimi në lindje korridore të shumta, përgjatë të cilave kalojnë rrugë që lidhin Detin Adriatik me territoret në brendësi të Ballkanit, ndërkohë që luginat e Ibrit, Sitnicës, Lepencit etj., mundësojnë lidhjen e trevave shqiptare me korridoret ballkanike.

Portet përgjatë vijës bregdetare të Adriatikut dhe Jonit kanë mundësuar që në periudhat e hershme lidhjen e trevave shqiptare me qendra të rëndësishme në brendësi të Gadishullit të Ballkanit e më gjerë (me Nishin, Shkupin, Sofjen, Kosturin, Selanikun e deri në Kostandinopojë). Një ndër arteriet më të rëndësishme tokësore ishte rruga “Egnatia”, e cila përbënte edhe linjën kryesore të komunikimit midis Perëndimit dhe Lindjes (nga Roma deri në Kostandinopojë).

Sot, një nga akset më të rëndësishme që lidhin midis tyre trevat shqiptare është autostrada Durrës-Kukës-Morinë

(Rruga e Kombit), vazhdim i së cilës është autostrada Vermicë - Merdare. Nëpërmjet këtij aksi synohet gjithashtu komunikimi rajonal midis vendeve përgjatë brigjeve të Adriatikut dhe atyre në brendësi të kontinentit evropian.

Në periudha të ndryshme, për shkak të pozicionit të tyre gjeografik (midis Lindjes dhe Perëndimit) trevat shqiptare janë bërë shpesh objekt pushtimi nga perandoritë e ndryshme (romake, bizantine, otomane), apo edhe arenë luftërash e betejash (gjatë dy luftërave botërore). Për rrjedhojë, ato kanë pësuar ndryshime edhe në hartën politike.

Sot, pozita gjeografike e trevave shqiptare ka një rëndësi strategjike, pasi mundëson përfshirjen e tyre në projekte të rëndësishme rajonale, të cilat lidhen kryesisht me infrastrukturën, tregtinë dhe energjetikën. Një rast i tillë është edhe përfshirja e Shqipërisë në projektin TAP.

Rëndësia ekonomike

Pozita gjeografike e trevave shqiptare mundëson zhvillimin e disa degëve të rëndësishme të ekonomisë, si: bujqësia, blegtoaria, peshkimi, turizmi, energjetika, industria ushqimore, tregtia dhe transporti. Po kështu, larmia e klimës krijon kushtet e përshtatshme për kultivimin e të gjitha bimëve bujqësore (drithëra, ullinj, agrume, fruta e perime, vreshta, bimë industriale), si dhe për mbarështimin e gjedhit, bagëtisë së imët, derrit dhe shpendëve. Dalja në dete dhe rrjeti i dendur i lumenjve e liqeneve mundësojnë zhvillimin e peshkimit.





Për shkak të vijës së gjatë bregdetare, biodiversitetit dhe trashëgimisë së pasur kulturore, në trevat shqiptare janë të zhvilluara të gjitha llojet e turizmit. Reshjet e mëdha që bien gjatë vitit, krijojnë rezerva ujore që përdoren në hidroenergjetikë, ndërsa kulturat e ndryshme bujqësore dhe prodhimet blegtorale mundësojnë zhvillimin e industrisë ushqimore. Si rezultat i pozicionit strategjik që zënë në Evropën Juglindore, trevat shqiptare kanë mundësi të mëdha për zhvillimin e tregtisë dhe të të gjitha llojeve të transportit. Pozita gjeografike mundëson gjithashtu përfshirjen e trevave shqiptare në projekte të ndryshme rajonale, duke sjellë përfitime të konsiderueshme ekonomike.

Rëndësia social-kulturore: Për shkak të popullimit të tyre të hershëm, trevat shqiptare janë bërë pjesë e rëndësishme e kulturës evropiane mesdhetare. Në trojet e veta, popullsia shqiptare ka ndërtuar gjatë shekujve një kulturë autentike, ku identifikohen qartë tiparet që dëshmojnë vazhdimësinë iliro-arbërore-shqiptare. Si rezultat i shtrirjes gjeografike midis Lindjes dhe Perëndimit, trevat shqiptare përbëjnë gjithashtu hapësira të bashkëveprimit të kulturave të ndryshme. Për shkak të pushtimeve të hershme të këtyre trevave nga perandoritë e Lindjes dhe të Perëndimit, si dhe lidhjeve të vazhdueshme tregtare, në kulturën e trashëguar ndër breza ndeshen edhe elemente të ndikimit kulturor të vendeve të tjera. Këto elemente vihen re në fushën e besimeve fetare, në disa tradita familjare, në kulinari, muzikë, artizanat etj.

Në vazhdim mësuesi/ja evidenton rolin rajonal të hapësirës shqiptare

Pas anëtarësimit në NATO, në prill të vitit 2009, Shqipëria ka fituar një status të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare, si rezultat i bashkëpunimit në rritje me strukturat e sigurisë rajonale dhe globale. Sot, ajo është bërë pjesë e procesit të reformave të rëndësishme për të përmbushur të gjitha kushtet si vend kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

	<p>Ndërkohë, Republika e Kosovës ka nënshkruar Marrëveshjen e Asocim-Stabilizimit me Bashkimin Evropian.</p> <p>Duke konsideruar bashkëpunimin rajonal si një parakusht për integrimin në strukturat euro-atlantike, Shqipëria dhe Kosova po luajnë një rol aktiv dhe konstruktiv në këtë drejtim. Ato janë anëtare të forumit më të rëndësishëm politik të Evropës Juglindore, i cili quhet “Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore” (SEECP). Ky forum është krijuar në qershor të vitit 1996 dhe synon bashkëpunimin e të gjitha vendeve të rajonit për ruajtjen e paqes e të stabilitetit dhe për zhvillimin ekonomik, politik e shoqëror. Në vitin 2001, Shqipëria ka qenë kryesuesja e radhës e SEECP-it.</p> <p>Për Shqipërinë dhe Kosovën, bashkëpunimi rajonal nuk përfaqëson thjesht vullnetin politik për një fqinjësi të mirë, por edhe përpjekjet për krijimin e një infrastrukture të përbashkët rajonale, çka do të sjellë rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe të bashkëpunimit ekonomik e kulturor.</p> <p>Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p>	<p>Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre dhe plotësojnë kllasterin e mëposhtëm:</p> <div data-bbox="445 1033 1255 1738"> <div data-bbox="445 1033 816 1246"> <p>Pozita gjeografike</p> <p>Trevat shqiptare shtrihen në gjerësitë mesatare të Hemisferës Veriore. Ato ndodhen në Evropën Juglindore, të vendosura në perëndim të Gadishullit Ballkanik.</p> <p>Lartësitë e Alpeve Shqiptare të Mokrës dhe të Kopaonikut, i krijojnë trevave një kufi natyror verior, ndërsa kufiri jugor i tyre shkon deri në gjirin e Ambrakisë. Kufirin perëndimor e përbëjnë brigjet e de-teve Adriatik dhe Jon (që nga Tivari në veri e deri në Prevezë në jug), ndërsa atë lindor lugina e Moravës së Jugut dhe lugina e Vardarit.</p> </div> <div data-bbox="830 1139 939 1246"> <p>Pozita gjeografike trevave shqiptare dhe roli i saj</p> </div> <div data-bbox="953 1033 1255 1333"> <p>Përbërja e trevave shqiptare</p> <p>Në përbërje të trevave shqiptare hyjnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Republika e Shqipërisë; • Republika e Kosovës; • Trevat shqiptare në Republikën e Malit të Zi: (Tivari, Ulqini, Tuzi, Plava, Gucia, Hoti, Gruda, Rozhaja, Kraja, Anamali, Shpuza); • Trevat shqiptare në Republikën e Serbisë: (Presheva, Bujanovci dhe Medvegja); • Trevat shqiptare në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: (Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Strugë, Ohër, Manastir, etj.); • Trevat shqiptare në Republikën e Greqisë: (Çamëria, Follorina, Kosturi, Grebenea, Konica etj.); </div> <div data-bbox="445 1284 747 1516"> <p>Rëndësi ekonomike sepse: mundëson zhvillimin e disa degëve të ekonomisë. Ajo është e përshtatshme për kultivimin e shumë kulturave bujqësore, për të gjitha llojet e turizmit, për industrinë energjitike, peshkimin, treg-tinë dhe të gjitha llojeve të transportit. Përfshirja në projekte rajonale infrastrukturore, tregëtare dhe energjitike, sjell gjithashtu përfitime ekonomike edhe nga pozicioni tranzit në to.</p> </div> <div data-bbox="761 1429 898 1738"> <p>Rëndësi nga pikëpamja natyrore sepse: krijojnë kushte të favorshme e të përshtatshme për jetesë. Behen të pranishme: tiparet mesdhetare dhe kontinentale të klimës, të hidrografisë, të tokave, të botës bimore e shtazore etj.</p> </div> <div data-bbox="912 1342 1255 1535"> <p>Rëndësi social-kulturore sepse: trevat shqiptare që në lashtësi janë bërë pjesë e rëndësishme përbërëse e kulturës së hershme mesd-hetare, me një kulturë unike. I ka bërë trevat shqiptare si hapësira të këmbimit të kulturave të ndryshme dhe të ndikimit të disa elementëve kulturor midis vendeve.</p> </div> <div data-bbox="912 1545 1255 1738"> <p>Rëndësi strategjike sepse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhin Mesdheun Perëndimor me vendet e Ballkanit dhe të Azisë së Vogël, përmes daljes në Kanalin e Otrantos dhe të Korfuzit. - Lehtësojnë lidhjen e pjesëve të brendshme të Ballkanit me Detin Adriatik përmes luginave lumore (Drin, Shkumbin, Vjosë, Fan, Lepenc, etj) që përshkojnë tërthor sipërfaqen e trevave. </div> </div>

Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.
-----------------------------	---

Tema 2.4

► Ndryshimet e hartës politike të trevave shqiptare përgjatë shekujve

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.4 Ndryshimet e hartës politike të trevave shqiptare përgjatë shekujve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan disa prej ndryshimeve që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare në ndryshimet që ka pësuar harta politike e trevave shqiptare.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare.Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
<u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi përcakton në hartë dhe përshkruan ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare.			
<u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare në ndryshimet që ka pësuar harta politike e trevave shqiptare.			

3. Marrja e vendimeve <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare. 	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare; 	Fjalët kyçe: Harta politike e trevave shqiptare në antikitet; harta politike e trevave shqiptare gjatë mesjetës; harta politike e trevave shqiptare pas periudhës së Shpalljes së Pavarësisë, statusi politik i sotëm i trevave shqiptare.
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit dinë: <ol style="list-style-type: none"> harta politike e trevave shqiptare ka pësuar ndryshime në kohë dhe në hapësirë; harta e sotme politike e trevave shqiptare është rezultat i vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër.
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe atë të trevave shqiptare, si dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 4 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> shtrirjes gjeografike të fiseve ilire; ndryshimeve që pësoi harta politike e trevave shqiptare nga vendimet e Konferencës së Londrës. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja nxit një brainstorming me pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Cila është përbërja e trevave shqiptare dhe çfarë pozite gjeografike kanë? Çfarë rëndësie ka pozita gjeografike e trevave shqiptare? Listo argumente. Pse trevat shqiptare janë të copëtuara në disa shtete? A ka pësuar aktualisht ndryshime harta politike e trevave shqiptare? <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesja fton nxënësit që duke iu referuar hartave të tekstit mësimor dhe atyre të ekspozuara në klasë të lexojnë në tekst mbi: ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare. Më pas së bashku me nxënësit trajtohet informacioni i ri duke realizuar vazhdimin komunikim interaktiv me nxënësit. Gjatë trajtimit të informacionit bëhet edhe plotësimi i kllasterit të mëposhtëm:

Pse ka ndryshuar harta politike e trevave shqiptare?

Ndryshimet e herë pas hershme, kanë ardhur si rezultat i ndikimit e i ndërthurjes së *faktorëve politikë dhe historiko-shoqërorë*.

Harta politike e trevave shqiptare në kohën antike

Në kohën antike, pjesa perëndimore e Ballkanit banohej nga ilirët, një nga popujt më të mëdhenj të gadishullit.

Ilirët shtriheshin që nga lumi Sava në veri deri tek gjiri i Ambrakisë në jug dhe që nga rrjedhja e lumenjve Moravë e Vardar në lindje deri në brigjet e Adriatikut e Jonit në perëndim. Ata kishin formuar bashkësitë fisnore që në shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit para erës sonë.

Në shek.VI-V p.e.sonë në Ilirinë e Jugut lindin formacionet e para shtetërore, pra lindi dhe shteti ilir.

Pas një periudhe të gjatë lulëzimi, fuqizimi e luftërash, në vitin 168 para.e.sonë, shteti Ilir ra nën sundimin Romak dhe më pas u nda në katër provinca: Prevali, Dardania, Epiri i Ri dhe Epiri i Vjetër.

Statusi i sotëm politik i trevave shqiptare dhe e ardhmja e tyre

Në 17 Shkurt 2008 Kosova u shpall republikë e pavarur, tashmë e njohur nga shumë shtete. Komunitat Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje, janë pjesë e Serbisë

Një pjesë tjetër e trevave shqiptare është pjesë e Republikës së Maqedonisë (pjesa perëndimore), pjesa tjetër në veri është pjesë Republikës së Malit të Zi dhe pjesa në jug, si pjesë e Republikës së Greqisë.

Harta politike e trevave shqiptare nga shek XIV- 1912

Në shek XV trevat shqiptare u ndanë në disa principata të drejtuara nga familjet e mëdha shqiptare: e Topiajve, e Balshajve, e Muzakajve, e Zenebishëve dhe e Shpatajve. Në mesin e shek. XIV, nisën sulmet osmane për pushtimin e viseve shqiptare dhe pas një shekulli qëndrese, trualli shqiptar ra nën sundimin e plotë osman. Ato u përfshinë në elajetin e Rumelisë dhe u ndanë në nëntë sanxhakë. Në vitet 60 të shek XV, u dallua për qëndresën kundër osmanëve, shteti i Skënderbeut. Në fundin e shek. XVIII e në fillimin e shek. XIX, filluan përpjekjet për shkëputjen e Shqipërisë nga sundimi osman dhe për formimin e një shteti shqiptar dhe në vitin 1912, u shpall Pavarësia e Shqipërisë.

Harta politike e trevave shqiptare gjatë shekujve V-XIV

Pas ndarjes së Perandorisë Romake, trevat iliro-shqiptare hynë në përbërje të Perandorisë Bizantine, gjatë sundimit të së cilës (në shek. IV-VII të e.s.) u prekën nga dyndjet e popujve. Gjatë këtij sundimi ato u ndanë mbi bazë themash (të Durrësit, të Nikopojës, të Dalmacisë e të Selanikut).

Në shek. XI- XII, u krijuan formacione autonome të fisnikëve shqiptarë ku u dallua më tepër formacioni shtetëror i Arbrit. Në shek. XIII, Shqipëri (Albania) dhe shqiptarë (Albanenses) quheshin trevat dhe popullsia që shtrihet nga kufijtë e Dioklesë (Gentës) në veri, deri në gjirin e Prevezës në jug.

Harta politike e trevave shqiptare nga shek XIV- 1912

Në shek XV trevat shqiptare u ndanë në disa principata të drejtuara nga familjet e mëdha shqiptare: e Topiajve, e Balshajve, e Muzakajve, e Zenebishëve dhe e Shpatajve. Në mesin e shek. XIV, nisën sulmet osmane për pushtimin e viseve shqiptare dhe pas një shekulli qëndrese, trualli shqiptar ra nën sundimin e plotë osman. Ato u përfshinë në elajetin e Rumelisë dhe u ndanë në nëntë sanxhakë. Në vitet 60 të shek XV, u dallua për qëndresën kundër osmanëve, shteti i Skënderbeut. Në fundin e shek. XVIII e në fillimin e shek. XIX, filluan përpjekjet për shkëputjen e Shqipërisë nga sundimi osman dhe për formimin e një shteti shqiptar dhe në vitin 1912, u shpall Pavarësia e Shqipërisë.

Ndryshimet e hartës politike të trevave shqiptare në vitin 1913

Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, u mor vendimi përfundimtar mbi kufijtë politikë të trevave shqiptare: që në atë moment e në vazhdim, mbetën jashtë kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë gjysma e territoreve shqiptare. Ato u ndanë midis Ser-bisë, Malit të Zi e Greqisë.

Hapi II: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup
Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.5

► Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Kosovës

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.5 Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Kosovës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore).			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Kosovës.• Evidenton tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore).			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare.• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			

<p align="center">Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përcakton në hartë pozitën gjeografike të Kosovës dhe kushtet natyrore të saj. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës. Vlerëson trashëgiminë natyrore të Kosovës. 	
<p>Rezultatet e të nxënës të temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> analizon tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore); analizon trashëgiminë natyrore të Kosovës. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e Republikës së Kosovës, veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgimi natyrore</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <p>a. ndryshimet që ka pësuar harta e sotme politike e trevave shqiptare (shpallja e Kosovës republikë e pavarur).</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin II.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Hapi I : Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë e vendosur në fillim të mësimin II.5 në tekst, të përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Kosovës dhe të diskutojnë rreth tyre.</p> <p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> pozitës gjeografike të Republikës së Kosovës; kushteve natyrore të saj. <p>Mësuesi/ja mund të japë edhe disa të dhëna plus në ndihmë të nxënësve.</p>

Koordinatat gjeografike të Republikës së Kosovës		
	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike
Veri	20° 48' 42''	43° 16' 23''
Perëndim	20° 52' 38''	42° 43' 45''
Jug	20° 37' 17''	41° 51' 07''
Lindje	21° 47' 23''	42° 39' 04''

Vendet me të cilat kufizohet Republika e Kosovës	Gjatësia e vijës kufitare që ndan Republikën e Kosovës nga shtetet me të cilat kufizohet	Pikat kufitare të trafikut rrugor me secilin prej vendeve	Pikat kufitare të trafikut hekurudhor me secilin prej vendeve
Me Republikën e Shqipërisë	113 551 km	Vermica; Qafa e Prushit; Qafa e Morinës (përveç këtyre, në raste festash funksionojnë edhe 2 pika kufitare të përkohshme: Krushevë dhe Orçushë)	—
Me Republikën e Maqedonisë	170 772 km	Hani i Elezit; Gllloboçica	Hani i Elezit
Me Republikën e Malit të Zi	79 165 km	Kulla	—
Me Republikën e Serbisë	380 068 km	Bërmjak; Jarinje; Merdare; Mutivodë; Dheu i Bardhë; Muçibabë	Leshaku dhe Merdare (jashtë funksionit)
Gjithsej	743 556 km	13 pika kufitare të përhershme dhe 2 të përkohshme	

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesja trajton sëbashku me ta informacionin e ri:

Ndërtimi gjeologjik. Trualli i Republikës së Kosovës ka një ndërtim gjeologjik të larmishëm, me formacione që u përkasin periudhave të ndryshme gjeologjike. Pjesa më e madhe e truallit përbëhet prej strukturës së albanideve dhe vetëm një pjesë e vogël e tij në lindje përbëhet nga struktura e vjetër e Rodopeve. Si rezultat i evolucionit gjeologjik, në truallin e Kosovës gjenden si shkëmbinjtë kristalinë të erës proterozoike, ashtu edhe shkëmbinjtë e rinj të Kuaternarit. Përhapje më të madhe kanë shkëmbinjtë sedimentarë dhe magmatikë, ndërsa ata metamorfikë janë më pak të përhapur. Shumëllojshmëria e shkëmbinjve përcakton edhe praninë e rezervave të shumta minerare...

Relievi. Format kryesore të relievit të Republikës së Kosovës janë malet dhe fushëgropat, ku malet zënë rreth 63% të tij, ndërsa fushëgropat, rreth 37%. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 810 m. Pika më e ulët e relievit (270 m mbi nivelin e detit) ndodhet në luginën e Drinit të Bardhë, ndërsa më e larta është në malin Gjeravica (2656 m mbi nivelin e detit). Lartësitë më të mëdha arrijnë në Bjeshkët e Nemuna, Pashtrik, Koritnik, Kopaonik etj.

	<p>Midis fushëgropave dallohet Fusha e Kosovës, Lugu i Dukagjinit, Fusha e Drenicës, Fusha e Llapit etj. Ato shtrihen kryesisht në perëndim e në lindje të Kosovës dhe rrethohen nga malet.</p> <p>Klima. Në klimën e Kosovës ndikojnë pozita gjeografike, masat ajrore, pozicioni i sistemeve barike (maksimumi i Azoreve dhe minimumi i Islandës), relievi, hidrografia dhe bimësia. Shtrirja e saj gjeografike në jug të brezit mesatar të Hemisferës Veriore dhe drejt brendësisë së Gadishullit Ballkanik, bën që klima të jetë nën ndikimin e masave ajrore mesdhetare dhe atyre kontinentale. Në pjesën më të madhe të sipërfaqes së Kosovës, klima është mesatare kontinentale. Në jug të Fushës së Dukagjinit shfaqen tipare të klimës mesdhetare, ndërsa me rritjen në lartësi ndeshet klima malore.</p> <p>Hidrografia. Republika e Kosovës ka një rrjet të dendur lumor, i cili dallon për luhatjet e mëdha të prurjeve dhe të niveleve të tyre. Drini i Bardhë, Ibri, Morava dhe Lepenci, që e përshkojnë në drejtime të ndryshme territorin e Kosovës, derdhen në tri dete (Detin Adriatik, Detin e Zi dhe Detin Egje). Pellgjet ujëmbledhëse të tyre ndahen në malin e Nerodimës. Në Kosovë gjenden edhe liqene akullnajore, sidomos në malet e Sharrit, liqene lumore (në lumin Mirusha) dhe liqene artificiale të ndërtuara përgjatë rrjedhave të lumenjve të ndryshëm. Zonat malore dhe fushore kanë burime të shumta, ndër të cilat dallohen burimi i Drinit të Bardhë, ai i Istogut etj.</p> <p>Tokat. Llojet kryesore të tokave janë: humusore, humusore silikate, toka të hirta acide skeletore, toka argjilore, toka aluviale dhe toka shkëmbore.</p> <p>Bota e gjallë. Në territorin e Kosovës gjenden rreth 1800 lloje bimësh, ndër të cilat, rreth 200 lloje janë endemike dhe subendemike. Në zonat e ulëta ndeshen: akacia, mani i zi dhe ai i bardhë, lisi i zi, plepi kanadez, dafina, ahu etj. Në brezin e drurëve gjetherënës (900-1500 m) gjenden: bredhi, gështenja, dëllinja, pisha e zezë dhe ajo e bardhë etj. Në lartësitë 1500 - 2200 m gjendet brezi i kullotave malore. Në Kosovë gjenden edhe rreth 230 lloje kafshësh, ku dallohet ariu i murrmë, kaprolli, ujku, shqarthe i bardhë, dhelpra, dhia e egër, derri i egër etj. Midis shpendëve dallohen fazani, thëllëza e fushës, korbi i murrmë etj. Zonat me faunën më të shumëllojshme janë Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst informacionin mbi rajonet gjeografike dhe trashëgiminë natyrore. Më pas</p>
--	---

	<p>nxënësit diskutojnë rreth tyre. Gjatë trajtimit të informacionit bëhet edhe plotësimi i plotë i kllasterit.</p> <p>Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1,2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.6

► Popullsia e Kosovës dhe trashëgimia kulturore e saj

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.6 Popullsia e Kosovës dhe trashëgimia kulturore e saj	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.Përcakton shpërndarjen gjeografike të popullsisë.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson trashëgiminë kulturore të Kosovës.Evidenton shpërndarjen gjeografike të popullsisë së Kosovës.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës.Analizon strukturën dhe ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të saj.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			

<ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton trashëgiminë kulturore të Kosovës dhe tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson trashëgiminë kulturore të Kosovës. Analizon strukturën, ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës. Analizon strukturën, ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> analizon trashëgiminë kulturore të Kosovës; analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Kosovës; strukturën dhe ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët); shpërndarjen gjeografike të popullsisë. 	<p>Fjalët kyçe: trashëgimia kulturore, dinamika e popullsisë, shpërndarja e popullsisë dhe faktorët që ndikojnë në të, struktura e popullsisë.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pozitën gjeografike të Republikës së Kosovës dhe tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të saj (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore). Vlera të trashëgimisë natyrore të Kosovës.

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Veprimet në situatë

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit II.6 në tekst, diskutojnë mbi popullimin e Kosovës në periudha të ndryshme historike dhe trashëgimisë kulturore të saj.

Diskutojmë rreth:

- popullimit të Kosovës në periudha të ndryshme historike;
- trashëgimisë kulturore të saj.


Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesja fton nxënësit të lexojnë mbi popullimin e hershëm dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës.

Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë...

Në vazhdim mësuesja trajton informacionin e ri mbi: dinamikën e popullsisë, shpërndarjen e popullsisë e faktorët që ndikojnë në të dhe strukturën e popullsisë



Regjistrimi i parë i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës është bërë në vitin 1921, ndërsa ai i fundit, më 2011-ën. Sipas CENSUS-it të vitit 2011, numri i popullsisë së Kosovës ishte 1 739 825 banorë. Ndër vite, numri i popullsisë ka pësuar vazhdimisht rritje, kryesisht prej ritmeve të larta të shtimit natyror. Vlerat më të larta të shtimit natyror kanë qenë deri në vitin 1971. Pas këtij viti, ritmet e shtimit natyror


	<p>të popullsisë kanë qenë më të ulëta. Sot, vlera e shtimit të popullsisë është 12,4 o/oo, ku lindshmëria është 17,2 o/oo, ndërsa vdekshmëria 4,8 o/oo. Kosova dallon për moshën e re të popullsisë, ku mosha mesatare është 30,2 vjeç (CENSUS, prill 2011).</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë grafikun mbi numrin e popullsisë në Kosovë (në vite)</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Një ndikim të madh në numrin e popullsisë, sidomos gjatë dekadave të fundit, ka pasur emigracioni i jashtëm, kryesisht drejt vendeve të Evropës Perëndimore (sidomos drejt Gjermanisë dhe Zvicrës). Faktorët kryesorë që kanë nxitur emigracionin lidhen me kushtet ekonomike, politike dhe sociale. Nivelin më të lartë ai e arriti gjatë viteve 1990-1999, për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë, nga ku emigroi rreth 15-20% e popullsisë, shumica e grup-moshës 18-35 vjeç. Dekadën e fundit emigracioni i popullsisë luhet midis shifrave 10 000 – 15 000 persona në vit.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë grafikun mbi emigracionin e popullsisë në Kosovë.</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Republika e Kosovës është rajoni me dendësinë më të madhe të popullsisë në të gjitha trevat shqiptare dhe me dendësi mesatare 163 banorë/km². Shpërndarja e popullsisë është e pabarabartë, ku dendësinë më të madhe të popullsisë (deri në 420 banorë/km²) e kanë fushëgropat, kryesisht Fusha e Kosovës dhe qendrat e mëdha urbane (sidomos Prishtina), ndërsa dendësinë më të vogël, zonat malore (me 25-50 banorë/km²).</p> <p>Shpërndarja e popullsisë së Kosovës është e lidhur ngushtë me faktorët natyrorë, socio-ekonomikë dhe politikë. Ndër faktorët natyrorë dallojnë: sipërfaqja e madhe e tokës bujqësore, rezervat e shumta ujore, si dhe klima e përshtatshme.</p> <p>Ndër faktorët kryesorë socio-ekonomikë veçojmë: shpërndarjen e degëve të ekonomisë, nivelin e zhvillimit të infrastrukturës, largësinë nga institucionet arsimore, shëndetësore, kulturore etj.</p> <p>Faktorët politikë lidhen ngushtë me politikat demografike të ndjekura në Kosovë gjatë kohës që ajo ishte pjesë e ish-Jugosllavisë, si dhe me konfliktet e armatosura për pavarësinë e saj.</p>
--	---

Struktura sipas grupmoshës. Rreth 28% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës është nën moshën 15 vjeç; rreth 64% e saj i përket popullsisë aktive (15-64 vjeç), dhe grupmosha mbi 65 vjeç përbën rreth 8% të popullsisë.

Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë grafikun.


Mësuesi/ja vazhdon: *Struktura sipas gjinisë.* Rreth 50,5% të popullsisë së përgjithshme e përbëjnë meshkujt dhe rreth 49,5% femrat. Ky raport thuajse i barabartë mes tyre lidhet me faktin se, ndonëse në Kosovë lindin më shumë meshkuj sesa femra, jetëgjatësia e këtyre të fundit është më e lartë sesa jetëgjatësia e meshkujve (deri në 70 vjet për femrat dhe 67 vjet për meshkujt).

Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë grafikun.



Mësuesi/ja vazhdon: *Struktura etnike.* Popullsia e përgjithshme e Republikës së Kosovës (sipas vlerësimeve të ESK-së) përbëhet nga 92% shqiptarë dhe pjesa tjetër janë pakica etnike, të cilat janë rezultat i zhvillimeve historike dhe i politikave të përdorura në Kosovë. Rreth 5,3 % janë pakica serbe, 1,2 % boshnjake e malazeze, 1,1 % rome dhe 0,4 % pakica turke.

Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë grafikun.



	<p>Mësuesi/ja vazhdon: <i>Struktura sipas vendbanimeve</i>. Në popullsinë e përgjithshme, popullsia rurale zë përqindje më të lartë se ajo urbane. Megjithatë, pas Luftës së Dytë Botërore e në vazhdim, popullsia urbane ka pësuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 1945, popullsia urbane përbënte 20% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës; më 1991-in, rreth 37%; sot, ajo përbën rreth 43% të saj. Rritja e numrit të qendrave urbane është shoqëruar edhe me disa pasoja negative, si: mungesa e infrastrukturës, ndërtimet informale apo pa planimetri të studiuar, shfrytëzimi joracional i tokës bujqësore dhe ndotja e mjedisit.</p> <p>Më pas nxënësit diskutojnë rreth tyre.</p> <p>Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3, 4 dhe 5 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 1 te rubrika: “Mbroni një pikëpamje”.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.7

► Ekonomia e Republikës së Kosovës

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.6 Ekonomia e Republikës së Kosovës	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit të degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit.Evidenton, me ndihmën e hartës, diferencimin rajonal të Republikës së Kosovës.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson trashëgiminë kulturore të Kosovës dhe akset e drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset e mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit.Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.

5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

- Ndan mendimet në grup.

6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.

7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

- Nxënësi evidenton, me ndihmën e hartës, diferencimin rajonal të Republikës së Kosovës dhe akset e drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

- Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë e shkallën e zhvillimit të tyre.
- Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë, akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian.

Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:

Nxënësi/ja:

- zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit;
- evidenton, me ndihmën e hartës, diferencimin rajonal të Republikës së Kosovës;
- vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian;

Fjalët kyçe: ekonomia bujqësore, sektori industrial, tregtia, turizmi, transporti dhe artizanati

Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Nxënësit dinë:

- Pozitën gjeografike të Republikës së Kosovës dhe tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të saj (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore).
- Vlera të trashëgimisë natyrore e kulturore të Kosovës.

Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 7 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimet në situatë

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit II.6 në tekst, diskutojnë mbi natyrën e ekonomisë së Kosovës dhe rolin e kushteve natyrore në zhvillimin e saj si dhe fushave të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Diskutojmë rreth:

- natyrës së ekonomisë së Kosovës dhe rolit të kushteve natyrore në zhvillimin e saj;
- fushave të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë.


Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesja fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit mbi: ekonominë bujqësore, sektorin industrial, tregtinë, turizmin, transportim dhe artizanatin.

Në vazhdim fton nxënësit të diskutojnë rreth tyre.

Nxënësit diskutojnë dhe plotësojnë kllasterin...



	Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 1 te rubrika: “Mbroni një pikëpamje”.
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.8

► Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.8 Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare.Identifikon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Evidenton dhe vlerëson veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale.Analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare.			
<u>3. Kompetenca e të nxënësve (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare.Analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare.Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			

<p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon kushtet natyrore dhe tiparet kryesore të zhvillimit demografik e social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale; analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e trevave shqiptare në Serbi dhe në Maqedoni, kushtet natyrore, popullimi dhe ekonomia e trevave shqiptare në Serbi, kushtet natyrore, popullimi dhe ekonomia e trevave shqiptare në Maqedoni</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit njohin:</p> <p>a. Pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Serbi dhe në Maqedoni</p>
	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 8 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit II. 8 në tekst, diskutojnë mbi pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Serbi dhe në Maqedoni; kushteve natyrore dhe rolin e tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave.</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pozitës gjeografike të trevave shqiptare në Serbi dhe në Maqedoni; • kushteve natyrore dhe rolit të tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesja së bashku me nxënësit trajtojnë në mënyrë interaktive kushtet natyrore dhe rolin e tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave.</p> <p>Gjatë trajtimit përdoret harta e trevave shqiptare: Format kryesore të relievit të trevave shqiptare në Serbi janë malet, kodrat dhe fushëgropat tektonike.</p> <p>Relievi kodrinoro-malor gjendet në të dyja anët e lumit Morava, ndërsa fushëgropat tektonike janë fushëgropa e Bujanovcit dhe ajo e Preshevës.</p> <p><i>Ndërtimi gjeologjik.</i> Trevat shqiptare në Serbi bëjnë pjesë në zonën e rrudhosjes së masivit të Rodopeve. Në zonën kodrinoro-malore mbizotërojnë shkëmbinjtë metamorfikë e sedimentarë të paleozoit (mermerë, dolomite etj.), ndërsa në fushëgropa mbizotërojnë kryesisht shkëmbinjtë sedimentarë të neogjenit (ranorë, argjilorë, konglomerat).</p> <p><i>Klima</i> në këto treva është kontinentale, për shkak të ndikimit të masave ajrore të ftohta që vijnë nga lugina e Moravës dhe atyre më të ngrohta, të ardhura nga lugina e Vardarit. Temperatura mesatare vjetore është 11,5°C dhe sasia mesatare e reshjeve shkon deri në 637 mm në vit.</p> <p><i>Hidrografia</i> përfaqësohet me lumenjtë Morava e Jabllanica dhe me burimet termominerale kurative (me temp. rreth 69°C) të Banjës së Sijarinës e të Banjës së Bujanovcit.</p> <p><i>Popullimi.</i> Shumicën e popullsisë në këto treva, rreth 62%, e përbëjnë shqiptarët. Komuna e Preshevës ka numrin më të lartë të popullsisë shqiptare (85%), ndërsa komuna e Medvegjës, atë më të ulët, 26,8%. Dendësia mesatare e popullsisë së këtyre trevave është rreth 80 banorë/km². Ndër to, për dendësinë më të madhe të popullsisë dallohet Komuna e Preshevës, me 129 banorë/km². Trevat shqiptare dallojnë për shtimin natyror, i cili lidhet ngushtë me lindshmërinë e lartë, 20/1000 banorë. Në strukturën e popullsisë sipas moshës, mbizotëron popullsia me moshë të re. Emigracioni,</p>
---	---

sidomos i të rinjve, ka qenë përherë prezent.

Dega kryesore e *ekonomisë* është bujqësia, me të cilën merret rreth 70% e popullsisë. Zonat kryesore bujqësore janë fushëgropa e Preshevës dhe ajo e Bujanovcit, të cilat dallohen për kultivimin e drithërave dhe të duhanit. Presheva dallohet për industrinë e përpunimit të duhanit, të materialeve të ndërtimit dhe të pijeve joalkoolike, ndërsa Bujanovci, për përpunimin e ujit mineral dhe industrinë e përpunimit të produkteve ushqimore. Në Medvegje, ku sipërfaqja e tokës bujqësore është e vogël, dega kryesore është blegtoria.

Kushtet natyrore, popullimi dhe ekonomia e trevave shqiptare në Maqedoni

Format kryesore të *relievit* të këtyre trevave janë malet, kodrat, fushëgropat dhe luginat. Midis maleve dallojnë vargu malor i Sharrit (2747 m), mali i Stegovës, i Bistrës, i Jabllanicës, i Galiçicës etj., ndërsa fushëgropat më të mëdha janë: fushëgropa e Pellagonisë, e Pollogut, e Shkupit, e Prespës dhe ajo e Dibrës. Fushëgropa e Pollogut (460-500 m mbi nivelin e detit) ka një shtrirje gjatësore me drejtim jugperëndim-verilindje, midis vargut malor të Sharrit dhe Malit të Thatë, dhe përbëhet nga fushat pjellore të Tetovës dhe të Gostivarit. Fushëgropa përshkohet nga lumi Vardar, i cili në këtë pjesë është fushor dhe me shtrat të gjerë. Fushëgropa e Pellagonisë është fushëgropa më e madhe dhe më e lartë e Maqedonisë (600 m mbi nivelin e detit). Pjesët përbërëse të saj janë fushëgropa e Prilepit dhe ajo e Manastirit. *Fushëgropa e Shkupit* e cila gjendet midis maleve të Sharrit e të Karadakut në veri dhe malit Jakupica në jug, është fushëgropa me lartësinë më të vogël mbi nivelin e detit (230 m). Ajo përshkohet nga lugina e Vardarit, e cila ndikon ndjeshëm në veçoritë e klimës së saj.

Ndërtimi gjeologjik i trevave shqiptare të Maqedonisë është i larmishëm. Strukturat mbizotëruese janë ato horst (malet) dhe graben (fushëgropat). Në pjesën perëndimore të këtyre trevave mbizotërojnë shkëmbinjtë e paleozoikut, ndërsa në pjesën lindore, shkëmbinjtë e masivit të vjetër të Rodopeve. Nëntoka është e pasur me linjit dhe hekur. *Klima* në këto treva është kontinentale, si pasojë e ndikimit të masave ajrore që vijnë nga brendësia e gadishullit.

Hidrografia përfaqësohet nga lumenjtë dhe liqenet, ku dallojnë: Drini i Zi, Vardari, Radika e Lumi i Zi, Liqeni i Ohrit, ai i Prespës së Madhe (me origjinë tektoniko-karstike) dhe liqenet akullnajore të Sharrit.

Bimësia e këtyre trevave dallon për diversitetin e saj,

	<p>sidomos për sipërfaqet pyjore dhe për kullotat malore.</p> <p><i>Popullimi.</i> Shifrat zyrtare të regjistrimit të popullsisë (janë ende ato të vitit 2002) tregojnë se në Republikën e Maqedonisë jetojnë 509 083 shqiptarë, të cilët përbëjnë 25,17% të popullsisë së përgjithshme. Të dhënat jozyrtare tregojnë se sot, numri i popullsisë shqiptare në Maqedoni është edhe më i madh. Për numrin dhe dendësinë më të madhe të popullsisë shqiptare dallohet fushëgropa e Pollogut. Kështu, në regjistrimin e vitit 2002, shqiptarët e komunës së Tetovës përbënin 72,25% të popullsisë së përgjithshme dhe ata të Gostivarit, 59,01%. Ndërkohë, në fushëgropën e Pellagonisë, ku shtrihen qyteti i Prilepit dhe ai i Manastirit, numri i popullsisë shqiptare është ulur ndjeshëm.</p> <p><i>Ekonomia</i> e këtyre trevave dallon për zhvillimin e ekonomisë bujqësore, turizmit, zejtarisë, si dhe për prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe për eksportin e produkteve të brumit. Në nëntokën e këtyre trevave gjenden edhe rezerva linjiti, të cilat shfrytëzohen kryesisht për prodhimin e energjisë. Fushëgropat dallohen për zhvillimin e bujqësisë, që mbështetet kryesisht në fermat e shumta, prodhimet cilësore të së cilave shkojnë në tregun vendas dhe për eksport. Kulturat kryesore janë: drithërat, perimet, prodhimet e frutikulturës dhe të vreshtarisë, foragjeret etj. Zonat malore të këtyre trevave dallojnë për mbarështimin e gjedhit, si dhe për bletarinë e peshkimit. Një degë tjetër e rëndësishme është turizmi, i cili përfaqësohet me turizmin liqenor, malor dhe atë kulturor. Përgjatë Liqenit të Ohrit shtrihen qyteti i Strugës dhe ai i Ohrit, të cilat dallojnë për cilësinë e shërbimit dhe vlerat e veçanta turistike. Në qytetin e Ohrit është ndërtuar edhe një aeroport. Tetova, si një qendër e rëndësishme ekonomike, arsimore, kulturore dhe administrative, është një destinacion tjetër turistik, i njohur për objektet e shumta kulturore e historike dhe për qendrën rekreative-turistike “Kodra e Diellit”, e cila gjendet në malin e Sharrit. Një qendër e njohur turistike është edhe komuna e Manastirit, ku, më 14-22 nëntor 1908 u zhvillua Kongresi i Manastirit, i cili miratoi alfabetin latin të gjuhës shqipe me 36 shkronja.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë/vlerësojnë...</p> <p>Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1,2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 1 te rubrika: “Mbroni një pikëpamje”.</p>
--	--

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.9

► Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë (vazhdim)

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.9 Trevat e tjera shqiptare jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë (vazhdim)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare.• Identifikon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Evidenton dhe vlerëson veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale.• Analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare.• Analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare.• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			

<p align="center">Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon kushtet natyrore dhe tiparet kryesore të zhvillimit demografik e social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale. 	
<p>Rezultatet e të nxënës të temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale; analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare. 	<p>Fjalët kyçe: Pozita gjeografike e trevave shqiptare në Mal të Zi dhe në Greqi; kushtet natyrore, popullimi dhe ekonomia e trevave shqiptare në Mal të Zi; kushtet natyrore, popullimi dhe ekonomia e trevave shqiptare në Greqi.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit njohin:</p> <p>a. Pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Mal të Zi dhe në Greqi;</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.9 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit II.9 në tekst, diskutojnë mbi pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Mal të Zi dhe në Greqi; kushteve natyrore dhe rolit të tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave;</p> <p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> pozitës gjeografike të trevave shqiptare në Mal të Zi dhe në Greqi; kushteve natyrore dhe rolit të tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave.

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesja së bashku me nxënësit trajtojnë në mënyrë interaktive kushtet natyrore dhe rolin e tyre në popullimin dhe ekonominë e këtyre trevave.</p> <p>Gjatë trajtimit përdoret harta e trevave shqiptare:</p> <p><i>Relievi</i> i trevave shqiptare në Malin e Zi është kryesisht malor dhe lartësinë më të madhe e arrin në Alpet Shqiptare, shpatet e të cilave janë të thepisura e të modeluara nga veprimtaria akullnajore, lumore dhe eolike. Në pjesën jugore e juglindore të komunës së Ulqinit dhe në zonën e Tuzit gjenden disa fusha të vogla. Midis brigjeve të Liqenit të Shkodrës në veri dhe vijës bregdetare të Ulqinit e Tivarit në jug shtrihet krahina e Anës së Malit, ajo e Krajës dhe krahina e Ulqinit.</p> <p>Ulqini ka dalje në bregdet, sipërfaqe fushore, klimë të butë dhe rrjedha ujore.</p> <p>Malësia e Madhe është një zonë malore, me lartësi 800-1700 m mbi nivelin e detit, me sipërfaqe shkurresh e kullotash dhe përshkohet nga lumi Cem. Qendra kryesore e kësaj zone, që në mesjetë njihej me emrin <i>Pult</i>, është Tuzi.</p> <p>Krahina e Plavës dhe e Gucisë përbëhet nga pllaja e kodra me lartësi 900-1000 mbi nivelin e detit. Hidrografia e saj përbëhet nga lumenjtë Lim e Lucë dhe liqeni akullnajor i Plavës. Ajo ka klimë kontinentale, me reshje bore. Krahina e Rozhajës shtrihet midis maleve të larta, me sipërfaqe pyjore e kullota. Qendra administrative, ekonomike, arsimore dhe shëndetësore e kësaj krahine është Rozhaja, e cila ka lidhje automobilistike me Republikën e Kosovës.</p> <p><i>Ndërtimi gjeologjik.</i> Trevat shqiptare në Malin e Zi dallohen për praninë e shkëmbinjve gëlqerorë të mesozoit dhe të atyre ranorë në zonat bregdetare.</p> <p><i>Klima</i> që mbizotëron në këto treva është mesatare mesdhetare. Me rritjen e lartësisë ndeshet klima malore. Trevat bregdetare dallohen për nivelin e diellzimit, i cili është më i lartë në komunën e Ulqinit (me 2700 orë me diell në vit). Temperatura mesatare vjetore e zonave bregdetare është 25°C dhe rënia e dëborës është një dukuri shumë e rrallë. Me rritjen e lartësisë, klima bëhet malore, me dimër të ashpër dhe verë të shkurtër e të freskët, ku ndeshen edhe reshje bore.</p>
---	--

Hidrografia përfaqësohet me Liqenin tektoniko-karstik të Shkodrës, liqenin akullnajor të Plavës dhe lumenjtë e shkurtër e malorë të Cemit, Lucës dhe Limit.

Bimësia e këtyre trevave është mesdhetare, ku dallohen të gjitha katet e bimësisë. Në brezin e shkurreve mesdhetare (që shkon deri në 400 m lartësi) gjenden makjet (dafina, gjineshtra, sherbela, rozmarina). Në këtë brez kultivohen edhe fiku e ulliri. Në brezin e dushqeve mbizotëron bungu dhe kultivohen gështenja, rrushi dhe frutat (dardha, molla e kumbullat). Në krahinën e Plavës e të Gucisë dhe në atë të Rozhajës, shpatet e maleve janë të mbuluara me sipërfaqe pyjore dhe kullota alpine.

Popullimi. Në trevat shqiptare në Malin e Zi banojnë rreth 47 700 shqiptarë, të cilët përbëjnë rreth 7% të popullsisë së përgjithshme. Pothuajse gjysma e popullsisë shqiptare jeton në Ulqin. Një ndikim të ndjeshëm në dinamikën e popullsisë shqiptare në Malin e Zi ka pasur emigracioni i saj, i cili është rritur edhe më shumë pas vitit 1966, kryesisht drejt vendeve të Evropës Perëndimore, ShBA-së, Kanadasë dhe Australisë.

Ekonomia e këtyre trevave mbështetet kryesisht në ekonominë bujqësore, turizëm, në ekonominë pyjore etj. Turizmi përfaqësohet nga ai bregdetar, malor dhe kulturor. Një destinacion turistik i rëndësishëm është Ulqini. Rreth 1-2 km larg bregdetit burojnë ujëra minerale sulfurike, të cilat dallojnë për vetitë e tyre kuruese.

Kushtet natyrore, popullimi dhe ekonomia e trevave shqiptare në Greqi

Format kryesore të *relievit* në trevat shqiptare në Greqi janë malet, kodrat, fushat dhe luginat. Fushat kryesore janë fusha e Llurit, e Frarit, e Gardhiqit etj. Vija bregdetare është kryesisht shkëmbore dhe e përthyer, ku dallohen gjire të shumta, si ai i Sajadhës, Igumenicës, Pllatares, Pargës dhe i Artës. Në grykëderdhjet e lumenjve krijohen edhe brigje të ulëta me plazhe ranore.

Ndërtimi gjeologjik. Trualli i këtyre trevave përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë dhe preket vazhdimisht nga aktiviteti sizmik. *Klima* është tipike mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë e me dimër të butë dhe të lagësht, për shkak të ndikimit të masave ajrore që vijnë nga Mesdheu. Me rritjen në lartësi ndeshet klima malore. *Hidrografia* përbëhet nga lumenj të shkurtër e malorë, me regjim mesdhetar të prurjeve, që rrjedhin në drejtime të ndryshme e derdhen kryesisht në Detin Jon. Dallohen lumenjtë: Kalama, Uji i Zi, Lluri, Arta etj. Në këto treva kalon dhe rrjedha e sipërme

	<p>e lumit të Aliakmonit, i cili buron nga mali Gramoz dhe derdhet në Detin Egje. Të pranishme janë edhe liqenet, si ai i Kosturit dhe i Janinës. <i>Tokat</i> më të përhapura janë tokat e hirta kafe, që shtrihen deri në lartësinë 600 m. Mbi këtë lartësi formohen tokat e murrme pyjore dhe livadhore malore. <i>Bimësia</i> është tipike mesdhetare. Sipërfaqe më të mëdha zënë shkurret e pyjet mesdhetare dhe dushqet, ndërsa halorët dhe kullotat alpine gjenden në sipërfaqe më të vogla. Tipike për këtë brez, është kultivimi i ullinjve, agrumeve, vreshtave dhe frutave. <i>Bota shtazore</i> ka tipare mesdhetare dhe përbëhet nga specie të shumëllojshme.</p> <p>Në numrin e <i>popullsisë</i> shqiptare të këtyre trevave kanë ndikuar disa faktorë, ku më kryesorët janë faktori demografik dhe ai historiko-shoqëror. Emigrimet dhe shpërnguljet e vazhdueshme të grupmohës së re dhe zbatimi i politikave të vendosjes në këto treva të familjeve greke, ka sjellë uljen e numrit të popullsisë shqiptare dhe rënien e ritmeve të shtimit natyror të saj. Dendësia mesatare e popullsisë shqiptare në këto treva është 31 banorë/km². Për dendësinë më të madhe dallohet krahina e Çamërisë, me 40 banorë/km².</p> <p><i>Ekonomia</i> e këtyre trevave mbështetet kryesisht tek ekonomia bujqësore, turizmi, përpunimi i produkteve bujqësore-blegtorale dhe artizanati. <i>Ekonomia bujqësore</i> dallohet për kultivimin e ullinjve, agrumeve, vreshtave e drithërave, për mbarështimin e bagëtisë së imët dhe për bletarinë e peshkimin. Banorët e këtyre trevave merren kryesisht me përpunimin e produkteve blegtorale, si qumështi, djathi, vera, vaji i ullirit etj. <i>Turizmi</i> dhe <i>shërbimet</i> kanë kushte shumë të mira për zhvillim, për shkak të peizazheve natyrore e bregdetare dhe trashëgimisë së pasur kulturore e historike. <i>Artizanati</i> dallohet për prodhimin e produkteve artizanale të leshit dhe të lëkurës. Kosturi është një qendër e njohur në rajon për prodhimin e peliçeve.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë/vlerësojnë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 2.10

► **Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë. Organizimi administrativo-territorial i saj**

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 2: Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare		Tema mësimore: 2.10 Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë. Organizimi administrativo-territorial i saj	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë.Evidenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe evropian.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë. Argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe evropian.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
<u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit.përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë.			

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë. 	
3. Marrja e vendimeve <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe evropian. 	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit; përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë; analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë; argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe evropian. 	Fjalët kyçe: Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë, Rëndësia e pozitës gjeografike, Format e organizimit administrativ të territorit të Republikës së Shqipërisë.
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit njohin: <ul style="list-style-type: none"> a. Pozitën gjeografike të Republikës së Shqipërisë.
	Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II. 10 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit II. 10 në tekst, diskutojnë rreth pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë dhe rolit të saj si dhe të organizimit të sotëm administrativo-territorial të Shqipërisë.</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Diskutojmë rreth:

- pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë dhe rolit të saj;
- organizimit të sotëm administrativo-territorial të Shqipërisë.

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst njohuritë mbi pozitën gjeografike të Republikës së Shqipërisë dhe rolit të saj, si dhe mbi organizimin e sotëm administrativo-territorial të Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë

Rëndësia e pozitës gjeografike

Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë, ka rëndësi gjeografike, strategjike, ekonomike dhe social-kulturore.

Ka **rëndësi gjeografike**, sepse vendosja në gjerësitë mesatare subtropikale, me dalje në Detin Mesdhe në perëndim dhe e ekspozuar ndaj masave ajrore kontinentale në lindje, ndikon shumë në natyrën e klimës, të hidrografisë, të tokave dhe të botës së gjallë. Ka **rëndësi strategjike**, sepse në raport me hapësirën ballkanike, Shqipëria vlerësohet si “*porta e Ballkanit*”, pasi në të zë fill e kalon rruga më e shkurtër që lidh perëndimin me lindjen. Kjo e favorizon Shqipërinë në projektet rajonale (infrastrukturore, tregëtare dhe energjitike) dhe për një zhvillim më të shpejtë ekonomik. Ka **rëndësi ekonomike**, sepse pozicioni gjeografik i Shqipërisë mundëson kushte natyrore të favorshme që mundësojnë zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë (bujqësisë, industrisë, tregëtisë, transportit, turizmit, etj.).

Ka **rëndësi social-kulturore**, sepse pozicioni midis perëndimit dhe lindjes ka mundësuar jo vetëm lidhje tregëtare të Shqipërisë me vende të tjera fqinje, por edhe këmbime kulturore me to.

Format e organizimit administrativ në Republikën e Shqipërisë

Organizimi administrativ në RSH ka pësuar një sërë ndryshimesh, që nga Shpallja e Pavarësisë deri në vitin 2014, me zbatimin e Ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”. Këto ndryshime kanë reflektuar fazat e zhvillimit të shtetit dhe shoqërisë shqiptare.

Me zhvillimin e shtetit dhe të shoqërisë shqiptare kanë evoluuar edhe format e ndarjes administrative të tij, përmes futjes së koncepteve të reja si bashki, rreth, komunë, prefekturë, qark etj.

Me ndryshimet e ndodhura pas vitit 90’ e në vazhdim, shteti shqiptar ka synuar drejt standartizimit të kriterëve dhe të mënyrës së ndarjes së njësive territoriale, sipas përvojave më të mira evropiane. Kjo filloi që me nënshkrimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, në maj të vitit 1998, dhe vazhdon deri aktualisht, me miratimin e ligjit të vitit 2014 për ndarjen administrative të territorit. Sipas tij, njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë: bashki (61) dhe qarqe (12).

Në vazhdim, nxënësit diskutojnë/debatojnë rreth tyre. Gjatë diskutimeve plotësohet kllasteri:

Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë informacionin që jep leximi: Një historik i shkurtër i ndryshimeve që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 të rubrikës “Radha juaj”.

<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të republikës së Shqipërisë

Tema 3.1

► Larmia e peizazheve dhe ndërtimi gjeologjik i Shqipërisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika III:Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.1 Larmia e peizazheve të Shqipërisë dhe ndërtimi gjeologjik i saj	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja <ul style="list-style-type: none">përshkruan larminë e mjediseve dhe të peizazheve natyrore të Shqipërisë;analizon etapat e formimit të truallit, përbërjen litologjike dhe strukturore të tij.		Fjalët kyçe: ndërtimi gjeologjik, larmia peizazheve	
Burimet:Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetari, histori, TIK	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Shpreh mendimin e vet mbi ndërtimin gjeologjik dhe veçoritë e tij.Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth veçorive të pozitës gjeologjike.Përshkruan veçorive e ndërtimit gjeologjik, duke analizuar shembuj nga përbërja gjeologjike e truallit shqiptar.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Jep shembuj të ngjashëm ilustrues mbi veçoritë e ndërtimit gjeologjik, bazuar në ato që paraqiten si modele në libër.Shpjegon strukturën tektonike të truallit shqiptar.Vlerëson dhe argumenton rëndësinë e mjediseve dhe peizazheve natyrore të Shqipërisë.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Dallon dhe analizon llojet e ndryshme të shkëmbinjve që përbëjnë truallin shqiptar.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			

<ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. Identifikon strukturat tektonike që përbëjnë truallin shqiptar. <p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit të grupit shoqëror, si p.sh rreth rëndësisë së trajtimit të pozitës gjeologjike të truallit shqiptar. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi ndërtimin gjeologjik dhe veçoritë e tij. 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan larminë e mjediseve e të peizazheve natyrore të Shqipërisë, duke analizuar shembuj. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi hulumton, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht mbi ndërtimin gjeologjik dhe peizazheve natyrore të Shqipërisë. 3. Marrja e vendimeve Nxënësi analizon llojet e shkëmbinjve që përbëjnë truallin shqiptar dhe analizon etapat kryesore të formimit të albanideve. 	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në njohuritë e marra nga nxënësit në klasën e gjashtë dhe të tetë mbi ndërtimin gjeologjik:</p> <p>Trualli shqiptar përbëhet nga struktura gjeologjike që quhen albanide, të cilat bëjnë pjesë në brezin e rrudhosur alpino-mesdhetar, i formuar gjatë orogjenezës alpine. Albanidet janë pjesë e nënnjësisë Apenino-Dinaride-Albanide-Helenid-Touride, pra përfshihen në degëzimin jugor të zonës mesdhetare të sistemit të rrudhosur alpin.</p>
	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit III.1.</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I : Rrjeti i diskutimit</p> <p>- Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit III. 1 në tekst: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> llojeve të peizazheve të Shqipërisë dhe disa prej faktorëve që kanë ndikuar në formimin e tyre. llojeve të shkëmbinjve që përbëjnë truallin shqiptar.

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësit përshkruajnë, përkufizojnë...

Mësuesi/ja vazhdon: Hapësira shqiptare dallohet për larminë e madhe natyrore, me mjedise të ndryshme si ne drejtimin horizontal, nga perëndimi në lindje, ashtu edhe në drejtimin veri-jug. E gjithë kjo larmi mjediseshe dhe peizazhesh gjeografike është rezultat i bashkëveprimit të faktorëve të brendshëm (lëvizjet tektonike e neotektonike dhe strukturat gjeologjike) dhe atyre të jashtëm (klima, veprimtaria e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore e nëntokësore, bota e gjallë, veprimtaria njerëzore etj).

- Mësuesja u drejtohet nxënësve me pyetjen që nxit brainstorming-un: Çfarë dini për secilin prej tyre? Jepni nga një shembull.

- Mësuesi/ja pret përgjigjet prej nxënësve ...

Mësuesi/ja vazhdon: Larmia e peizazhit ndeshet që në vijën bregdetare shqiptare ,e përbërë nga forma të ulëta ranore e laguna, si dhe nga pjesë të larta shkëmbore e me faleza abrazioni, duke vazhduar drejt lindjes malet e larta në trajtën e vargjeve apo të zonave malore dhe malësi ,midis të cilave shtrihen lugina që modelojnë relievin malor , duke krijuar kontraste të mëdha morfometrike midis majave dhe kreshtave dhe fundit të luginave.

- Mësuesja u drejtohet nxënësve: Sillni shembuj të ngjashëm...

- Gjatë përgjigjeve të nxënësve, mësuesja i fton ata të përshkruajnë edhe figurat 1, 2, 3 dhe 4 të tekstit.

Mësuesi/ja vazhdon: Trualli shqiptar përbëhet nga struktura gjeologjike që quhen albanide, të cilat bëjnë pjesë në brezin e rrudhosur alpino-mesdhetar, i formuar gjatë orogjenezës alpine. Albanidet janë pjesë e nënnjesisë Apenino-Dinaride-Albanide-Helenid-Touride, pra përfshihen në degëzimin jugor të zonës mesdhetare të sistemit të rrudhosur alpin. Ato zënë kryesisht sektorin e brendshëm dhe pjesërisht sektorin e jashtëm të këtij degëzimi.

Evolucioni gjeologjik i albanideve (si pjesë e gjithë nënnjesisë) ka ndjekur drejtimin nga lindja në perëndim. Si pasojë e këtij evolucioni , sektori i brendshëm i tyre është më i vjetër dhe me një përhapje të madhe të shkëmbinjve magmatikë, ndërsa sektori i jashtëm është më i ri dhe përbëhet kryesisht prej shkëmbinjve sedimentarë.

	<p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin informacionin e tekstit duke vëzhguar figurën 5 dhe u kërkon nxënësve të përcaktojnë strukturat kryesore të albanideve dhe analizojnë evolucionin gjeologjik të tyre. Në vazhdim i fton ata të paraqesin shembuj të ngjashëm.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Në vazhdim, nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 3 dhe 4 të tekstit, në rubrikën “Radha juaj”.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/ gjetjet e tyre: a) analizojnë etapat kryesore të formimit të albanideve. b) evidentojnë zonat që përbëjnë sektorin e brendshëm dhe atë të jashtëm të albanideve.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 3.2

► Pasuritë minerare të truallit shqiptar

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika3:Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.2 Pasuritë minerare të truallit shqiptar	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Identifikon në hartë rezervat minerare të vendit tonë dhe shpërndarjen e tyre gjeografike.• Përshkruan veçorit kryesore te rezervave minerare që gjenden në truallin shqiptar.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeologjike në larminë e pasurive minerare.• Vlerëson rëndësinë e pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Argumenton rëndësinë e pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit.• Evidenton tiparet më të përgjithshme të pasurive minerare.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			

<ul style="list-style-type: none"> Sjell shembuj të përdorimit dhe të shfrytëzimit të pasurive të shumta minerare në vendin tonë. <p><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p><u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p><u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi pasuritë minerare të truallit shqiptar. 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme të rezervave minerare të Shqipërisë. <p><u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson rëndësinë e pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit. <p><u>3. Marrja e vendimeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson ndërvarësinë midis shfrytëzimit të pasurive minerare dhe zhvillimit ekonomik të vendit në ditët e sotme. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Identifikon rezervat minerare të vendit tonë dhe shpërndarjen e tyre gjeografike; përshkruan tiparet më të përgjithshme të minerareve që gjenden në truallin shqiptar; vlerëson rëndësinë e pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit. 	<p>Fjalët kyçe: pasuri minerare, lëndë djegëse, minerale metalore, minerale jometalore</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. rezervave të shumta minerare të vendit tonë</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit III. 2 në tekst - Diskutojmë rreth: -rezervave minerare të vendit tonë dhe shpërndarjes së tyre gjeografike;</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>-rolit të pasurive minerare në zhvillimin ekonomik të vendit. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me rezervat e shumta minerare në truallin shqiptar. Shumëllojshmëria e shkëmbinjve, e depozitimeve dhe e strukturave shkëmbore ka bërë që nëntoka shqiptare të dallohet për rezerva të shumta minerare. Bazuar në përdorimin industrial të tyre, mineralet ndahen në: lëndë të djegshme, minerale të dobishme metalore dhe minerale të dobishme jometalore. Këto rezerva minerare përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe shpërndarja e tyre është e lidhur ngushtë me evolucionin gjeologjik të truallit. Mineralet metalore gjenden kryesisht në pjesën lindore të vendit, ato të lëndëve të djegshme, në perëndim dhe jugperëndim, ndërsa mineralet jometalore dallohen për përhapjen e tyre në të gjithë vendin.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën e rezervave minerare dhe e industrive përpunuese në figurën 4. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p>
	<p>Së bashku me nxënësit, mësuesi/ja diskuton rreth shfrytëzimit të rezervave minerare në kushtet e ekonomisë së tregut. Nëntoka shqiptare është mjaft e pasur me rezerva minerare dhe zbulimi e shfrytëzimi i tyre përbëjnë një aktivitet të rëndësishëm ekonomik për vendin. Gjatë periudhës 1944-1990, industria nxjerrëse dhe ajo përpunuese e kromit, bakrit, hekurit, nikelit e qymyrgurit kanë siguruar të ardhura të konsiderueshme për vendin. Pas vitit '90, kalimi nga një ekonomi e centralizuar në kushtet e ekonomisë së tregut, të ndërthurura me një sërë faktorësh politike dhe sociale, ka ndikuar ndjeshëm në kapacitetet nxjerrëse e përpunuese të rezervave minerare.</p> <p>Më pas së bashku me nxënësit trajtohet informacioni i ri duke realizuar vazhdimin komunikim interaktiv me nxënësit. Gjatë trajtimit të informacionit bëhet edhe plotësimi i kllasterit të mëposhtëm:</p>

<p><i>Bazuar në përdorimin industrial të tyre, mineralet ndahen në lëndë të djegjshme, minerale të dobishme metalore dhe minerale të dobishme jometalore.</i></p>	
<p><i>Rezervat e lëndëve djegëse:</i> Rezervat e qymyrgurit gjenden në formë shtresash në konglomeratet dhe ranorët e oligocenit dhe miocenit (gjenden në: ultësirën ndërmalore Korçë-Gorë-Mokër, Memaliaj, etj). Linjitet: rezervat e RSH janë qymyre të cilësisë së ulët. Në Republikën e Kosovës, linjiti ka rëndësi energjetike dhe gjendet në rezerva të mëdha, në fushëgropën e Kosovës dhe rrafshin e Dukagjinit. Torfat: janë grumbullime të krijuara në zona ish-kënetore që përfshihen në grupin e qymyreve të dobët. Asfalti: është një bitum natyror që gjendet në shtresa argjilore e ranore. Vendburimi më i vjetër është ai i Selenicës. Rezervat e naftës: gjenden në RSH dhe lidhen me praninë e shkëmbinjve karbonatikë (Ballsh, Gorisht) dhe të shkëmbinjve ranorë (Kuçovë, Patos, Marinzë). Studime dhe kërkime po bëhen edhe në platformën detare të Detit Jon. Gazi natyror gjendet kryesisht i shoqëruar me naftën, por në disa zona edhe i veçuar prej saj (në kodrat e Divjakës).</p>	<p><i>Rezervat e mineraleve të dobishme metalore:</i> Xeherorët e kromit gjendet në shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë. Grumbullimet më të rëndësishme të këtij minerali janë në vendburimet e Bulqizës e të Batrës në RSH, ato në lindje të Republikës së Kosovës dhe në trevat tona në Maqedoni. Rezervat e bakrit gjendet në shkëmbinjtë vullkanogjen-sedimentarë. Janë të përhapur në zonën e Korabit dhe të Gashit në RSH. Rezervat e hekur-nikelit gjendet në disa shkëmbinj metamorfikë, kryesisht në zonat juglindore të RSH, në disa zona në Republikën e Kosovës (Çikatovë-Magur, Carralevë) dhe në trevat tona në Maqedoni. Boksitet kanë përhapje të kufizuar dhe lidhen me praninë e shkëmbinjve gëlqerorë. Gjenden kryesisht në zonën e Alpeve dhe të Vermoshit, në Republikën e Kosovës (Gremnik) dhe në Plavë. Mineralet e zinkut të plumbit dhe argjendit gjenden në shkëmbinj magmatikë. Rezervat më të mëdha gjenden në disa zona në Republikën e Kosovës (sidomos në Trepçe.</p>
	<p><i>Rezervat e mineraleve të dobishme jometalore:</i> Rezervat e asbestit, janë të përhapur në shkëmbinjtë ultrabazikë. Gjenden në verilindje, lindje e juglindje të RSH dhe në Republikën e Kosovës. Magnezi formohet nga veprimtaria hidrotermale mbi shkëmbinjtë ultrabazikë. Gjendet në RSH (Gomsiqe, Devoll) dhe në Kosovë (Goleshtë, Guri i Bardhë). Sqafari shoqëron vendburimet e bakrit. Fosforiti dhe Kripa e gurit gjenden në shkëmbinj gëlqeror, kryesisht në zonën Jonike. Gipsi gjendet në RSH (Dumre, Korab, Vlorë) dhe në trevat shqiptare në Maqedoni etj. Argjilat kanë përhapje të gjerë në treva. Dallohen vendburimet e RSH (Kavajë, Tiranë, Lushnjë) dhe të Kosovës (Gjakovë, Skënderaj, Klinë, Pejë Viti etj). Gëlqerorët dhe Dolomitët përdoren si materiale ndërtimi dhe kanë përhapje të gjerë në trevat shqiptare. Rezervat e mermerit gjenden në disa vendburime të RSH (Muhur, Burrel, etj) dhe në trevat tona në Maqedoni. Rëra e kuarcit Lidhet me shkëmbinjtë magmatikë. Është e përhapur në RSH dhe në Republikën e Kosovës (Ferizaj, Lipjanë).</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 3.3

► Relievi i Shqipërisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.3 Relievi i Shqipërisë	


<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p><u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Përshekruan tiparet e përgjithshme natyrore të relievit shqiptar. <p><u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerëson rolin e relievit në klimë, hidrografi, bimësi, shpërndarjen e popullsisë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Evidenton larminë e relievit të Shqipërisë dhe formave që mbizotërojnë në të. <p><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon rolin e relievit në zhvillimet dhe në shpërndarjen hapësinore të elementeve demografikë dhe ekonomikë. Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. <p><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. <p><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p><u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p><u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përcakton në hartë format kryesore natyrore të relievit shqiptar. <p><u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton faktorët që kanë ndikuar në formimin e relievit të vendit tonë. <p><u>3. Marrja e vendimeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon morfologjinë e relievit të Shqipërisë, duke evidentuar format kryesore të tij. Vlerëson ndikimin e relievit në kushtet e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në natyrën e ekonomisë së Shqipërisë, duke sjellë shembuj nga krahina apo zona ku banojnë. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon morfologjinë e relievit të Shqipërisë, duke evidentuar format kryesore të tij. Vlerëson rolin e relievit në klimë, hidrografi, bimësi, shpërndarjen e popullsisë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. 	<p>Fjalët kyçe: reliev, morfologji e relievit, natyrë e relievit, reliev i lartë, reliev i mesëm, reliev i ulët</p>

Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit dinë: b. Republika e Shqipërisë ka një relief kodrinoro-malor dhe me larmishmëri të madhe të formave të relievit.
b. Ndërtimi i njohurive të reja	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë e vendosur në fillim të mësimit 3.3 në tekst, të përcaktojnë në hartë format kryesore të relievit shqiptar dhe të diskutojnë rreth tyre.</p> <p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Larmisë së relievit të Shqipërisë dhe formave që mbizotërojnë në të. - Rolit të relievit në klimë, hidrografi, bimësi, shpërndarjen e popullsisë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja trajton së bashku me ta informacionin e ri:</p> <p>Natyra e relievit shqiptar: Republika e Shqipërisë ka një relief kodrinoro-malor me lartësi mesatare 708m mbi nivelin e detit. Ai dallohet për shkallën e lartë të copëtimit vertikal dhe për pjerrësinë e madhe të shpateve , e cila luhetet kryesisht midis vlerave 10°-45°. Në disa raste, rritja e madhe e pjerrësisë së relievit i jep atij karakter greminor. Lartësia e relievit luhetet midis nivelit të detit në perëndim (ku pika më e ulët arrin -8 m në ëish kënetën e Tërbufit) dhe lartësi 2751 m në malin e Korabit, në lindje .</p>

	<p>Më pas së bashku me nxënësit trajtohet informacioni i ri duke realizuar vazhdimisht komunikim interaktiv me nxënësit. Gjatë trajtimit të informacionit bëhet edhe plotësimi i kllasterit të mëposhtëm:</p> <p>- Morfologjia e relievit</p> <p>Morfologjia e relievit të Shqipërisë përbëhet nga male, Vargje malore, malësi, kodra, vargje kodrinore, fusha, fushëgropa, lugje, lugina lumore etj. (shih figurat 1 deri në 5). Relievi është i orientuar në drejtime të ndryshme, ku mbizotërues është ai veriperëndim-juglindje (kryesisht në perëndim dhe jug të vendit: në vargjet kodrinore të Kërrabës dhe të Mallakastrës, në vargjet malore Shëndëlli-Lunxhëri-Bureto, Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë etj.). Në veri dhe në lindje të vendit, relievi merr drejtime të ndryshme. Në Alpe mbizotëron drejtimi rrezor, në Vargjet e Lurës dhe në Malin e Thatë e shfaqet drejtimi veri-jug, ndërsa në vargun e Korabit ndeshet drejtimi harkor. Në malet dhe kodrat e vendit, si rezultat i ndërtimit gjeologjik, kohës së formimit dhe veprimit të faktorëve të jashtëm, janë krijuar kreshta me forma të ndryshme.</p> <p>Prania e copëtimit vertikal që krijon një diferencim vertikal të relievit në tri kate hipsometrikë: Relievi i ulët, relievi i mesëm dhe relievi i lartë.</p> <p>Fushat shtrihen në pjesën perëndimore të vendit, përgjatë luginave lumore, si dhe në tabanin e gropave ndërmallore. Fusha më e madhe e vendit është Ultësira Perëndimore, pjesa më e madhe e së cilës ka origjinë tektonike ngritëse, të shoqëruar me veprimtarinë depozituese të lumenjve që derdhen në Adriatik. Pjesa veriore e saj, Ultësira e Shkodrës, ka origjinë tektonike fundosëse, të shoqëruar me veprimtarinë depozituese të Drinit dhe të përrenjve të Mbishkodrës.</p> <p>Fushëgropat janë formuar si rezultat i fundosjeve tektonike dhe shfaqin e ndeprirje drejt uljes në reliev. Për shkak të kësaj prirjeje, ato karakterizohen nga një taban i sheshtë, i modeluar nga depozitimi. Mes tyre dallojnë fushëgropa e Korçës dhe ajo e Delvinës.</p>
--	--

Trevat shqiptare dallohen për:

- një *reliev original, tepër të spikatur dhe të shumëllojshëm*;
- karakterin *kodrinoro-malor* të tyre.
- lartësia ulet nga lindja në perëndim gradualisht nga malet dhe malësitë e larta në male më të ulëta, në kodra e së fundmi në fushat pranë bregdetit, sepse ka ndjekur drejtimin e evolucionit gjeologjik që kanë pësuar trevat.



Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4, 5 dhe 6.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësit

Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.


Tema 3.4

► Klima e Shqipërisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.4 Klima e Shqipërisë	

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p><u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Përshtkruan tiparet kryesore të klimës së Shqipërisë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj. <u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u> Vlerëson rolin që ka klima e vendit tonë në dukurit e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj. Evidenton elementet e klimës së Shqipërisë. <u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u> <ul style="list-style-type: none"> Analizon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës së vendit tonë. Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. <u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. <u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përcakton në hartë rajonizimin klimatik të Shqipërisë. <p><u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton tiparet kryesore të klimës së Shqipërisë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj. <p><u>3. Marrja e vendimeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës së vendit tonë. Vlerëson rolin që ka klima e vendit tonë në dukurit e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> analizon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës së vendit tonë. vlerëson rolin që ka klima e vendit tonë në dukurit e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj. 	<p>Fjalët kyçe:Klima, element klimatikë, faktorë lokalë</p>
<p>Burimet:Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	

<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike e Shqipërisë në gjerësitë mesatare të Hemisferës Veriore dhe dalja e gjerë në Mesdhe përcakton praninë e klimës mesatare mesdhetare, me dimër të butë e të lagësht dhe me verë të nxehtë e të thatë.
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit III. 4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë e vendosur në fillim të mësimit III. 4 në tekst të diskutojnë rreth tyre.</p> <p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tipareve kryesore të klimës së vendit tonë dhe faktorëve që ndikojnë në formimin e saj; - Rolit të klimës në kushtet e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj. <p>Mësuesi/ja mund të jap edhe disa të dhëna plus në ndihmë të nxënësve.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Më pas së bashku me nxënësit trajtohet informacioni i ri duke realizuar vazhdimet komunikim interaktiv me nxënësit. Gjatë trajtimit të informacionit bëhet edhe plotësimi i kllasterit të mëposhtëm:</p>



Mësuesja trajton së bashku me ta informacionin e ri:

Pozita gjeografike e Shqipërisë në gjerësitë mesatare të Hemisferës Veriore dhe dalja e gjerë në Mesdhe përcakton praninë e klimës mesatare mesdhetare, me dimër të butë e të lagësht dhe me verë të nxehtë e të thatë. Ndërthurja e formave të relievit dhe copëtimi i tij kushtëzon formimin e mikroklimave. Me rritjen e lartësisë së relievit ndeshet klima malore, ndërsa në drejtim të lindjes, klima merr tipare kontinentale. Klima e vendit tonë dallohet për dy veçori kryesore, të cilat janë: larmia e saj në varësi të sipërfaqes (formimi i mikroklimave) dhe regjimi i çrregullt i elementeve klimatikë, sidomos i temperaturës dhe ai i reshjeve (shoqëruar shpesh me ndryshime të ndjeshme brenda një kohe të shkurtër).

Ndikimi i klimës në kushtet e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në ekonomi

Klima luan një rol të rëndësishëm në modelimin e peizazhit

	<p>gjeografik, në shpërndarjen e popullsisë dhe në ekonominë e vendit. Ajo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në relievin, hidrografinë, tokat dhe bimësinë e tij. Klima është një faktor i jashtëm, që ndikon kryesisht në intensitetin e evolucionit të relievit. Kështu, relievi i ekspozuar ndaj reshjeve, erës dhe luhatjeve të temperaturës i nënshtrohet një modeli më të shpejtë, krahasuar me një reliev më pak të ekspozuar. Natyra e hidrografisë dhe rezervat e mëdha ujore që ka Shqipëria, janë të lidhura ngushtë me larminë e klimës. Regjimi i lumenjve, dinamika e ujërave nëntokësore, rezervat ujore në liqenet artificiale etj., ndryshojnë në varësi të sasisë dhe të regjimit të reshjeve. Po kështu, llojet e tokave dhe bimësia janë krijuar në përshtatshmëri me tiparet e klimës (në varësi të temperaturës dhe lagështirës).</p> <p>Hapi III :Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 5 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3,4.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 3.5

► Hidrografia e Shqipërisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.5 Hidrografia e Shqipërisë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan tiparet e përgjithshme të hidrografisë së vendit tonë.<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>Vlerëson rolin e rezervave hidrike në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.Evidenton disa nga veçorit kryesore të hidrografisë së Shqipërisë.<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u><ul style="list-style-type: none">Analizon disa veçori të përgjithshme të deteve, liqeneve dhe lumenjve të vendit tonë.			

<ul style="list-style-type: none"> Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. <p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin <i>(Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. <p>5. Kompetenca personale <i>(Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare <i>(Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale <i>(Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përcakton në hartë detet që lagin brigjet shqiptare. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton tiparet e përgjithshme të deteve, liqeneve dhe lumenjve. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon tiparet e përgjithshme të detit Adriatik dhe detit Jon, liqeneve dhe lumenjve. Vlerëson rolin e rezervave hidrike në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> vlerëson rolin e rezervave hidrike në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë; analizon tiparet e përgjithshme të detit Adriatik dhe detit Jon, liqeneve dhe lumenjve. 	<p>Fjalët kyçe: rezerva hidrike, hidrografi, dete, liqene, lumenj</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> c. Shqipëria dallohet për rezerva të mëdha ujore në raport me sipërfaqen e saj. Hidrografia e pasur paraqitet në formën e deteve, liqeneve, lagunave, lumenjve, përrenjve, burimeve, ujërave nëntokësore etj.

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit III.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë e vendosur në fillim të mësimit III. 5 në tekst, të përcaktojnë në hartë detet që lagin brigjet tona dhe të diskutojnë rreth tyre. Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Larmisë hidrografike të vendit tonë, duke sjellë shembuj të ndryshëm; - Rolit të rezervave hidrike në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. <p>Mësuesi/ja mund të japë edhe disa të dhëna plus në ndihmë të nxënësve.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja trajton së bashku me ta informacionin e ri: Shqipëria ka dalje të gjerë në detin Adriatik dhe në detin Jon. <i>Deti Adriatik</i> është pjesë e detit Mesdhe, me një sipërfaqe prej 132 000km² dhe gjendet midis Gadishullit Apenin në perëndim dhe Gadishullit të Ballkanit në lindje (me një gjerësi mesatare prej 200km). Ai ka një shtrirje gjatësore prej 850 km nga Gjiri i Triestes në veri, deri në Kanalin e Otrantos në jug, me një kripësi mesatare 38%. <i>Deti Adriatik</i> gjendet në gropën e madhe tektonike midis dy gadishujve dhe në pjesën më të madhe të tij thellësia shkon në 200 m, ndërsa thellësia maksimale e arrin në jug të tij, me 1589m. Ai është bregdet i ulët grumbullues dhe dallohet për plazhe të shumta si: Velipoja, Shëngjini, Durrësi, Divjaka, Vlora etj. <i>Deti Jon</i> shtrihet në Kanalin e Otrantos dhe përbën pjesën më të thellë në të detit Mesdhe. Deti Jon dallohet për tejdukshmërinë e lartë të ujërave të tij dhe për kripësi më të madhe se Deti Adriatik (39%). Bregdeti shqiptar i Jonit shtrihet nga Kepi i Gjuhëzës, në gadishullin e Karaburunit,</p>
---	--

deri në Kepin e Stillos në jug. Bregdeti i Jonit është një bregdet i lartë shkëmbor, me plazhe të vogla, zallore e me thellësi të madhe në brigje si plazhi Dhërmiut, Jalës, Himarës , Borshit, Sarandës etj.

Liqenet: Sipas origjinës së formimit, liqenet ndahen në: liqene tektoniko-karstike, bregdetare, akullnajore, karstike dhe artificiale. Liqenet me sipërfaqe me te madhe janë ato me origjinë tektoniko karstike.

Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Gadishullin e Ballkanit. Tabani i tij është gëlqeror dhe ushqehet nga reshjet e shiut e ujërat nëntokësore. Në këtë liqen derdhet Moraça dhe buron Buna. Liqeni dallohet për luhatje të mëdha të nivelit të ujërave, tejdukshmërinë e ulët, mineralizimin mesatar dhe për temperaturën e ujërave që luhatet midis vlerave 6,80-25,90C. Ai dallohet gjithashtu për llojet e ndryshme të peshqve (sidomos për krapin dhe gjucën) dhe si rezervat i njohur i shpendëve. Liqeni i Shkodrës është shpallur Rezervat Natyrori Menaxhuar.

Liqeni i Ohrit është liqeni më i thellë në Gadishullin e Ballkanit. Ai është formuar në të njëjtën kohë me grabene te tjera juglindore të Shqipërisë, por në dallim me to , është ripërtërirë me një amplitudë më të madhe. Nga liqeni i Ohrit buron Drini i Zi, ndërkohë që ai furnizohet në rrugë nëntokësore nga ujërat e Liqenit të Prespës (pasi Prespa e Madhe ndodhet 157 m mbi nivelin e tij) dhe të masivit karstik të Malit të Thatë.

Mësuesja fton nxënësit të shohin figurat 4 deri në 7 në tekst.

Më pas nxënësit analizojnë tabelën e mëposhtme dhe nxjerrin në fletoren e tyre duke plotësuar digramën e Venit me tiparet e përbashkëta dhe veçorit dalluese midis tri liqeneve që ndodhen në vendin tonë.

Lumenjtë

Detet në të cilët derdhen	Lumenjtë (gjatësia285km) (prurja 352m³/sek)		Gjatësia vjetore	Prurjet mesatare
Adriatik	D	Drini		3
		Buna	44km	320m³/sek
		Shkumbin	181km	61,5m³/sek
		Mati	144km	103m³/sek
	Semani	Devolli	161km	32,5m³/sek
		281km	49,5m³/se	(prurja mesatare e Devollit
		Vjosa	272k1	95,7m³/sek)
Jon		Erzei	08km	195m³/sek
		Pavl	50km	18m³/sek
		Bistrica	32km	6,5m³/sek
		Kalasa	41	23,9m³/sek

	<p><i>Drini Zi</i> buron nga Liqeni i Ohrit dhe pasi përshkon një rrugë me ngushtime midis maleve, merr disa degë të tjera lumore, futet në Republikën e Shqipërisë (në Miresh-Bulqizë) dhe rrjedh nëpër një territor të gjerë. Në vazhdim, shtrati i tij ngushtohet e zgjerohet herë pas here, derisa derdhet në Liqenin e Kukësit. Atje bashkohet me Drinin e Bardhë dhe formon lumin Drin, i cili kthehet në një varg liqenesh artificiale. Lumenjtë e tjerë që derdhen në detin Adriatik janë: Buna, Shkumbini, Mati, Devolli etj.</p> <p><i>Lumenjtë</i> që derdhen në Detin Jon janë: Bistrica, Pavloja dhe Kalasa. Ata janë lumenj të shkurtër dhe me prurje të konsiderueshme. Bistrica është një lumë që ushqehet prej ujërave nëntokësore, burimet (20 burime) e të cilave dalin në rrëzën jugore të Qafës së Muzinës. Burimi kryesor i këtij lumi është “Syri i Kaltër”. Rezervat hidrike të Bistricës shfrytëzohen nëpërmjet dy HEC-eve: Bistrica 1 dhe Bistrica 2.</p> <p>Hapi III :Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3 dhe 4.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 3.6

► Llojet e tokave dhe faktorët e formimit të tyre

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.6 Llojet e tokave dhe faktorët e formimit të tyre	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përcakton llojet e tokave kryesore në truallin shqiptar.• Përshkruan tiparet më të përgjithshme të tokave.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rëndësinë e larmisë së tokave në vendin tonë.			

<ul style="list-style-type: none"> Analizon faktorët që ndikojnë në formimin e tokave. <p>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</p> <ul style="list-style-type: none"> Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. Argumenton rëndësinë e larmisë së tokave në zhvillimin e sektorit të parë të ekonomisë dhe më gjerë. Evidenton tiparet kryesore të tokave zonale dhe azonale. <p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. Sjell shembuj të ndërvlerësive e të bashkëveprimit midis zhvillimit të ekonomisë bujqësore dhe larmisë së tokave. <p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme të tokave në truallin shqiptar. 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme të tokave. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson rëndësinë e larmisë së tokave në vendin tonë. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson faktorët që kanë ndikuar në degradimin e tokave dhe sjell shembuj të tokave të degraduara në zona të caktuara dhe jep disa propozime për përmirësimin e situatës. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton faktorët që kanë ndikuar në formimin e tokave. përshkruan tiparet më të përgjithshme të tokave zonale dhe azonale. vlerëson faktorët që kanë ndikuar në degradimin e tokave. 	<p>Fjalët kyçe: llojet e tokave, toka zonale, toka azonale, degradim etj.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. trualli i vendit tonë përbehet nga toka të shumëllojshme, formimi i të cilave lidhet me pozitën gjeografike dhe ndërtimin gjeologjik të vendit.</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor figurat dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.6 në tekst - Diskutojmë rreth: - larmisë së tokave në vendin tonë; - faktorëve që ndikojnë në degradimin e tyre. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje larminë e tokave dhe faktorët që ndikojnë në degradimin e tyre. <i>Klima</i> ndikon në formimin e llojeve të ndryshme të tokave dhe në shpërndarjen gjeografike të tyre. Njëpërmjet temperaturës dhe reshjeve, ajo përcakton proceset biologjike, fizike dhe kimike që zhvillohen në toka. <i>Relievi</i> ndikon me anë të lartësisë, pjerrësisë së shpateve dhe ekspozimit. Me rritjen e lartësisë së relievit, tokat marrin veçori të dallueshme nga njëra-tjetra, për shkak të formimit të tyre në kushte të ndryshme temperature, lagështie dhe reshjesh. Pjerrësia e shpateve ndikon në sasinë e ujit që qëndron në toka, ndërsa ekspozimi përcakton zhvillimin e proceseve të ndryshme fizike e kimike në tokat e shpateve. <i>Bota e gjallë</i> (mikrogjallesat dhe bimët) është një faktor i rëndësishëm që përcakton shpërndarjen, përmbajtjen e humusit dhe shkëmbësinë e tokave. Gjatë formimit, tokat krijojnë veçoritë e tyre si pasojë e procesit të shkëmbimit të lëndëve dhe energjisë midis tyre dhe botës së gjallë. <i>Përbërja gjeologjike</i> e shkëmbinjve mëmë përcakton përbërjen mineralogjike, shkëmbësinë dhe rezistencën që shfaqin ndaj erozionit tokat e formuara mbi ta. Një ndikim të drejtpërdrejtë në toka ka edhe veprimtaria njerëzore, nëpërmjet: sistemimit, kullimit, ujitjes, plehërimit të tokave, mbjelljes së bimësisë, ndërtimeve të ngritura si pa një plan-studimi etj. Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të RSH dhe të diskutojnë rreth llojeve të tokave që janë në vendin tonë saj.</p>
---	---

	<p><i>Tokat e hirta kafe</i> shtrihen kryesisht në terrenet fushore e kodrinore të pjesës perëndimore të Shqipërisë, deri në 600m lartësi. Ato formohen mbi shkëmbinj sedimentarë, në kushtet e klimës dhe të bimësisë së shkurreve mesdhetare. Tokat e hirta kafe janë porozë, përmbajnë 3% dhe janë të pasura me kalium. Trashësia e tyre shkon në 1,5 m.</p> <p><i>Tokat e kafenjta</i> shtrihen kryesisht në terrenet kodrinoromalore (nga 600-1000 m lartësi). Ato formohen në kushtet e klimës mesdhetare malore e të bimësisë së dushqeve dhe mbi shkëmbinj sedimentarë e magmatikë. Këto toka kanë trashësi deri në 1,4 m, përmbajnë rreth 5% humus dhe janë mjaft të përshtatshme për kultivimin e lajthisë dhe të gështenjës.</p> <p><i>Tokat e murrme pyjore</i> shtrihen kryesisht në lartësitë 1000-1700 m mbi nivelin e detit dhe kanë një trashësi që shkon deri në 1,2 m. Ato formohen mbi shkëmbinj sedimentarë e magmatikë, në kushtet e klimës mesdhetare malore dhe të pyjeve (kryesisht të ahut). Këto toka janë të përshtatshme për kultivimin e patates dhe të drurëve frutorë.</p> <p><i>Tokat livadhore malore</i> gjenden në të gjitha zonat malore të vendit, në lartësitë mbi 1700 m mbi nivelin e detit. Ato formohen mbi shkëmbinj sedimentarë e magmatikë, në kushtet e klimës malore dhe të bimësisë barishtore. Këto toka dallojnë për përqindjen e lartë të humusit (deri në 20%) dhe për trashësinë e tyre, që shkon deri në 90 cm.</p> <p><i>Tokat aluvionale</i> gjenden pranë luginave lumore dhe formohen prej depozitimeve lumore (aluvioneve). Ato janë të pasura me karbonate kalciumi, kanë përqindje të lartë lagështie dhe janë të varfra në humus.</p> <p><i>Tokat e kripura</i> gjenden në disa zona bregdetare në perëndim dhe mbi depozitime liqenore. Për shkak të kripës që depozitojnë nëntokësore pranë sipërfaqes së tyre, këto toka nuk janë produktive. Kullimi dhe ujitja e tyre me kriter mundëson kultivimin e kulturave bujqësore.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>

Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.
-----------------------------	---

Tema 3.7

► Bota bimore dhe shtazore në Shqipëri

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.7 Bota bimore dhe shtazore në Shqipëri	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja <ul style="list-style-type: none">Përshkruan llojet e faunës së vendit tonë.Evidenton faktorët që ndikojnë në larminë e botës së gjallë në vendin tonë.		Fjalët kyçe: Botë bimore dhe shtazore, fauna ujore etj.	
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetari, histori, TIK	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u> <ul style="list-style-type: none">Shpreh mendimin e vet mbi llojet e veçanta të botës bimore dhe shtazore.Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth botës bimore dhe shtazore.Përshkruan veçorive të botës bimore, botës shtazore dhe faunës ujore.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u> <ul style="list-style-type: none">Jep shembuj të ngjashëm ilustrues mbi veçoritë e botës bimore dhe shtatzore, bazuar në ato që paraqiten si modele në libër.Shpjegon pse përbërja gjeologjike ndikon në larminë e botës bimore.Vlerëson dhe argumenton rëndësinë e veprimtarisë njerëzore mbi botën e gjallë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u> <ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Dallon dhe analizon llojet e ndryshme të botës së gjallë.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u> <ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.Identifikon faktorët që ndikojnë në larminë e botës së gjallë.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u> <ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			

<ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit të grupit shoqëror, si p.sh rreth rëndësisë së mbrojtjes së diversitetit të botës së gjallë. 7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>) <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi botën bimore dhe shtazore. 	
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përcakton faktorët që ndikojnë në larminë e botës së gjallë në vendin tonë, duke analizuar shembuj. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi hulumton, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht mbi llojet e botës bimore dhe shtazore. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon rëndësinë e veprimtarisë njerëzore mbi botën e gjallë në vendin tonë. 	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në njohuritë e marra nga nxënësit në klasën e gjashtë dhe të tetë mbi botën bimore dhe shtazore.</p> <p>Republika e Shqipërisë dallohet për diversitetin dhe origjinalitetin e botës së gjallë. Tiparet e sotme, ajo i ka marrë.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.7.</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit - Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.7 në tekst: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> Larmisë së peizazheve që e karakterizojnë territorin shqiptar; Veçorive të florës dhe faunës së Shqipërisë dhe llojeve të tyre; Llojeve të specieve endemike që rriten në vendin tonë dhe faktorëve që kanë ndikuar në formimin e tyre. <p>Nxënësit përshkruajnë, përkufizojnë...</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Republika e Shqipërisë dallohet për diversitetin dhe origjinalitetin e botës së gjallë. Tiparet e sotme, ajo i ka marrë në fund të neogjenit. Një karakteristikë tjetër e botës së gjallë, që rritet në vendin tonë, është prania e madhe e specieve endemike dhe e atyre gjysm endemike. Të gjitha këto veçori kushtëzohen nga pozita gjeografike e Shqipërisë, përbërja gjeologjike e truallit të saj, larmia e relievit, e klimës, e hidrografisë, e tokave, si dhe nga ndikimi human.</p>

	<p>- Mësuesja u drejtohet nxënësve me pyetjen që nxit brainstorming-un: Çfarë dini për secilin prej specieve endemike ? Jepni nga një shembull.</p> <p>- Mësuesi/ja pret përgjigjet prej nxënësve ...</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Për shkak të pozitës gjeografike të vendit tonë, bota bimore dhe ajo shtazore që rriten në territorin e tij, karakterizohen nga tipare mesdhetare, ballkanike dhe të Evropës Qendrore. <i>Përbërja gjeologjike</i> e truallit përcakton llojin e tokave, e për rrjedhojë, edhe veçoritë e botës së gjallë që rritet në to. <i>Relievi</i> ndikon me anë të lartësisë dhe ekspozimit. Me rritjen e lartësisë së relievit, <i>ndryshimi i elementeve klimatike</i> përcakton katëzimin e botës së gjallë. Shkallët e ndryshme të ekspozimit ndaj <i>rrezatimit diellor, erës dhe reshjeve</i>, përcaktojnë llojet e botës së gjallë (p.sh., specie që duan ose jo diell, lagështirë etj.). <i>Klima dhe hidrografia</i> në dy faktorë të tjerë që ndikojnë në shumëllojshmërinë e botës bimore dhe asaj shtazore..</p> <p>- Mësuesi/ja u drejtohet nxënësve: Sillni shembuj të ngjashëm...</p> <p>- Gjatë përgjigjeve të nxënësve ... mësuesi/ja i fton ata të përshkruajnë edhe figurat 1 dhe 2 të tekstit.</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Bota shtazore e pasur e vendit tone është e pranishme si në mjediset tokësore, ashtu edhe në ato ujore.</p> <p><i>Fauna tokësore:</i> Bota shtazore që rritet në mjediset tokësore të vendit tonë është e ngjashme me atë të Evropës Mesdhetare. Ajo gjendet në të gjitha format e relievit dhe është përshtatur mire me brezat e bimësisë dhe me kushtet e tyre klimatike. Në mjedise të ndryshme tokësore bota shtazore paraqet specifikat e veta, të cilat e bëjnë atë të dallueshme nga një mjedis në tjetrin.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin informacionin e tekstit duke vëzhguar figurat 3 dhe 4 dhe u kërkon nxënësve të përcaktojnë llojet e faunës ujore. Në vazhdim i fton ata të paraqesin shembuj.</p> <p>Vendi ynë dallohet gjithashtu për faunën e pasur ujore, e cila ndeshet në tri forma: fauna e ujërave të kripura, fauna e lagunave bregdetare, fauna e ujërave të ëmbla.</p> <p>•Në faunën e ujërave të kripura, e cila është fauna më e pasur ujore, bëjnë pjesë disa lloje molusqesh, karkalecash e breshkash, si dhe sardelja, kocja, levreku, barbuni, ngjala</p>
--	---

	<p>etj. Në raste të rralla, në kushtet e rritjes së temperaturës së ujërave, në thellësi jo shumë të mëdha janë vënë re peshkaqenë apo tufa delfinësh. Pjesë e kësaj faune janë edhe disa lloje pulëbardhash, si dhe dallëndyshja e detit.</p> <p>•Në faunën e lagunave bregdetare ndeshen: pelikani, fazani, rosa, mjellma etj. Në këtë mjedis jetojnë edhe specie endemike, ndër të cilat dallohet pelikani kaçurrel i Lagunës së Karavastasë.</p> <p>•Fauna e ujërave të ëmbla (liqene, lumenj) përfaqësohet me lloje të ndryshme peshqish, zvarranikësh (breshka, gjarpërinj) dhe amfibësh (bretkosa). Ajo është më e pasur dhe e shumëllojshme në liqene sesa në lumenj. Peshqit më tipikë të këtyre ujërave janë krapit, korani, ballëgjeri, trofta etj.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Në vazhdim, nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 2 dhe 3 të tekstit, në rubrikën “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4 dhe 5 të rubrika “Mbroni një pikëpamje”.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 3.8

► Trashëgimia natyrore e vendit tonë dhe problemet e mjedisit

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 3: Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 3.8 Trashëgimia natyrore e vendit tonë dhe problemet e mjedisit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore të vendit tonë.• Evidenton problemet kryesore të mjedisit në Shqipëri.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore në vendin tonë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			

<ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit. Analizon kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe evidenton përmes shembujve disa nga problematikat me të cilat përballen ato. <p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. Sjell shembuj të problematikave kryesore mjedisore në Shqipëri dhe jep disa zgjidhje për përmirësimin e situatës. <p>5. Kompetenca personale (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi menaxhimin e trashëgimisë natyrore në vendin tonë. 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore të vendit tonë. Evidenton problemet kryesore të mjedisit në Shqipëri. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore në vendin tonë. Nxënësi vlerëson gjendjen e mjedisit në Shqipëri dhe paraqet disa nga problematikat kryesore. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore të vendit tonë. Evidenton problemet kryesore të mjedisit në Shqipëri. 	<p>Fjalët kyçe: Trashëgimi natyrore, kategori të zonave të mbrojtura, probleme mjedisore.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. trashëgimisë natyrore të vendit tonë dhe disa prej problematikave kryesore mjedisore.</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.8 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor tabelën e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.8 në tekst - Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore të vendit tonë dhe rëndësisë së saj në zhvillimin e turizmit; - problemeve të mjedisit dhe faktorëve që kanë ndikuar në to. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi: - trashëgiminë natyrore - zonat e mbrojtura - <i>problemet mjedisore</i> Pozicioni gjeografik I favorshëm, ndërtimi gjeologjik i larmishëm, rezervat e mëdha minerare e ujore, shumëllojshmëria e tokave, larmia e relievit dhe e klimës, përbëjnë një mozaik vlerash të mjedisit fizik dhe atij jetësor në Shqipëri. Kjo tërësi vlerash quhet trashëgimi natyrore. Fillimet e veta, njohja dhe evidentimi i vlerave të natyrës në Republikën e Shqipërisë i kanë që në vitin 1940. Më pas, ky proces ka ardhur gradualisht në rritje. Zonat në të cilat janë evidentuar vlera të veçanta dhe të rëndësishme, janë përfshirë në kategoritë e zonave të mbrojtura. Në Republikën e Shqipërisë, ato përbëjnë rreth 1 0% të sipërfaqes së saj. Zhvillimi ekonomik dhe ndryshimet demografike në Shqipëri kanë vënë përballë sfidave të mëdha raportin midis shoqërisë dhe mjedisit. Problemet mjedisore të dhjetë vjeçarëve të fundit kanë nxjerrë në plan të parë nevojën e përdorimit racional dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore, sidomos të atyre të papërtëritshme, dhe të gjetjes së rrugëve të duhura për të zbutur dhe minimizuar dëmet ndaj mjedisit. Ndër problemet kryesore të mjedisit në Shqipëri janë: ndotja e ajrit, ndotja e ujërave dhe e tokave, si dhe ajo akustike. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit ti referohen tabelës së zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe të përcaktojnë kategoritë e zonave të mbrojtura që ndodhen në vendin tonë...</p>
---	--

Kategorizimi I Zonave të Mbrojtura është bërë në Asamblenë e Përgjithshme të Unionit Botëror për Ruajtjen e Natyrës (ang. IUCN), në vitin 1994. Zonat e mbrojtura janë klasifikuar në 6 kategori.

Kategoria e zonës së mbrojtur		Përshkrimi i zonës së mbrojtur	Bëjnë pjesë
I.	Rezervë strikte natyrore	Janë territore tokësore ose ujore të vogla, pak deri në aspak të shqetësuar nga njeriu, që ruhen dhe menaxhohen për qëllime shkencore dhe për mbrojtjen e botës së gjallë. Rezervatet mund të jenë me rëndësi botanike, ku ruhen në formë "insitu" llojet bimore dhe bashkësitë bimore, ose me rëndësi shtazore, për shkak të ruajtjes së llojeve shtazore në vendbanimet burimore të natyrës.	4 rezervate të tilla: Laguna e Karavastasë, Lugina e Gashit, Kardihi dhe Rrajca.
II.	Park kombëtar	Është një zonë e gjerë tokësore e ujore (jo më e vogël se 1000 ha), e cila ruhet e menaxhohet për mbrojtjen e ekosistemeve, për qëllime edukimi dhe rekreacioni (për çlodhje e argëtim). Në këtë zonë nuk lejohet shfrytëzimi i mjedisit për qëllime të tjera, përveç atyre shkencore, arsimore, kulturore dhe rekreative, të cilat mund të shërbejnë për mbajtjen e zonës në kushtet optimale natyrore ose afërsisht natyrore.	13 parqe kombëtare: mali i Dajtit, Thethi, Lura, Pisha e Divjakës, Llogaraja, Bredhi i Drenovës, mali i Tomorit, Lugina e Valbonës, Bredhi i Hotovës, Qafështama, Zall-Gjocaji, Prespa, Butrinti.
III.	Monument Natyror	Quhen zonat me përmasa të vogla, por dhe objektet biotike dhe abiotike, që mbrohen e menaxhohen për ruajtjen e karakteristikave të veçanta (unikale) natyrore. Monumentet natyrore janë me karakter: gjeologjik, gjeomorfologjik (shpella, humnera, shkëmbinj), hidrologjik (ujërrjedha, ujëvara, liqene) dhe botanik (ekzemplarët e rrallë të botës bimore).	Rreth 750 monumente natyrore, ndër të cilët dallohen: Bredhi i Sotirës, Syri i Kaltër, Vlashaj, Zhejjetj. Numrin më të madh të këtyre monumenteve e ka Vlora (51) dhe atë më të vogël, Fieri (5).
IV.	Rezervate natyrore të menaxhuara	Janë zonat e mbrojtura tokësore e ujore, ku sigurohet përkujdesja. Ndaj habitateve dhe plotësimi i kërkesave specifike të botës së gjallë përmes një menaxhimi të përshtatshëm për qëllime çlodhjeje, argëtimi, studimore etj.	25 rezervate natyrore të menaxhuara, ndër të cilat dallohen rezervatet e: Rrshkullit, Pishë- Poros, Velipojës, Kune-Vainit, Maliqit, Patok-Fushëkuqe- Negelit, Karaburunit, Cangonjit, Bërzanës, Levanit, Qafëmolle- Derjes, Ballollit, Bogovës etj.
V.	Peizazh i mbrojtur	Quhen zonat që mbrohen dhe menaxhohen me qëllim ruajtjen e diversitetit biologjik, cilësisë së peizazheve dhe bashkëveprimet harmonik të veprimtarisë njerëzore në to. Kjo kategori përfshin pjesë toke ose deti në pronësi publike, private apo qendra banimi, brenda të cilave zhvillohen aktivitete të ndryshme (si: bujqësi, pemëtimi, pylltari, peshkim etj.).	6 zona të tilla: Biza, Bërdheti, Nikolica etj.
VI.	Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara	Quhen zonat e mbrojtura e të menaxhuara, me qëllim ruajtjen dhe mirëmbajtjen e diversitetit biologjik në kushtet e një përdorimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore, në funksion të përbushjes së nevojave të shoqërisë.	4 zona: Luzni-Bulaci, Piskal-Shqeri, Bjeshka e Oroshit dhe Guri i Nikës.

	<p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i> Kategorizimi i Zonave të Mbrojtura është bërë në Asamblenë e Përgjithshme të Unionit Botëror për Ruajtjen e Natyrës (ang. IUCN), në vitin 1994. Zonat e mbrojtura janë klasifikuar në 6 kategori.</p> <p>Pavarësisht punës së vazhdueshme për ruajtjen dhe zgjerimin e sipërfaqeve të tyre, në zonat e mbrojtura ndeshen ende probleme. Kështu, për disa prej tyre del sidomos domosdoshmëri rishikimi i statusit të mbrojtjes, në varësi të vlerave që kanë dhe të atyre që mund të merren në ruajtje. Për zonat bregdetare, të cilat kanë përparësi zhvillimin e turizmit, del në plan të parë administrimi i drejtë i tyre dhe ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike që i karakterizon. Disa prej këtyre zonave përballen me ndërtime private në sipërfaqet e tyre, të cilat bëhen kryesisht për qëllime turizmi. Kështu, ndërhyrje dhe dëmtime janë vënë re në Parkun Kombëtar të Lurës, në atë Qafë-Shtamës, në Bredhin e Hotovës, në rezervatet e gjuetisë Kune-Vain, në Rrushkull, Pishë-Poro, Levan, Maliq, Cangonj etj.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Përsëritje 1

► Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë

Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë mbi pyetjet/çështjet e mëposhtme:

1. Diskutoni mbi pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë ndikimi ka pozita gjeografike e Shqipërisë mbi kushtet natyrore të saj?
- Si ndikojnë faktorët e brendshëm dhe ata të jashtëm në modelimin e relievit shqiptar?
- Si ndikon relievi mbi dukuritë e tjera natyrore, mbi popullimin dhe natyrën e ekonomisë së vendi?
- Cilat janë disa veçoritë përgjithshme të klimës së Shqipërisë?
- Si ndikon klima e vendit tonë në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe në aktivitetet e saj?
- Cilat janë disa nga veçoritë e përgjithshme të hidrografisë së Shqipërisë?

2. Përshkruani larminë e peizazheve natyrore të Shqipërisë dhe renditni faktorët e përgjithshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim.

3. Evidentoni pozicionin gjeologjik të truallit shqiptar dhe etapat kryesore të formimit të albanideve.

4. Mësuesi udhëzon nxënësit që të plotësojnë tabelën e mëposhtme:

Mineralet					
Lëndë të djegshme		Minerale metalore		Minerale jometalore	
Llojet	Shpërndarja gjeografike	Llojet	Shpërndarja gjeografike	Llojet	Shpërndarja gjeografike

5. Përshkruani natyrën e relievit shqiptar dhe renditni faktorët që kanë ndikuar në formimin e relievit shqiptar.

6. Emërtoni në figurën përbri katet hipsometrike të relievit të Shqipërisë dhe përcaktoni zonat që bëjnë pjesë në secilin prej tyre.

7. Analizoni morfologjinë e relievit të Shqipërisë, duke evidentuar sistemet kryesore të tij.

8. Analizoni faktorët që ndikojnë në formimin e klimës së Shqipërisë.

9. Evidentoni elementet e klimës së Shqipërisë.

10. Analizoni veçoritë kryesore të:

a) Detit Adriatik dhe të bregdetit shqiptar të Adriatikut;

b) Detit Jon dhe të bregdetit shqiptar të Jonit;

c) liqeneve tektoniko-karstike;

d) liqeneve bregdetare;

e) liqeneve akullnajore;

f) liqeneve karstike.

11. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Faktorët që ndikojnë në formimin e tokave në vendin tonë	Llojet e tokave		Veçoritë kryesore të tyre
	Zonale		
	Azonale		

12. **Evidentoni** faktorët që ndikojnë në larminë e botës së gjallë në hapësirën shqiptare.
13. **Analizoni** veçoritë e brezave të bimësisë që formohen në Shqipëri sipas rritjes së lartësisë së relievit.
14. **Klasifikoni** dhe përshkruani mjediset më tipike të faunës së Shqipërisë.
15. **Plotësoni** tabelën e mëposhtme:

Kategoritë e zonave të mbrojtura	Kategoria I	Kategoria II	Kategoria III	Kategoria IV	Kategoria V	Kategoria VI
Përshkrimi i zonës së mbrojtur						
Shembuj ilustrues						

- Mësuesi/ja fton nxënësit të ndajnë mendimet, sugjerimet dhe pyetjet që ato kanë për të gjitha temat e trajtuara gjatë orës së përsëritjes.
- Nxënësit nxjerrin përfundime, diskutojnë sugjerorinë...

III. Disa modele pyetjesh që mund të përdoren në testimin e tremujorit të I

TESTI I Grupi A

1. Plotëso dhe argumento përgjigjen:

a) Nga pikëpamja gjeologjike trualli shqiptar bën pjesë në _____

_____ (1 pikë)

b) Relievi i trevave shqiptare ndikon mbi klimën me anë të:

1. _____ (argumento si ndikon) _____

2. _____ (argumento si ndikon) _____

3. _____ (argumento si ndikon) _____

(3 pikë)

2. Vendos përmbri tipit të shkëmbinjve, llojin e mineralit që gjendet në të: plumbi, zinku, magneziti, bakri, qymyri i gurit, kripa e gurit, mermeri, kromi, nikeli, azbesti, nafta. (3 pikë)

1. Shkëmbinj magmatikë _____

2. Shkëmbinj sedimentarë _____

3. Shkëmbinj metamorfikë _____

3. Plotëso: Për nga mosha shkëmbinjtë e truallit shqiptar ndahen në: (3 pikë)

1. _____ dhe gjenden në _____

2. _____ dhe gjenden në _____

3. _____ dhe gjenden në _____

4. Evidento disa veçori të përgjithshme të klimës së Shqipërisë: _____

(3 pikë)

5. Argumento mendimin:

a. Rindërtimi i strukturave fillestare të rrudhosura në lindje të truallit shqiptar paraqitet në reliev me format: _____

b. Asimetria e formave të relievit në strukturat në perëndim e jug të truallit lidhet me: _____

(2 pikë)

6. Krahaso midis tyre liqenet: e Ohrit dhe të Shkodrës dhe evidento të përbashkëtat dhe dallimet midis tyre:

Dallime	Të përbashkëta

(5 pikë)

7. Plotëso tabelën e mëposhtme:

(4 pikë)

Kategoritë e zonave të mbrojtura	Kategoria I	Kategoria II
Përshkrimi i zonës së mbrojtur		
Shembuj ilustrues		

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-9	10-13	14-16	17-19	20-22	23-24

TESTI I Grupi B

1. Plotëso mendimin: klima e Republikës së Shqipërisë është e natyrës:

_____ dhe dallohet për verën _____ dhe dimrin _____ (1 pikë)

2. Plotëso dhe argumento përgjigjen. Republika e Shqipërisë ndodhet

_____. Pozita gjeografike ka rëndësi:

a. _____ sepse _____

b. _____ sepse _____

c. _____ sepse _____

(4 pikë)

3. Vendos përbri grupimeve të pasurive minerale përbërësin e secilit grup: gazi natyror, zinku, kuarci, bakri, qymyri i gurit, krija e gurit, mermeri, kromi, gipsi, boksidet, nafta.

1. Minerale metalore _____

2. Lëndë e djegshme _____

3. Minerale jometalore _____

(3 pikë)

4. Plotëso: Për nga mosha shkëmbinjtë e truallit shqiptar ndahen në:

a. _____ dhe gjenden në _____

b. _____ dhe gjenden në _____

c. _____ dhe gjenden në _____ (3 pikë)

5. Analizo morfologjinë e relievit të Shqipërisë, duke evidentuar sistemet kryesore të tij. (6 pikë)

6. Argumento mendimin:

a. Relievi i trevave dallohet për prani të drejtimeve të ndryshme: _____

b. Masat ajrore janë faktorë të rëndësishëm klimë-formues sepse: _____

c. Gjatë erës mesozoike kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme: _____

(3 pikë)

7. Plotëso tabelën e mëposhtme: (4 pikë)

Kategoritë e zonave të mbrojtura	Kategoria III	Kategoria IV
Përshkrimi i zonës së mbrojtur		
Shembuj ilustrues		

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-9	10-13	14-16	17-19	20-22	23-24

TESTI I Grupi C

1. Disa veçori të përgjithshme të hidrografisë në Shqipëri janë: _____

(2 pikë)

2. **Plotëso dhe argumento:** faktorët kozmikë dhe planetare janë:

1. _____ (argumento si ndikon) _____
2. _____ (argumento si ndikon) _____
_____ (4 pikë)

3. **Vendos përbri tipit të shkëmbinjve, llojin e mineralit që gjendet në të:** plumbi, zinku, magneziti, bakri, qymyri i gurit, kripa e gurit, mermeri, kromi, nikeli, azbesti, nafta.

1. Shkëmbinj
magmatikë _____
2. Shkëmbinj
sedimentarë _____
3. Shkëmbinj
metamorfikë _____ (3 pikë)

4. **Plotëso:**

- a. Relievi i ulët shtrihet në lartësinë: _____ dhe
përfshin: _____
- b. Relievi i mesëm shtrihet në lartësinë: _____ dhe përfshin: _____
- c. Relievi i lartë shtrihet në lartësinë: _____ dhe përfshin: _____
(3 pikë)

5. **Analizo** veçoritë e brezave të bimësisë që formohen në Shqipëri sipas rritjes së lartësisë së relievit.

(3 pikë)

6. **Krahaso** midis tyre detet që lagin brigjet e trevave shqiptare: Adriatik e Jon dhe nxirr në dukje të përbashkëtat dhe dallimet midis tyre:

Dallime	Të përbashkëta

(5 pikë)

7. Plotësoni tabelën e mëposhtme:

(4 pikë)

Kategoritë e zonave të mbrojtura	Kategoria V	Kategoria VI
Përshkrimi i zonës së mbrojtur		
Shembuj ilustrues		

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-9	10-13	14-16	17-19	20-22	23-24

Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë

Tema 4.1

► Popullimi dhe ndryshimet demografike në Shqipëri

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 4.1 Popullimi dhe ndryshimet demografike në Shqipëri	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan tiparet e popullimit dhe vendbanimeve të hershme ilire.• Përcakton ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson faktorët që kanë ndikuar në uljen e numrit të popullsisë pas vitit 1990.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Analizon dinamikën e popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi evidenton tiparet e popullimit dhe vendbanimeve të hershme ilire.			
2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi vlerëson faktorët që kanë ndikuar në uljen e numrit të popullsisë pas vitit 1990.• Analizon dinamikën e popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme.			
3. <u>Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të Republikës së Shqipërisë.• Analizon strukturën, ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë			

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon dinamikën e popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme; Evidenton tiparet e popullimit dhe vendbanimeve të hershme ilire; Analizon faktorët që kanë ndikuar në uljen e numrit të popullsisë pas vitit 1990. 	<p>Fjalët kyçe: dinamika e popullsisë, shpërndarja e popullsisë dhe faktorët që ndikojnë në të, vendbanime të hershme.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <p>a. Trualli i vendit tonë ka pasur popullim dhe vendbanime të hershme ilire;</p> <p>b. ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë në periudha të ndryshme.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 4.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 4.1 në tekst, diskutojnë mbi popullimin e Shqipërisë në periudha të ndryshme historike dhe dinaika e popullsisë. Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - popullimit dhe vendbanimeve të hershme ilire; - ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë përgjatë periudhave të ndryshme. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë mbi popullimin e hershëm të Shqipërisë dhe të ndërtojnë në fletoret e tyre një kllaster. Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë...</p> <p>Në vazhdim mësuesja trajton informacionin e ri mbi: dinamikën e popullsisë, faktorët që ndikojnë në të.</p>

	<p>Trualli ku banojnë sot shqiptarët, në kohët më të lashta është banuar nga një popullsi paleo-indoevropiane, në antikitet nga ilirët dhe në periudhën e mesjetës së hershme, nga pasardhësit e tyre, arbrit. Popullsia e këtyre trojeve ka ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi gjuhën dhe kulturën e vet. Të dhënat arkeologjike që janë gjetur në Xarë të Konispolit, në Kryegjatë (në afërsi të Apolonisë), në Gajtan të Shkodrës etj., dëshmojnë se trevat shqiptare janë banuar që nga paleoliti i mesëm (100000 vjet-30000 vjet më parë). Zbulimet arkeologjike në zona të ndryshme të vendit vërtetojnë gjithashtu se popullimi i këtyre trevave në neolit u bë më i dendur, për shkak të klimës dhe botës së gjallë që u zhvillua gjatë kësaj periudhe.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p>Në shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit pr. K., bashkësitë e fiseve ilire shtriheshin nga lumi Sava në veri deri në Gjirin e Ambrakisë në jug, dhe nga rrjedha te lumenjve Morava e Vardar në lindje, deri në brigjet e Adriatikut dhe Jonit në perëndim.</p> <p>Zhvillimi politiko-shoqëror i popullsisë ilire gjatë shek. XII-V pr. K., solli shpërbërjen e organizimit Fisnor dhe kalimin e saj në një rend të ri, në atë skllavopronar. Lindja dhe zhvillimi i vrullshëm qyteteve përgjatë brigjeve të Adriatikut në shek. III pr. K., sollën gradualisht formimin e shteteve.</p> <p>Ndër formacionet shtetërore të krijuara, shkallën më të lartë të zhvillimit politik e arriti Shteti Ilir.</p> <p>Gjatë mesjetës, sidomos në periudhën e dyndjeve në Ballkan (deri në përfundim të dyndjeve sllave në fund të shek. VIII), pavarësisht rritjes së numrit të popullsisë shqiptare, sipërfaqja e shtrirjes së saj, krahasuar me atë të mëparshme, filloi të tkurrej. Regjistrimi i pare i popullsisë shqiptare gjendet i pasqyruar në regjistrin kadastral të vitit 1431-1432. Megjithatë, të dhënat e tij janë të pjesshme, pasi tregojnë vetëm numrin e popullsisë së Sanxhakut të Shqipërisë (me kryeqendër Gjirokastrën). Në vitin 1506, ai u plotësua me të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të të gjitha tokave shqiptare (përveç të dhënave rreth tokave ku ishte zbatuar më parë sistemi i timarit, u shtuan të dhëna të reja mbi krahinat malore të vetëqeverisura, në të cilat nuk ishte zbatuar ky sistem).</p> <p><i>Mësuesi/ja fton nxënësit të interpretojnë grafikun që ndodhet në mësimin 4.1 në tekst.</i></p>
--	---

	<p>Mësuesi/ja vazhdon: Mendohet se deri në momentin e copëtimit të trevave shqiptare në vitin 1913, numri i popullsisë së tyre ishte rreth 1500000 banorë. Pas copëtimit të tyre, Brenda kufirit politik të Shqipërisë mbeti më pak se gjysma e popullsisë shqiptare (rreth 740000 banorë). Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 1923, i cili është edhe më i hershmi në Shqipëri, tregoi se numri i popullsisë ishte rreth 814380 banorë. Që nga ajo kohë e deri në vitin 2011 janë kryer disa regjistrime të popullsisë, të cilat deri në vitin 1960 kanë qenë regjistrime 5-vjeçare, më pas 10-vjeçare (1969-1979), sërish 5-vjeçare (1983-1989) dhe pas 1989-ës e në vazhdim u kaluan në sistemin 10-vjeçar. Për vite me radhë, nga regjistrimi i përgjithshëm i vitit 1923 deri në regjistrimin e 1989-ës, numri i popullsisë ka njohur vazhdimisht rritje. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e popullsisë janë ritmet e larta të shtimit natyror të saj.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i> Rritjen më të madhe, ajo e ka shënuar gjatë viteve 89, periudhë e cila u karakterizua nga lindshmëria e lartë (e stimuluar nga politikat demografik e shtetërore) dhe nga ulja e vdekshmërisë. Në regjistrimin e vitit 1989, popullsia e Shqipërisë ishte 3182417 banorë, me një rritje vjetore prej rreth 2%.</p> <p>Regjistrimi i popullsisë më 1 prill të vitit 2001 shënoi një ulje të ndjeshme të numrit të popullsisë, krahasuar me atë të vitit 1989. Ndonëse nga Instituti i Statistikave, bazuar në ritmet e shtimit natyror, parashikohej që numri i përgjithshëm i saj të ishte 3,78 milionë banorë, ajo rezultoi 3087159 banorë</p> <p>Më pas nxënësit diskutojnë rreth tyre.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4 të rubrika: “Radha juaj”.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 4.2

► Shpërndarja e popullsisë dhe struktura e saj

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 4.2 Shpërndarja e popullsisë dhe struktura e saj	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan tiparet më të përgjithshme demografike të Shqipërisë.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Shqipërisë dhe të faktorit politiko-ekonomik në shpërndarjen e popullsisë.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Shqipërisë dhe të faktorit politiko-ekonomik në shpërndarjen e popullsisë;Analizon tiparet më të përgjithshme demografike të Shqipërisë.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.Sjell shembuj të rolit që ka luajtur faktori natyror në shpërndarjen e popullsisë.			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi shpërndarjen e popullsisë dhe strukturën e saj në vendin tonë.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme demografike të Shqipërisë.			
2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Shqipërisë dhe të faktorit politiko-ekonomik në shpërndarjen e popullsisë.			
3. <u>Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi analizon strukturën e popullsisë.			

Rezultatet e të nxënës të temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet më të përgjithshme demografike. • analizon strukturën e popullsisë. 	Fjalët kyçe: shpërndarje e popullsisë, struktura e popullsisë, mbipopullim.
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit kanë njohuri rreth: a. Popullimit të hershëm dhe të vazhdueshëm të territorit shqiptar.
b. Ndërtimi i njohurive të reja	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 4.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 4.2 në tekst - Diskutojmë rreth: - shpërndarjes gjeografike të popullsisë në vendin tonë dhe faktorëve që ndikojnë në të; - tipareve të përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, sipas moshës, gjinisë, etnisë etj. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi: - shpërndarjen e popullsisë; - strukturën e popullsisë. Më pas ata analizojnë dhe diskutojnë mbi: Ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë në Shqipëri dhe për ndryshimet në shpërndarjen dhe dendësinë mesatare të saj.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të referohen hartës dhe grafikut që paraqesin dendësinë e popullsisë së Shqipërisë dhe së bashku me ta trajton veçoritë e shpërndarjes së popullsisë në vendin tonë.</p> <p><i>Shpërndarja gjeografike e popullsisë nuk ka qenë e njëjtë në të gjithë hapësirën e Republikës së Shqipërisë, për shkak të disa faktorëve të rëndësishëm, siç është ai natyror, faktori demografik dhe faktori politiko-ekonomik.</i></p>

	<p><i>Faktori natyror</i> ka ndikuar në çdo periudhë historinë shpërndarjen e popullsisë në Shqipëri. Relievi fushor, tarracat lumore, shpatet me pjerrësi të vogël, si dhe zonat me klimë të butë e pranë burimeve ujore kanë njohur përqendrimin më të madh të popullsisë. Edhe pas vitit '90, një ndër faktorët kryesorë që ndikoi në lëvizjen e një pjese të popullsisë drejt territoreve perëndimore të vendit ishte ai natyror.</p> <p><i>Faktori demografik</i> njihet si një ndër faktorët e rëndësishëm që ka ndikuar në shpërndarjen e pabarabartë të popullsisë në vend. Në zonat rurale, për shkak të aktivitetit bujqësor (i cili kërkonte sa më shumë krahë pune), lindshmëria ka qenë për herë më e lartë se në zonat urbane pavarësisht se pas viteve '90, ritmet e shtimit natyror të popullsisë pësuan rënie edhe në këto zona. Në vitin 2011, numri mesatar i anëtarëve të një familjeje rezultoi të jetë më i ulët, krahasuar me regjistrimet e mëparshme (shih tabelën 1 në tekst).</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë hartën dhe grafikun që ndodhen në libër.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Struktura e popullsisë sipas moshës.</i> Republika e Shqipërisë është dalluar gjithnjë për peshën e madhe që zë në popullsinë e përgjithshme të vendit grupmosha e re dhe ajo aktive për punë (shih grafikun e figurës 5). Këto grupmosha përbëjnë një potencial të rëndësishëm në zhvillimin demografik dhe ekonomiko-shoqëror të vendit.</p> <p><i>Struktura e popullsisë sipas gjinisë.</i> Përqindja e popullsisë së gjinisë mashkull në Shqipëri ka qenë përherë më e lartë se ajo e popullsisë së gjinisë femër. Vetëm në regjistrimin e vitit 2001 u vu re një rritje e lehtë e përqindjes së popullsisë femër (50,1%), në krahasim me atë të gjinisë tjetër (49,9%).</p> <p><i>Struktura e popullsisë sipas vendbanimeve.</i> Deri në regjistrimin e vitit 2001, numri i popullsisë rurale në Republikën e Shqipërisë ka qenë më i lartë se ai i popullsisë urbane, megjithëse popullsia urbane ka ardhur vazhdimisht në rritje. (shih grafikun e figurës 6)</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Struktura etnike e popullsisë.</i> Në Republikën e Shqipërisë jeton një popullsi homogjene, ku 98% të popullsisë së përgjithshme e përbën ajo shqiptare dhe vetëm 2% janë pakica kombëtare (greke, maqedonase dhe malazeze). Pjesë e popullsisë janë edhe pakicat gjuhësore arumune e rome.</p> <p><i>Struktura fetare e popullsisë.</i> Vendi ynë dallohet për tolerance midis besimeve fetare. Bashkësitë fetare myslimane e bektashiane të besimit islam dhe ato ortodokse e katolike</p>
--	--

	<p>të besimit të krishterë bashkëjetojnë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën. Pjesa më e madhe e popullsisë së Shqipërisë i përket besimit islam.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4 dhe 5 të rubrikës “Mbroni një pikëpamje”</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

► PROJEKT (ORA E PARË)

Tema: Trashëgimia natyrore, humane dhe kulturore e Shqipërisë. Zhvillimi ekonomik i saj dhe perspektiva e integritetit evropian

Rezultatet e të nxënës

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- analizon pozitën gjeografike të Republikës së Shqipërisë, kushtet natyrore të saj dhe rolin e tyre për zhvillimin ekonomik;
- evidenton site-t kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tonë dhe hulumton në burime të ndryshme mbi zonat e mbrojtura, pasuritë natyrore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;
- identifikon faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve të mjedisit në Shqipëri;
- vlerëson ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve dhe parashikon rrugët e menaxhimit efektiv të tyre;
- interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve në Shqipëri;
- analizon zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe rolin e sektorë ve të saj në perspektivën ekonomike të vendit;
- vlerëson problemet e sotme dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritetit rajonal dhe evropian;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (përpjekjet personale dhe ato në grup);
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- është krijues/e, shfaq ide të reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj;
- tregon objektivitet në kryerjen e detyrave, në diskutime dhe në debate.

Burimet kryesore të informacionit:

Teksti mësimor i Gjeografisë 11, kllastera dhe materiale të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruar nga interneti, INSTAT-i apo nga OJF të ndryshme; të dhëna zyrtare nga Ministria e Financave, pushteti vendor, si dhe nga anketimet në zonën e banimit; vëzhgime të nxënësve në terren, guida të ndryshme turistike, enciklopedi, libra dhe revista me kuriozitete, shtypi

dhe programe televizive.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh, anketa dhe vëzhgime në terren.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin e projektit:

teksti mësimor i Gjeografisë 11, materiale të printuara (materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara), materiale të siguruar nga pushteti vendor dhe nga shtypi, kompjuter, videoprojektor, fletë-anketa, tabelë prezantimi, shënjes, fletëpalosje, postera, fotografi, skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë punës për realizimin e projektit:

- përshkrimi i larmisë së peizazheve e mjediseve natyrore të Shqipërisë dhe i faktorëve të përgjithshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim;
- analizimi i kushteve natyrore të Shqipërisë;
- evidentimi dhe vlerësimi i rezervave minerare të vendit tonë dhe i shpërndarjes gjeografike të tyre;
- evidentimi i site-ve kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tonë dhe hulumtimi mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;
- identifikimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë në ndotjen e mjedisit;
- vlerësimi i ndikimit të veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e mjedisit natyror dhe parashikimi i rrugëve për menaxhimin efektiv të tij;
- analizimi i dinamikës së popullsisë, i shpërndarjes gjeografike të saj dhe i veçorive të vendbanimeve në Shqipëri;
- analizimi i zhvillimit ekonomik të Shqipërisë;
- vlerësimi i potencialeve humane të Shqipërisë dhe i ndikimit të tyre në zhvillimin ekonomik të vendit;
- analizimi i rolit të sektorëve të ekonomisë (bujqësisë, industrisë, tregtisë, transportit, turizmit, shërbimeve dhe artizanatit) në zhvillimin e Shqipërisë;
- vlerësimi i problemeve dhe i perspektivës së zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritetit rajonal dhe evropian.

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit:

Ndahen grupet e punës (me nga 3-4 anëtarë secili). Diskutohen detyrat dhe ndahen rolet brenda grupit.

Ndahet në disa nëntematika tema e projektit dhe përcaktohen drejtimet/fushat ku do të përqendrohet më tepër secili prej grupeve.

Diskutohet rreth rezultateve të të nxëniet nga ky projekt.

Sugjerohen e përcaktohen burimet e informacionit dhe diskutohet rreth mënyrës së menaxhimit të tyre. Përcaktohet formati i projektit dhe diskutohet rreth mënyrës së prezantimit të tij.

Tema 4.3

► Migrimet e popullsisë shqiptare. Shkaqet dhe pasojat e tyre

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 4.3 Migrimet e popullsisë shqiptare. Shkaqet dhe pasojat e tyre	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja <ul style="list-style-type: none">Evidenton periudhat e lëvizjeve migratore të popullsisë shqiptare dhe faktorët që kanë ndikuar në to.Përshkruan periudhat e emigracionit shqiptar dhe identifikon faktorët që ndikuan në këtë dukuri sociale.Analizon pasojat e emigracionit shqiptar pas vitit ’90.		Fjalët kyçe: Migrim i popullsisë, emigracion, migrim i brendshëm etj.	
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetari, histori, TIK	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u> <ul style="list-style-type: none">Shpreh mendimin e vet mbi llojet e migrimeve dhe veçorit e tyre.Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth migrimit të popullsisë dhe pasojave të tij.Përshkruan shkaqet dhe pasojat e migrimit,duke analizuar shembuj.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u> <ul style="list-style-type: none">Jep shembuj të ngjashëm ilustrues mbi migrimin e popullsisë, bazuar në ato që paraqiten si modele në libër.Vlerëson dhe argumenton rëndësinë e emigracionit të jashtëm në ekonominë e vendit.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u> <ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Dallon dhe analizon llojet e ndryshme të lëvizjes së popullsisë.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u> <ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			

<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon faktorët që ndikuan në emigrimin e popullsisë. <p>5. Kompetenca personale (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit të grupit shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi migrimin dhe emigrimin e popullsisë. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi përcakton kuptimin mbi migrimin dhe emigrimin, duke analizuar shembuj. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi hulumton, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht mbi llojet e migrimit dhe faktorët që ndikojnë në to. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi analizon periudhat e lëvizjeve migratore të popullsisë shqiptare dhe faktorët që kanë ndikuar në to. 	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në njohuritë e marra nga nxënësit në klasën e gjashtë dhe të tetë mbi migrimet: Migrimi i popullsisë është pjesë e rëndësishme e dinamikës së popullsisë shqiptare. Ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në shpërndarjen gjeografike të popullsisë, në strukturën e saj, në procesin e urbanizimit dhe në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit. Migrimi i popullsisë është pjesë e rëndësishme e dinamikës së popullsisë shqiptare. Ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në shpërndarjen gjeografike të popullsisë, në strukturën e saj, në procesin e urbanizimit dhe në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 4.3.</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>- Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 4.3 në tekst: Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> • koncepteve <i>migrim dhe emigrim</i> • Lëvizjeve migratore të popullsisë shqiptare pas vitit '90 dhe faktorëve kryesorë që kanë ndikuar në to. <p>Nxënësit përshkruajnë, përkufizojnë...</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon:</p> <p>Migrimet e popullsisë janë shfaqur në formën e migrimit të brendshëm dhe në atë të migrimit të jashtëm. Përmasat, drejtimet dhe motivet e migrameve kanë qenë përherë të lidhura ngushtë</p>

	<p>me faktorët politikë (luftërat, pushtimet, politikat qeveritare, stabiliteti politik etj.), ekonomikë (varfëria, papunësia, paga e ulët, mungesa e sipërfaqes bujqësore, mbyllja e aktivitetit ekonomik) dhe shoqërorë (pasiguria, gjakmarrja, kërkesa për shërbim më të mire arsimor, shëndetësor, kulturor etj.).</p> <p>Në Republikën e Shqipërisë, migrimi i brendshëm ka njohur tri faza të rëndësishme.</p> <p><i>Faza e pare</i> (1923-1945) u karakterizua nga migrimi i një pjese të madhe të popullsisë nga zona të thella malore drejt atyre të ulëta (sidomos drejt zonës bregdetare), për shkak të prapambetjes ekonomike dhe gjendjes së vështirë të krijuar nga luftërat botërore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesja u drejtohet nxënësve me pyetjen që nxit brainstorming-un: Çfarë dini për secilin prej tyre? Jepni nga një shembull. - Mësuesi/ja pret përgjigjet prej nxënësve... <p>Mësuesi/ja vazhdon:</p> <p><i>Faza e dytë</i> (1945-1990) dallohet për migrimin e brendshëm, të kontrolluar dhe të drejtuar nga shteti. Lëvizjet më të mëdha të popullsisë Brenda territorit të vendit janë shënuar në vitet 1950-1970, pasi gjatë kësaj periudhe forcat e punësuar orientuan drejt qendrave kryesore bujqësore dhe industriale që u ndërtuan.</p> <p><i>Faza e tretë</i> (pas vitit 1990) karakterizohet nga një zhvendosje masive, kaotike dhe jo e njëtrajtshme e popullsisë drejt zonave urbane, në kushtet e lëvizjes së lirë. Kjo fazë u shoqërua edhe me rritjen e ritmeve të urbanizimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja u drejtohet nxënësve: Sillni shembuj të ngjashëm... - Gjatë përgjigjeve të nxënësve... mësuesi/ja i fton ata të përshkruajnë edhe figurat 1 dhe 2 të tekstit. <p>Mësuesi/ja vazhdon:</p> <p>Fillimet e veta, emigracioni shqiptar i ka në shekullin XV. Në etapa të caktuara ai është ndikuar nga faktorë të ndryshëm ekonomikë, politikë dhe shoqërorë.</p> <p><i>Periudha e pare</i> e emigracionit masiv është ajo midis shek. XV-XVII, ku një pjesë e popullsisë shqiptare u largua drejt zonave të jugut të Italisë, të cilat nuk kishin rënë nën sundimin osman. Kjo popullsi krijoi disa vendbanime shqiptare, një pjesë e të cilave gjenden edhe sot në Kalabri dhe Sicili.</p>
--	--

	<p><i>Periudha e dytë</i> u përket viteve 1912-1923, gjatë të cilave emigrimi u nxit nga kushte të vështira ekonomike dhe gjendja e krijuar pas Luftës së Parë Botërore, ku një pjesë e madhe e të emigruarve u larguan drejt ShBA-së.</p> <p><i>Periudha e tretë</i> është ajo e viteve 1923-1939, gjatë të cilës emigrimi u nxit nga prapambetja e theksuar ekonomike dhe nga pasiguria politike në vend. Edhe gjatë kësaj periudhe, pjesa më e madhe e të emigruarve u larguan drejt ShBA-së.</p> <p><i>Periudha e katërt</i> (gjatë viteve 1945-1990) u karakterizua fillimisht nga largime të individëve që ishin kundër regjimit komunist. Me vendosjen dhe konsolidimin e regjimit komunist, dukuria e migrimit të jashtëm të popullsisë u ndalua me ligj.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin informacionin e tekstit duke vëzhguar grafikët 3 dhe 4 dhe u kërkon nxënësve të përcaktojnë periudhat migratore të vendit tonë. Në vazhdim i fton ata të paraqesin shembuj të ngjashëm.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Në vazhdim, nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 2 dhe 3 të tekstit, në rubrikën “Radha juaj”.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/ gjetjet e tyre për lëvizjen migratore.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.


Tema 4.4

► Struktura e vendbanimeve në Shqipëri

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 4. Struktura e vendbanimeve në Shqipëri	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan veçoritë e zhvillimit të vendbanimeve shqiptare.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e qyteteve dhe të fshatrave në zhvillimin ekonomik të hapësirës shqiptare.			

<p><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. • Argumenton evoluimin e vendbanimeve shqiptare në shekuj. • Analizon tiparet e qyteteve dhe fshatrave në hapësirën shqiptare. <p><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. • Sjell shembuj të rolit që ka luajtur faktori natyror në shpërndarjen e vendbanimeve. <p><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan mendimet në grup. <p><u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p><u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi Struktura e vendbanimeve në Shqipëri. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi përshkruan veçoritë e zhvillimit të vendbanimeve shqiptare. <p><u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi vlerëson rëndësinë e qyteteve dhe të fshatrave në zhvillimin ekonomik të hapësirës shqiptare. <p><u>3. Marrja e vendimeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi analizon tiparet e qyteteve dhe fshatrave në hapësirën shqiptare. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan veçoritë e zhvillimit të vendbanimeve shqiptare; • analizon tiparet e qyteteve dhe fshatrave në hapësirën shqiptare. 	<p>Fjalët kyçe: vendbanime shqiptare, struktura e popullsisë, llojet e vendbanimeve.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. Popullimit dhe vendbanimeve të hershme dhe të vazhdueshme të territorit shqiptar.</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 4.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 4.4 në tekst - <i>Diskutojmë rreth</i>: - vendbanimeve të hershme në vendin tonë, duke sjellë disa shembuj; - veçoritë të arkitekturës së vendbanimeve të ndryshme në Shqipëri etj. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi: - strukturën e vendbanimeve; - llojet e vendbanimeve. Më pas ata analizojnë dhe diskutojnë mbi: Në periudha të largëta të prehistorisë, që nga paleoliti i mesëm e deri në fund të neolitit, vendbanimet në Shqipëri gjendeshin në për shpella, në tarraca lumore, pranë burimeve ujore, pranë tokave pjellore dhe në për pyje. Gradualisht, banesat kaluan nga ato në formë gropash të nëndheshme, në kasolle të ndërtuara mbi hunj(palafite). Në epokën e hekurit, ilirët jetonin në fshatra dhe në vendbanime të fortifikuara. Nga të dhënat arkeologjike (në Mat, në Korçë, në Kukës, në luginën e Drinosit, Elbasan, Himarë, etj.), vendbanimet fshatare ilire të kësaj kohe përbëheshin nga grupe banesash të grumbulluara mbi bazë familjesh të mëdha patriarkale që i përkisnin një vëllazërie. Në krahinat e brendshme dhe veriore ilire gjendeshin vendbanime të mbrojtura me ledhe, ndërsa Iliria Jugore përbëhej nga vendbanime të fortifikuara. Në fund të epokës së hekurit . Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë... Mësuesi/ja fton nxënësit të plotësojnë kllasterin e mëposhtëm.</p>
---	---



	Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4 të rubrikës “Mbroni një pikëpamje”.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 4.5

► Potencialet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe veçoritë e tij

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 4.5 Potencialet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe veçoritë e tij	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan veçoritë kryesore të ekonomisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme.Evidenton potencialet natyrore të Republikës së Shqipërisë, që favorizojnë zhvillimin ekonomik të saj.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson ndikimin e potencialeve humane në zhvillimin ekonomik të vendit.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon se në çfarë raporti janë kushtet natyrore dhe faktorët historio-shoqërorë në zhvillimin ekonomik të vendit.Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton potencialet natyrore të Republikës së Shqipërisë, që favorizojnë zhvillimin ekonomik të saj. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson ndikimin e potencialeve humane në zhvillimin ekonomik të vendit. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë, akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruan veçoritë kryesore të ekonomisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme; analizon se në çfarë raporti janë kushtet natyrore dhe faktorët historio-shoqërore në zhvillimin ekonomik të vendit; vlerëson ndikimin e potencialeve humane në zhvillimin ekonomik të vendit. 	<p>Fjalët kyçe: potencialet e zhvillimit ekonomik, degët e ekonomisë, ekonomia.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <p>a. Pozitën gjeografike të Republikës së Shqipërisë dhe tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të saj (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore) të cilat kanë ndikim të madh në zhvillimin e ekonomisë.</p>
	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 4.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 4.5 në tekst, diskutojnë mbi natyrën e ekonomisë së Shqipërisë dhe rolin e kushteve natyrore në zhvillimin e saj si dhe potencialet që ajo ka.</p> <p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> zhvillimit ekonomik të Shqipërisë gjatë periudhave të ndryshme;

	<ul style="list-style-type: none"> • potencialeve natyrore e humane të Shqipërisë dhe ndikimit të tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....
b. Ndërtimi i njohurive të reja	<p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit mbi: potencialet natyrore, potencialet humane, roli i faktorit historiko-shoqëror etj.</p> <p>Në vazhdim fton nxënësit të diskutojnë rreth tyre. Nxënësit diskutojnë dhe plotësojnë kllasterin...</p>

Potencialet e zhvillimit ekonomik

Potencialet natyrore

Pozita gjeografike e Shqipërisë dhe pasuritë natyrore të saj janë dy faktorë të rëndësishëm që mbështesin zhvillimin e një ekonomie shumë degëshe dhe të qëndrueshme. Kështu, pozita gjeografike ndikon në krijimin e kushteve natyrore, të përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë bujqësore, energjetikës, turizmit, shërbimeve, industrisë, transportit, tregtisë etj. Larmia e relievit dhe e klimës, kohëzgjatja e ditëve me diell, vlerat e temperaturave, regjimi dhe sasia e reshjeve, drejtimi dhe shpejtësia e erës, hidrografia e pasur dhe tokat pjellore mundësojnë: kultivimin e një numri të madh kulturash bujqësore, si perime, fruta, drithëra, bimë industriale, ullinj, agrume, foragjere etj.; mbarështimin e gjedhit, të bagëtisë së imët, shpendëve, derrit etj.; si dhe zhvillimin e peshkimit e të bletarisë.

Ndërkohë, nëntoka e pasur mundëson zhvillimin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve, si dhe eksportin e Mozaikut i formave të relievit përcakton profiling e zhvillimit ekonomik, ku sipërfaqet fushore mundësojnë zhvillimin e ekonomisë bujqësore, transportit dhe të shumë degëve të industrisë. Ndërkohë, relieve kodrinoro-malor krijon kushte të përshtatshme si për zhvillimin e ekonomisë bujqësore, ashtu edhe për zhvillimin e turizmit, industrisë nxjerrëse e përpunuese të mineraleve etj. Rrjeti hidrografik i pasur mundëson gjithashtu zhvillimin e transportit dhe lidhjen me zonave të ndryshme të vendit.

Potencialet humane

Krahas potencialeve natyrore, Shqipëria dallohet edhe për potenciale të mëdha humane si: traditat, përqindja e lartë që zë grupmosha e punës, niveli i lartë i kualifikimit dhe i arsimimit, përvojat që kanë sjellë emigrantët shqiptarë nga vendet perëndimore, shkollimi i një pjese të brezit të ri në universitetet evropiane, amerikano-veriore etj. Traditat. Në shekuj, popullsia shqiptare ka krijuar dhe trashëguar përvoja shumë të mira në disa degë të ekonomisë, si bujqësia, blegtoria, peshkimi, bletaria, artizanati, nxjerrja e mineraleve etj.

Roli i faktorëve historiko-shoqërorë

Faktorët që kanë penguar ose ngadalësuar ritmet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë janë luftërat dhe pushtimet e ndryshme, copëtimi i trevave shqiptare, emigrimet masive të popullsisë dhe zbatimi i politikave të gabuara ekonomike. Kështu, trevave shqiptare nga perandoritë romake, bizantine dhe që ekonomia e tyre, për shekuj me radhë të ishte e ekonomive të perandorive pushtuese. Më vonë, dy luftërat botërore jo vetëm që frenuan zhvillimin e vendit, por sollën rrënimin ekonomik të tij. Pas përfundimit të luftës së Dytë Botërore deri në vitin '90, ekonomia e vendit u orientua drejt modeleve të vendeve lindore. Zbatimi i ekonomisë së centralizuar dhe i politikës së “mbështetjes në forcat e veta” solli pas vitit '80 degradimin ekonomik të Shqipërisë, i cili u shoqërua e ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore.

	<p><i>Mësuesi/ja vazhdon me zhvillimin ekonomik pas viteve '90:</i> Pas vitit 1991 e në vazhdim, Shqipëria u fut në rrugën e zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe të vendosjes e zgjerimit të marrëdhënieve politike, ekonomike e shoqërore me vendet perëndimore, duke synuar edhe integrimin në Bashkimin Evropian. Në vitin 1991, pas përmbysjes së regjimit komunist, qeveria e re mori një sërë reformash. Si rezultat i teknologjisë së prapambetur dhe cilësisë së ulët të prodhimit, u mbyllën të gjitha objektet industriale, çka solli rritjen e papunësisë në vend. Papunësia në sektorin industrial e bujqësor ishte një prej faktorëve kryesorë të emigracionit masiv të shqiptarëve gjatë periudhës postkomuniste. Në vitin 1992 filloi privatizimi i pronës shtetërore, i tokës bujqësore, i bazës blegtorale dhe i të gjitha aseteve të fermave kolektive.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 5 të rubrika: “Mbroni një pikëpamje”.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 4.6

► Ekonomia e Republikës së Shqipërisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 4: Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisëshqiptare		Tema mësimore: 4.6 Ekonomia e Republikës së Shqipërisë	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit të degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson ndikimin e pozitës gjeografike dhe të kushteve natyrore të vendit, në zhvillimin e secilit prej sektoreve të ekonomisë shqiptare.			
<u>3. Kompetenca e të nxënës (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit të tyre në ditët e sotme.			

<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. <p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. <p>5. Kompetenca personale (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi evidenton sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë e shkallën e zhvillimit të tyre. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi evidenton zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë, akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit; • vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian; • analizon ndikimin e pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore në zhvillimin ekonomik të vendit. 	<p>Fjalët kyçe:ekonomia bujqësore, sektori industrial, tregtia, turizmi, transporti dhe artizanati</p>
<p>Burimet:Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat tjera ose temat ndërkurrikulare:Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Pozitën gjeografike të Republikës së Shqipërisë dhe tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të saj (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore); – Vlera të trashëgimisë natyrore e kulturore të Shqipërisë;

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 4.6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Veprimet në situatë

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 4.6 në tekst, diskutojnë mbi natyrën e ekonomisë së Shqipërisë dhe rolin e kushteve natyrore në zhvillimin e saj si dhe fushave të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

Diskutojmë rreth:

- Sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.
- Rreth problemeve që ndeshen sot në ekonomi dhe mundësive për zgjidhjen e tyre.
- Perspektivës së zhvillimit ekonomik të Shqipërisë në kuadër të integritetit rajonal dhe evropian.

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit mbi: ekonominë bujqësore, sektorin industrial, tregtinë, turizmin, transportin dhe artizanatin.

Në vazhdim fton nxënësit të diskutojnë rreth tyre.

Nxënësit diskutojnë dhe plotësojnë kllasterin...

Ekonomia e Republikës së Shqipërisë

Sektori i parë i ekonomisë

Peshën kryesore në ekonominë bujqësore e zë *bujqësia*, e cila është e përqendruar kryesisht në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë, në Fushëgropën e Korçës dhe në atë të Delvinës. Bujqësia është e zhvilluar gjithashtu përgjatë tarracave lumore dhe në shpatet e kodrave. Kulturat që zënë sipërfaqet më të mëdha bujqësore janë: drithërat, perimet, frutat, vreshtat dhe foragjeret. Drithërat (gruri, misri, thekra) kultivohen në të gjitha zonat fushore të vendit (dallohet Ultësira Perëndimore). Perimet kultivohen në të gjithë hapësirën fushore dhe kodrinore të vendit, ndër të cilat, Fushëgropa e Korçës dhe zona verilindore e Shqipërisë dallohen sidomos për kultivimin e patates, fasules dhe qepës; ullinjë kultivohen kryesisht në zonat kodrinore të Ultësirës Perëndimore (në Berat, Vlorë, Mallakastër, Kërrabë etj.).

Sektori i dytë i ekonomisë

Industria nxjerrëse dhe përpunuese e mineraleve mbështetet në rezervat e mëdha minerale të nëntokës shqiptare, si ato të naftës, gazit natyror, kromit dhe bakrit. Vendi ynë është i pasur edhe me rezerva minerale të tjera, por për shkak të mungesës së investimeve në teknologjinë e minierave, shumë prej tyre nuk shfrytëzohen. Vendburimet kryesore të naftës janë Kuçova, zona e Patos-Marinzës dhe Mallakastër, ndërsa përpunimi i saj bëhet në Ballsh dhe në Fier. *Energjetika* është një degë e rëndësishme e ekonomisë dhe mbështetet në shfrytëzimin e rezervave hidrike nëpërmjet HEC-eve të Drinit, Matit dhe Bistricës. *Industria e lehtë dhe ajo ushqimore* mbështeten kryesisht mbi traditën dhe përfaqësohen nga sipërmarrje të vogla e të mesme. *Industria e lehtë* përfaqësohet më së shumti me sipërmarrjet fasone (të prodhimit të veshmbathjeve) dhe është e përqendruar në Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Korçë dhe Gjirokastrë. *Ndërtimtaria është një degë* e ekonomisë, e zhvilluar shumë vitet e fundit, e cila punëson një pjesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore.

	<p>Sektori i tretë i ekonomisë</p> <p><i>Turizmi</i> zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e Shqipërisë. Degët e tij kryesore janë: turizmi blu (përgjatë gjithë vijës bregdetare: Velipojë, Durrës, Vlorë, Sarandë etj., dhe në zonat bregliqenore, si Pogradeci); turizmi i bardhë (në Dardhë, Voskopojë, Tomor, Razmë, Valbonë, Dajti, Qafë-Shtamë etj.); turizmi kulturor (në qytetet muzeale e historike, si Berati, Gjirokastra, Shkodra, Lezha, Kruja etj.; në qendrat e trashëgimisë kulturore të vendit, si Butrinti, Apollonia, Durrësi, Bylisi etj., si dhe pranë objekteve të kultit, shpellave karstike etj.).</p> <p><i>Transporti</i> është një ndër degët e ekonomisë që përfshihet në shumë investime. Ndonëse në Shqipëri janë të zhvilluara të gjitha degët e transportit, peshën më të madhe të lëvizjes së mallrave dhe të njerëzve e mban ai automobilistik, më pas transporti detar dhe ai ajror. Transporti automobilistik është i shpërndarë në të gjithë hapësirën e vendit.</p> <p><i>Shërbimet dhe tregtia</i> kanë njohur një zhvillim të madh kohët e fundit dhe dallohen për numrin e lartë të të punësuarve. <i>Shërbimet</i> dallohen gjithashtu për përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë dhe përpërqendrimin tyre kryesisht në qendra qarqesh, në qytete të mëdha, në zonat bregdetare e bregliqenore, në qendrat muzeale dhe në porte.</p> <p><i>Artizanati</i> bazohet në prodhimin e artikujve të traditës dhe është i zhvilluar kryesisht pranë zonave turistike, ndër të cilat dallohen: Kruja, Berati dhe Gjirokastra. Ai përfaqësohet nga zejjet tradicionale shqiptare, si: punime te veshjeve popullore, sixhadeve, drurit, qeramikës, filigranit, argjendarisë etj.</p>
	<p>Hapi III :Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 2 te rubrika: “Mbroni një pikëpamje”.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Përsëritje 2

► Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë mbi pyetjet/çështjet e mëposhtme:

1. Diskutoni mbi pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë disa nga veçoritë kryesore të popullimit të hershëm në Shqipëri?
- Si paraqitet dinamika e popullsisë në vendin tone gjatë periudhave të ndryshme?
- Cilat janë veçoritë e vendbanimeve të hershme shqiptare?
- Si kanë evoluuar llojet e vendbanimeve shqiptare gjatë shekujve?
- Cilat janë veçoritë kryesore të ekonomisë së Shqipërisë:
 - Deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore;
 - Gjatë viteve 1945-1990;
 - Gjatë periudhës post-komuniste?
- Cilat janë potencialet natyrore të vendit tonë, që favorizojnë zhvillimin ekonomik të tij?
- A ndikojnë potencialet humane në zhvillimin ekonomik të vendit? Pse?

2. Përshkruani si ka ndryshuar numri i popullsisë në Shqipëri pas vitit 1990 dhe **përcaktoni** faktorët që kanë ndikuar. Sill shembuj ilustrues.

3. Analizoni: a) shpërndarjen e popullsisë në Shqipëri; b) faktorët që kanë ndikuar në këtë shpërndarje; c) strukturën e popullsisë në Shqipëri.

4. Shpjegoni si ndikon mbizotërimi i grupmoshës së re në numrin e përgjithshëm të popullsisë në Shqipëri.

5. Analizoni lëvizjet migratore në Shqipëri gjatë periudhave të ndryshme edhe faktorët që kanë ndikuar në to.

6. Plotësoni tabelën e më poshtme.

Periudhat kryesore të emigracionit shqiptar	Shkaqet e emigracionit	Pasojat e emigracionit pas vitit '90

7. Evidentoni llojet e qyteteve dhe të fshatrave në Shqipëri.

8. Analizoni peshën që kanë kushtet natyrore dhe faktorët historiko-shoqërorë në zhvillimin ekonomik të vendit.

9. Analizoni zhvillimin e sotëm të tre sektorëve kryesorë të ekonomisë shqiptare, duke evidentuar peshën që zë secila prej degëve të tyre.

10. Vlerësoni rolin e pozitës gjeografike dhe të kushteve natyrore të vendit tone në zhvillimin e tre sektorëve kryesorë të ekonomisë.

11. Diskutoni mbi :a) dinamikën e popullsisë në vendbanimin tuaj, gjatë periudhave të ndryshme dhe faktorët që kanë ndikuar;b) veçoritë e strukturës së popullsisë dhe të shpërndarjes së saj në zonën ku banoni; c) ndikimin e emigracionit në dinamikën e popullsisë dhe të ekonomisë së vendbanimit tuaj.

TESTI II GRUPI A

1. Plotëso mendimin:

a. Dendësia e popullsisë në Shqipëri është: _____ dhe ndikohet nga faktorët: _____
(2 pikë)

2. Analizo kushtet natyrore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë (ilustro me shembuj): _____

(8 pikë)

3. Analizo: Degët kryesore të industrisë dhe shpërndarjen gjeografike të tyre: _____

(6 pikë)

4. Evidento strukturën e popullsisë sipas grupmoshës dhe gjinisë: _____

(2 pikë)

5. Përcakto momentet më të rëndësishme historike në të cilat ka ndryshuar fizionomia e vendbanimeve shqiptare dhe **analizo** se çfarë ndryshime kanë ndodhur:

- a. _____ (shembull) _____
- b. _____ (shembull) _____
- c. _____ (shembull) _____
- d. _____ (shembull) _____
- e. _____ (shembull) _____

(2 pikë)

6. Përcakto rajonet kryesore të ekonomisë bujqësore në Shqipëri dhe **evidento** kulturat kryesore që kultivohen në secilin prej tyre:

1. _____, përfshin _____ dhe dallohet për: _____
2. _____, përfshin _____ dhe dallohet për: _____
3. _____, përfshin _____ dhe dallohet për: _____
4. _____, përfshin _____ dhe dallohet për: _____

(4 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-9	10-13	14-16	17-19	20-22	23-24

TESTI II GRUPI B**1. Plotëso mendimin:**

Sipas zonave gjeografike, dallojnë përdendësi të madhe populimi: _____

____ (1 pikë)

2. Plotëso dhe argumento: Tri prej kushtet natyrore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, janë:

1. _____ (argumento si ndikon) _____

2. _____ (argumento si ndikon) _____

3. _____ (argumento si ndikon) _____

(3 pikë)

3. Analizo: Degët kryesore të ekonomisë bujqësore dhe shpërndarjen gjeografike të tyre: _____

_____ (6 pikë)

4. Evidento strukturën e popullsisë sipas etnisë dhe sipas vendbanimeve në Shqipëri: _____

_____ (2 pikë)

5. Përcakto etapat kryesore të lëvizjes migratore në Shqipëri dhe faktorët që kanë ndikuar mbi to: _____

_____ (6 pikë)

6. Analizo shpërndarjen dhe zhvillimin e degëve kryesore të industrisë në Shqipëri: _____

_____ (6 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-9	10-13	14-16	17-19	20-22	23-24

TESTI II GRUPI C

1. Plotëso mendimin:

Peshkimi dhe bletaria në vendin tonë, janë të zhvilluara sepse: _____
(1 pikë)

2. Vlerëso rolin e pasurive natyrore të Shqipërisë në zhvillimin e industrisë:

_____ (4 pikë)

2. Analizo sektorin e tretë të ekonomisë së vendit tonë sipas degëve, duke **përcaktuar** edhe zonat ku këto degë janë më të zhvilluara: _____

_____ (6 pikë)

3. Evidento tri prej pasojave të emigracionit shqiptar: _____

(3 pikë)

4. Përcakto zonat me përqendrimin më të madh të vendbanimeve fshatare në Shqipëri dhe **klasifiko** qytetet sipas periudhës së ndërtimit:

a. Zonat me përqendrimin më të madh të vendbanimeve fshatare

b. qytetet sipas kohës së ndërtimit:

1. _____

2. _____

3. _____

(4 pikë)

5. Evidento ecurinë dhe ndryshimet që kanë ndodhur në numrin e popullsisë shqiptare në etapa të ndryshme historike:

(3 pikë)

6. Argumento ndikimin e faktorëve historiko-shoqëror në zhvillimin ekonomik të vendit tonë: _____

(3 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-9	10-13	14-16	17-19	20-22	23-24

PROJEKT 1 (ORA E DYTË)

Tema: Trashëgimia e pasur natyrore, humane dhe kulturore e Shqipërisë. Zhvillimi ekonomik I saj dhe perspektiva e integritit evropian.

Rezultatet e të nxënës:

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- analizon pozitën gjeografike të Republikës së Shqipërisë, kushtet natyrore të saj dhe rolin

e tyre në zhvillimin ekonomik;

- evidenton site-t kryesore të trashëgimisë natyrore të vendit tone dhe hulumton në burime të ndryshme mbi zonat e mbrojtura, pasuritë natyrore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;
- identifikon faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve të mjedisit në Shqipëri;
- vlerëson ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve dhe parashikon rrugët e menaxhimit efektiv të tyre;
- interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve në Shqipëri;
- analizon zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe rolin e sektorëve të saj në perspektivën ekonomike të vendit;
- vlerëson problemet e sotme dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritetit rajonal dhe evropian;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (përpjekjet personale dhe ato në grup);
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- është krijues/e, shfaq ide të reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj;
- tregon objektivitet në kryerjen e detyrave, në diskutime dhe në debate.

Burimet kryesore të informacionit:

Teksti mësimor I Gjeografisë 11, kllastera dhe material të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruar nga interneti, INSTAT-I apo nga OJF të ndryshme; të dhëna zyrtare nga Ministria e Financave, pushteti vendor, si dhe nga anketimet në zonën e banimit ; vëzhgime të nxënësve në terren, guida të ndryshme turistike, enciklopedi, libra dhe revista me kuriozitete, shtypi dhe programe televizive.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh, anketa dhe vëzhgime në terren.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin e projektit:

Teksti mësimor i Gjeografisë 11, material të printuar (material të hulumtuar dhe të grumbulluar), material të siguruar nga pushteti vendor dhe nga shtypi, kompjuter, videoprojektor, fletë-anketa, tabelë prezantimi, shënjes, fletëpalosje, postera, fotografi, skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit:

Shënim: Për udhëzimet mbi realizimin e projektit, referojuni rubrikës përkatëse, të paraqitur në orën e parë të tij.

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së dytë të projektit

- Prezantimi i punës së secilit grup, i cili mund të bëhet në mënyrë elektronike (me Power Point apo me forma të tjera) ose me anë të posterave, skemave, tabakëve, maketeve etj., sipas vendimmarrjes së grupit.
- Dorëzimi i produktit të printuar.
- Diskutimi në klasë mbi përfundimet e arritura.
- Vlerësimi i nxënësve nga mësuesi/ja.
- Shpërndarja në klasë (më pas edhe te bashkëmoshatarët dhe komuniteti) e posterave/fletëpalosjeve të përgatitura.

Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë

Tema 5.1

► Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika: 5 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.1 Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Perëndimor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor.Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Perëndimor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe rolin e saj në zhvillimin e ekonomisë së vendit.Evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Perëndimor.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.Sjell shembuj të veçorive kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe potencialet natyrore për zhvillim.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Perëndimor.			

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Perëndimor. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Perëndimor; vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e Rajonit Perëndimor dhe roli i saj; kushtet natyrore.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.1 në tekst - <i>Diskutojmë rreth:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe rolit të saj; - potencialeve natyrore të Rajonit Perëndimor.. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë....</p>

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe rolin e saj: Rajoni Perëndimor shtrihet në perëndim të Republikës së Shqipërisë, nga Hani i Hotit në veri deri në qytetin e Vlorës në jug, në një gjatësi prej 205 km. Në perëndim, ai laget nga Deti Adriatik, ndërsa në verilindje, në lindje dhe në jug kufizohet përkatësisht me Rajonin Veriore Verilindor, Rajonin Juglindor dhe atë Jugor.

Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe të diskutojnë rreth kushteve natyrore të tij.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Rajoni ka një pozitë të favorshme gjeografike që mundëson jo vetëm komunikimin e tij me rajonet e tjera të Shqipërisë, por edhe lidhjen e kësaj të fundit me trevat e tjera shqiptare e më gjerë. Kjo lidhje realizohet nëpërmjet Kanalit të Otrantos dhe rrjetit automobilistik (që zë përfshinë portet e Durrësit, Vlorës dhe Shëngjinit) e hekurudhor, i cili vazhdon në brendësi të vendit. Rajoni Perëndimor mundëson gjithashtu lidhjen në rrugë ajrore të Shqipërisë me vendet e tjera të botës, pasi në të (në Rinas) ndodhet aeroporti “Nënë Tereza”, i cili është aeroporti i vetëm ndërkombëtar në vend. Në Rajonin Perëndimor ndodhen pika kufi e Hanit të Hotit dhe ajo e Muriqanit, të cilat lidhin Shqipërinë me Malin e Zi.

Ndërtimi gjeologjik: Trualli i këtij rajoni ka një moshë më të re se rajonet e tjera. Ai nisi të formësohej nga depozitimet lumore që prej fundit të pliocenit e në vazhdim dhe formën e plotë e mori gjatë kuaternarit, kur doli plotësisht mbi ujë. Në Ultësirën e Shkodrës, lëvizjet tektonike kanë çuar në formimin e relievit horst-graben. Pjesa fushore e rajonit përbëhet nga argjila, rëra, zhavorre etj., ndërsa zonat kodrinore kanë në përbërjen e tyre shkëmbinj ranorë, konglomeratë, argjilorë dhe pak gëlqerorë. Nëntoka e rajonit është e pasur me rezerva naftë, gazi natyror dhe qymyrguri.

Relievi: Format kryesore të relievit janë fushat, por nuk mungojnë edhe kodrat e vargjet kodrinore. Rajoni përfaqëson hapësirën fushore më të madhe të Ballkanit Perëndimor. Fushat janë aluvionale, pothuajse të sheshta dhe me lartësi të vogël mbi nivelin e detit. Kodrat dhe vargjet kodrinore shtrihen në drejtimin veriperëndim-juglindje dhe pjesa më e madhe e tyre gjenden në struktura antiklinale asimetrike.

	<p><i>Klima:</i> Dalja e gjerë në Detin Adriatik përcakton në këtë rajon mbizotërimin e klimës së butë mesdhetare, ndërsa lartësia e vogël mbi nivelin e detit, lejon depërtimin e masave ajrore detare në brendësi të vendit. Rajoni Perëndimor dallon për klimën tipike mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të butë e të lagësht, si rezultat i ndikimit të masave ajrore të Adriatikut.</p> <p>Rajoni ka një hidrografi mjaft të pasur, e cila përfaqësohet me rrjedha të poshtme të lumenjve më të mëdhenj të vendit (Drinit, Matit, Ishmit, Erzenit, Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës); me lumenjtë që rrjedhin tërësisht apo pjesërisht brenda rajonit (Buna, Kiri, Gjadri, Droja, Gjanica etj.); me liqene (ai i Shkodrës dhe liqene të Dumresë) e laguna (ajo e Kune-Vainit, e Patokut, e Karavastas, Nartës); me ujëra nëntokësore arteziane dhe me një numër të vogël burimesh.</p> <p><i>Tokat:</i> Tokat më të përhapura janë ato të hirta kafe dhe përveç tyre, në pjesë të ndryshme të rajonit gjenden tokat e hirta kafe livadhore, aluvionale, moçalore dhe të kripura.</p> <p><i>Bota e gjallë:</i> Rajoni Perëndimor është rajoni me sipërfaqen më të vogël të bimësisë natyrore, për shkak të zëvendësimit të saj me bimësi të kultivuar. Megjithatë, <i>flora natyrore</i> përfaqësohet me disa masive pyjore, si: pylli halor i Divjakës, pylli me dushqë i Rodonit dhe ai i Ardenicës, si dhe pyjet e përziera të Kunes. Për sa i përket <i>faunës</i>, ajo është e kufizuar në lloje; ndeshen kryesisht shpendët ujorë (rosat, patat e egra, pelikani kaçurrel) dhe shpendë të tokës (fazani, thëllëza e fushës, shkurta etj.), ndërsa nga kafshët: ujku, çakalli dhe dhelpra.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.2

► Njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.2 Njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor.Përshkruan tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor në zhvillimin e rajonit.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit.Evidenton tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
<u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor.			
<u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor.			
<u>3. Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor në zhvillimin e rajonit.			

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit. përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Perëndimor. përcakton njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor. 	<p>Fjalët kyçe: njësi përbërëse, veçori natyrore.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth: a. pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe njësitë përbërëse të tij.</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 5.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimin 5.2 në tekst - Diskutojmë rreth: - veçorive të njësive përbërëse të këtij rajoni. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të rajonit . Rajoni Perëndimor përbëhet nga dy njësi të mëdha: Ultësira e Shkodrës dhe fushat e kodrat midis Lezhës e Vlorës. <i>Ultësira e Shkodrës</i> Ultësira e Shkodrës është formuar nga lëvizje tektonike fundosëse. Ajo përbëhet nga Ultësira e Mbishkodrës dhe ajo e Nënshkodrës. Ultësira e Mbishkodrës, e cila përbën pjesën veriore të Ultësirës së Shkodrës, shtrihet në trajtën e një brezi të ngushtë midis bregut lindor të Liqenit të Shkodrës dhe Alpeve Shqiptare. Formimi dhe evolucioni i kësaj ultësire lidhet me fundosjen tektoniko-karstike të Liqenit të Shkodrës dhe me grumbullimin e më vonshëm të sedimenteve në të.</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Ultësira e Nënshkodrës është njësi më e madhe e Ultësirës së Shkodrës. Ajo përbëhet prej gëlqerorëve e terrigjenëve dhe përshkohet nga lumenjtë Drin dhe Buna. Në përbërje të saj përfshihen fushat e Bregut të Bunës, fusha te Bregut të Drinit, fusha e Anës së Malit, e Trushit, e Velipojës, e Zadrimës dhe fusha e Kakariqit. Në pjesën jugperëndimore të saj lartësohen vargu i kodrave të Rencit dhe të Kakariqit. *Fushat dhe kodrat midis Lezhës, Durrësit e Tiranës:* Kjo njësi e Rajonit Perëndimor përbëhet nga disa nën njësi, të cilat janë: fushat dhe kodrat midis Lezhës, Durrësit e Tiranës; fusha e Myzeqesë; fusha e Elbasanit; zona kodrinore midis Erzenit të Mesëm dhe Shkumbinit të Mesëm; pllaja e Dumre-Darsisë, kodrat e Sulovës dhe kodrat e Mallakastrës.

Fushat dhe kodrat midis Lezhës, Durrësit e Tiranës. Kjo nën njësi fillon nga Shëngjini në veri deri në luginën e Erzenit në jug dhe përbëhet nga gëlqerorë e terrigjenë. Në përbërje të saj hyjnë: fusha e Lezhës, ajo e Tiranës dhe fusha e Durrësit, si dhe një numër kodrash e vargjeshe kodrinore, ku dallon vargu kodrinor Kepi i Rodonit-Vorë-Erzen.

Fusha e Myzeqesë është fusha më e madhe dhe më pjellore e vendit tonë. Ajo përbëhet nga: fusha e Kavajës (që shtrihet midis bregut jugor të Gjirit të Durrësit dhe Shkumbinit të Poshtëm); Myzeqeja e Madhe (shtrihet midis Shkumbinit të Poshtëm dhe Semanit të Poshtëm); Myzeqeja e Vogël (shtrihet midis Semanit të Poshtëm dhe Vjosës së Poshtme) dhe Myzeqeja e Vlorës (nga Vjosa e Poshtme deri në Vlorë). Në monotoninë e fushës së Myzeqesë dallohen kodrat e Kryevidhit, të Divjakës, Ardenicës, Frakullës etj.

Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe të përcaktojnë në hartë njësitë përbërëse të tij dhe të diskutojnë rreth veçorive të tyre.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Më pas mësuesi/ja përcakton në hartë njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor dhe i fton nxënësit të plotësojnë kllasterin e mëposhtëm që ndodhet në libër të ushtrimit 2 të rubrikës “Radha juaj”.

Mësuesja fton nxënësit që t’i përcaktojnë ato në hartë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 të rubrikës “Radha juaj”.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.3

► Popullimi në Rajonin Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.3 Popullimi në Rajonin Perëndimor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Perëndimor.• Përcakton ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë së Rajonit Perëndimor përgjatë periudhave të ndryshme.• Evidenton shkaqet dhe pasojat e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të popullsisë pas vitit 1990 në Rajonit Perëndimor.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Analizon shpërndarjen gjeografike të popullsisë në këtë rajon.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi evidenton veçoritë e popullimit të hershëm të Rajonit Perëndimor.			
2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi vlerëson faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të popullsisë pas vitit 1990 në këtë rajon.			

<ul style="list-style-type: none"> Analizon shkaqet dhe pasojat e migrimit të popullsisë drejt këtij rajoni. 	
3. Marrja e vendimeve <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Perëndimor. Analizon strukturën, ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë gjatë periudhave të ndryshme kohore. 	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> analizon veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Perëndimor; analizon shkaqet dhe pasojat e migrimit të popullsisë drejt këtij rajoni; analizon faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të popullsisë pas vitit 1990. 	Fjalët kyçe: dinamika e popullsisë, shpërndarja e popullsisë dhe faktorët që ndikojnë në të, vendbanime të hershme.
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit dinë: <ol style="list-style-type: none"> Rajoni Perëndimor ka pasur popullim dhe vendbanime të hershme ilire; Ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë në periudha të ndryshme.
	Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).
	Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 5.3 në tekst, diskutojnë mbi popullimin e Rajonit Perëndimor në periudha të ndryshme historike dhe dinamika e popullsisë. Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - gjurmëve më të hershme të popullimit të Rajonit Perëndimor; - shpërndarjes gjeografike të popullsisë në këtë rajon; - shkaqeve dhe pasojave të lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor; Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të lexojnë mbi popullimin e hershëm të Rajoni Perëndimor dhe të n dërtojnë në fletoret e tyre një kllaster.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë...</p> <p>Në vazhdim mësuesi/ja trajton informacionin e ri:</p> <p>Gjurmë te para të popullimit të Rajonit Perëndimor i përkasin paleolitit të mesëm. Veglat prej stralli që janë zbuluar në stacionet si ai i Kryegjatës pranë Apolonisë (Fier), i Gajtanit (Shkodër) etj., vërtetojnë popullimin e hershëm të këtij rajoni. Ndër shekuj ai është populluar në të gjithë sipërfaqen e tij dhe është karakterizuar gjithmonë nga rritja e numrit të popullsisë. Rritja e vazhdueshme e popullsisë ka sjellë krijimin dhe shtimin e shumë vendbanimeve (urbane dhe rurale). Këtë e dëshmojnë zbulimet dhe gjetjet neolitike të Rrëzës së Dajtit, të zonës së Cakranit (Fier) e të Velçës (Vlorë); varrezat tumulare të epokës së bronzit në Pazhok (Elbasan), në Divjakë (Lushnjë), në Patos (Fier), në Vajzë e Dukat (Vlorë) etj., si dhe rrënojat e qendrave të vjetra urbane.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p>Politikat demografike dhe natyra e zhvillimit ekonomiko-social gjatë viteve 1945-1990 ndikuan ndjeshëm në rritjen e numrit të popullsisë. Gjatë kësaj periudhe, politikat nxitëse në favor të rritjes së lindshmërisë dhe ardhje te planifikuara të punonjësve të kualifikuar në sektorin e shërbimeve, në objektet industrial dhe në aktivitetet tregtare e bujqësore të rajonit, ndikuan në rritjen e numrit të popullsisë së tij.</p> <p>Me rritjen e numrit të popullsisë, në Rajonin Perëndimor është rritur paralelisht edhe dendësia mesatare e saj. Rajoni dallon në shkallë vendi për dendësinë mesatare më të lartë të popullsisë, e cila shkon në 182,1 banorë/km² (sipas census-it të vitit 2011).</p> <p>Për shkak të faktorëve të ndryshëm ekonomiko-shoqërorë, demografikë dhe natyrorë, shpërndarja e popullsisë në këtë rajon nuk është e njëjtë (shih grafikun e figurës 3).</p> <p>Hapi III :Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4 te rubrika: “Radha juaj”.</p>
---	--

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.4

► Struktura e popullsisë dhe veçoritë e vendbanimeve në Rajonin Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.4 Struktura e popullsisë dhe veçoritë e vendbanimeve në Rajonin Perëndimor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan tiparet më të përgjithshme demografike të Rajonit perëndimor.Evidenton llojet e vendbanimeve të Rajonit perëndimor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson strukturën e popullsisë të Rajonit perëndimor dhe shpërndarjen e saj gjeografike.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Analizon tiparet më të përgjithshme demografike të Rajonit perëndimor.Analizon shpërndarjen gjeografike të popullsisë në këtë rajon.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.Sjell shembuj të rolit që ka luajtur faktori natyror në shpërndarjen e popullsisë.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi shpërndarjen e popullsisë dhe strukturën e saj në Rajonit perëndimor.			

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan strukturën e popullsisë së Rajonit perëndimor. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson strukturën e popullsisë të Rajonit perëndimor dhe shpërndarjen e saj gjeografike. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon strukturën e popullsisë. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> analizon strukturën e popullsisë të Rajonit perëndimor dhe shpërndarjen e saj gjeografike. evidenton llojet e vendbanimeve të Rajonit perëndimor. 	<p>Fjalët kyçe: shpërndarje e popullsisë, struktura e popullsisë, mbipopullim.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. Popullimit të hershëm dhe të vazhdueshëm të Rajonit Perëndimor.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.4 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - strukturës së popullsisë së Rajonit Perëndimor; - llojeve të vendbanimeve të rajonit dhe veçorive të tyre. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - strukturën e popullsisë; - llojet e vendbanimeve. <p>Më pas ata analizojnë dhe diskutojnë mbi: Ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë në këtë rajon dhe për ndryshimet në shpërndarjen dhe dendësinë mesatare të saj.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit t'i referohen hartës dhe grafikut që paraqesin dendësinë e popullsisë së rajonit dhe së bashku me ta trajton strukturën e popullsisë së rajonit:</p>

	<p><i>Struktura e popullsisë sipas moshës:</i> krahasuar me rajonet e tjera të vendit, Rajoni Perëndimor dallon për përqindjen e lartë që zënë grupmosha e re dhe ajo e punës në numrin e përgjithshëm të popullsisë (shih grafikun e figurës 1), për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të popullsisë së ardhur. Census i vitit 2001 tregoi se në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Rajonit Perëndimor, përqindjen më të lartë e zinte popullsia femër. Më pas, nga census-i i vitit 2011 rezultoi një përqindje pothuajse e barabartë midis të dyja gjinive, për shkak të rritjes që pësoi numri i lindjeve të gjinisë mashkull (shih grafikun e figurës 2).</p> <p><i>Struktura etnike e popullsisë:</i> Rajoni përbëhet kryesisht nga një popullsi homogjene shqiptare. Krahas saj, në këtë rajon jeton dhe një pakicë kombëtare malazeze, e cila është e përqendruar kryesisht në disa fshatra të zones së Vrakës (Gril, Omaraj dhe Boriçi i Vogël.)</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të interpretojnë hartën dhe grafikun që ndodhen në libër.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Struktura e popullsisë sipas vendbanimeve:</i> Rajoni Perëndimor dallohet për përqindjen e lartë të popullsisë urbane, e cila ka pësuar vazhdimisht rritje. Bazuar në të dhënat e census-it 2011, rreth 59% e popullsisë së përgjithshme të rajonit është popullsi urbane. Përqindjen më të lartë të popullsisë e kanë bashkitë: Tiranë, Durrës, Kuçovë, Vlorë.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Karakteristikat e vendbanimeve:</i> Rajoni Perëndimor dallohet nga rajonet e tjera të vendit për numrin më të madh të vendbanimeve urbane dhe për sipërfaqet e mëdha të tyre. Midis vendbanimeve urbane dallohen: Tirana, Durrësi, Shkodra, Elbasani, Vlora, Fieri, Berati, Lezha (si qendra qarku), Kruja, Kavaja, Lushnja, Kuçova, Patosi, Cërriku, Belshi, Vora, Kamza, Shijaku, Rrogozhina, Divjaka, Roskoveci, Peqini e Ura Vajgurore (si bashki), Kopliku, Laçi dhe Ballshi (si qendra të bashkive).</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit</p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

Tema 5.5

► Trashëgimia kulturore dhe natyrore e Rajonit Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 5.5 Trashëgimia kulturore dhe natyrore e Rajonit Perëndimor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan veçoritë e trashëgimisë natyrore të Rajonit Perëndimor.Evidenton disa nga zonat e mbrojtura të këtij rajoni.Përshkruan veçoritë e trashëgimisë kulturore të Rajonit Perëndimor.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore në Rajonin Perëndimor.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit.Analizon kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe evidenton përmes shembujve disa nga problematikat me të cilat përballen ato në këtë rajon.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.Sjell shembuj të disa nga zonat e mbrojtura të këtij rajoni.			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi menaxhimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë rajon.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të këtij rajoni.Evidenton disa nga zonat e mbrojtura të këtij rajoni.			
2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë rajon;			
3. <u>Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit.			

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të këtij rajoni; • evidenton disa nga zonat e mbrojtura të këtij rajoni. 	<p>Fjalët kyçe: Trashëgimi natyrore dhe kulturore, kategori të zonave të mbrojtura,</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth: a. trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit tonë dhe të Rajonit Perëndimor.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor tabelën e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.5 në tekst - Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor, duke sjellë disa shembuj. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi: - trashëgiminë natyrore; - trashëgiminë kulturore; - zonat e mbrojtura.</p> <p>Rajoni Perëndimor ka burime të shumta natyrore dhe një trashëgimi kulturore të pasur, të cilat mundësojnë kushtet për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Ndër burimet natyrore dallojnë: rezervat e mëdha të lëndëve djegëse dhe të lëndëve të para të materialeve të ndërtimit; biodiversiteti i pasur; sipërfaqe të mëdha të tokave pjellore, të cilat mundësojnë kultivimin e të gjitha bimëve bujqësore; klima mesdhetare, që favorizon sidomos zhvillimin e ekonomisë bujqësore; dalja e gjerë në Adriatik, e cila bën të mundur lidhjen e tij me rajonin e Evropës dhe zhvillimin e tregtisë e të turizmit etj.</p>

Disa prej zonave apo hapësirave me vlera të veçanta natyrore të rajonit janë kategorizuar në rrjetin e Zonave të Mbrojtura të vendit (shih tabelën e figurës 1).

Zonat e Mbrojtura të Rajonit Perëndimor					
Nr.	Kategoria	Qarku	Bashkia	Zona e Mbrojtur	Sipërfaqja (në
1.	II.Park Kombëtar	Fier	Divjakë	Divjakë-Karavasta	22230,2
2.	IV.Rezervat Natyror	Lezhë	Lezhë	Kune	800
3.	IV.Rezervat Natyror	Lezhë	Lezhë	Vain	1500
4.	IV.Rezervat Natyror	Fier	Fier	Pishë-Poro	1500
5.	IV.Rezervat Natyror	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushë-Kuqe	2200
6.	IV.Rezervat Natyror	Lezhë	Lezhë	Bërzanë	880
7.	IV.Rezervat Natyror	Fier	Fier	Levan	200
8.	IV.Rezervat Natyror	Durrës	Durrës	Rrushkull	650
9.	IV.Rezervat Natyror	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	26535
10.	V.Peizazh i Mbrojtur	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	19738
11.	V.Peizazh i Mbrojtur	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	23027

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Mësuesi/ja fton nxënësit t'i referohen tabelës së zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe të përcaktojnë kategoritë e zonave të mbrojtura që ndodhen në këtë rajon.

Mësuesi/ja vazhdon:

Trashëgimia kulturore e Rajonit Perëndimor përfshin një rrjet të gjerë qendrash e objekteve arkeologjike, historike e kulturore, të cilat krahas mundësive që krijojnë për zhvillimin e turizmit kulturor, përfaqësojnë elemente të rëndësishme të identitetit kombëtar. Pjesë e trashëgimisë kulturore të rajonit janë qendra të rëndësishme arkeologjike, si: Dyrrahu, Apolonia dhe Bylisi, të cilat përfaqësojnë qytetërimin antik të vendit tonë. Në këtë rajon gjenden disa kala të periudhës ilire dhe të mesjetës, si ajo e Shkodrës, Lezhës, Krujës, Durrësit, Tiranës, Beratit, Elbasanit, Petrelës etj. Për vlera të rëndësishme historike dallojnë një sere objekteve dhe muzesh, si: vend varrimi i Skënderbeut në Lezhë, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Krujë, Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, Muzeu i Pavarësisë në Vlorë, Muzeu Arkeologjik në Durrës e Arkivi Shtetëror. Në këtë rajon kalon një pjesë e rrugës “Egnatia”(që zë fill në portin e Durrësit), gjurmët e së cilës përbëjnë një destinacion turistik. Trashëgimia kulturore e rajonit përfaqësohet edhe me disa objekte të rëndësishme, si: Kodikët e Beratit, Mozaiku i Tiranës dhe ai i Durrësit, Fototeka Marubi në Shkodër, objekte të kultit etj.

	Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.6

► Ekonomia bujqësore në Rajonin Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 5.6 Ekonomia bujqësore në Rajonin Perëndimor	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë bujqësore në Rajonin Perëndimor.Evidenton produktet kryesore bujqësore e blegtorale, për të cilat dallohet rajoni.			
2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson potencialet natyrore dhe humane të Rajonit Perëndimor.			
3. Kompetenca e të nxënësve (Nxënësi mëson për të nxënë)			
<ul style="list-style-type: none">Analizon zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë bujqësore dhe shkallën e zhvillimit të tyre.Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton, me ndihmën e hartës, zonat me zhvillim më të lartë të ekonomisë bujqësore në këtë rajon. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë e shkallën e zhvillimit të tyre; <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë bujqësore, akset dhe drejtimitet e zhvillimit të ardhshëm të Rajonit Perëndimor me shanset dhe mundësitë që ofron ai. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruan faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë bujqësore në Rajonin Perëndimor; evidenton produktet kryesore bujqësore e blegtorale, për të cilat dallohet rajoni; analizon zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë bujqësore dhe shkallën e zhvillimit të tyre. 	<p>Fjalët kyçe: ekonomia bujqësore, blektori, ekonomia pyjore etj.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të tij (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore). Degët kryesore të ekonomisë bujqësore.
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 5.6 në tekst, diskutojnë mbi natyrën e ekonomisë bujqësore të rajonit dhe rolin e kushteve natyrore në zhvillimin e saj si dhe fushave të bashkëpunimit mes rajoneve të tjera.</p> <p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> Faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë bujqësore në Rajonin Perëndimor; Produkteve kryesore bujqësore e blegtorale, për të cilat dallohet rajoni.

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesja fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit mbi ekonominë bujqësore, degët kryesore të ekonomisë bujqësore në këtë rajon.

Dalja e gjerë në det, klima mesdhetare, relieve kryesisht fushor, hidrografia e pasur, tokat pjellore, mbizotërimi i grupmohës së re në numrin e përgjithshëm të popullsisë, janë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë bujqësore të Rajonit Perëndimor. Kjo ka bërë që ai të dallohet nga rajonet e tjera për pjesën e madhe të prodhimit bujqësor e blegtoral që jep në shkallë vendi. Për vite me radhë, pavarësisht etapave edhe veçorive të zhvillimit historiko-shoqëror dhe politikave ekonomike, ekonomia bujqësore ka pasur peshën kryesore në ekonominë e këtij rajoni.

Në vazhdim fton nxënësit të diskutojnë rreth tyre.

Nxënësit diskutojnë dhe plotësojnë kllasterin...

Ekonomia bujqësore në Rajonin Perëndimor

Bujqësia

Bujqësia ka luajtur rolin kryesor në ekonominë bujqësore të rajonit. Ndër vite, ai është dalluar për kultivimin e pothuajse të gjitha llojeve të kulturave bujqësore (drithëra, perime, bimë industriale, fruta, foragjere etj.), pavarësisht se mbjellja e sipërfaqeve me to është kushtëzuar nga politikat ekonomike dhe nga nevojat e tregut.

Deri në vitin 1945, bujqësia në këtë rajon ishte ekstensive, e përqendruar vetëm në disa sipërfaqe të tij, pasi në atë periudhë, një pjesë e sipërfaqes së rajonit ishte e kënetëzuar, tokat në rrjedha te poshtme të lumenjve përmyteshin vazhdimisht, mungonin sistemet e kullimit e të ujitjes, si dhe mekanika bujqësore e plehtrat kimike. Kulturat që mbilleshin më të përdorshme ishin drithërat (sidomos misri), perimet dhe duhani.

Blegtoria dhe peshkimi

Vendin e dytë në ekonominë bujqësore të Rajonit Perëndimor e zë *blegtoria*, e cila është edhe një ekonomi e traditës. Në dallim me periudhën 1945-1990, kur sektori blegtoral ishte i organizuar në kooperativa bujqësore, pas vitit '90 mbarështimi i bagëtive nisi të bëhej në ferma të vogla individuale dhe më pas, në komplekse (ferma të mëdha) blegtorale. Rajoni Perëndimor dallohet për rritjen e gjedhit (kryesisht në fushën e Myzeqesë dhe në Ultësirën e Shkodrës), të bagëtisë së imët (kryesisht në Vlorë, Berat dhe Mallakastër), të derrit (sidomos në Lezhë e Kurbin) dhe të shpendëve (në të gjithë rajonin).

Një degë e rëndësishme e ekonomisë bujqësore është edhe *peshkimi*, i cili deri më 1991-in realizohej nga ndërmarrjet e peshkimit, ndërsa pas këtij viti u kthye në aktivitet privat, i organizuar në shoqata peshkimi. Peshkimi zhvillohet kryesisht në zonat bregdetare të rajonit, në laguna dhe në Liqenin e Shkodrës. Në zonat kodrinore të rajonit dhe në sipërfaqe me bimësi natyrore është e zhvilluar edhe bletaria.

	<p><i>Mësuesi/ja sqaron:</i> <i>Bujqësi ekstensive</i>-bujqësi që zhvillohet kryesisht duke zgjeruar sipërfaqen e tokave të punueshme, pa bërë përpjekje për ripërtëritjen dhe shtimin e fuqisë prodhuese të tyre.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.7

► Industria në Rajonin Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 5.7 Industria në Rajonin Perëndimor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë industriale në Rajonin Perëndimor.Evidenton degët kryesore të ekonomisë industriale, për të cilat dallohet rajoni.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rolin e potencialeve natyrore dhe humane të Rajonit Perëndimor në zhvillimin e ekonomisë industriale në këtë rajon.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë industriale dhe shkallën e zhvillimit të tyre.Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			

<p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton, me ndihmën e hartës, zonat me zhvillim më të lartë të ekonomisë industriale në këtë rajon. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë industriale dhe shkallën e zhvillimit të tyre. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson rolin e potencialeve natyrore dhe humane të Rajonit Perëndimor në zhvillimin e ekonomisë industriale në këtë rajon. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> përkshkruan faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë industriale në Rajonin Perëndimor; evidenton degët kryesore industriale e blegtorale, për të cilat dallohet rajoni; analizon zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë industriale dhe shkallën e zhvillimit të tyre. 	<p>Fjalët kyçe:ekonomia industriale, potenciale natyrore dhe humane.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të tij (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore); Degët kryesore të ekonomisë industriale.

<p><i>b. Ndërtimi i njohurive të reja</i></p>	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.7 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 5.7 në tekst, diskutojnë mbi natyrën e ekonomisë bujqësore të rajonit dhe rolin e kushteve natyrore në zhvillimin e saj si dhe fushave të bashkëpunimit mes rajoneve të tjera.</p> <p>Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Faktorëve që ndikojnë në zhvillimin industrial të Rajonit Perëndimor; • degëve kryesore të industrisë së këtij rajoni. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit mbi ekonominë industrial, degët kryesore të ekonomisë industrial në këtë rajon.</p> <p>Krahasuar me rajonet e tjera të vendit, Rajoni Perëndimor është hapësira ku gjenden qendrat më të rëndësishme industriale. Faktorët kryesorë që mundësojnë zhvillimin e industrisë në këtë rajon janë: pozita gjeografike, potencialet natyrore dhe humane të tij. Kështu, porte te mëdha detare, aksesit infrastrukturor (automobilistik, detar, ajror dhe hekurudhor) që ka ky rajon Brenda hapësirës së tij dhe me rajonet e tjera, qendra te mëdha urbane, klima e përshtatshme, relieve i ulët, rezerva te naftës, gazit natyror, bitumit e të lëndëve të para për ndërtimtarinë, si dhe përqindje te larta të grupmoshës së re të popullsisë e të grupmoshës së punës, janë potencialet kryesore ku mbështetet në mënyrë të përhershme zhvillimi i kësaj dege të ekonomisë.</p> <p>Krahas këtyre faktorëve, një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin industrial të rajonit kanë pasur edhe politikat ekonomike të ndjekura në periudha të ndryshme historiko-shoqërore të vendit. Deri në vitin 1945, niveli i zhvillimit</p>
--	---

të industrisë në këtë rajon ishte mjaft i ulët. Ai dallohej për nxjerrjen dhe përpunimin e naftës (nga shoqëria italiane AIPA) dhe të gazit natyror në Kuçovë, nxjerrjen e bitumit në Selenicë, si dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale në punishte të vogla, kryesisht në qytetet kryesore të rajonit..

Në vazhdim fton nxënësit të diskutojnë rreth tyre.
Nxënësit diskutojnë dhe plotësojnë kllasterin...

Ekonomia industriale në Rajonin Perëndimor

Industria e lehtë dhe ushqimore

Rajoni Perëndimor dallohet për zhvillimin e *industrisë së lehtë* dhe asaj ushqimore, ndërtimtarisë, energjetikës, industrisë metalurgjike, mekanike dhe industrisë nxjerrëse. Industria e lehtë përfaqësohet me sipërmarrjet fasone, të përqendruara kryesisht në Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë dhe Berat.

Industria ushqimore është e përhapur në të gjithë rajonin, me fabrika të përpunimit të ambalazhimit të produkteve bujqësore dhe atyre blegtorale. Rajoni dallohet për prodhimin e vajit ushqimor (në Tiranë, Fier dhe Berat); prodhimin e vajit të ullirit (në Vlorë, Mallakastër, Berat etj.); përpunimin e qumështit (në Tiranë, Lushnjë, Fier, Berat dhe Shkodër); përpunimin e produkteve të mishit (në Tiranë, Shkodër, Fier, Patos etj.); prodhimin e vezëve (në Durrës, Patos, Vlorë dhe Berat); prodhimin e miellit (në Tiranë dhe Fier); prodhimin e pijeve alkoolike (në Tiranë, Lezhë, Berat, Vlorë dhe Fier); prodhimin e pijeve jo alkoolike (kryesisht në Tiranë); konservimin e fruta-perimeve (në Tiranë, Berat dhe Fier) dhe të prodhimeve të detit (në Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Vlorë).

Industria

Ndërtimtaria është një degë, e cila vitet e fundit ka njohur një zhvillim të madh në këtë rajon dhe punëson një pjesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore. Ky zhvillim është i lidhur kryesisht me numrin e madh popullsisë së ardhur drejt Rajonit Perëndimor, dhe me kërkesat rritje të saj për strehim dhe mjedise shërbimesh e biznesi.

Energjetika në këtë rajon mbështetet kryesisht në nxjerrjen dhe përpunimin e naftës dhe në prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-I i Ashtës (Gjatë punimeve në zonën naftëmbajtëse "Shpirag 2 Drin).

Vend burimet kryesore të nxjerrjes së *naftës* janë Kuçova, zona e Patos- Marinëzës dhe Mallakastra, ndërsa përpunimi i saj bëhet në rafineritë e Ballshit dhe të Fierit. Përfshirja e Shqipërisë në projektin TAP (Trans Adriatic Pipeline), ka bërë që rajoni të përfitojë investime për ngritjen e infrastrukturës së transportit të gazit. Deri në vitet '90, energjetika e këtij rajoni përfaqësohej edhe me TEC-et, të cilat për shkak të teknologjisë së vjetruar dhe të kostonë së lartë të prodhimit janë mbyllur.

Industria metalurgjike dhe ajo mekanike përfaqësohen me uzinat e shkrirjes e të prodhimit të hekurit për ndërtim dhe të prodhimit të ferrokromit (në Elbasan), uzinat mekanike të industrisë nxjerrëse të naftës (në Kuçovë dhe Patos), si dhe me disa fabrika të vogla të prodhimit të tubave e të përpunimit të aluminit (në Tiranë, Durrës, Lushnjë, Fier etj.).

Industria nxjerrëse e bitumit është e përqendruar në Selenicë. Rezervat e këtij minerali janë shfrytëzuar që herët dhe pa ndërprerje. Ndonëse kohët e fundit kuotat e prodhimit dhe të përpunimit të tij kanë pësuar rënie, një pjesë e prodhimit vazhdon të eksportohet.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës "Radha juaj". Detyrë shtëpie ushtrimi 4.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.8

► Sektori i tretë i ekonomisë në Rajonin Perëndimor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore: 5.8 Sektori i tretë i ekonomisë në Rajonin Perëndimor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan faktorët që ndikojnë në zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Perëndimor.• Analizon zhvillimin e degëve të sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Perëndimor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rolin e burimeve natyrore dhe humane të Rajonit Perëndimor në zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë së tij;			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon zhvillimin e degëve të sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Perëndimor.<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi evidenton, me ndihmën e hartës, zonat me zhvillim më të lartë të sektorit të tretë në këtë rajon. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson zhvillimin e degëve kryesore të sektorit të tretë të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit të tyre. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerëson rolin e burimeve natyrore dhe humane të Rajonit Perëndimor në zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë së tij. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan faktorët që ndikojnë në zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Perëndimor; analizon zhvillimin e degëve të sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Perëndimor; vlerëson rolin e burimeve natyrore dhe humane të Rajonit Perëndimor në zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë së tij. 	<p>Fjalët kyçe: turizmi, sektori shërbimeve, transporti, potenciale natyrore dhe humane.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor dhe tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të tij (pozitën gjeografike, kushtet dhe pasuritë natyrore); - Degët kryesore të sektorit të tretë të ekonomisë.

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.8 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 5.8 në tekst, diskutojnë mbi zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë së rajonit dhe rolin e kushteve natyrore në zhvillimin e saj si dhe fushave të bashkëpunimit mes rajoneve të tjera. Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mundësive që ka rajoni për zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë; - degëve kryesore të sektorit të tretë të ekonomisë. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit mbi:sektorin e tretë të ekonomisë, degët kryesore të zhvilluara në këtë rajon. <i>Mësuesi/ja vazhdon:</i> Në Rajonin Perëndimor, potencialet natyrore dhe humane që mundësojnë zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë, janë të shumta. Pozita gjeografike, vija e gjatë bregdetare (me portet detare më të mëdha të vendit), relieve i ulët (që favorizon zhvillimin e të gjitha llojeve të transportit), klima tipike mesdhetare (kohëzgjatja e diellzimit), diversiteti i ekosistemeve, numri i madh i zonave të mbrojtura, i qendrave më të mëdha urbane të vendit dhe i qendrave të rëndësishme arkeologjike e historike, trashëgimia e pasur kulturore dhe artizanale, përqindje të larta të grupmoshës së re të popullsisë e të grupmoshës së punës dhe numri gjithnjë e në rritje i popullsisë së ardhur, investimet e shumta etj., janë faktorët kryesorë që mbështesin zhvillimin e këtij sektori të ekonomisë. Pas vitit ‘90, roli i degëve të këtij sektori ka ardhur vazhdimisht në rritje, si për shërbimet që ofrojnë, ashtu edhe për përqindjen e lartë të punësimit në këtë rajon. Burimet natyrore dhe ato humane, kërkesat në rritje të popullsisë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit, mundësitë që krijon ky sektor për punësimin etj., janë disa nga faktorët që shërbejnë si premise për zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë, turizmit dhe shërbimeve. Në vazhdim fton nxënësit të diskutojnë rreth tyre. Nxënësit diskutojnë dhe plotësojnë kllasterin...</p>
---	---

Sektori i tretë i ekonomisë në Rajonin Perëndimor

Në Rajonin Perëndimor janë të zhvilluara të gjitha degët e transportit (automobilistik, detar, ajror dhe hekurudhor). Rrjeti i *transportit automobilistik* mbulon fluksin më të madh të lëvizjes së mallrave dhe të njerëzve. Rajoni ka rrjetin më të gjerë rrugor dhe infrastrukturën më të zhvilluar në të gjithë vendin. Pas vitit '90, transporti automobilistik i tij ka përthithur investimet më të mëdha në shkallë vendi. Në këtë rajon janë ndërtuar autostradat dhe superstradat e para në vend, ndër të cilat përmendim autostradat Tiranë-Durrës, Durrës-Fier, Levan-Vlorë, Tiranë-Elbasan dhe superstradat Tiranë-Shkodër e Shkodër-Hani i Hotit.

Transporti detar kryhet nëpërmjet anijeve dhe trageteve që udhëtojnë përmes linjave të rregullta në Adriatik, duke realizuar një vëllim të madh të lëvizjes së njerëzve. Transporti ajror realizohet nëpërmjet aeroportit "Nënë Tereza", i cili ndodhet 17 km larg Tiranës dhe është një nyjë shumë e rëndësishme që lidh Shqipërinë me vendet e tjera të botës.

Transporti hekurudhor. Deri në vitin 1991, në Rajonin Perëndimor ishte përqendruar rreth 70% e rrjetit hekurudhor të vendit, i cili mundësonte lidhjen e qyteteve kryesore të rajonit përmes linjave hekurudhore: Tiranë-Durrës, Tiranë-Shkodër, Tiranë-Vlorë. Sot, rrjeti hekurudhor lë për të dëshiruar dhe ka nevojë për

Tregtia dhe shërbimet

Tregtia zë një peshë të rëndësishme në sektorin e tretë të ekonomisë së rajonit, për shkak të përhapjes së gjerë të rrjetit të njësive të shitblerjes, ku është punësuar një pjesë e madhe e popullsisë.

Zhvillimi i tregtisë në këtë rajon është shoqëruar paralelisht edhe me zhvillimin e sektorit të shërbimeve. Ky sektor përfaqësohet me një numër të madh objektivshërbimi, si resorte turistike, hotele, restorante, bar-kafe etj., të cilat, pavarësisht përhapjes në të gjithë rajonin, përqendrimin më të madh e kanë në qendrat urbane.

Turizmi është një degë e rëndësishme e ekonomisë në Rajonin Perëndimor, roli i së cilës ka ardhur gjithnjë e në rritje. Peshën kryesore në zhvillimin e turizmit e kanë investimet në infrastrukturën rrugore, zgjerimi i rrjetit të shërbimeve të hotelieri-turizmit dhe promovimi i vazhdueshëm i rajonit. Ndër degët kryesore të turizmit që zhvillohen në përmendim: turizmin blu, të gjelbër dhe atë kulturor.

Artizanati është një ndër degët e traditës në këtë rajon, e cila përfaqësohet me prodhime druri, guri dhe leshi, të punuara në mënyrë individuale ose në punishte të vogla artizanale. Artizanati zhvillohet kryesisht pranë qendrave urbane, zonave arkeologjike e historike, si dhe pranë objekteve fetare.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës "Radha juaj". Detyrë shtëpie ushtrimi 4.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

PUNË PRAKTIKE 1

► Tema: Rajoni Perëndimor i Republikës së Shqipërisë.

Rezultatet e të nxënës:

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përcakton në hartë njësitet kryesore që përbëjnë Rajonin Perëndimor të Republikës së Shqipërisë;
- lokalizon, emërtin dhe ngjyros në hartën-skicë format kryesore të relievit dhe hidrografinë

e tij;

- lokalizon dhe emërton në hartën-skicë qendrat më të rëndësishme urbane, ekonomike, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit;
- shfaq kureshtje për zhvillimet demografike dhe për strukturën e popullsisë në këtë rajon, si dhe përcakton veçoritë kryesore të popullimit në të;
- analizon veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45 minuta; në klasë.

Materialet burimore: teksti mësimor, materialet teorike e harta të siguruar nga internet apo enciklopedi të ndryshme, si dhe material të rekomanduar nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: harta-skicë, atlas gjeografik, harta fiziko-gjeografike dhe ajo politiko-administrative e Republikës së Shqipërisë, teksti mësimor, laps, rapidograf, lapsa me ngjyrë/lapustila.

Metodologjia që do të përdoret: punë individuale (ngjyrosje dhe emërtim i hartës-skicë), punë në grupe (diskutim, shkëmbim idesh).

Puna përgatitore:

- Përsëriten njohuritë e marra nga teksti mësimor mbi veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore dhe kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe mbi veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor.
- Përzgjidhen dhe diskutohen të dhënat e marra nga burime të ndryshme (internet, enciklopedi, harta, fotografi, dokumentarë televizivë etj.) në lidhje me veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore e kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe me veçoritë e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Hapat që do të ndiqni gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

1. Përcaktoni dhe emërtoni në hartën-skicë njësitë kryesore që përbëjnë Rajonin Perëndimor të Republikës së Shqipërisë.
2. Lokalizoni, emërtoni dhe ngjyrosni në hartën-skicë format kryesore të relievit (fushat, kodrat, pllajajat etj.) të këtij rajoni.
3. Lokalizoni dhe emërtoni në hartën-skicë hidrografinë e rajonit (detet, liqenet, rrjedhat kryesore lumore etj.).
4. Emërtoni në hartën-skicë zonat e rajonit që dallohen për pasuritë e mëdha natyrore (zona mineral mbajtëse, turistike, energjetike, pyjore, ujore, termale etj.), si dhe qendrat kryesore të trashëgimisë kulturore të tij.
5. Përcaktoni dhe emërtoni në hartën-skicë qendrat më të rëndësishme urbane dhe ekonomike të këtij rajoni.
6. Analizoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë, si dhe veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.
7. Vlerësoni mundësitë e shfrytëzimit të pasurive natyrore të rajonit në favor të zhvillimit social-ekonomik.
8. Interpretoni grafikë, të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me zhvillimin e sektorëve të ekonomisë në Rajonin Perëndimor gjatë periudhave të ndryshme.
9. Vlerësoni perspektivat demografike dhe ekonomike të Rajonit Perëndimor.

Tema 5.9

► **Pozita gjeografike e Rajonit Verior e Verilindor dhe disa veçori të përgjithshme të tij**

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika: 5 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.9 Pozita gjeografike e Rajonit Verior e Verilindor dhe disa veçori të përgjithshme të tij	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përcakton pozitën gjeografike të Rajonit Verior dhe Verilindor.• Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Verior dhe Verilindor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Verior dhe Verilindor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Verior dhe Verilindor dhe rolin e saj në zhvillimin e ekonomisë së vendit.• Evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Verior dhe Verilindor.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.• Sjell shembuj të veçorive kryesore natyrore të Rajonit Verior dhe Verilindor dhe potencialet natyrore për zhvillim.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Verior dhe Verilindor.			

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Verior dhe Verilindor. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Verior dhe Verilindor dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Rajonit Verior dhe Verilindor dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Verior dhe Verilindor; vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Verior dhe Verilindor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e Rajonit Verior dhe Verilindor dhe roli i saj; kushtet natyrore.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të Rajonit Verior dhe Verilindor.
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.9 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.9 në tekst - <i>Diskutojmë rreth:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të Rajonit Verior e Verilindor dhe rolit të saj; - veçorive natyrore të këtij rajoni.

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Rajonit Verior dhe Verilindor dhe rolin e saj: Rajoni Verior dhe Verilindor është hapësira me sipërfaqen më të madhe, krahasuar me rajonet e tjera të Shqipërisë. Rajoni kufizohet në veriperëndim dhe në veri me Malin e Zi, në verilindje me Kosovën dhe në lindje me Maqedoninë. Në jug, ai kufizohet me rrjedhën e mesme të Shkumbinit, ndërsa në perëndim, me Rajonin Perëndimor. Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Rajonit Verior dhe Verilindor dhe të diskutojnë rreth kushteve natyrore të tij.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Rajoni Verior Verilindor përfaqëson një mozaik me potenciale të mëdha natyrore. Tiparet natyrore që karakterizojnë pjesë të ndryshme të këtij rajoni, kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në llojin e vendbanimeve, në natyrën e popullimit dhe të ekonomisë së tij.

Rajoni dallohet për larminë e përbërjes litologjike dhe për strukturat e ndërlikuara tektonike. Shkëmbinjtë janë të moshave të ndryshme dhe përfaqësohen nga magmatikët, gëlqerorët e terrigjenët. Trualli i këtij rajoni është i pasur me rezerva minerare (kryesisht metale, si kromi dhe bakri).

Përbërja gjeologjike e larmishme dhe lëvizjet e shpeshta diferencuese kanë përcaktuar formimin e një relievi të copëtuar, i cili haste në drejtime të ndryshme (p.sh.: drejtimi rrezor, ai veriperëndim-juglindje, drejtimi pothuajse veri-jug). *Relievi* i lartë, i ndërthurur me lugina dhe gropa tektonike, gjendet kryesisht në trajtën e vargjeve malore, të malësive apo të maleve të veçuara. Ai modelohet në mënyrë të vazhdueshme nga faktorë të jashtëm, si: erozioni lumor, veprimtaria karstike, akullnajore e denuduese. Në këtë rajon mbizotëron *klima* mesdhetare malore dhe ajo mesdhetare paramalore. Në lindje dhe në veri të rajonit ndihet ndikimi i klimës kontinentale. Rajoni Verior dhe Verilindor ka një hidrografi mjaft të pasur, ku dallojnë: rrjeti i dendur lumor (kryesisht rrjedha të sipërme dhe të mesme të lumenjve), liqenet akullnajore, karstike e artificiale, ujërat nëntokësore, burimet minerale dhe ato termale. Rajoni karakterizohet gjithashtu nga një *botë bimë* e larmishme, në të cilën dallojnë masivet pyjore më të mëdha të vendit, ku rriten dushku, ahu, pisha etj. Ai dallohet gjithashtu për praninë e një sere bimësh endemike dhe mjekësore. Përhapje më

	<p>të gjerë në këtë rajon kanë <i>tokat</i> e kafenjta, si dhe tokat e murrme pyjore e ato livadhore malore.</p> <p>Një vështrim më nga afër i rajonit nxjerr në pah disa specifika, të cilat e diferencojnë hapësirën e tij në dy nën njësi: Nënrajoni Verior ose Alpet Shqiptare dhe Nënrajoni Verilindor.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.10

► Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Alpeve Shqiptare

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika: 5 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.10 Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Alpeve Shqiptare	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përcakton pozitën gjeografike të Alpeve Shqiptare.• Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Alpeve Shqiptare.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Alpeve Shqiptare, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe rolin e saj në zhvillimin e ekonomisë së vendit.• Evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të Alpeve Shqiptare.			

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.
- Sjell shembuj të veçorive kryesore natyrore të Alpeve Shqiptare dhe potencialet natyrore për zhvillim.

5. Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

- Ndan mendimet në grup.

6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.

7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të Alpeve Shqiptare.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

- Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Alpeve Shqiptare.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

- Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit.

3. Marrja e vendimeve

- Nxënësi vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të Evropës dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal.

Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:

Nxënësi/ja:

- argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit;
- përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Alpeve Shqiptare;
- vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Alpeve Shqiptare, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Fjalët kyçe: pozita gjeografike e Alpeve Shqiptare dhe roli i saj; kushtet natyrore.

Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Nxënësit kanë njohuri rreth:
- pozitës gjeografike të Alpeve Shqiptare.

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.10 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.10 në tekst - <i>Diskutojmë rreth:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe rolit të saj; - veçorive natyrore të këtij rajoni. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe rolin e saj: Nënrajon Verior (ose Alpet Shqiptare) shtrihet në pjesën më veriore të Republikës së Shqipërisë, në një largësi vijë drejtë 40 km nga Deti Adriatik. Kufijtë e këtij rajoni janë më se të dallueshëm, pasi ai rrethohet nga gropa tektonike dhe lugina të thella. Si kufi verior dhe verilindor i tij shërben kufiri shtetëror me Malin e Zi (pavarësisht se struktura të Alpeve vazhdojnë edhe përtej kufirit), ndërsa në jug, rajoni zbrit deri në luginën e Drinit (në sektorin nga Fierza deri në Vaun e Dejës). Në verilindje e lindje, kufiri ndarës ndjek luginën e Valbonës së Poshtme, kalon në Tropojën e vjetër dhe në Qafë-Morinë, ndërsa në perëndim zbrit në Ultësirën e Mbishkodrës.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe të diskutojnë rreth kushteve natyrore të tij.</p> <p><i>Ndërtimi gjeologjik:</i> Nga pikëpamja gjeologjike, Alpet Shqiptare shtrihen tërësisht në Albanidet Veriore. Formacionet kryesore gjeologjike që ndërtojnë Alpet Shqiptare (rreth 60% së sipërfaqes së përgjithshme të tyre) janë gëlqerorët e erës mesozoike. Krahas tyre ndeshen edhe terrigjenët (në formën e rreshpeve të paleozoit dhe të flisheve të paleocenit), kryesisht në Vermoshe Cukal, si dhe magmatikët intrusive dhe ata efuzivë të mesozoit, në verilindje të Alpeve (në Malësinë e Gashit). Një vend të rëndësishëm në këtë nënrajon zënë edhe depozitimet e periudhës së kuaternarit, të cilat janë formuar nga proceset erozivo-denuduese. Ato gjenden</p>
---	---

kryesisht në zallishtoret, tarracat lumore, rrëzë shpateve dhe në gropat e cirqet akullnajore. Veprimi i fazave të një pas njëshme malformuese dhe aktivizimi i shpeshtë i lëvizjeve neotektonike diferencuese kanë krijuar struktura tektonike të larmishme.

Relievi: Alpet Shqiptare dallohen për kontraste të theksuara të relievit, të shprehura me një amplitudë të madhe midis fundit të luginave dhe kreshtave malore rrethuese, e cila shkon deri në 2000m. Lartësia mesatare e Alpeve është 1140 m, gati 1,5 herë më e madhe se lartësia mesatare e vendit mbi nivelin e detit. Format kryesore të relievit të Alpeve Shqiptare janë blloqet malore, kurrizet malore dhe malësitë, të cilat ndahen nga njëra-tjetra prej luginave lumore.

Klima: Alpet Shqiptare janë nënrajoni më i ftohtë i vendit. Ato kanë klimë mesdhetare malore, me dimër të ashpër e të lagësht, periudhë të gjatë me ngrica, reshje të shumta shiu e bore dhe verë të freskët e relativisht më të lagësht se rajonet e tjera të vendit. Në kufijtë jugorë dhe perëndimorë të Alpeve, ndeshet klima mesdhetare paramalore.

Hidrografia: Alpet Shqiptare kanë rezerva të mëdha ujore, të cilat përfaqësohen me lumenj të vegjël, ujëra nëntokësore, liqene akullnajore dhe burime.

Tokat: Pjesa më e madhe e këtij nënrajoni përbëhet nga tokat e kafenjta malore, ndërsa pjesa tjetër, nga tokat e murrme pyjore dhe ato livadhore malore. Tokat e kafenjta malore shtrihen në pjesët më të ulëta të Alpeve, deri në lartësitë 900-1200 m mbi nivelin e detit. Ato janë formuar në shkëmbinj karbonatikë e rreshpe dhe gjenden kryesisht në rrjedha të poshtme e të mesme të luginave kryesore të Alpeve. Në këto toka mbillet kryesisht grurë, misër, patate, fasule, foragjere, drufrutorë etj.

Bimësia: Alpet Shqiptare kanë një botë bimore të pasur, e cila zë rreth 32% të sipërfaqes së përgjithshme të tyre. Alpet dallojnë nga çdo rajon tjetër i vendit tone për numrin e madh të bimëve endemike që rriten në to (ylli alpin, boronica, lloje të ndryshme shëlgjesh etj.).

Fauna: Larmia e kushteve natyrore të Alpeve ka përcaktuar edhe diversitetin e botës shtazore që rritet në mjedisin e tyre. Nga gjitarët, më të përhapur janë: ujku, dhelpra, lepuri, kunadhja, ketri etj. Në disa teritore ndeshen edhe dhia e egër, ariu, kaprolli, derri i egër, rrëqebulli, baldosa etj. Shpendët karakteristike janë: stërqoka e malit, lauresha me brirë, thëllëza e malit, shqiponja e malit etj.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...

	Hapi III :Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup: Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4 dhe 5.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.11

► Njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe veçorit e tyre

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.11 Njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe veçorit e tyre	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare.Përshkruan tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare në zhvillimin e rajonit.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit.Evidenton tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare.			

<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare në zhvillimin e rajonit. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit. përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Alpeve Shqiptare. Përcakton njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare. 	<p>Fjalët kyçe: njësi përbërëse, veçori natyrore,</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. pozitës gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe njësitë përbërëse të tij.</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.11 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.11 në tekst - Diskutojmë rreth: - tipareve të përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Alpeve Shqiptare. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Alpeve dhe më pas diskutojnë rreth veçorive të njësive përbërëse të Alpeve. Plotësojnë në hartën-skicë njësitë kryesore të Alpeve.</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Blloku i Jezercës shtrihet në qendër të Alpeve Shqiptare, i rrethuar nga thyerje të fuqishme tektonike. Ai përfaqëson pjesën më të lartë e më madhështore të relievet të Alpeve dhe gjendet midis Gropës së Thethit, luginës së Valbonës e asaj të Kukajve, lugut të Runicës dhe pellgut të Gucisë (jashtë kufirit). Jezerca është mali më i lartë i Alpeve Shqiptare dhe i dyti (për nga lartësia) në Shqipëri, pas Korabit.

Malësia e Madhe, e cila shtrihet në pjesën veriperëndimore të Alpeve, përbëhet nga kurrize malore, blloqe malore e male të larta, gropa dhe lugina lumenjsh e përrunjsh. Ndër to dallojnë Bjeshkët e Namuna (me maja të larta dhe të thepisura), pllaja karstike Veleçik-Bridash, lugina e Cemit, ajo e Përroit të Thatë etj.

Bjeshkët e Namuna përfaqësojnë një bllok malor, të përbërë nga male shumë të larta (maja më e lartë është Shëniku, me 2553 m) dhe nga gropa të kuaternarit, me origjinë akullnajoro-karstike. Bjeshkët e Namuna përbëhen nga shkëmbinj gëlqerorë të thatë e të zhveshur, të cilët u janë nënshtruar lëvizjeve tektonike ngritëse.

Harku malori Nikaj-Mërturit: Kjo njësi malore shtrihet midis luginës së Valbonës në veri dhe lindje, luginës së Shalës në perëndim dhe luginës së Drinit në jug. Ajo dallon për lartësinë e madhe të relievit dhe për forma te mprehta të tij. Kurrizet malore që përbëjnë këtë njësi, ndahen midis tyre prej thyerjeve tektonike dhe qafave të shumta. Midis majave të larta dallohet Maja e Hekurave (2560 m), Maja Ismet Sali Bruçaj (2527 m) etj.

Malësia e Gashit shtrihet nga lugina e Gashit deri në luginën e Tropojës. Ajo dallohet për relievin e ashpër, me vargje malore që ndahen midis tyre nga qafa malesh. Relievi i kësaj malësie është rezultat i ngritjes së saj tektonike dhe i fundosjes së pellgut të Tropojës e të Gjakovës.

Lugina e Valbonës është një nga luginat më të mëdha e më të bukura të Alpeve Shqiptare. Në të gjithë gjatësinë e saj, lugina formon një gjysmë hark të madh, me pjesën e lugët nga jugperëndimi. Lugina zë fill në lugun akullnajor të Valit, në juglindje të Bllokut të Jezercës dhe rrjedha e sipërme e saj, deri në Dragobi, ka formën e një lugine akullnajore. Burimet ujore të Valbonës janë disa burime karstike në rrëzë të shpatit të Qafës së Valbonës. Më pas, ujërat që bien në trajtën e një ujëvare, humbasin nëpër zallishten e luginës në fshatin Rragam dhe dalin si rrjedhje e përhershme sipërfaqësore në fshatin Valbonë.

Lugina e Shalës shtrihet në qendër të Alpeve, me një reliev me kontraste të mëdha. Ajo përshkohet nga lumi me të njëjtin

	<p>emër dhe formohet nga dy degët kryesore të tij: përroi i Kapreit dhe ai i Stupjes. Në fillim të saj, në Gropën e Thethit (në lartësinë 1200 m), lugina ka drejtimin veri-jug, ndërsa pranë bashkimit me Drinin, shkon drejt juglindjes.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Mësuesja fton nxënësit që t'i përcaktojnë ato në hartë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës "Radha juaj". Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.12

► Tiparet kryesore të popullimit të Alpeve Shqiptare

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.12 Tiparet kryesore të popullimit të Alpeve Shqiptare	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)			
<ul style="list-style-type: none">Përshkruan veçorit e popullimit të hershëm të Alpeve Shqiptare.Evidentoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë së Alpeve.Analizoni faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajoni.			
2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajoni.			
3. Kompetenca e të nxënësve (Nxënësi mëson për të nxënë)			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Analizon shpërndarjen gjeografike të popullsisë në këtë nënrajon.			
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			

<p>5. Kompetenca personale (<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara). 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi eidenton veçoritë e popullimit të hershëm të Alpeve Shqiptare. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <p>Nxënësi vlerëson faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajoni.</p> <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi analizon veçoritë e popullimit të hershëm të Alpeve Shqiptare. Analizon strukturën, ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë gjatë periudhave të ndryshme kohore. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan veçoritë e popullimit të hershëm të Alpeve Shqiptare; Eidentoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë së Alpeve. Analizoni faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajoni. 	<p>Fjalët kyçe: dinamika e popullsisë, shpërndarja e popullsisë dhe faktorët që ndikojnë në të, vendbanime të hershme.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <p>a. Alpet Shqiptare kanë pasur popullim dhe vendbanime të hershme ilire;</p> <p>b. Ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë në periudha të ndryshme.</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.12 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 5.12 në tekst, diskutojnë mbi popullimin e Alpeve Shqiptare në periudha të ndryshme historike dhe dinamika e popullsisë. Diskutojmë rreth:</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<ul style="list-style-type: none"> - veçorive të vendbanimeve në Alpet Shqiptare; - shpërndarjes së popullsisë në këtë nënrajon. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat....</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të lexojnë mbi popullimin e hershëm në këtë nënrajon dhe të ndërtojnë në fletoret e tyre një kllaster. Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë...</p> <p>Në vazhdim mësuesi/ja trajton informacionin e ri:</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p>Popullimi i Alpeve Shqiptare ka qenë përherë i lidhur ngushtë me kushtet natyrore të tyre. Nga njëra anë, në Alpe ndeshen ekosisteme me bukuri të rralla natyrore, burime të shumta ujore, florë e faunë e larmishme dhe endemike, lëndë minerare, drusore e për ndërtim etj., të cilat përbëjnë potenciale natyrore që favorizojnë jetesën dhe zhvillimin ekonomik të popullsisë. Nga ana tjetër, klima me dimër të gjatë e të ashpër, peizazhi malor alpin me kontraste të dukshme, me male të larta e të thepisura, lugina të thella, qafa malore të larta (të cilat bllokohen nga bora gjatë dimrit), krijojnë vështirësi në komunikimin Brenda hapësirës së Alpeve, si dhe midis tyre e rajoneve të tjera të vendit. Gjatë periudhave të ndryshme, terreni i Alpeve ka shërbyer si një barrierë e madhe për depërtimin e pushtuesve të huaj në territorin shqiptar.</p> <p>Pavarësisht klimës së ashpër dhe relievit malor, Alpet Shqiptare janë populluar në mënyrë të përhershme, nga ilirët deri në ditët e sotme. Në Iliri, Alpet populloheshin nga fisi i labeatëve. Tumulat e epokës së bronzit dhe ato të hekurit, figurat gjeometrike të gdhendura në enë metalike, në qeramikë, në dru dhe në kockë, përfaqësojnë artin ilir të periudhave të hershme.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Dinamika e popullsisë së Alpeve Shqiptare:</i> Deri në vitin 1990, Alpet njohën një rritje të numrit të popullsisë dhe shtim të vendbanimeve. Rritja më e madhe dhe dendësia më e lartë e popullsisë së Alpeve është shënuar gjatë viteve 1945-1990, si rezultat i zbatimit të politikave demografike të shtimit të lindshmërisë dhe uljes së vdekshmërisë. Pas vitit 1990, për shkak të emigrimit dhe të uljes së lindshmërisë, numri i popullsisë në këtë nënrajon pësoi rënie. Disa nga faktorët kryesorë që ndikuan në largimin e popullsisë nga</p>
---	---

	<p>ky nënrajon janë: sipërfaqja e kufizuar e tokës bujqësore, kërkesat në rritje për punësim, shkollim e shërbime, e drejta e lëvizjes së lire etj. Popullsia e Alpeve Shqiptare përbën rreth 2,6% të popullsisë së përgjithshme të vendit. <i>Migrimet e popullsisë</i> kanë ndikuar ndjeshëm në dendësinë e këtij nënrajonit, e cila shkon në rreth 36 banorë/km². Shpërndarja e popullsisë është e pabarabartë, e kushtëzuar sidomos nga relievet dhe klima. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar në tarracat dhe në zgjerimet lumore, si dhe në shpatet me pjerrësi të vogël të këtij nënrajonit. Dendësi më të madhe të popullsisë kanë sidomos luginat e Valbonës dhe ajo e Shalës.</p> <p><i>Struktura e popullsisë</i> sipas grupmoshës është pothuajse e njëjtë me atë në shkallë vendi, ndërsa në strukturën sipas vendbanimeve ka ndryshime. Dallim me strukturën sipas vendbanimeve në shkallë vendi, nënrajonit për përqindjen e lartë të vendbanimeve rurale. Popullsia qytetare përbën të popullsisë së përgjithshme të rajonit, ku si qendër urbane dallohet qyteti i Bajram Currit. Vendbanimet rurale janë të vogla dhe me një distancë midis tyre. Një pjesë e fshatrave shtrihen në rrëzën jugore të Shkëlzen-Radeshës, rrëzë Kores së Mërturit etj. Pjesa më e madhe e vendbanimeve gjenden deri në lartësinë 800 m, disa të tjera ndeshen deri në 1200m lartësi. Ndërtimet e tyre karakteristike janë në trajtën e kullave prej guri, me çati shumë të pjerrët (për të mos u grumbulluar bora) dhe me dritare të vogla.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.13

► Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Alpeve Shqiptare dhe ekonomia e tyre

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
------------------------------------	-------------------------	-------------------	------------------

Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.	Tema mësimore 5.13: Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Alpeve Shqiptare dhe ekonomia e tyre
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p><u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Alpeve Shqiptare. • Renditin zonat e mbrojtura të këtij nënrajon. • Evidenton veçoritë e trashëgimisë kulturore të Alpeve Shqiptare. <p><u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore në Alpet Shqiptare. <p><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. • Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të nënrajonit. • Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Alpeve Shqiptare dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire. <p><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. <p><u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndan mendimet në grup. <p><u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p><u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi zhvillimin e ekonomisë në këtë nënrajon. 	
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Alpeve Shqiptare. • Evidenton degët kryesore të ekonomisë në këtë nënrajon. <p><u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Alpeve Shqiptare dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire. <p><u>3. Marrja e vendimeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit. 	

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë nënrajon. • Evidenton degët kryesore të ekonomisë në këtë nënrajon. • Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Alpeve Shqiptare dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire. 	<p>Fjalët kyçe: Trashëgimi natyrore, kategori të zonave të mbrojtura, zhvillim ekonomik, degët e ekonomisë.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth: a. vlerave dhe potencialeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë nënrajon.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 5.13 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor tabelën e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimin 5.13 në tekst - Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore të Alpeve Shqiptare dhe rolit të tyre në zhvillimin e turizmit Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi: - trashëgiminë natyrore dhe kulturore; - zonat e mbrojtura; - degët më të zhvilluara të ekonomisë në këtë nënrajon.</p> <p>Trashëgimia natyrore dhe zonat e mbrojtura të Alpeve Potencialet natyrore dhe trashëgimia kulturore e popullsisë që jeton në Alpet Shqiptare, i identifikojnë ato si një nga hapësirat më panoramike dhe madhështore të Shqipërisë. Mbizotërimi i gëlqerorëve masive dhe relieve tërheqës, me sipërfaqet pyjore, kullotat e shumta malore, llojet endemike të botës së gjallë etj., mundësojnë zhvillimin e turizmit malor, të sporteve dimërore, të blegtorisë (sidomos mbarështimin e bagëtisë së imët dhe të bletarisë) dhe eksportin e bimëve mjekësore. Disa prej zonave natyrore me vlera unike të këtij nënrajoni janë kategorizuar në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura (shih tabelën 1).</p>

Zonat e Mbrojtura në Alpet Shqiptare					
Nr	Kategoria	Qarku	Bashkia	Zona e Mbrojtur	Sipërfaqja (në ha)
1.	I. Rezervë Strikte	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	3000
2.	II. Park Kombëtar	Shkodër	Shkodër	Thethi	2630
3.	II. Park Kombëtar	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	8000

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Trashëgimia kulturore: Alpet Shqiptare përfaqësojnë gjithashtu një hapësirë me vlera unike të trashëgimisë kulturore, ndër të cilat spikatin: folklori, me këngët e vallet popullore me shumë ritëm, veshjet karakteristike, arti i gatimit, mikpritja, artizanati etj. Një element karakteristik i Alpeve është edhe arkitektura, me ndërtime në trajtë kullash prej guri (në anë midis tyre), me çati shumë të pjerrët e me dritare të vogla. Pjesë e trashëgimisë kulturore të nënrajonit janë edhe festat tradicionale që organizohen nga banorët, ndër të cilat dallohet festa e Logut të Bjeshkës, që organizohet çdo vit në Qafën e Bordolecit, në Malësinë e Madhe.

Mësuesi/ja vazhdon:

Turizmi: Peizazhi malor dhe i veçantë alpin, format e shumta karstike dhe akullnajore, ujëvarat e kristalta, rrjedhjet ujore me ujë të ftohtë e të rrëmbyeshëm, fauna e larmishme, krijojnë në Alpe ekosisteme të cilat përbëjnë një potencial të madh për zhvillimin e terrenit malor. Kështu, në periudhën e ngrohtë të vitit, gjelbërimit kullotave alpine me ajër të pastër i shtohet bimësia graminore shumë ngjyrëshe. Ky peizazh nxit gjithashtu zhvillimin e turizmit ekologjik. Në stinën e ftohtë të vitit, trashësia e bores dhe qëndrimi i saj për një kohë të gjatë pa shkrirë, favorizojnë zhvillimin e turizmit të bardhë dhe të sporteve dimërore. Razma, Valbona dhe Thethi janë kthyer në qendra të rëndësishme të turizmit malor dhe të alpinizmi, sidomos për turistët e huaj.

Blegtoria: Relievi malor i nënrajonit, kullotat alpine dhe tradita e mbarështimit të bagëtive kanë favorizuar zhvillimin e blegtorisë. Popullsia e Alpeve dallohet për mbarështimin e bagëtisë së imët (dhentë, dhitë), ndërsa gjedhi rritet në numër më të vogël, kryesisht në luginat lumore.

Ekonomia pyjore: Ekonomia pyjore e këtij nënrajonit mbështetet në sipërfaqe të mëdha pyjore që shtrihen gjerësisht në shpatet malore. Lënda drusore pritet dhe sistemohet në

	<p>disa stabilimente sharre.</p> <p><i>Bujqësia:</i> Bujqësia është dega me mundësi më të pakta zhvillimi, për shkak të sipërfaqeve të kufizuara të tokës të punueshme. Gjatë viteve 1945-1990 janë bërë përpjekje për përfitime nga tokat bujqësore, por për shkak të terrenit të ashpër malor kjo gjë nuk u bë e mundur. Pas '90-ës, braktisja e tokave për shkak të migrimit të popullsisë solli aktivizimin e erozionit.</p> <p><i>Mineralet:</i> Alpet janë të pasura gjithashtu me polimetale, boksite dhe gurë gëlqerorë për ndërtim.</p> <p><i>Transporti:</i> Pavarësisht relievit të vështirë, në Alpet Shqiptare janë bërë një sere investime infrastrukturore, me rrugë automobilistike deri në Theth, Valbonë e në afërsi të Vermoshit.</p> <p><i>Artizanati:</i> Popullsia e Alpeve ka ruajtur e trashëguar edhe traditën e artizanatit. Në këto zona prodhohen kryesisht veshje popullore, sixhade, prodhime e zbukurime druri dhe vegla muzikore (çifteli, lahutë, sharki).</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 7.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

► Përsëritje 3

Nëntematika V (Rajoni Perëndimor dhe Alpet Shqiptare)

Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë mbi pyetjet/çështjet e mëposhtme:

1. Qarkoni alternative e duhur:

- Lumenjtë Drini dhe Buna përshkajnë:
 - a) Pllajën e Dumre-Darsisë;
 - b) Fushën e Elbasanit;
 - c) Ultësira e Nënshkodrës;
 - d) Ultësirën e Mbishkodrës.
- Grumbulli kodrinor më i madh i rajonit janë:

- a) Kodrat e Sulovës;
 - b) Kodrat e Mallakastrës;
 - c) Kodrat e Kërrabës;
 - d) Pllaja e Dumre-Darsisë.
- Në antikitet, Rajoni Perëndimor është banuar kryesisht nga fisi ilir:
 - a) I albanëve dhe i taulantëve;
 - b) I kaonëve dhe molosëve;
 - c) I labeatëve;
 - d) I enkelejve.
 - Formacionet kryesore gjeologjike që ndërtojnë Alpet Shqiptare janë:
 - a) gëlqerorë të mesozoit;
 - b) gëlqerorë të paleozoit;
 - c) flishet e kenozoit;
 - d) magmatikët e mesozoit.
 - Përbëhet kryesisht nga formacionet magmatike:
 - a) Malësia e Gashit;
 - b) Malësia e Madhe;
 - c) Blloku i Jezercës;
 - d) Lugina e Valbonës.
 - Forma kupolë dhe ngritja e Bllokut të Jezercës lidhet me:
 - a) veprimin e borës dhe të akujve;
 - b) ngritjet e fuqishme tektonike të pliocen-kuaternarit;
 - c) fundosjet tektonike të Malësisë së Madhe;
 - d) veprimin e karstit.
2. Përcaktoni në hartë dhe vlerësoni pozitën gjeografike të:
- a) Rajonit Perëndimor;
 - b) Alpeve Shqiptare.
3. Plotësoni tabelën e më poshtme.

Rajoni Perëndimor		Alpet Shqiptare	
Njësitë përbërëse	Veçoritë kryesore	Njësitë përbërëse	Veçoritë kryesore

4. Analizoni:

- a) Veçoritë e relievit, klimës, hidrografisë, tokave dhe të botës së gjallë në Rajonin Perëndimor dhe në Alpet Shqiptare.
- b) Shpërndarjen gjeografike dhe dinamikën e popullsisë në Rajonin Perëndimor dhe në Alpet Shqiptare.
- c) Strukturën e popullsisë në Rajonin Perëndimor dhe në Alpet Shqiptare.
- d) Trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare.
- e) Zhvillimin ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe të Alpeve Shqiptare.

5. Diskutoni mbi shkaqet kryesore të migrimit të popullsisë drejt Rajonit Perëndimor, pas vitit '91. Ilustroni me shembuj.

6. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Rajoni/nënrajoni	Veçoritë kryesore të rajonit /nënrajonit	Të përbashkëtat	Dallimet
Rajoni Perëndimor			
Alpet Shqiptare			

7. Vlerësoni perspektivën e popullimit dhe të ekonomisë së:

- a) Rajonit Perëndimor;
- b) Alpeve Shqiptare.

TESTI III**GRUPI A**

1. a. Qarko në hartën përbri Rajonin Perëndimor. (1 pikë)
b. Emërto në hartë, njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor dhe analizo veçoritë e secilit prej tyre. (6 pikë)
c. Krahajo pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor me atë të Rajonit Verior. (6 pikë)
2. Analizo zhvillimin ekonomik të Alpeve Shqiptare. (5 pikë)
3. a. Qarko dhe emërto në hartën përbri Malësinë e Pukës dhe Mirditës. (2 pikë)
b. Analizo kushtet natyrore, veçoritë e popullimit dhe natyrën e ekonomisë në këto malësi. (5 pikë)
4. a. Qarko dhe emërto në hartën përbri Vargjet e Skënderbeut. (2 pikë)
b. Analizo kushtet natyrore, veçoritë e popullimit dhe natyrën e ekonomisë në to. (5 pikë)



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-12	13-17	18-22	23-26	27-29	30-32

TESTI III

GRUPI B

1. a. Qarko në hartën përbri Rajonin Verior dhe Verilindor.

(1 pikë)

b. Emërto në hartë, Alpet Shqiptare, listo njësitë përbërëse të tyre dhe analizo kushtet natyrore që kanë.

(6 pikë)

c. Krahaso midis tyre veçoritë e popullimit në Rajonin Verior e Verilindor dhe në Rajonin Perëndimor.

(6 pikë)

2. Analizo zhvillimin e sektorit të dytë të ekonomisë në Rajonin Perëndimor.

(5 pikë)

3. a. Qarko dhe emërto në hartën përbri Pellgun e Matit.

(2 pikë)

b. Analizo kushtet natyrore, veçoritë e popullimit dhe natyrën e ekonomisë në të.

(5 pikë)

4. a. Qarko në hartën përbri Luginën e Drinit të Zi.

(2 pikë)

b. Analizo kushtet natyrore të kësaj lugine, veçoritë e popullimit dhe natyrën e ekonomisë që ka.

(5 pikë)



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-12	13-17	18-22	23-26	27-29	30-32

TESTI III GRUPI C

1. **a.** Përcakto pozitën gjeografike të Rajonit Verilindor dhe qarkoje atë. (1 pikë)
- b.** Analizo veçoritë e popullimit në Alpet Shqiptare. (6 pikë)
- c.** Krahaso zhvillimin ekonomik të Rajonit Verior e Verilindor me atë të Rajonit Perëndimor. (6 pikë)
2. Analizo zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Perëndimor. (5 pikë)
3. **a.** Qarko dhe emërto në hartën përbri Vargun e Korabit. (2 pikë)
- b.** Analizo kushtet natyrore, veçoritë e popullimit dhe natyrën e ekonomisë në të. (5 pikë)
4. **a.** Qarko dhe emërto në hartën përbri Malësinë Martanesh, Çermenikë e Gollobordë. (2 pikë)
- b.** Krahaso midis tyre të tria malësitë dhe përcakto të përbashkëtat e dallimet midis tyre. (5 pikë)



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-12	13-17	18-22	23-26	27-29	30-32

Tema 5.14

► Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Nënrajonit Verilindor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika: 5 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.14 Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Nënrajonit Verilindor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton pozitën gjeografike të Nënrajonit Verilindor.Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Nënrajonit Verilindor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Nënrajonit Verilindor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e saj në zhvillimin e ekonomisë së vendit.Evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të Nënrajonit Verilindor.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.Sjell shembuj të veçorive kryesore natyrore të Nënrajonit Verilindor dhe potencialet natyrore për zhvillim.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të Nënrajonit Verilindor.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
<u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Nënrajonit Verilindor.			
<u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhënieve me rajonet e tjera të vendit.			
<u>3. Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson ndërvlerësimin midis rajoneve të vendit dhe sjell shembuj të ndërvlerësimit të bashkëveprimit rajonal.			

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit. Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Nënrajonit Verilindor dhe njësitë përbërëse të tij. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e Nënrajonit Verilindor dhe roli i saj; kushtet natyrore; njësitë përbërëse.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth: - pozitës gjeografike të Nënrajonit Verilindor</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 5.10 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimin 5.14 në tekst - <i>Diskutojmë rreth:</i> - Pozitës gjeografike dhe veçorive natyrore të Nënrajonit Verilindor; - Njësitë përbërëse të këtij nënrajonit. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e saj dhe i orienton nxënësit që të plotësojnë kllasterin e mëposhtëm:</p>

<p style="text-align: center;">Nënrajoni verilindor</p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="width: 45%;"> <p>Kushtet natyrore Ndërtimi gjeologjik: Dominojnë shkëmbinjtë e ndryshëm magmatikë intruziv e efuziv, sidomos ata ultrabazikë, por edhe shkëmbinjtë sedimentarë, të tipit karbonatikë dhe terrigenë Relievi, përbëhet nga vargje malorë, kurrize malorë, malësi, blloqe malorë, male të veçuar, kodra, lugina lumore gjatësore e tërthore disa lugina dhe gropa. Relievi fillon nga lartësia 100-150 m në disa lugina në perëndim, deri në 2751 m në Korab dhe është shumë i copëtuar. Hidografia: përfaqësohet nga lugina gjatësore dhe tërthore. Klima: Pozita gjeografike, lartësia mbi nivelin e detit dhe ndërthurja e formave të relievit, janë faktorët kryesorë klimë formues të këtij nënrajoni. Në të ndeshen klima mesdhetare kodrinore, ajo paramalore dhe klima malore. Nënrajoni dallon për numrin e madh të ditëve të vranëta, të ftohta e me borë, si dhe për intensitetin dhe kohëzgjatjen e erërave veriore e verilindore. Reshjet e bores janë një dukuri e zakonshme, sidomos në lartësitë mbi 1000m. Tokat: Tokat që ndeshen më tepër në këtë nënrajon janë ato livadhore malore, të murrme pyjore dhe të kafenja. Krahas tyre hasen edhe tokat aluvionale, malore torfike etj. Bimësia: Nënrajoni dallohet për larinë e botës bimore, e cila përbën brezit mesatar të Evropës dhe ajo e llojit mesdhetar. Krahasuar me rajonet e tjera të vendit, ky nënrajon dallohet për fondin e madh pyjor (ahu, pisha dhe bredhi) me vlera të mëdha ekonomike.</p> </div> <div style="width: 45%;"> <p>Pozita gjeografike e rajonit Rajoni Verilindor i Shqipërisë, shtrihet midis luginës së Shkumbinit të mesëm në jug. Kufiri perëndimor kalon në lindje të Fushës së Nënshkodrës, vazhdon përgjatë rrëzës perëndimore të Vargjeve të Skënderbeut dhe zbret deri në Shkumbinin e Mesëm. Në lindje, nënrajoni kufizohet me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë me Kosovën dhe me Republikën e Maqedonisë. Pozita gjeografike e nënrajonit mundëson lidhjen e të gjitha rajoneve të vendit me trevat shqiptare jashtë kufirit, pasi në të kalojnë rrugë të rëndësishme automobilistike.</p> <p>Njësitë përbërëse të nënrajonit Larmia e kushteve natyrore dhe veçoritë e zhvillimit demografik e ekonomik të këtij nënrajoni krijojnë një mozaik hapësirash më të vogla, të cilat përfaqësojnë njësitë përbërëse të tij. Në Nënrajonin Verilindor bëjnë pjesë: Malësia e Gjakovës dhe e Hasit, Vargu malor i Korabit, Lugina e Drinit të Zi, Vargjet e Lurës, Malësia Pukë-Mirditë, Pellgu i Matit (ose Klos-Kalivac), Vargjet e Skënderbeut, malësitë e Martaneshit, Çermenikës dhe Gollobordës.</p> </div> </div>	
	<p><i>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</i> Mësuesja fton nxënësit që t'i përcaktojnë ato në hartë... Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup: Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës "Radha juaj". Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.15

► Popullsia, trashëgimia kulturore dhe ekonomia e Nënrajonit Verilindor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
--	-----------------------------	-------------------	------------------

Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.
Tema mësimore 5.15: Popullsia, trashëgimia kulturore dhe ekonomia e Nënrajonit Verilindor
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

- Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Nënrajonit Verilindor.
- Evidenton dinamikën dhe strukturën e popullsisë së Nënrajonit Verilindor.
- Përshkruan zhvillimin e sektorëve ekonomikë të nënrajonit.

2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

- Vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore në Nënrajonit Verilindor.

3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.
- Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Nënrajonit Verilindor.
- Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Nënrajonit Verilindor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire.
- Analizon faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajonit.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.

5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

- Ndan mendimet në grup.

6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.

7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi zhvillimin e ekonomisë në këtë nënrajon.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës
1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

- Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Nënrajonit Verilindor.
- Evidenton degët kryesore të ekonomisë në këtë nënrajon.
- Evidenton faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajonit.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

- Nxënësi vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Nënrajonit Verilindor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire.

3. Marrja e vendimeve

- Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit.

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë nënrajon; • Evidenton degët kryesore të ekonomisë në këtë nënrajon; • Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Nënrajonit Verilindor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire; • Analizon faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajonit. 	<p>Fjalët kyçe: Trashëgimi natyrore, kategori të zonave të mbrojtura, zhvillim ekonomik, degët e ekonomisë, popullim.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. vlerave dhe potencialeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë nënrajon.</p> <p>b. faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajonit.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.15 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor tabelën e zonave të mbrojtura në Nënrajonit Verilindor dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.15 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore të Nënrajonit Verilindor dhe rolit të tyre në zhvillimin e disa degëve të ekonomisë. <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - trashëgiminë natyrore dhe kulturore; - dinamikën e popullsisë; - degët më të zhvilluara të ekonomisë në këtë nënrajon. <p><i>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</i> Nënrajonit Verilindor është banuar që në lashtësi. Në antikitet, në hapësirën e tij banonin fiset ilire të albanëve dhe penestëve. Trualli i tij është banuar historikisht nga popullsia shqiptare, e cila ka trashëguar përgjatë shekujve gjuhën dhe traditat e saj.</p>

Një ndër provat që e vërtetojnë këtë vazhdimësi është Kultura e Komanit (varreza e shek. VI-VIII, zbuluar pranë Kalasë së Dalmaces, në fshatin Koman të Pukës). Kultura e Komanit përfaqëson kulturën e popullsisë shqiptare të shek. VI-VIII, gjatë të cilëve u bë kalimi gradual nga antikiteti ilir në mesjetën arbërore.

Popullsia e këtij nën rajoni përbën rreth 11,2 % të popullsisë së përgjithshme të vendit. Ai karakterizohet nga një numër i vogël i popullsisë në raport me sipërfaqen dhe nga shpërndarja gjeografike e pabarabartë e saj. Kjo lidhet me karakterin kodrinoro-malor të relievit dhe sipërfaqen e kufizuar të tokave bujqësore. Dendësia mesatare e popullsisë shkon deri në 60,5b/km². Pjesët më të populluara janë tarracat lumore dhe gropat, në të cilat është përqendruar shumica e vendbanimeve, ndërsa në terrenet malore popullimi është më i pakët.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore të nënrajonit duke iu referuar edhe tabelës së mëposhtme...

Zonat e Mbrojtura në Nënrajonin Verilindor					
Nr	Kategoria	Qarku	Bashkia	Zona e Mbrojtur	Sipërfaqja(në ha)
1.	II. Park Kombëtar	Dibër	Dibër	Lura	1280
2.	II. Park Kombëtar	Durrës	Krujë	Qafë-Shtamë	2000
3.	II. Park Kombëtar	Dibër	Mat	Zall-Gjoçaj	140
4.	II. Park Kombëtar	Tiranë,Durrës	Tiranë,Krujë	Mali i Dajtit	29216,9
5.	III. Monument natyror	Dibër	Dibër	Vlashaj	50
6.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Kukës	Has	Tej-Drini i Bardhë	30
7.	V. Peizazh i Mbrojtur	Tiranë, Dibër,Elbasan	Tiranë-Mat-Bulqizë-Librazhd	Mali me Gropa-Bizë-Martanesh	25266,4
8.	VI. Zonë e Mbrojtur Natyrore e Resurseve të Menaxhuara	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	5900
9.	VI. Zonë e Mbrojtur Natyrore e Resurseve të Menaxhuara	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	4745

Mësuesi/ja vazhdon:

Diversiteti i ndërtimit gjeologjik dhe i relievit, hidrografia e pasur, larmia e botës së gjallë etj., përfaqësojnë potencialet natyrore më të rëndësishme të Nënrajonit Verilindor. Përbërja shkëmbore e larmishme dhe e veçantë e relievit, sipërfaqet e mëdha pyjore, kullotat e shumta malore, format e veprimtarisë akullnajore dhe llojet endemike të botës së gjallë mundësojnë zhvillimin e turizmit (të bardhë dhe të gjelbër), të sporteve dimërore, të blegtorisë etj. Rrjeti i dendur lumor, i cili here ndjek thyerjet e strukturave shkëmbore dhe here i pret tërthor ato, krijon peizazhe tërheqëse e unike. Në këtë nënrajon gjenden edhe një sere zonash me vlera të veçanta natyrore, të cilat janë kategorizuar në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura.

Mësuesi/ja vazhdon:

Pasuritë natyrore dhe ekonomia: **Një nëntokë e pasur:** me minerale metalike si bakër dhe krom, por edhe me gurë ndërtimi e zbukurimi, mermere, inerte të shtretërve të lumenjve, argjila kaolinike, etj. Rajoni përmban **fondin më të madh pyjor**, qoftë si lëndë drusore ashtu edhe si

	<p>lëndë zjarri. Pasuria ujore: Rajoni verilindor ofron rezervat më të mëdha hidroenergjitike të vendit. Turizmi: Rajoni ofron mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit të bardhë, ekologjik dhe sporte dimërore. Ekonomia bujqësore: kulturat më të përhapura janë patatja, fasulja, molla, dardha, kumbulla, arra, etj., të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm ekonomik për jetën e banorëve.</p> <p>Hapi III :Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi7.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.16

► Disa nga njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.16 Disa nga njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor.Përshkruan tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor në zhvillimin e rajonit.			
<u>3. Kompetenca e të nxënësve (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit.Evidenton tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			

<p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor në zhvillimin e rajonit. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor; Përcakton njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor. 	<p>Fjalët kyçe: njësi përbërëse, veçori natyrore</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. pozitës gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe njësitë përbërëse të tij.</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.16 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.16 në tekst - Diskutojmë rreth:</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>- pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të Malësisë së Gjakovës dhe të Hasit, të Vargut të Korabit dhe të Luginës së Drinit të Zi’.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Nënrajonit Verilindor.</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe të përcaktojnë në hartë njësitë përbërëse të tij dhe të diskutojnë rreth veçorive të tyre.</p> <p>Më pas mësuesi/ja përcakton në hartë njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe i fton nxënësit të plotësojnë kllasterin në fletoren e tyre.</p> <div data-bbox="288 662 662 1331"> <p>Malësia e Gjakovës dhe e Hasit ndahen prej Përroit të Skatinës. Këto malësi, janë prekur nga lëvizje neotektonike diferencuese dhe kanë një ndërtim gjeologjik të ndryshëm. Malësia e Gjakovës, përbëhet kryesisht nga shkëmbinj magmatikë të tipit ultrabazik, ndërsa ajo e Hasit nga shkëmbinj gëlqerorë. Me këtë përbërje gjeologjike lidhet edhe prania e mineraleve të bakrit dhe të kromit.</p> <p>Relievi i Malësisë së Gjakovës, është kryesisht kodrinor, me valëzime të vogla të krijuara nga alternimet e kurrizeve me gropat dhe luginat, që janë prekur nga lëvizje tektonike ngritëse, që kanë krijuar një taban të çrregullt. Malësia e Hasit dallohet për relieving kryesisht malor. Përbëhet nga groja e Krumës dhe pllaja karstike e Hasit. Klima është mesdhetare malore. Hidrografia përbëhet nga liqeni artificial i Fierzës, përroi i Krumës dhe burimet tektonikokarstike. Popullimi në Malësinë e Gjakovës dhe të Hasit është më i dendur se në Alpe. Popullimi më i madh dhe vendbanimet, janë përqendruar kryesisht në groja. Ka më tepër popullsi rurale. Qendrat urbane janë Kruma dhe Fierza. Ekonomia bazë është ajo bujqësore. Kultivohen patatet, fasulet, gështenjat, mollët dhe kumbullat. Blegoria përfaqësohet me bagëtinë e imët, sidomos dhitë.</p> </div> <div data-bbox="696 662 1190 861"> <p>Vargu i Korabit shtrihet në formë harku (me pjesën e lugut në lindje) në skajin më lindor të Nënrajonit Verilindor. Ai është vargu malor më i lartë i vendit tone (maja e Korabit 2751 m), por edhe më i lartë i të gjithë vargut malor Sharr-Korab-Stegovë, pjesë e të cilit është. Formimi dhe lartësimi i këtij vargu malor kanë ardhur si rezultat i lëvizjeve të fuqishme diferencuese ngritëse (në trajtën e një horsti), ndërkohë që në territoret rreth tij (Gropa e Kukësit, lugina e Drinit të Zi etj.) kanë ndodhur fundosjet tektonike (në trajtën e grabeneve).</p> </div> <div data-bbox="738 913 1170 985"> <p>Disa nga njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor</p> </div> <div data-bbox="703 1045 1163 1402"> <p>Lugina e Drinit të Zi</p> <p>Ndërtimi gjeologjik: Është një graben i përbërë nga shkëmbinj sedimentarë që karakterizohet nga zgjerime dhe ngushtime. Lugina ka shpatë përgjatë rrjedhës dallohen deri në tre nivele terracash lumore. Në këtë luginë ndihet ndikimi i klimës kontinentale me amplitude vjetore të mëdha të temperaturës. Popullsia më e madhe është ajo rurale. Ekonomia bazë e kësaj zone është ekonomia bujqësore: me drithërat (kryesisht misri), perimet (patatja, fasulja) dhe pemëtaria (mollë, kumbulla, dardha, arra). Blegoria përfaqësohet me rritjen e gjedhit dhe të bagëtisë së imët. Përveç ekonomive tradicionale, buzë Drinit, në fshatin Arren, janë bërë investime nga sipërmartje private edhe për rritjen e troftës.</p> </div>
	<p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit</p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

Tema 5.17

► **Disa nga njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor (Vazhdim)**

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.17 Disa nga njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor (Vazhdim)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton njësitë e tjera përbërëse të Nënrajonit Verilindor.Përshkruan tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor në zhvillimin e rajonit.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit.Evidenton tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
3. <u>Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor në zhvillimin e rajonit.			

Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. 	Fjalët kyçe: njësi përbërëse, veçori natyrore
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit kanë njohuri rreth: a. pozitës gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe njësitë përbërëse të tij.
b. Ndërtimi i njohurive të reja	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.17 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.17 në tekst - Diskutojmë rreth: - kushteve natyrore të Vargjeve të Lurës, Malësisë Pukë-Mirditë dhe Pellgut të Matit. - Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Nënrajonit Verilindor. Më pas mësuesi/ja përcakton në hartë njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe i fton nxënësit të plotësojnë kllasterin në fletoren e tyre.</p>

<p>Malësia Pukë-Mirditë Ndërtimi gjeologjik. Masivet malore të malësisë përbëhen kryesisht prej shkëmbinjve magmatikë ultrabazikë, ndërsa gropat përbëhen edhe prej gëlqerorëve dhe terigjenëve. Relievi. Në pjesën qendrore malore ndërsa pjesët periferike që rrethojnë qendrën e lartë, janë në formën e gropave tektonike. Klima është mesdhetare malore, me dimër të ashpër dhe verë të freskët. Hidrografia është e pasur e përfaqësohet me lumenjtë Fani i Madh dhe Fani i Vogël e një sërë përrenjsh. Bimësia. Malësia është një nga të gjithë katet bimorë. Popullimi. Deri në vitet '90, popullsia e kësaj malësie, ka pësuar rritje. Pas vitit '90, numri i popullsisë ra, si rezultat i emigrimeve drejt rajonit perëndimor dhe jashtë vendit. Pjesa më e madhe e popullsisë dhe e vendbanimeve është rurale. Ekonomia bazë në këtë malësi, është prerja dhe përpunimi i lëndës drusore, por edhe bujqësia dhe blegtoia luajnë një rol të rëndësishëm.</p>	<p>Vargjet e Lurës përbëhen nga dy vargje paralele, që dallojnë nga njëri tjetri prej përbërjes gjeologjike dhe formave të relievit. Vargu lindor, është i përbërë prej shkëmbinjve gëlqerorë dhe ka reliev të copëtuar prej erozionit të degëve të Drinit të Zi e të Matit, ndërsa vargu perëndimor përbëhet nga shkëmbinj ultrabazikë dhe gëlqerorë. Këtu arrihet edhe lartësia më e madhe e vargjeve të Lurës. Më të përhapura janë tokat e kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore. Një shtrirje të gjerë ka kati i ahut dhe i kullotave alpine.</p>
<p>Disa nga njësitet përbërëse të Nënrajonit Verilindor</p>	
<p>Pellgu Matit Pellgu i Matit gjendet midis Vargjeve të Lurës në lindje dhe vargjeve të Skënderbeut në perëndim. Në veri, ai kufizohet me malësinë Pukë-Mirditë, ndërsa në jug, me malësinë e Martaneshit. Formacionet gjeologjike që përbëjnë këtë pellg, janë shkëmbinjtë magmatikë dhe ata terrigjenë (molasa). Relievi përbëhet nga gropa, kodra të buta dhe lugina, ku mbizotërojnë lartësitë 200-400 m.</p>	<p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë... Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë... Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit</p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

Tema 5.18

► Njësitet e tjera përbërëse të Nënrajonit Verilindor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.18 Njësitet e tjera përbërëse të Nënrajonit Verilindor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton njësitet e tjera përbërëse të Nënrajonit Verilindor.Përshkruan tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor në zhvillimin e rajonit.			

<p>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</p> <ul style="list-style-type: none"> Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit. Evidenton tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. <p>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. <p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor në zhvillimin e rajonit. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Nënrajonit Verilindor. 	<p>Fjalët kyçe: njësi përbërëse, veçori natyrore</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. pozitës gjeografike të Nënrajonit Verilindor dhe njësitë përbërëse të tij.</p> <p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.18 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p>

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimet në situatë

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimi 5.18 në tekst - Diskutojmë rreth:

- veçorive të përgjithshme të Vargjeve të Skënderbeut dhe të Malësive të Martaneshit, Çermenikës e Gollobordës.
- Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Nënrajonit Verilindor.

Më pas mësuesi/ja përcakton në hartë njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe i fton nxënësit të plotësojnë kllasterin në fletoren e tyre.

Malësitë e Martaneshit, Çermenikës, Gollobordës

Malësia e Martaneshit, zë pjesë veriperëndimore të malësive dhe përbëhet kryesisht nga shkëmbinjtë magmatikë, por edhe nga gëlqerorë. Ajo përbëhet nga kurrize malore, të copëtuara nga hidrografia dhe është e pasur me pyje pishe e ahu.

Malësia e Çermenikës, zë pjesën jugore të malësive, përbëhet kryesisht prej shkëmbinjve terrigjenë dhe ka reliev malor. që lartësohet më tepër në veri dhe verilindje.

Malësia e Gollobordës, zë lindjen e malësive dhe përbëhet prej shkëmbinjve gëlqerorë. Në këtë malësi gropat dhe fushat karstike ndërthuren me luginat të ngushta e të thata karstike. Rjedhjet sipërfaqësore janë të pakta. **Popullsia** në këto malësi është e pakët, e vendosur në vendbanime rurale. Krijimi i qendrave urbane, është e lidhur me aktivitetin e nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit.

Ekonomia. Përveç nxjerrjes së mineralit të kromit, ekonomi e rëndësishme është ajo pyjore, ndërsa një pjesë e popullsisë merret me bujqësi dhe blegtori. Banorët vendas kanë traditë në përpunimin e produkteve blegtorale dhe në mjeshtërinë e ndërtimit.

Vargjet e Skënderbeut : Përbehen nga dy vargje paralele, të ndara midis tyre nga luginat e Vilzës. Përbëhen prej shkëmbinjve magmatikë (mali i Skënderbeut), gëlqerorë (Mali me Gropa) ranorë dhe flishe. Vargu perëndimor është ai Krujë-Dajt, i cili arrin lartësinë më të madhe në malin e Dajtit (1612 m). Vargu lindor është më i lartë se ai perëndimor. Klima është mesdhetare paramalore dhe malore. Në Malin e Dajtit, në lartësinë 900-1100 m, ruhen fragmente të terracës së dikurshme detare. Mali me Gropa dallohet për veprimtari karstike, nga ku dalin edhe shumë burime ujore, që janë shfrytëzuar për ujë të pijshëm. Vargjet kanë edhe pasuri drusore me vlera ekonomike. Zona njihet gjithashtu për pasuri ekologjike dhe turistike.

Njësitë e tjera përbërëse të Nënrajonit Verilindor

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1,2,3 dhe 4 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 5.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.
------------------------------------	---

PUNË PRAKTIKE 2

Tema: Rajoni Verior dhe Verilindor i Republikës së Shqipërisë

Rezultatet e të nxënës:

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përcakton dhe emërton në hartën-skicë njësitë kryesore përbërëse të Republikës së Shqipërisë;
- lokalizon, emërton e ngjyros në hartën-skicë format kryesore të relievit dhe hidrografinë e tij;
- qarkon dhe emërton në hartën-skicë qendrat më të rëndësishme urbane, ekonomike, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit;
- shfaq kureshtje për zhvillimet demografike dhe strukturën e popullsisë në këtë rajon si dhe përcakton teorit kryesore të popullimit të tij;
- analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45minuta; në klasë.

Materialet burimore: teksti mësimor, material teorike e harta të siguruara nga internet apo të rekomanduara nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: harta-skicë, atlasit gjeografi, harta fiziko-gjeografi dhe ajo politiko-administrative e Republikës së Shqipërisë, teksti mësimor, laps, rapidograf, lapsa me ngjyrë/lapustila.

Metodologjia që do të përdoret: punë individuale (ngjyrosje dhe emërtimi hartës skicë), punë në grupe (diskutim, shkëmbim mendimesh).

Puna përgatitore:

- Përsëriten njohuritë e marra nga teksti mësimor mbi veçoritë fiziko-gjeografike njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore dhe kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe mbi veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior dhe Verilindor të Republikës së Shqipërisë.
- Përzgjidhen dhe diskutohen të dhënat e marra nga burime të ndryshme (internet, enciklopedi, harta, fotografi dokumentarë televizivë etj.), në lidhje me veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore e kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe me veçoritë e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Hapat që do të ndiqni gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

1. Përcaktoni dhe emërtoni në hartën-skicë njësitë kryesore përbërëse të Rajonit Verior dhe Verilindor të Republikës së Shqipërisë.

2. Lokalizoni, emërtoni dhe ngjyrosni në hartën-skicë format kryesore të relievit (fushat, kodrat, pllajajat etj.) të këtij rajoni.
3. Lokalizoni dhe emërtoni në hartën-skicë hidrografinë e rajonit (liqenet, rrjedhat kryesore lumore, burimet etj.).
4. Emërtoni në hartën-skicë zonat e rajonit që dallohen për pasuritë e mëdha natyrore (zona mineral mbajtëse, turistike, energjetike, pyjore, ujore, termale etj.), si dhe qendrat kryesore të trashëgimisë kulturore të tij.
5. Përcaktoni dhe emërtoni qendrat më të rëndësishme urbane dhe ekonomike të këtij rajoni.
6. Analizoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë, si dhe veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.
7. Vlerësoni mundësitë e shfrytëzimit të pasurive natyrore të rajonit në favor të zhvillimit social-ekonomik.
8. Interpretioni grafikët të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me zhvillimin e sektorëve të ekonomisë së Rajonit Verior dhe Verilindor gjatë periudhave të ndryshme.
9. Vlerësoni perspektivat demografi dhe ekonomike të Rajonit Verior e Verilindor.

Tema 5.19

► Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Juglindor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika: 5 Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.19 Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Juglindor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përcakton pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor.Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Juglindor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Juglindor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Rajonit Juglindor dhe rolin e saj në zhvillimin e ekonomisë së rajonit.Evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Juglindor.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.Sjell shembuj të veçorive kryesore natyrore të Rajonit Juglindor dhe potencialet natyrore për zhvillim.			

<p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Juglindor. 	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Juglindor. <p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të vendit dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Rajonit Juglindor dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit; Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Juglindor dhe njësitë përbërëse të tij. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e Rajonit Juglindor dhe roli i saj; kushtet natyrore.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të Rajonit Juglindor.
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.19 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.19 në tekst - <i>Diskutojmë rreth:</i></p>

- pozitës gjeografike dhe veçorive natyrore të Rajonit Juglindor.

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor dhe rolin e saj dhe i orienton nxënësit që të plotësojnë kllasterin e mëposhtëm:

Rajoni Juglindor

Pozita gjeografike :

Ky rajon zë pjesën juglindore të Shqipërisë, nga rrjedha e mesme e Shkumbinit deri në Leskovik. Në perëndim kufizohet me kodrat e Sulovës, luginën e Tomorricës dhe krahinën e Dangëllisë, ndërsa në lindje, me kufirin shtetëror të Shqipërisë me Maqedoninë e Greqinë. Rajoni ka një pozitë gjeostrategjike, sepse në pjesën veriore të tij, në luginën e Shkumbinit, është projektuar kalimi i korridorit VIII, i cili ndjek gjurmët e rrugës “Egnatia” dhe përfaqëson arterien më të shkurtër që lidh perëndimin me lindjen. Përmes tij kalojnë rrugë automobilistike që lidhin Rajonin Perëndimor dhe kryeqytetin e vendit me trevat shqiptare në Maqedoni dhe Greqi, si dhe me shtete të tjera të rajonit. Pikat e kalimit kufitar të Qafë-Thanës, Tushemishtit dhe Gorricës e lidhin Shqipërinë me Maqedoninë, ndërsa pika e kalimit kufitar e Kapshticës krijon lidhje me Greqinë. Rajoni ka mundësi lidhëse me rajonet e tjera edhe përmes rrjetit hekurudhor, por ai aktualisht ka nevojë për investime që të jetë funksional

Kushtet natyrore :

Rajoni përbëhet nga shkëmbinj me përbërje gjeologjike të larmishme dhe moshë të ndryshme. Shkëmbinjtë terrigjenë të llojit molasë gjenden në gropa, fushëgropa, lugina, por edhe në malësi e male mesatare; terrigjenë të llojit flish përbëjnë malet më të larta (malin Gramoz 2523 m, më i larti i të gjithë rajonit); gëlqerorët ndërtojnë kurrizet, vargjet malore e malësitë, ndërsa magmatikët (të kufizuar në shtrirje) ndërtojnë masivet malore.. Në gropa dhe fushëgropa klima ka tipare kontinentale, ndërsa me rritjen e relievit ndeshet klima malore.

Hidrografia përfaqësohet me rrjedhat e sipërme të Shkumbinit, Osumit dhe Devollit, si dhe me një rrjet përrenjsh. Përveç rrjetit lumor, pjesë e rëndësishme e hidrografisë së këtij rajoni janë Liqeni i Ohrit, ai i Prespës së Madhe dhe Liqeni i Prespës së Vogël, si dhe një numër liqenesh akullnajore në disa kreshta malesh (në Shebenik, Gramoz etj.).

Tokat më të përhapura janë kryesisht ato të kafenjta dhe të murrme pyjore. Rajoni ka një mbulesë bimore të pasur, në të cilën mbizotërojnë kati i ahut dhe ai i halorëve. Kjo bimësi është më e përhapur në Polis, Valamarë, Moravë, Vithkuq, Guri i Zi, Guri i Topit etj. Në kreshtat e larta të maleve (në Valamarë, Malin e Thatë, Shebenik, Malin e Shpatit, Voskopojë, Malësitë e Kolonjës etj.) shtrihen kullota malore.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë....

Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...

Hapi III :Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup:

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/ gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.20

► Njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.20 Njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Rajonit Juglindor.• Përcakton njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Juglindor në zhvillimin e rajonit.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Juglindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit.• Evidenton tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Rajonit Juglindor.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Juglindor.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
<u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Juglindor.			
<u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të njësive përbërëse të Rajonit Juglindor.			
<u>3. Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Juglindor në zhvillimin e rajonit.			

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Juglindor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Juglindor; Përcakton njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor. 	<p>Fjalët kyçe: njësi përbërëse, gropa, fushëgropa etj.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <p>a. pozitës gjeografike të Rajonit Juglindor dhe njësitë përbërëse të tij.</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.20 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.20 në tekst - Diskutojmë rreth: - pozitës gjeografike dhe kushteve natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Juglindor. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor. Mësuesja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Rajonit Juglindor dhe të përcaktojnë në hartë njësitë përbërëse të tij dhe të diskutojnë rreth veçorive të tyre. Më pas mësuesi/ja përcakton në hartë njësitë përbërëse të Nënrajonit Verilindor dhe i fton nxënësit të plotësojnë kllasterin në fletoren e tyre.</p>

	<div data-bbox="316 241 662 884"> <p>Malet dhe malësitë. Malësia e Mokrës, përbëhet nga ranorët, argjilat, konglomeratët dhe gëlqerorët. Në pjesën perëndimore ka reliev më të çrregullt, me kontraste e me veprimtari erozive, ndërsa në pjesën lindore, ka reliev më të rregullt. Malësia e Gorës, ka reliev më të copëtuar dhe më të lartë në pjesën veriore se në atë jugore. Malësia e Kolonjës, dallohet për reliev të çrregullt të përbërë nga pllaja e kurrize malorë të copëtuar nga lugina dhe gropa. Malësitë midis Devollit dhe Osumit të Sipërm, dallohet për kontraste të relievit. Malet midis Luginës së Shkumbinit dhe Luginës së Devollit, shtrihen në veriperëndim të rajonit dhe përbëhen nga masive e vargje malorë. Vargu Moravë-Mali i Vashës, shënon dhe lartësinë më të madhe të gjithë rajonit. Mali i Shebenikut e Jabllanicë-Belica, përbën nënjesinë më veriore dhe më të madhe të rajonit. Mali i Thatë dhe malësitë në juglindje të tij, kanë të zhvilluar procesin e karstit.</p> </div> <div data-bbox="696 208 1185 407"> <p>Fushëgropat Fushëgropa e Korçës, e Përrenjasit dhe e Devollit, ndodhen në lartësi mbi nivelin e detit, janë me origjinë gabenore dhe vazhdojnë të ulen në reliev. Dallohen për toka pjellore dhe tipare kontinentale të klimës. Temperatura mesatare vjetore është 10.50 C dhe amplituda e temperaturës shkon rreth 200C gjenden vendbanimet qytetare dhe një sërë vendbanimesh fshatare.</p> </div> <div data-bbox="724 450 1138 510"> <p>Njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor</p> </div> <div data-bbox="758 542 1195 761"> <p>Gropat Gropa e Pogradecit, e Prespës dhe e Kolonjës, përbëhen nga fusha dhe relieve të larta përreth që vazhdojnë të ngrihen në reliev. Buçimasit dhe rripi bregliqenor perëndimor. Ndahen midis tyre nga pragje. Gropa e Pogradecit ka përbërje argjilore, Gropa e Prespës, përbëhet prej gëlqerorëve, ndërsa Gropa e Kolonjës, përbëhet nga terrigjenë. Gropa e Kolonjës është edhe gropa më e lartë midis tyre.</p> </div> <div data-bbox="717 788 1170 942"> <p>Luginat Lugina e Devollit të Sipërm, dhe Lugina e Shkumbinit të Sipërm, janë lugina asimetrike me reliev të thyer, me ngushtime dhe me zgjerime.</p> </div>
	<p>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë. Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit</p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

Tema 5.21

► Popullsia e Rajonit Juglindor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.21 Popullsia e Rajonit Juglindor	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

- Përshkruan veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Juglindor.
- Evidentoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë së Rajonit Juglindor.
- Analizoni faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së Rajonit Juglindor.

2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

- Vlerëson faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së Rajonit Juglindor.

3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.
- Analizon shpërndarjen gjeografike të popullsisë në Rajonin Juglindor.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.

5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

- Ndan mendimet në grup.

6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.

7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

- Nxënësi evidenton veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Juglindor.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi vlerëson faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij rajoni.

3. Marrja e vendimeve

- Nxënësi analizon veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Juglindor.
- Analizon strukturën, ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë gjatë periudhave të ndryshme kohore.

Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Juglindor;
- Evidentoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë së Rajonit Juglindor;
- Analizoni faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij rajoni.

Fjalët kyçe: dinamika e popullsisë, shpërndarja e popullsisë dhe faktorët që ndikojnë në të, vendbanime të hershme.

Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit dinë: a. Rajoni Juglindor ka pasur popullim dhe vendbanime të hershme ilire; b. Ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë në periudha të ndryshme.
b. Ndërtimi i njohurive të reja	Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.21 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 5.21 në tekst, diskutojnë mbi popullimin e Rajonit Juglindor në periudha të ndryshme historike dhe dinamika e popullsisë. Diskutojmë rreth: - veçorive të popullimit dhe të vendbanimeve në Rajonin Juglindor. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...
	Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë mbi popullimin e hershëm në këtë nënrajon dhe të ndërtojnë në fletoret e tyre një kllaster. Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë... Në vazhdim mësuesi/ja trajton informacionin e ri: <i>Mësuesi/ja vazhdon:</i> Rajoni Juglindor përfaqëson një nga hapësirat e banuara që në lashtësi. Në antikitet, trevat e tij janë banuar nga fiset ilire të dasaretëve (enkelejve). Gjurmët arkeologjike të gjetura në vende të ndryshme të rajonit, dëshmojnë popullimin e tij të hershëm dhe të vazhdueshëm. Të një rëndësie të veçantë janë sidomos të dhënat arkeologjike të gjetura në Maliq. Dëshmitë e kulturës së Maliqit, të cilat i përkasin bronzit të hershëm, bronzit të mesëm dhe atij të vonë, vërtetojnë vazhdimësinë kulturore dhe ekonomiko-shoqërore të këtij rajoni. Gjurmë

të tilla arkeologjike janë gjetur edhe në Shpellën e Trenit, në Kamenicë, në Luaras të Kolonjës, në tumat e Barçit, të Kuçit të Zi etj.

Mësuesi/ja vazhdon:

Popullsia e Rajonit Juglindor përbën rreth 12% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Ajo karakterizohet nga ritme të ulëta të shtimit natyror, si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe emigrimit të popullsisë (sidomos të moshës së re), i cili ka pasur një ndikim të përhershëm në dinamikën e popullsisë së rajonit. Me përjashtim të periudhës 1945-1990, kur emigracioni ishte i ndaluar me ligj, pas vitit '90 e në vazhdim ai ka qenë përherë i pranishëm, me drejtim kryesor Greqinë dhe ShBA-në. Popullsia e këtij rajoni ka migruar vazhdimisht edhe Brenda vendit, kryesisht drejt Rajonit Perëndimor, ku lëvizjet më të mëdha migratore janë shënuar pas vitit '90.

Në strukturën e popullsisë sipas moshës, peshën kryesore e zë grupmosha e re dhe ajo e punës. Megjithatë, përqindje të secilës prej grupmoshave të këtij rajoni, krahasuar me përqindjet që zë secila prej tyre në popullsinë e përgjithshme të vendit, kanë diferenca të konsiderueshme midis tyre. Në Rajonin Juglindor, grupmosha 0-14 vjeç është afërsisht 2,2% më e ulët se përqindja në shkallë vendi, ndërsa grupmosha e tretë është 2,7% më e lartë. Kjo lidhet me uljen e ritmeve të lindshmërisë dhe me emigrimin e moshës së re (fertilë). Në strukturën e popullsisë sipas gjinisë, në këtë rajon përqindja e popullsisë femër është pothuajse e barabartë me përqindjen e popullsisë mashkull, me një diferencë të vogël në favor të kësaj të fundit (50,5% kundrejt 49,5%).

Në strukturën e popullsisë sipas vendbanimeve, përqindjen më të lartë e zë popullsia rurale. Popullsia urbane përbën 31,9% të popullsisë së përgjithshme të rajonit, vlerë e cila luhet nga 43,6% në bashkinë e Kolonjës, në 16% në bashkinë e Librazhdit. Qendrat urbane të Rajonit Juglindor janë: Korça, Pogradeci, Librazhdi, Përrenjasi, Gramshi, Bilishti, Erseka, Maliqi dhe Leskoviku.

Struktura sipas etnisë: Rajoni përbëhet nga popullsi homogjene shqiptare. Krahas saj, në këtë rajon banon një pakicë kombëtare maqedonase, e përqendruar në bashkinë Pustec (në nëntë fshatra të saj):. Pjesë e popullsisë së rajonit janë edhe pakicat gjuhësore arumune e rome. Arumunët janë vendosur kryesisht në Korçë, Voskopojë dhe Grabovë, ndërsa romët në Pogradec, Korçë e Bilisht.

Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë...

	Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3 dhe 4.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.22

► Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Juglindor dhe ekonomia e tij

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore 5.22 Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Juglindor dhe ekonomia e tij	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor.Evidenton veçoritë e trashëgimisë kulturore të Rajonit JuglindorPërshkruani veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore në Rajonit Juglindor.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor.Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			

7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin) <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi zhvillimin e ekonomisë në këtë nënrajon. 	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës	
1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike <ul style="list-style-type: none"> Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor. Evidenton degët kryesore të ekonomisë në Rajonit Juglindor. 	
2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire. 	
3. Marrja e vendimeve <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit. 	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonit Juglindor; Evidenton degët kryesore të ekonomisë në Rajonin Juglindor; Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire. 	Fjalët kyçe: Trashëgimi natyrore, kategori të zonave të mbrojtura, zhvillim ekonomik, degët e ekonomisë.
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit kanë njohuri rreth: <ul style="list-style-type: none"> a. vlerave dhe potencialeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë rajon.
	Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.22 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor tabelën e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.22 në tekst - Diskutojmë rreth: <ul style="list-style-type: none"> - trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore të Rajonit Juglindor dhe rolit të tyre në zhvillimin e turizmit - sektorëve kryesore të ekonomisë në këtë rajon.

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi:

- trashëgiminë natyrore dhe kulturore;
- zonat e mbrojtura;
- degët më të zhvilluara të ekonomisë në këtë rajon.

Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...

Ndërthurja e formave të larmishme të relievit, rrjedhjet e rrëmbyeshme ujore, liqenet e thella tektoniko-karstike, lartësia e madhe mbi nivelin e detit, klima kontinentale, si dhe diversiteti i botës së gjallë përbëjnë një trashëgimi të pasur natyrore me potenciale ekonomike për Rajonin Juglindor.

Ndërthurja e elementeve të relievit me ato klimatike apo me llojet e botës së gjallë, ka sjellë krijimin e peizazheve natyrore me vlera unike, një pjesë e të cilave është përfshirë në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura (shih tabelën 1).

Zonat e Mbrojtura në Rajonin Juglindor					
Nr	Kategoria	Qarku	Bashkia	Emri i Zonës së Mbrojtur	Sipërfaqja (në ha)
1.	II. Park Kombëtar	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	1380
2.	II. Park Kombëtar	Korçë	Korçë	Prespa	27750
3.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Korçë	Devoll	Cangonj	250
4.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Korçë	Korçë	Krastafillak	250
5.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	430
6.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Elbasan	Librazhd	Polis	45
7.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Elbasan	Librazhd	Stravaj	400
8.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Elbasan	Librazhd	Sopot	300
9.	IV. Rezervat Natyror i Menaxhuar	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	400
10.	V. Peizazh i Mbrojtur	Korçë	Devoll	Nikolicë	510
11..	V. Peizazh i Mbrojtur	Korçë	Pogradec	Pogradec	27323
12.	VI. Zonë e Mbrojtur Natyrore e Resurseve të Menaxhuara	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	5400

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Mësuesi/ja vazhdon:

Ekonomia bujqësore ka qenë përherë një sektor i rëndësishëm ekonomik i Rajonit Juglindor. Në varësi të zhvillimit ekonomik të vendit dhe të kërkesave të tregut, pasha e bujqësisë dhe e blegtorisë kanë ndryshuar vazhdimisht. Bujqësia është e zhvilluar kryesisht në Fushëgropën e Korçës dhe në luginën e Devollit të Sipërm. Kulturat kryesore janë drithërat, të cilat përbëjnë rreth 20% të sipërfaqeve fushore dhe tarracave lumore të rajonit dhe foragjeret, që zënë rreth 40% të sipërfaqeve të

	<p>ulëta. Krahës tyre, rajoni dallohet për kultivimin e perimeve, të drurëve frutorë dhe të vreshtave kryesisht në Librazhd, Leskovik e Devoll.</p> <p><i>Sektori i dytë i ekonomisë:</i> Nëntoka e Rajonit Juglindor është e pasur me rezerva të hekur-nikelit, bakrit dhe qymyrgurit. Ashtu si ekonomia bujqësore, edhe industria ka pësuar ndryshime strukturore. Deri në vitet '90, vendin kryesor në ekonominë e rajonit e zinin: industria e nxjerrjes dhe e pasurimit të hekur-nikelit, kromi e e qymyrgurit; industria e lehtë e ushqimore, energjetika, si dhe industria mekanike me uzinën e precizonit etj. Pas vitit '90, mospërshtatja e prodhimit industrial me kërkesat e ekonomisë së tregut dhe teknologjia e vjetruar sollën mbylljen e këtyre degëve të industrisë.</p>
	<p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Sektori i tretë i ekonomisë:</i> Turizmi dhe shërbimet janë degët e favorizuara prej pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore të rajonit, të cilat vitet e fundit kanë njohur ritme të larta zhvillimi. Për zhvillimin e turizmit dallohen: Pogradeci (me turizmin liqenor), Voskopoja dhe Dardha (me turizmin kulturor dhe malor) dhe Korça, për trashëgiminë muzeale, historike, kulturore e arsimore, traditat në kulinari etj. Numri i madh i hoteleve kryesisht në qytetin e Korçës e të Pogradecit dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për turistët vendas dhe të huaj, mundësojnë zhvillimin e turizmit të këtij rajoni.</p> <p><i>Tregtia</i> është një sektor i rëndësishëm në këtë rajon, pasi punëson një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Ajo është e përqendruar kryesisht në qendrat urbane të tij, ndër të cilat dallohen Korça dhe Pogradeci.</p> <p><i>Artizanati</i> përbën një degë tradicionale të ekonomisë së rajonit, e cila dallohet për përpunimin e drurit, metalit, argjilës, leshit dhe gurit dekorativ.</p> <p><i>Transporti</i> është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë, për shkak të pozicionit gjeografik dhe pranisë së disa pikave të kalimit kufitar në këtë rajon, që mundësojnë lidhjen me vendet fqinje.</p> <p>Peshën kryesore të transportit e mbulon ai automobilistik, ku janë bërë edhe investimet të mëdha për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Transporti hekurudhor, dikur funksional, sot ka nevojë për investime.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 7.</p>

<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

PUNË PRAKTIKE 3

► Tema: Rajoni Juglindor i Republikës së Shqipërisë

Rezultatet e të nxënit:

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përcakton në hartën-skicë dhe emërton njësitë kryesore të Rajonit Juglindor të Republikës së Shqipërisë;
- lokalizon, emërton e ngjyros në hartën-skicë format kryesore të relievit dhe hidrografisë së tij;
- lokalizon dhe emërton në hartën-skicë qendrat më të rëndësishme urbane, ekonomike, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit;
- shfaq kureshtje për zhvillimet demografi dhe strukturën e popullsisë në këtë rajon, si dhe përcakton veçoritë kryesore të popullimit të tij;
- analizon veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45minuta; në klasë.

Materialet burimore: teksti mësimor, material teorike e harta të siguruar nga internet apo nga enciklopedi të ndryshme, si dhe material të rekomanduar nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: harta-skicë, atlas i gjeografi harta fiziko-gjeografike dhe ajo politiko-administrative e Republikës së Shqipërisë, teksti mësimor, laps, rapidograf, lapsa me ngjyrë/lapustila.

Metodologjia që do të përdoret: punë individuale (ngjyrosje dhe emërtimi hartës-skicë), punë në grupe (diskutim, shkëmbim idesh).

Puna përgatitore:

- Përsëriten njohuritë e marra nga teksti mësimor mbi veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore dhe kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe mbi veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor të Republikës së Shqipërisë.
- Përzgjidhen dhe diskutohen të dhënat e marra nga burime të ndryshme (internet, enciklopedi, harta, fotografi dokumentarë televizivë etj.) në lidhje me veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore e kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike, dhe strukturën e popullsisë, si dhe me veçoritë e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Hapat që do të ndiqni gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

1. Lokalizoni dhe emërtoni në hartën-skicë njësitë kryesore të Rajonit Juglindor të Republikës së Shqipërisë.
2. Lokalizoni, emërtoni dhe ngjyrosni në hartën-skicë format kryesore të relievit (fushat, kodrat, pllajajat etj.) të këtij rajoni.
3. Lokalizoni dhe emërtoni në hartën-skicë hidrografinë e rajonit (liqenet, rrjedhat kryesore lumore, burimet etj.).
4. Emërtoni në hartën-skicë zonat e rajonit që dallohen për pasuritë e mëdha natyrore (zonat mineral mbajtëse, turistike, energjetike, pyjore, ujore, termale etj.), si dhe zonat më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore.
5. Përcaktoni dhe emërtoni në hartën-skicë qendrat më të rëndësishme urbane dhe ekonomike të këtij rajoni.
6. Analizoni zhvillimet demografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.
7. Vlerësoni mundësitë e shfrytëzimit të pasurive natyrore të rajonit në favor të zhvillimit social-ekonomik.
8. Interpretoni grafik të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me zhvillimin e sektorëve të ekonomisë në Rajonin Juglindor gjatë periudhave të ndryshme.
9. Vlerësoni perspektivat demografi dhe ekonomike të Rajonit Juglindor.

Tema 5.23**► Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Jugor**

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika: 5 Rajonet Republikës së Shqipërisë	gjeografike të	Tema mësimore: 5.23	Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të Rajonit Jugor
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p><u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcakton pozitën gjeografike të Rajonit Jugor. • Përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Jugor. <p><u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Jugor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë. <p><u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij. • Argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Rajonit Jugor dhe rolin e saj në zhvillimin e ekonomisë së vendit; • Evidenton tiparet më të përgjithshme natyrore të Alpeve Shqiptare; <p><u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u></p>			

<ul style="list-style-type: none"> Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit. Sjell shembuj të veçorive kryesore natyrore të Rajonit Jugor dhe potencialet natyrore për zhvillim. <p>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndan mendimet në grup. <p>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror. <p>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Jugor. 	
<p align="center">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Jugor. 	
<p>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Jugor dhe rolin e saj në zhvillimin e marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit. <p>3. Marrja e vendimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi vlerëson ndërvlerësinë midis rajoneve të vendit dhe sjell shembuj të ndërvlerësisë e të bashkëveprimit rajonal. 	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> argumenton rëndësinë e pozitës gjeografike të Rajonit Jugor dhe rolin e saj në zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjera të vendit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të Rajonit Jugor; vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Jugor, për zhvillimin socio-ekonomik të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë. 	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike e Rajonit Jugor dhe roli i saj; kushtet natyrore.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pozitës gjeografike të Rajonit Jugor.
	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.23 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Evropës dhe situatën e vendosur në fillim të mësimi 5. 23 në tekst - <i>Diskutojmë rreth:</i> - pozitës gjeografike të Rajonit Jugor; - veçorive natyrore të këtij rajoni.</p> <p><i>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</i></p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Rajonit Jugor dhe rolin e saj:</p>
	<p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin hartën fiziko-gjeografike të Rajonit Jugor dhe të diskutojnë rreth kushteve natyrore të tij. <i>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</i> Rajoni Jugor zë pjesën jugore e jugperëndimore të Republikës së Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 6200 km², gjatësi 130 km dhe gjerësi rreth 100 km. Në verilindje, ai kufizohet me Rajonin Juglindor, ndërsa në veriperëndim me Rajonin Perëndimor. Në perëndim e jugperëndim, rajoni ka dalje në Detin Jon dhe në Gjirin e Vlorës (që është pjesë e Detit Adriatik), ndërsa në juglindje kufizohet me kufirin shtetëror të Shqipërisë me Greqinë. Rajoni Jugor ka një pozitë të rëndësishme gjeografike, pasi përmes tij kalojnë arterie automobilistike (rruga e Rivierës dhe ajo Tepelenë-Gjirokastrë-Kakavijë), të cilat mundësojnë lidhjen e rajoneve të tjera të vendit me pjesën jugore të Ballkanit. Porti i Sarandës dhe ai i Himarës, si dhe pikat e kalimit kufitar të Kakavijës, Tri Urave e Qafë-Botës, bëjnë të mundur lidhjen e tij dhe të rajoneve të tjera të vendit me Greqinë.</p> <p><i>Kushtet natyrore:</i> Rajoni Jugor dallon për ndërtimin e thjeshtë gjeologjik të truallit, i përbërë kryesisht nga shkëmbinjtë gëlqerorë. Në relieve të larta malore gjenden edhe dolomite, ndërsa nëpër lugina e kodra të ulëta përhapen depozitime të ndryshme terrigjene. Krahësuar me rajone të tjera të vendit, ai dallohet gjithashtu për një ndërtim të thjeshtë strukturor.</p> <p>Pjesa më e madhe e truallit të tij përbëhet prej antiklinaleve e sinklinaleve asimetrikë, ndërsa strukturat shkëputëse horst-graben ndeshen pranë Detit Jon (ku dallohet graben i Gjiri i Vlorës-Dukat dhe ai i Delvinës). Pjesë të tjera më në brendësi, si: Tomori, Nëmërçka, Kurveleshi, Çika etj., kanë pësuar lëvizjen ngritëse me amplitudë të madhe (1500-2000 m), duke krijuar kontraste të mëdha hipsometrike.</p>

	<p><i>Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...</i></p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Relievi</i> pasqyron dukshëm ndërtimin gjeologjik të rajonit, kualternimi i strukturave antiklinale me ato sinklinale pasqyrohet në alternimin e relievave malore në formë vargësh të vendosura paralel midis tyre dhe me luginat lumore. Në relievin e këtij rajoni mbizotëron drejtimi veriperëndim-juglindje, por nuk mungojnë edhe relievat në formën e malësisë, siç është ajo Tomor-Melesin dhe malësia e Kurveleshit.</p> <p><i>Klima</i> e këtij rajoni ndeshet në formën e klimës mesdhetare fushore, kodrinore dhe malore. Veçoritë e saj janë krijuar si</p>
	<p>rezultat i pozicionit gjeografik jugor të rajonit, afërsisë me detin Jon, hapjes së luginave lumore drejt veriperëndimit (kundrejt ndikimit të detit Adriatik), ndryshimeve të relievit në lartësi etj. Në pjesën perëndimore të rajonit, vera është e gjatë, e thatë dhe e nxehtë, ndërsa dimri i shkurtër dhe i lagësht. Në terrene të larta malore, sidomos në lindje, klima është me dimër të ftohtë, me ngrica dhe me bore.</p> <p><i>Tokat</i> në këtë rajon janë kryesisht të hirta kafe dhe të kafenjta. Në zona të ulëta, në Orikum, Delvinë e Mursi, ka edhe toka moçalore, ndërsa në lartësitë e Tomorit, Zaloshnjës dhe Nemërçkës gjenden edhe toka të murrme pyjore e livadhore malore.</p> <p><i>Bimësia</i> përfaqësohet nga shkurret mesdhetare sidomos të tipit makje. Ajo është e varfër dhe fragmentare në dushqe dhe në pyje me drurë të lartë ahu e pishe.</p> <p><i>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</i></p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup:</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.24

► Njësitë e Rajonit Jugor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.24 Njësitë përbërëse të Rajonit Jugor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përcakton njësitë përbërëse të Rajonit Jugor.• Përshkruan tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Rajonit Jugor.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Jugor në zhvillimin e rajonit.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Jugor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit.• Evidenton tiparet më të përgjithshme të njësive përbërëse të Rajonit Jugor.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Jugor.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Jugor.			
2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi vlerëson pozitën gjeografike të njësive përbërëse të Rajonit Jugor.			
3. <u>Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi vlerëson rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Jugor në zhvillimin e rajonit.			

<p>Rezultatet e të nxënës të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e njësive përbërëse të Rajonit Jugor dhe rolin e tyre në zhvillimin e rajonit; përshkruan tiparet më të përgjithshme natyrore të njësive përbërëse të Rajonit Jugor; Përcakton njësitë përbërëse të Rajonit Jugor. 	<p>Fjalët kyçe: njësi përbërëse, veçori natyrore</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><i>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p>	<p>Nxënësit kanë njohuri rreth: a. pozitës gjeografike të Rajonit Jugor dhe njësitë përbërëse të tij.</p>
	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 5.24 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor hartën fiziko-gjeografike të Alpeve Shqiptare dhe situatën e vendosur në fillim të mësimi 5.24 në tekst - Diskutojmë rreth: - veçorive kryesore të njësive përbërëse të Rajonit Jugor. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Së bashku me nxënësit mësuesi/ja saktëson përgjigjen e duhur në lidhje me pozitën gjeografike të Rajonit Jugor dhe më pas diskutojnë rreth veçorive të njësive përbërëse të këtij rajoni. Plotësojnë në hartën-skicë njësitë kryesore të Rajonit Jugor. <i>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</i> Bazuar në format e relievit që karakterizojnë hapësirën gjeografike të rajonit, dallohen disa nënnyjësi fiziko-gjeografike, të cilat janë: Malësia Tomor-Melesin, Lugina e</p>

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Vjosës, Vargjet Paralele, Lugina e Drinosit, Vargu Kurvelesh-Mali i Gjerë-Stugarë-Murganë, Lugina e Shushicës, Vargu Bregdetar Jonik, Fushëgropa e Delvinës dhe Riviera Jonike. Mësuesja fton nxënësit që t'i përcaktojnë ato në hartë...</p> <p><i>Malësia e Tomor-Melesinit:</i> Kjo malësi dallohet për relievin e çrregullt, me male, vargje, kurrize malore e kodra të copëtuara prej rrjedhjeve ujore dhe përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë e terrigjenë. Gëlqerorët përbëjnë relieve te larta të Tomorit, Kulmakut, Miçanit, Çarshovës etj., ndërsa terrigjenët gjenden në zona te ulëta përreth tyre.</p> <p><i>Vargjet Paralele:</i> Vargjet paralele përbëhen nga dy vargje malore: vargu lindor, i cili përfshin mallet Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë, dhe vargu perëndimor, me malet Shëndëlli-Lunxheri-Bureto. Vargjet përbëhen nga shkëmbinj gëlqerorë, ndërsa luginat që i ndajnë ato, kanë përbërje terrigjene.</p> <p><i>Lugina e Vjosës:</i> Pjesë e Rajonit Jugor janë vetëm sektori i sipërm dhe ai i mesëm i Luginës së Vjosës, të cilët ndahen midis tyre nga Gryka e Këlcyrës. Në fillim, sektori i sipërm është i ngushtë dhe i pjerrët, ndërsa në grykëderdhjen e Lengaricës zgjerohet shumë, duke e prere fushën e Vjosës së Sipërme. Në sektorin e mesëm, lugina prët tërthor Vargjet Paralele dhe krijon Grykën e Këlcyrës..</p> <p><i>Lugina e Drinosit:</i> Lugina e Drinosit është e mbushur me sediment te këtij lumi dhe të përrenjve që derdhen në të. Ajo karakterizohet nga tabani i sheshtë, tokat pjellore dhe klima e përshtatshme për kultivimin e të gjitha llojeve të kulturave bujqësore.</p> <p><i>Vargu malor Kurvelesh-Mali i Gjerë-Stugarë-Murganë:</i> ky varg malor përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë dhe karakterizohet nga tektonikë e diferencuar. Në të bëjnë pjesë: malësia e Kurveleshit në very, vargu Mali i Gjerë-Murganë në jug, të cilët ndahen midis tyre prej luginës e Drinos. Mësuesja fton nxënësit që ti përcaktojnë ato në hartë...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit</p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

Tema 5.25

► Popullsia e Rajonit Jugor

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë		Tema mësimore: 5.25 Popullsia e Rajonit Jugor	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
1. <u>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përshkruan veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Jugor.• Evidentoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë së Rajonit Jugor.• Analizoni faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së Rajonit Jugor.			
2. <u>Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Vlerëson faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së këtij nënrajoni.			
3. <u>Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.• Analizon shpërndarjen gjeografike të popullsisë në Rajonin Jugor.			
4. <u>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
5. <u>Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Ndan mendimet në grup.			
6. <u>Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
7. <u>Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara).			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
1. <u>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi evidenton veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Jugor.			
2. <u>Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
Nxënësi vlerëson faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së Rajonit Jugor.			
3. <u>Marrja e vendimeve</u>			
<ul style="list-style-type: none">• Nxënësi analizon veçoritë e popullimit të hershëm të Rajonit Jugor.• Analizon strukturën, ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët) dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë gjatë periudhave të ndryshme kohore.			

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan veçorit e popullimit të hershëm të Rajonit Jugor; • Evidentoni dinamikën dhe strukturën e popullsisë së Rajonit Jugor; • Analizoni faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e popullsisë së Rajonit Jugor. 	<p>Fjalët kyçe: dinamika e popullsisë, shpërndarja e popullsisë dhe faktorët që ndikojnë në të, vendbanime të hershme.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Rajonit Jugor ka pasur popullim dhe vendbanime të hershme ilire; b. Ndryshimet që ka pësuar numri i popullsisë në periudha të ndryshme.
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.25 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit që duke u bazuar në rubrikën diskutojmë, e vendosur në fillim të mësimit 5.25 në tekst, diskutojnë mbi popullimin e Rajonit Jugor në periudha të ndryshme historike dhe dinamika e popullsisë. <i>Diskutojmë rreth:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - veçorive të popullimit dhe vendbanimeve të Rajonit Jugor. <p>Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë dhe ndërtojnë me përgjigjet e tyre një kllaster në tabelë/fletore/fletëformat...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë mbi popullimin e hershëm në këtë rajon dhe të ndërtojnë në fletoret e tyre një kllaster. Nxënësit përshkruajnë/diskutojnë...</p> <p>Në vazhdim mësuesi/ja trajton informacionin e ri: <i>Mësuesi/ja vazhdon:</i> Rajoni Jugor dallohet për popullimin e tij të hershëm. Objektet arkeologjike të gjetura në Xarë të Konispolit dëshmojnë banimin e trevave shqiptare që në periudhën e paleolitit të mesëm (100000-30000 vjet pr.K.). Gjatë shekujve,</p>

	<p>popullimi i rajonit ka qenë një proces i vazhdueshëm dhe është rritur në numër. Këtë e vërtetojnë veglat e punës që janë zbuluar në shpellën e Shën Marinës (në Bogas të Sarandës) e në Konispol; vendbanimi mezolitik i Vlushës (Skrapar); varrezat tumulare të epokës së bronzit në Piskovë (Përmet), Dropull, Bajkaj (Sarandë) etj. Në antikitet, rajoni ka qenë i banuar nga fisi ilir i kaonëve.</p> <p>Deri në vitin '90, popullsia e rajonit është rritur në mënyrë të vazhdueshme, me gjithë semerit me të ndryshme. Pas '90-ës, numri i popullsisë pësoi rënie të ndjeshme, si rezultat i migrimit të një pjese të madhe të popullsisë dhe i uljes së ritmeve të lindshmërisë. Lëvizjet migratore të popullsisë u orientuan si jashtë vendit, kryesisht drejt Greqisë dhe Italisë, ashtu edhe drejt Rajonit Perëndimor të Shqipërisë. Këto lëvizje prekën më tepër grupmoshën 20-39 vjeç dhe më pak atë 45-59 vjeç, gjë e cila solli uljen e lindshmërisë së popullsisë.</p> <p><i>Mësuesi/ja vazhdon:</i></p> <p><i>Shpërndarja gjeografike e popullsisë:</i> Sot, popullsia e Rajonit Jugor përbën rreth 7% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Ajo dallohet për dendësinë e ulët të saj, e cila shkon mesatarisht 38 banorë/km². Për shkak të kushteve të relievit dhe zhvillimit ekonomik të rajonit, shpërndarja e popullsisë është e pabarabartë. Zonat më të populluara janë: Fushëgropa e Delvinës, Lugina e Vjosës, ajo e Drinosit dhe Lugina e Shushicës, ndërsa ato më pak të populluara janë Vargjet Paralele, Malësia e Kurveleshit, Malësia midis Tomor-Melesinit dhe Vargu Bregdetar. Dendësinë më të madhe të popullsisë e ka bashkia Gjirokastrë (me 48 banorë/km²) dhe atë më të ulët, bashkia Përmet (me 27,7 banorë/km²).</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, 2, dhe 3 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
<i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i>	Nxënësit diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre
<i>Vlerësimi i nxënësit</i>	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 5.26

► **Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Jugor dhe ekonomia e tij**

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika 5: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.		Tema mësimore 5.26: Trashëgimia natyrore dhe ajo kulturore e Rajonit Jugor dhe ekonomia e tij	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor.Renditin veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor.Evidenton veçoritë e trashëgimisë kulturore të Rajonit Jugor.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Vlerëson rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore në Rajonin Jugor.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor.Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi zhvillimin e ekonomisë në Rajonin Jugor.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
<u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
<ul style="list-style-type: none">Evidenton veçantinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor;Evidenton degët kryesore të ekonomisë në Rajonin Jugor.			
<u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			
<ul style="list-style-type: none">Nxënësi vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire;			

3. Marrja e vendimeve <ul style="list-style-type: none"> Argumenton rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe rolin e saj në zhvillimin në zhvillimin e turizmit. 	
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Përshkruan tiparet më të përgjithshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Rajonin Jugor; Evidenton degët kryesore të ekonomisë në këtë rajon; Vlerëson potencialet natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të kësaj hapësire. 	Fjalët kyçe: Trashëgimi natyrore, kategori të zonave të mbrojtura, zhvillim ekonomik, degët e ekonomisë.
Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi, të dhëna nga njësia vendore.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve	Nxënësit kanë njohuri rreth: a. vlerave dhe potencialeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në këtë rajon.
b. Ndërtimi i njohurive të reja	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.26 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor tabelën e zonave të mbrojtura në vendin tonë dhe situatën e vendosur në fillim të mësimit 5.26 në tekst. - Diskutojmë rreth: - trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor; - sektorëve kryesorë të ekonomisë së këtij rajoni. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi: - trashëgiminë natyrore dhe kulturore; - zonat e mbrojtura; - degët më të zhvilluara të ekonomisë në këtë rajon.</p> <p>Rajoni Jugor ka pasuri të shumta natyrore. Klima mesdhetare, larmia e hidrografisë dhe e relievit, mundësojnë zhvillimin e një faune e flore të shumëllojshme. Sipërfaqet pyjore, burimet e</p>

shumta të ujërave karstike dhe ato termominerale, përveç rëndësisë ekonomike që kanë, krijojnë peizazhe me vlera të veçanta natyrore. Bregdeti jonian është një perlë e vërtetë natyrore, e cila me bukurinë, faunën e pasur që rritet në ujërat detare (dallojnë korale te kuqe) dhe kontraste te relievit, mundëson një turizëm blu të pakrahasueshëm.

Mësuesi/ja vazhdon:

Bujqësia është përqendruar kryesisht në Fushën e Vurgut, të Mursisë, të Dropullit dhe përgjatë luginave të Vjosës e Drinosit. Banorët vendas përpunojnë edhe bimë të ndryshme mjekësore, të cilat rriten kryesisht në shpatet e maleve.

Zonat e Mbrojtura në Rajonin Jugor					
Nr	Kategoria	Qarku	Bashkia	Zona e Mbrojtur	Sipërfaqja (në)
1.	I. Rezervë Strikte Natyrore/Rezervat Shkencor	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	1800
2.	II. Park Kombëtar	Vlorë	Vlorë	Llogara	1010
3.	II. Park Kombëtar	Berat	Berat, Skrapar, Gramsh	Mali i Tomorit	4000
4.	II. Park Kombëtar	Vlorë	Sarandë	Butrinti	8591,2
5.	II. Park Kombëtar	Vlorë	Vlorë	Parku Kombëtar Detar "Karaburun-	12570,8
6.	III. Monument Natyror	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	1740
7.	III. Monument Natyror	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	1500
8.	III. Monument Natyror	Vlorë	Delvinë	Syri i Kaltër	180
9.	IV. Rezervat Natyror i	Vlorë	Vlorë	Karaburun	20000
10.	IV. Rezervat Natyror i	Berat	Skrapar	Bogovë	330
11.	IV. Rezervat Natyror i	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	1400

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Blegtoria dallohet kryesisht për mbarështimin e bagëtisë së imët. Zonat më të njohura blegtorale jo vetëm për rajonin, por edhe në shkallë vendi janë: zona e Lunxhërisë, ajo e Zagorisë, malësia e Tomorit dhe ajo e Kurveleshit. Rajoni dallohet për përpunimin dhe tregtimin e produkteve cilësore blegtorale.

Mësuesi/ja vazhdon:

Industria: Nëntoka e Rajonit Jugor është e pasur me rezerva ujore, qymyrguri, boksitesh, fluoritesh, mermerësh, dolomitësh, argjilash, inertesh për ndërtim, si dhe me burime minerale e termominerale, mbi bazën e të cilave mbështetet zhvillimi industrial i rajonit.

Energjetika përfaqësohet me dy hidrocentralet e lumit Bistrica. Industria e lehtë dhe ajo ushqimore janë degët tradicionale të rajonit. Industria e lehtë është e përqendruar kryesisht në qytetet e Gjirokastrës dhe të Çorovodës me sipërmarrjet fasone, në formën e ndërmarrjeve të përbashkëta shqiptaro-greke

Industria e materialeve të ndërtimit bazohet në nxjerrjen dhe

	<p>përpunimin e materialeve inerte për ndërtim (në luginat e Vjosës dhe të Drinosit): në prodhimin e tullave (në Këlcyrë), në nxjerrjen dhe përpunimin e pllakave të gurit dekorativ (në Skrapar), në prodhimin e gëlqeres (në Sarandë dhe Gjirokastrë) etj</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

► PUNË PRAKTIKE 4

Tema: Rajoni Jugor i Republikës së Shqipërisë

Rezultatet e të nxënësit:

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përcakton dhe emërton në hartën-skicë njësitë kryesore të Rajonit Jugor të Republikës së Shqipërisë;
- lokalizon, emërton e ngjyros në hartën-skicë format kryesore të relievit dhe hidrografisë së tij;
- lokalizon dhe emërton në hartën-skicë qendrat më të rëndësishme urbane, ekonomike, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit;
- shfaq kureshtje për zhvillimet demografike dhe strukturën e popullsisë në këtë rajon, si dhe përcakton veçoritë kryesore të popullimit të tij;
- analizon veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45 minuta; në klasë.

Materialet burimore: teksti mësimor, materiale teorike e harta të siguruar nga internet apo nga enciklopedi të ndryshme, si dhe material të rekomanduar nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: harta-skicë, atlas i gjeografikë harta fiziko-gjeografike dhe ajo politiko-administrative e Republikës së Shqipërisë, teksti mësimor, laps, rapidograf, lapsa me ngjyrë/lapustila.

Metodologjia që do të përdoret: punë individuale (ngjyrosje dhe emërtim i hartës-skicë), punë në grupe (diskutim, shkëmbim idesh).

Puna përgatitore:

- Përsëriten njohuritë e marra nga teksti mësimor mbi veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore dhe atë kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe mbi veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor të Republikës së Shqipërisë.
- Përzgjidhen dhe diskutohen të dhënat e marra nga burime të ndryshme (internet, enciklopedi, harta, fotografi, dokumentarë televizivë etj.) në lidhje me veçoritë fiziko-gjeografike, njësitë përbërëse, trashëgiminë natyrore e kulturore, dinamikën, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e popullsisë, si dhe me veçoritë e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

Hapat që do të ndiqni gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

1. Lokalizoni dhe emërtoni në hartën-skicë njësitë kryesore të Rajonit Jugor të Republikës së Shqipërisë.
2. Lokalizoni, emërtoni dhe ngjyrosni në hartën-skicë format kryesore të relievit (fushat, kodrat, pllajajat etj.) të këtij rajoni.
3. Lokalizoni dhe emërtoni në hartën-skicë hidrografinë e rajonit (liqenet, rrjedhjet kryesore lumore, burimet etj.).
4. Emërtoni në hartën-skicë zonat që dallojnë për pasuritë e mëdha natyrore të rajonit (zonat mineral mbajtëse, turistike, energjetike, pyjore, ujore, termale etj.), si dhe qendrat më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të tij.
5. Përcaktoni dhe emërtoni qendrat më të rëndësishme urbane dhe ekonomike të këtij rajoni.
6. Analizoni zhvillimet demografike, strukturën e popullsisë dhe veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të rajonit.
7. Vlerësoni mundësitë e shfrytëzimit të pasurive natyrore të rajonit në favor të zhvillimit social-ekonomik.
8. Interpretoni grafik të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me zhvillimin e sektorëve të ekonomisë së Rajonit Jugor gjatë periudhave të ndryshme.
9. Vlerësoni perspektivat demografike dhe ekonomike të këtij rajoni.

► PROJEKT 2 (ORA E PARË)

Tema: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimit rajonal

Rezultatet e të nxënit:

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- zbulon dhe analizon tiparet natyrore, demografike, kulturore dhe ekonomike të rajoneve të Shqipërisë: Perëndimor, Veriore, Verilindor, Juglindor dhe Jugor;
- shfrytëzon teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe material të tjera mbështetëse për realizimin e projektit;
- përzgjedh informacionin dhe e përpunon atë (ndërton grafi, diagrame me të dhëna statistikore);
- evidenton dhe vlerëson trashëgiminë natyrore dhe atë kulturore të rajoneve të Shqipërisë;
- vlerëson diversitetin natyror, shoqëror dhe kulturor të rajoneve të Shqipërisë;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (idetë individuale dhe ato në grup);

- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- është krijues, prezanton idetë e reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj.

Burimet kryesore të informacionit: teksti mësimor, kllastera dhe material të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruara nga interneti, pushteti vendor, shtypi; guida të ndryshme turistike, enciklopedi, libra dhe revista me kuriozitete, media dhe dokumentarë të ndryshëm televizivë.

Metodologjia që do të përdoret: punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit: teksti mësimor, material të printuara (material të hulumtuara dhe të grumbulluara), material të siguruara nga pushteti vendor, shtypi, kompjuteri, videoprojektor, e të-anketa, tabelë prezantimi, shënjes, fletëpalosje, postera, fotografi skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit:

- Identifikimi i kriterëve të rajonizimit gjeografik të Shqipërisë, ndarja rajonale e saj dhe lloje të rajoneve.
- Vlerësimi i rolit të pozitës gjeografike të secilit prej rajoneve gjeografike të Shqipërisë.
- Përshkrimi i kushteve natyrore të secilit prej rajoneve gjeografike dhe i potencialeve natyrore për zhvillim.
- Evidentimi i karakteristikave kryesore të popullimit të secilit prej rajoneve, me fokus të veçantë shpërndarjen gjeografike, ndryshimi në numrit të popullsisë, shtimin natyror dhe ndryshimet strukturore të saj.
- Analizimi i shkaqeve të lëvizjeve migratore të popullsisë në secilin prej rajoneve dhe pasojat e tyre.
- Analizimi i procesit të urbanizimit në secilin prej rajoneve dhe rrjedhojat e tij.
- Vlerësimi i zhvillimit bujqësor, industrial, të tregtisë, turizmit, transportit etj., në secilin prej rajoneve.
- Interpretimi i grafikeve e, të dhënave statistikore, hartave etj., në lidhje me ecurinë e zhvillimit ekonomik të secilit prej rajoneve gjatë periudhave të ndryshme.
 - Vlerësimi i trashëgimisë natyrore dhe i asaj kulturore të secilit prej rajoneve të vendit dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik.
- Identifikimi i mundësive dhe parashikimi i perspektives së zhvillimit ekonomik të secilit prej rajoneve të vendit.
- Përshkrimi i tipareve dalluese të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit tonë.
- Analizimi i faktorëve që kanë ndikuar në zhvillimin jo të njëjtë të rajoneve.
- Vlerësimi i potencialeve të rajoneve të Shqipërisë për zhvillimin ekonomik të saj.

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit

- Nxënësit ndahen në grupe, me nga katër anëtarë secili.
- Prezantimi i produktit të projektit do të bëhet në orën e tretë të tij.
- Përcaktohen: përmbajtja e projektit, burimet e informacionit, mënyrat sesi do të punojnë dhe komunikojnë nxënësit.

- Mësuesi/ja jep sugjerime mbi organizimin e punës Brenda grupit.
- Nxënësit ndajnë rolet Brenda grupit dhe detyrat për secilin.

Përsëritja 4

► Nëntematika V (Rajoni Verilindor, Juglindor dhe ai Jugor i Shqipërisë)

Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë mbi pyetjet/çështjet e mëposhtme:

1. Qarkoni alternative e duhur.

- Me luginat e Drinit dhe të Shkumbinit të Mesëm kufizohet:
 - a) Rajoni Verior dhe Verilindor;
 - b) Rajoni Verilindor;
 - c) Rajoni Juglindor;
 - d) Rajoni Jugor.
- Nga pikëpamja e relievit, Rajoni Verilindor dallohet për:
 - a) sipërfaqe të sheshta, të alternuara me kodrat;
 - b) copëtimin dhe larminë e formave të relievit;
 - c) numrin e madh të gropave dhe të fushëgropave;
 - d) rrjedha të poshtme të lumenjve më të mëdhenj të vendit.
- Përbërja magmatike e Malësisë së Gjakovës, kushtëzon:
 - a) formimin e ujërave nëntokësore;
 - b) shpëputje të fuqishme tektonike;
 - c) zhvillimin e veprimtarisë karstike;
 - d) praninë e rezervave të bakrit.
- Në përbërjen gjeologjike të Vargut të Korabit, vendin kryesorë zënë:
 - a) molasa të pliokuaternarit;
 - b) magmatikët ultrabazikë;
 - c) rreshpet paleozoike;
 - d) magmatikët acidë.
- Fusha më e madhe dhe më e rëndësishme e Rajonit Juglindor është:
 - a) Fushëgropa e Përrenjasit;
 - b) Fushëgropa e Korçës;
 - c) Gropa e Pogradecit;
 - d) Gropa e Kolonjës.
- Drejtimi mbizotërues i relievit të Rajonit Jugor është:

- a) në formë malësie;
- b) veriperëndim-juglindje;
- c) verilindje-jugperëndim;
- d) veri-jug.

2. Përcaktoni në hartë dhe vlerësoni pozitën gjeografike të:

- Rajonit Verilindor;
- Rajonit Juglindor;
- Rajonit Jugor.

3. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Nënrajonit Verilindor		Rajonit Juglindor		Rajonit Jugor	
Njësitë përbërëse	Veçoritë kryesore	Njësitë përbërëse	Veçoritë kryesore	Njësitë përbërëse	Veçoritë kryesore

4. Analizoni:

- a) veçoritë e relievit, të klimës, hidrografisë, tokave dhe të botës së gjallë në:
 - Nënrajonin Verilindor; • Rajonin Juglindor; • Rajonin Jugor;
- b) shpërndarjen gjeografike dhe dinamikën e popullsisë në:
 - Nënrajonin Verilindor; • Rajonin Juglindor; • Rajonin Jugor;
- c) strukturën e popullsisë në:
 - Nënrajonin Verilindor; • Rajonin Juglindor; • Rajonin Jugor;
- d) trashëgiminë natyrore dhe kulturore të:
 - Nënrajonit Verilindor; • Rajonit Juglindor; • Rajonit Jugor;
- e) zhvillimin ekonomik të:
 - Nënrajonit Verilindor; • Rajonit Juglindor; • Rajonit Jugor;

5. Diskutoni mbi shkaqet kryesore të emigrimit të popullsisë së këtyre rajoneve pas vitit '91. Sillni disa shembuj.

6. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Rajoni/nënrajonit	Veçoritë kryesore të popullimit, ekonomisë dhe të trashëgimisë kulturore	Të përbashkëtat	Dallimet

Nënrajonit Verilindor			
Juglindor			
Jugor			

7. Vlerësoni perspektivën e popullimit dhe të ekonomisë së:

- Nënrajonit Verilindor;
- Rajonit Juglindor;
- Rajonit Jugor;

TESTI IV

GRUPI A

1. Përcakto pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor dhe rëndësinë e saj (qarko këtë rajon në hartën përbri).
(2 pikë)

2. Emërto në hartë njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor. dhe analizo veçoritë e gropave dhe fushëgropave.
(6 pikë)

3. Analizo zhvillimin bujqësor të Rajonit Jugor.

(3 pikë)

4. Përcakto shpërndarjen e vendbanimeve rurale në Rajonin Juglindor dhe analizo veçoritë e tyre.
(3 pikë)

5. Analizo zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Jugor.
(6 pikë)



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-4	5-7	8-10	11-12	13-15	16-18	19-20

GRUPI B

1. Përcakto pozitën gjeografike të Rajonit Jugor dhe rëndësinë e saj (qarko këtë rajon në hartën përbri).

(2 pikë)

2. Emërto në hartë njësitë përbërëse të Rajonit Jugor dhe analizo veçoritë e malësive dhe të vargjeve malorë në këtë rajon.

(6 pikë)

3. Analizo zhvillimin bujqësor të Rajonit Juglindor.


(3 pikë)

4. Përcakto shpërndarjen e vendbanimeve urbane në Rajonin Juglindor dhe analizo veçoritë e tyre.

(3 pikë)

5. Analizo zhvillimin e sektorit të tretë të ekonomisë në Rajonin Juglindor.

(6 pikë)



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-4	5-7	8-10	11-12	13-15	16-18	19-20

GRUPI C

1. Përcakto pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor dhe rëndësinë e saj (qarko këtë rajon në hartën përmbri).
(2 pikë)

2. Emërto në hartë njësitë përbërëse të Rajonit Jugor dhe analizo veçoritë e luginave dhe të Fushëgropës së Delvinës.
(6 pikë)

3. Analizo zhvillimin industrial të Rajonit Jugor.
(3 pikë)

4. Përcakto strukturën e popullsisë dhe shpërndarjen gjeografike të saj në Rajonin Juglindor.
(3 pikë)

5. Emërto në hartë njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor dhe analizo veçoritë e vargjeve kryesore malore të këtij rajoni.
(6 pikë)



Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-4	5-7	8-10	11-12	13-15	16-18	19-20

Tema 6.1

► Pabarazia e zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit dhe treguesit e

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika VI: Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale		Tema mësimore: 6.1 Pabarazia e zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit dhe treguesit e saj	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<u>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Shpreh mendimin e vet për pabarazitë që vihet re në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të vendit.Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi veçorit e zhvillimit socio-ekonomik të secilit prej rajoneve gjeografike të Shqipërisë.			
<u>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përdor konceptin e zhvillimit rajonal për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.Identifikon treguesit e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve.			
<u>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.Shpjegon ecurinë e pabarazive në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve midis periudhave të ndryshme.Analizon perspektivën zhvillimore të rajoneve të vendit.			
<u>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.			
<u>5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Ndan mendimet në grup.			
<u>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.			
<u>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)</u>			
<ul style="list-style-type: none">Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi rëndësinë që zhvillimi i barabartë midis rajoneve për ekonominë e vendit.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës			
<u>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</u>			
Nxënësi shpjegon treguesit e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve.			
<u>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</u>			

<p>Nxënësi sjell shembuj të pabarazive në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të vendit.</p> <p>3. Marrja e vendimeve</p> <p>Nxënësi përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja shpjegon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ecurinë që kanë në periudha të ndryshme, pabarazitë në zhvillimin socio-ekonomik midis rajoneve; • treguesit e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve; • perspektivën zhvillimore të rajoneve të vendit. 	<p>Fjalët kyçe: pabarazi në zhvillimin socio-ekonomik, perspektivë zhvillimore e rajoneve.</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit njohin konceptet:</p> <p>a. rajon, veçoritë e rajoneve, pabarazi</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit</p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 6.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 6.1 në tekst - Diskutojmë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> • veçorive të zhvillimit socio-ekonomik të secilit prej rajoneve gjeografike të Shqipërisë; • pabarazisë që vihet re në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të vendit. <p>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë treguesit e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve: Në periudha të ndryshme të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit, pavarësisht përpjekjeve për të pasur rajone me zhvillim ekonomik, sociale mjedisor të balancuar, konkurrues dhe të qëndrueshëm, diferencat midis rajoneve kanë qenë gjithmonë të pranishme. Kështu, krahasuar me rajonet e tjera të vendit, Rajoni Perëndimor ka njohur vazhdimisht një zhvillim më të madh ekonomik,</p>

	<p>duke tërhequr në mënyrë të vazhdueshme fuqi punëtore të kualifikuar nga këto rajone. Disa nga treguesit e pabarazisë së zhvillimit rajonal janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • prodhimi i brendshëm bruto për frymë (GDP për frymë); • sasia e prodhimit industrial dhe bujqësor; • rendimenti dhe teknologjia; • investimet (mundësitë dhe shkalla e përthithjes së tyre); • niveli i varfërisë, papunësisë, arsimimit, shërbimeve shëndetësore (si faktorë socialë); <p>Mësuesja fton nxënësit të përshkruajnë figurën 1.</p> <p><i>Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</i></p> <p>Më pas vazhdon të trajtojë së bashku me nxënësit një historik i shkurtër rreth pabarazisë së zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve. Deri në vitin 1945, Shqipëria ishte një vend agrar i prapambetur, me bujqësi ekstensive, me një zhvillim të ulët artizanal dhe industrial. Gjatë viteve 1945-1990, nëpërmjet planifikimit ekonomik dhe politikave të ndjekura synojë ndër të tjera zbutja e pabarazisë së zhvillimit midis rajoneve të vendit.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të sjellin modele ilustruese...</p> <p>Më pas mësuesi/ja fton nxënësit që të diskutojnë rreth perspektivave zhvillimore të rajoneve të vendit tonë duke sjelle dhe shembuj ilustrues për secilin rajon...</p> <p>Hapi III : Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

Tema 6.2

► Faktorët dhe pasojat e pabarazisë së zhvillimit të rajoneve

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEODRAFI	SHKALLA: V	KLASA: XI
Nëntematika VI: Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale		Tema mësimore: 6.2 Faktorët dhe pasojat e pabarazisë së zhvillimit të rajoneve	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

- Evidentojnë faktorët që kanë sjellë pabarazi në zhvillimin socio-ekonomik midis rajoneve.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi faktorët që kanë sjellë pabarazi në zhvillimin socio-ekonomik të secilit prej rajoneve gjeografike të Shqipërisë.
- **2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)**
- Përdor konceptin e zhvillimit rajonal për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.
- Identifikon treguesit e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve.
- **3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)**
 - Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.
 - Analizojnë ndikimin e secilit prej këtyre faktorëve në zhvillimin e pabarabartë midis rajoneve. Ilustroni përgjigjen me shembuj nga vendbanimi juaj.
 - Evidentojnë pasojat e pabarazisë së zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.

5. Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

- Ndan mendimet në grup.

6. Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së debatit në grupin shoqëror.

7. Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi rëndësinë që zhvillimi i barabartë midis rajoneve për ekonominë e vendit.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi shpjegon faktorët e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi sjell shembuj të pabarazive në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të vendit.

3. Marrja e vendimeve

Nxënësi përdor konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.

<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja shpjegon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Evidentojnë pasojat e pabarazisë së zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit; Analizojnë ndikimin e secilit prej këtyre faktorëve në zhvillimin e pabarabartë midis rajoneve; Evidentojnë faktorët që kanë sjellë pabarazi në zhvillimin socio-ekonomik midis rajoneve. 	<p>Fjalët kyçe: pabarazi në zhvillimin socio-ekonomik, pasojat e pabarazisë së zhvillimit socio-ekonomik,</p>
<p>Burimet: Teksti, foto, harta, internet, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, qytetaria, historia, TIK</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	<p>Nxënësit njohin konceptet: a. rajon, veçoritë e rajoneve, pabarazi zhvillimore midis rajoneve, pasojat e pabarazisë socio-ekonomike</p>
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja</p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 6.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 6.2 në tekst - Diskutojmë rreth: - Faktorët që kanë ndikuar në pabarazinë e zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve gjeografike të Shqipërisë.</p> <p>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë faktorët e zhvillimit të pabarabartë të rajoneve: Faktorët që kanë ndikuar në pabarazinë e zhvillimit të rajoneve: Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të një rajoni ka efikasiteti ekonomik dhe social që duhet të sigurojë organizimi territorial i tij. Zhvillimi rajonal në Shqipëri, ashtu si në çdo vend tjetër, ka pasur specifika të veta, që lidhen me madhësinë dhe pozitën gjeografike, e veçoritë natyrore, si dhe me natyrën e zhvillimit ekonomik e social të rajoneve. Në përgjithësi, zhvillimi i pabarabartë i rajoneve të vendit ka qenë rezultat i ndikimit të faktorëve kryesorë, ndër të cilët përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> faktorin natyror; faktorin socio-ekonomik; faktorin demografik.

	<p>Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë figurën 1, 2 dhe 3. Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p>Më pas vazhdon të trajtojë së bashku me nxënësit pasojat e pabarazisë së zhvillimit të rajoneve: Bujqësia, energjia, turizmi, industria nxjerrëse e mineraleve etj., janë disa prej potencialeve me peshë të Shqipërisë për zhvillimet e ardhshme rajonale dhe evropiane. Megjithatë, pabarazia që ekziston në zhvillimin e rajoneve të vendit përbën një ndër pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të tij. Kjo pa barazi shoqërohet me një sërë pasojash ekonomike, demografike, sociale dhe mjedisore. Pasojat ekonomike reflektohen sidomos në diferencat që vihen re midis rajoneve në të ardhurat për frymë dhe në buxhetin e miratuar për njësitë administrative vendore të secilit prej tyre. Pasojat demografike reflektohen në ndryshimet që kanë rajonet midis tyre në dinamikën, shpërndarjen dhe në strukturën e popullsisë, (sidomos në atë sipas grupmoshës dhe në strukturën sipas vendbanimeve). Ndër pasojat sociale dallohen: mbi popullimi, papunësia, varfëria, shanset e pabarabarta në edukim, kujdes shëndetësor dhe në shërbime; braktisja ose dobësimi i traditave dhe i vlerave të trashëgimisë kulturore të rajoneve të ndryshme etj.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të sjellin modele ilustruese...</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet 1, dhe 2 të rubrikës “Radha juaj”. Detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
Vlerësimi i nxënësit	Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

► PROJEKT 2 (ORA E DYTË)

Tema: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimit të rajoneve

Rezultatet e të nxënësit

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- Zbulon dhe analizon tiparet natyrore, demografike, kulturore dhe ekonomike të rajoneve të Shqipërisë: Perëndimor, Verior/Verilindor, Juglindor dhe Jugor;
- Shfrytëzon teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe material të tjera

mbështetëse për realizimin e projektit;

- Përzgjedh informacionin dhe e përpunon atë (ndërton grafikë, diagrame me të dhëna statistikore);
- Evidenton dhe vlerëson trashëgiminë natyrore dhe atë kulturore të rajoneve të Shqipërisë;
- Vlerëson diversitetin natyror, shoqëror dhe kulturor të rajoneve të Shqipërisë;
- Vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (idetë individuale dhe ato në grup);
- Tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- Është krijues/e, prezanton idetë e reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj.

Burimet kryesore të informacionit: Teksti mësimor, kllastera dhe material të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruar nga interneti, pushteti vendor, shtypi; guida të ndryshme turistike, enciklopedi, libra dhe revista me kuriozitete, media dhe dokumentarë të ndryshëm televizivë.

Metodologjia që do të përdoret: Punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit: teksti mësimor, material të printuara (material të hulumtuara dhe të grumbulluara), material të siguruar nga pushteti vendor ose nga shtypi, kompjuter, videoprojektor, fletë-anketa, tabela prezantimi, shënjes, e të palosje, postera, fotografi, skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit:

Shënim: Për udhëzimet mbi realizimin e projektit referojuni rubrikës përkatëse, të paraqitur në orën e parë të tij.

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit

- Nxënësit përshkruajnë punën e bërë deri në këtë fazë të projektit , tashme ai duhet të jetë në trajtën e një raporti paraprak, ndaj këshillohen nga mësuesi/ja t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë projektit në lidhje me origjinalitetin dhe cilësinë, për të pasur një produkt sa më të frytshëm në fazën përfundimtare.
- Evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre.
- Nxënësit përshkruajnë shkallën e përdorimit të burimeve të informacionit, rrugët e sigurimit dhe vlefshmërinë e tyre.
- Raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës të grupeve të tjera, mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme.

► PROJEKT 2 (ORA E TRETË)

Tema: Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë. Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimit të rajoneve

Rezultatet e të nxënit:

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- zbulon dhe analizon tiparet natyrore, demografike, kulturore dhe ekonomike të rajoneve të Shqipërisë: Perëndimor, Verior/Verilindor, Juglindor dhe Jugor;
- shfrytëzon teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe material të tjera mbështetëse për realizimin e projektit;

- përzgjedh informacionin dhe e përpunon atë (ndërton grafikë, diagrame me të dhëna statistikore);
- evidenton dhe vlerëson trashëgiminë natyrore e kulturore të rajoneve të Shqipërisë;
- vlerëson diversitetin natyror, shoqëror dhe kulturor të rajoneve të Shqipërisë;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (idetë individuale dhe ato në grup);
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- është krijues, prezanton idetë e reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.

Burimet kryesore të informacionit: teksti mësimor, kllastera dhe material të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruar nga interneti, pushteti vendor, shtypi; guida të ndryshme turistike, enciklopedi, libra dhe revista me kuriozitete, media dhe dokumentarë të ndryshëm televizivë.

Metodologjia që do të përdoret: punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit: teksti mësimor, material të printuara (material të hulumtuara dhe të grumbulluara), materiale të siguruar nga pushteti vendor ose nga shtypi, kompjuter, videoprojektor, fletë-anketa, tabelë prezantimi, shënjes, fletëpalosje, postera, fotografi, skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit:

Shënim: Për udhëzimet mbi realizimin e projektit referojuni rubrikës përkatëse, të paraqitur në orën e parë të tij.

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit

- Paraqitja e punës së secilit grup, që mund të bëhet në mënyrë elektronike (me Power Point apo me forma të tjera) ose me anë të posterave, skemave, tabakëve etj., sipas vendim marrjes së grupit.

- Dorëzimi i produktit të printuar.
- Diskutimi në klasë mbi përfundimet e arritura.
- Vlerësimi i nxënësve.
- Shpërndarja në klasë (më pas edhe të bashkëmoshatarët e tjerë) e posterave/ e të palosjeve të përgatitura.

► Modele testesh të tremujorëve

TESTI 1

Tremujori I

GRUPI A KLASA _____
EMRI _____ MBIEMRI _____

1. Plotëso mendimin:

- a. Strukturat e Albanideve u krijuan gjate _____ etapave kryesore:
gjatë etapës _____ dhe gjatë etapës _____ (1 pikë)
b. Gjatë etapës _____ u krijuan: _____ (1 pikë)
c. Gjatë etapës _____ u krijuan: _____ (1 pikë)
d. Për nga mosha shkëmbinjtë ndahen në: 1. _____ që gjenden në

_____ dhe përbëhen nga _____ (1 pikë)

2. _____ që gjenden në _____ dhe përbëhen
nga _____

_____ (1 pikë)

3. _____ që gjenden në _____ dhe
përbëhen nga _____

_____ (1 pikë)

2. Plotëso dhe argumento përgjigjen:

Pozita gjeografike e trevave shqiptare ka rëndësi:

- a. _____ sepse _____
b. _____ sepse _____
c. _____ sepse _____ (3 pikë)

3. Evidento cilat janë tipat e relievit të trevave shqiptare?

Çfarë veçori ka secili prej tyre? _____

_____ (3 pikë)

4. Analizo dukuritë negative të klimës: _____

_____ (3 pikë)

5. Analizo faktorët që ndikojnë në hidrografinë e pasur të trevave Shqiptare

_____ (3 pikë)

6. Krahajo midis tyre liqenet tektonikë të trevave shqiptare dhe evidentat të përbashkëta e dallimet midis tyre, shoqëruar me argumentin përkatës: _____

____ (5 pikë)

Notat	5	6	7	8	9	10
Pikët	6-8	9-11	12-14	15-17	18-20	21-23

► TESTI 1

Tremujori I

GRUPI B KLASA _____

EMRI _____ MBIEMRI _____

1. Plotëso mendimin:

a. Gjeografikisht, trevat shqiptare ndodhen në: _____

(1 pikë)

b. Trualli shqiptar i përket teknogjenezës _____ dhe
përbëhet nga struktura gjeologjike që quhen _____
(1 pikë)

c. Tokat e kafenjta shtrihen _____ dhe karakterizohen
nga _____
(1 pikë)

d. Pozita gjeologjike e trevave ndikon në: _____
_____ (1 pikë)

e. Klima është faktor që ndikon në toka, sep
se _____
(1 pikë)

2. Analizo faktorët që ndikojnë në formimin e klimës së Shqipërisë:

_____ (4 pikë)

3. Përcakto: Pse trevat shqiptare dallohen për larminë e peizazheve natyrore? Renditni
faktorët që ndikojnë: _____
(3 pikë)

4. Argumento mendimin: Masat ajrore janë faktorë të rëndësishëm klimëformues sepse:

_____ (3 pikë)

5. Plotëso dhe analizo veçoritë:

Relievi i ulët shtrihet në lartësinë: _____ dhe
karakterizohet: _____

2. Relievi i mesëm shtrihet në lartësinë: _____ dhe
karakterizohet: _____

3. Relievi i lartë shtrihet në lartësinë: _____ dhe karakterizohet:

_____ (3 pikë)

6. Krahazo midis tyre detet që lagin trevat shqiptare dhe evidentto të përbashkëtat dhe dallimet.

_____ (5 pikë)

Notat	5	6	7	8	9	10
Pikët	6-8	9-11	12-14	15-17	18-20	21-23

► TESTI 2

Tremujori II

GRUPI A **KLASA** _____

EMRI _____ **MBIEMRI** _____

1. Plotëso mendimin:

a. Shqiptarët janë ndër popujt më të vjetër të _____ pasardhësit e fiseve _____

b. Në mesjetë, kur vendi quhej _____ dhe banorët quheshin _____

c. Njësia më e madhe (e lartë) administrative në Shqipëri është: _____

d. Vendbanimet shqiptare të periudhave të ndryshme, ndryshojnë midis tyre për nga: _____

e. Llojet e vendbanimeve përcaktohen mbi bazën e kritereve: _____ dhe sipas tyre ndahen në: _____

f. Sipas zonave gjeografike, dallojnë për dendësi të madhe popullimi: _____ (6 pikë)

2. Analizo faktorët që ndikojnë mbi zhvillimin e sektorit të parë të ekonomisë (ilustro me shembuj) _____

_____ (5 pikë)

3. Përcakto veçoritë e migrimit të popullsisë në Republikën e Shqipërisë:

a. Migrimi i brendshëm: _____

b. Migrimi i jashtëm: _____ (2 pikë)

4. Cilët faktorë kanë ndikuar në shtrirjen gjeografike dhe numrin e popullsisë në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhave të ndryshme historike: _____

_____ (3 pikë)

5. Argumento se si ka ndikuar ndërtimtaria në zhvillimin ekonomik të Republikës së Shqipërisë gjatë viteve të fundit: _____

(3 pikë)

6. Analizo: Degët kryesore të industrisë dhe shpërndarjen gjeografike të tyre: _____

(4 pikë)

Notat	5	6	7	8	9	10
Pikët	6-8	9-11	12-14	15-17	18-20	21-23

► TESTI 2

Tremujori II

GRUPI B KLASA _____
EMRI _____ MBIEMRI _____

1. Plotëso mendimin:

- a. Arkitektura dhe stili i ndërtesave në qytetet tona pasqyron : _____

- b. Shtimi natyror i popullsisë (në 0/00) në Republikën e Shqipërisë, ndryshon. Ajo paraqitet: _____

- c. Të dhënat më të hershme rreth numrit të popullsisë shqiptare i përkasin periudhës së pushtimit _____

- d. Llojet e vendbanimeve përcaktohen mbi bazën e kriterëve: _____ dhe sipas tyre ndahen në: _____

- e. Peshkimi dhe bletaria në Republikën e Shqipërisë, janë të zhvilluara sepse: _____ (5 pikë)

2. Analizo a. shpërndarjen gjeografike të popullsisë në hapësirën shqiptare:

- b. strukturën e popullsisë shqiptare sipas:
moshës _____
gjinisë _____
përbërjes kombëtare _____
besimit fetar _____
_____ (5 pikë)

3. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në migrimin e brendshëm dhe të jashtëm të popullsisë shqiptare? _____
_____ (3 pikë)

4. Vlerëso a. burimet natyrore që janë në favor të zhvillimit ekonomik të Republikës së Shqipërisë: _____

b. rolin e faktorëve historiko-shoqëror në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë:

(4 pikë)

5. Analizo sektorin e tretë të ekonomisë të Republikës së Shqipërisë sipas degëve, duke përcaktuar edhe zonat ku këto degë janë më të zhvilluara: _____

(6 pikë)

Notat	5	6	7	8	9	10
Pikët	6-8	9-11	12-14	15-17	18-20	21-23

► TESTI 3

Tremujori III

GRUPI A KLASA _____
EMRI _____ MBIEMRI _____

1. Emërto në hartë njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor dhe analizo veçoritë e secilit prej tyre. _____

(4 pikë)

2. Qarko alternativën e duhur:

• Lumenjtë Drini dhe Buna përshkojnë:

- a) Pllajën e Dumre-Darsisë;
- b) Fushën e Elbasanit;
- c) Ultësira e Nënshkodrës;
- d) Ultësirën e Mbishkodrës.

(1 pikë)

• Grumbulli kodrinor më i madh i rajonit janë:

- a) Kodrat e Sulovës;
- b) Kodrat e Mallakastrës;
- c) Kodrat e Kërrabës;
- d) Pllaja e Dumre-Darsisë.

(1 pikë)

• Në antikitet, Rajoni Perëndimor është banuar kryesisht nga fisi ilir:

- a) i albanëve dhe i taulantëve;
- b) i kaonëve dhe molosëve;
- c) i labeatëve;
- d) i enkelejve.

(1 pikë)



3. Krahaso pozitën gjeografike të Rajonit Perëndimor me atë të Alpeve Shqiptare:

(3 pikë)

4. a. Përcakto natyrën e popullimit të Rajonit Perëndimor: _____

(2 pikë)

b. Natyrën e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor: _____

(2 pikë)

5. Analizo kushtet natyrore, veçoritë e popullimit dhe natyrën e ekonomisë të: Bllokut të Jezercës, Malësisë së Madhe dhe Luginës së Valbonës: _____

(5 pikë)

Notat	5	6	7	8	9	10
Pikët	5-8	9-11	12-13	14-15	16-17	18-19

► TESTI 3

Tremujori III

GRUPI B KLASA _____
EMRI _____ MBIEMRI _____

1. Emërto njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare dhe analizo veçoritë e secilit prej tyre. _____

_____ (5 pikë)

2. Qarko alternativën e duhur:

• Formacionet kryesore gjeologjike që ndërtojnë Alpet Shqiptare janë:

- a) gëlqerorë të mesozoit;
- b) gëlqerorë të paleozoit;
- c) flishet e kenozoit;
- d) magmatikët e mesozoit.

(1 pikë)

• Përbëhet kryesisht nga formacionet magmatike:

- a) Malësia e Gashit;
- b) Malësia e Madhe;
- c) Blloku i Jezercës;
- d) Lugina e Valbonës.

(1 pikë)

• Forma kupolë dhe ngritja e Bllokut të Jezercës lidhet me:

- a) veprimin e borës dhe të akujve;
- b) ngritjet e fuqishme tektonike të pliocen-kuaternarit;
- c) fundosjet tektonike të Malësisë së Madhe;
- d) veprimin e karstit.

(1 pikë)

3. Krahajo zhvillimin ekonomik të Alpeve Shqiptare me atë të Rajonit Perëndimor:



(3 pikë)

4. a. Përcakto natyrën e popullimit të Alpeve Shqiptare: _____

(2 pikë)

b. Trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Alpeve Shqiptare: _____

(2 pikë)

5. Analizoni mbi shkaqet kryesore të migrimit të popullsisë drejt Rajonit Perëndimor, pas vitit '91. Ilustroni me shembuj: _____

(4 pikë)

Notat	5	6	7	8	9	10
Pikët	5-8	9-11	12-13	14-15	16-17	18-19